LIGJ
Nr. 112/2024

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË VITIT 2023

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 158 të Kushtetutës dhe nenit 63, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Miratimi i raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit

Miratohet raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit për vitin 2023 sipas dokumenteve të mëposhtme, që i bashkëlidhen këtij ligji dhe janë pjesë përbërëse të tij:

a) pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit për vitin 2023;

b) raporti për zbatimin e buxhetit vjetor 2023 në nivelin e fondeve të miratuara dhe objektivat e realizuar;

c) raporti për borxhin publik dhe përbërjen e tij për vitin 2023;

ç) raporti për përdorimin e fondit rezervë dhe të kontingjencës për vitin 2023;

d) raporti për situatën e kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme gjatë vitit 2023.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 7.11.2024.

Shpallur me dekretin nr. 392, datë 19.11.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

RAPORT

MBI
ZBATIMIN E BUXHETIT VJETOR,
SITUATËN MAKROEKONOMIKE DHE FISKALE
GJATË VITIT 2023

Tiranë, Maj 2024

P Ë R M B A J T J A

1. REZULTATI I BUXHETIT TË KONSOLIDUAR

2. PASQYRË E ZHVILLIMEVE MAKROEKONOMIKE .

2.1 Zhvillimet e fundit ekonomike .

2.1.1 Sektori real
2.1.2 Sektori monetar
2.1.3 Sektori i jashtëm

2.2 Krahasimi me vendet e rajonit

3. POLITIKAT FISKALE DHE REZULTATI I MBLEDHJES SË TË ARDHURAVE

3.1 Politika fiskale në vitin 2023 dhe efektet në buxhet e në ekonomi .

3.1.1 Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
3.1.2 Tatimi mbi të Ardhurat
3.1.3 Akciza

3.2 Të ardhurat e përgjithshme.

3.2.1 Të ardhurat nga ndihmat
3.2.2 Të ardhurat tatimore
3.2.3 Të ardhurat nga pushteti vendor
3.2.4 Të ardhurat nga fondet speciale
3.2.5 Të ardhurat jotatimore
3.2.6 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat

3.3 Të ardhurat sipas taksave, tatimeve dhe burimeve të tjera

3.3.1 Taksimi Indirekt
3.3.2 Taksimi direkt

4. SHPENZIMET E PËRGJITHSHME

4.1 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike .
4.2 Shpenzimet sipas natyrës funksionale
4.3 Ndryshimet në ligjin e buxhetit 2023
4.4 Rezervat dhe Kontigjencat
4.5 Programi i Rindërtimit

5. BUXHETI VENDOR

5.1 Të ardhurat e njësive të vetëqeverisjes vendore
5.2 Shpenzimet e njësive të vetëqeverisjes vendore.

6. MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK

7. RISQET FISKALE DHE DETYRIMET KONTIGJENTE

7.1 Ndërmarrjet shtetërore .

7.1.1 Ndërmarrjet e Sektorit Energjetik.

7.1.2 Ndërmarrjet e Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve

7.2 Detyrimet e prapambetura të Qeverisjes së Përgjithshme .

7.2.1 Detyrimet e prapambetura për njësitë e Qeverisjes Qendrore

7.2.2 Detyrimet e prapambetura për njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV)

7.3 Koncesionet/PPP-të .

7.4 Detyrime të tjera Kontigjente:

7.4.1 Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ).

7.4.2 Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit

8. SHTOJCAT

8.1 Shtojca 1 - Zbatimi dhe monitorimi i parimeve dhe rregullave fiskale

8.2 Shtojca 2 – Efektet e paketës fiskale 2023

8.3 Shtojca 3 – Treguesit kryesorë të performancës sipas ministrive të linjës

8.3.1 Shëndetësia dhe Mbrojtja Sociale

8.3.2 Arsimi

8.3.3 Bujqësia dhe Zhvillimi Rural

8.3.4 Infrastruktura dhe Energjia

8.3.5 Turizmi dhe Mjedisi

8.3.6 Drejtësia

8.3.7 Institucionet e Sistemit të Drejtësisë

8.3.8 Financat, Ekonomia, Punësimi dhe Arsimi Profesional

8.3.9 Mbrojtja

8.3.10 Kultura

8.3.11 Rendi dhe Siguria Publike

8.3.12 Politika e Jashtme

TABELA DHE GRAFIKË

Tabela 1 Produkti i Brendshëm Bruto
Tabela 2 Norma e papunësisë .
Tabela 3 Bilanci tregtar
Tabela 4 Norma e inflacionit.
Tabela 5 Bilanci fiskal
Tabela 6 Borxhi publik
Tabela 7 Treguesit e të ardhurave kryesore (në miliardë LEK).
Tabela 8 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat (në milionë LEK)
Tabela 9 Performanca e të ardhurave nga akciza: mallrat kryesorë 2021 - 2020
Tabela 10 Shpenzimet sipas funksionit (në milionë LEK) .
Tabela 11 Të ardhurat dhe shpenzimet e pushtetit vendor, sipas natyrës .
Tabela 12 Matrica e riskut .
Tabela 13 Të dhënat mbi impaktin e sektorit të energjisë në financat publike sipas periudhave përkatëse (në milion LEK)
Tabela 14 Detyrimet e ndërsjella midis ndërmarjeve të sektorit energjitik, ML/IB,MF dhe DPT 7
Tabela 15 Të dhënat financiare për Sektorin Energjitik (në mijë LEK) .
Tabela 16 Të dhënat financiare 12 mujore për OSHEE Group Sh.a (në mijë LEK)
Tabela 17 Të dhënat financiare 12 mujore për KESH sh.a (në mijë LEK)
Tabela 18 Të dhënat financiare 12 mujore për OST Sh.a (në mijë LEK)
Tabela 19 Stoku i detyrimeve të prapambetura e Sektorit Ujësjellës-Kanalizime ndaj OSHEE Group Sh.a (në mld LEK) .
Tabela 20 Detyrimet e prapambetura në nivel vendor sipas kategorive .
Tabela 21 Koncesionet/PPP-të aktive me mbështetje nga buxheti i shtetit (në mijë LEK)
Tabela 22 Detyrimet faktike dhe kontigjente nga vendimet e GJEDNJ (në EUR) .
Tabela 23 Detyrime për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar (në EUR) .
Tabela 24 Treguesit kryesorë të performancës 2023, sipas ministrive të linjës
Tabela 25 Realizimi i buxhetit 2023 në disa institucione kryesore qendrore (në 000/LEK).
Tabela 26 Realizimi i buxhetit 2023 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (në mijë LEK).
Tabela 27 Realizimi i buxhetit 2023 për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (në mijë LEK)
Tabela 28 Realizimi i buxhetit 2023 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (në mijë LEK) .
Tabela 29 Realizimi i buxhetit 2023 për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (në mijë LEK)
Tabela 30 Realizimi i buxhetit 2023 për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit
Tabela 31 Realizimi i buxhetit 2023 për Ministrinë e Drejtësisë
Tabela 32 Realizimi i buxhetit 2023 për Institucionet e Drejtësisë .
Tabela 33 Realizimi i buxhetit 2023 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
Tabela 34 Realizimi i buxhetit 2023 për Ministrinë e Mbrojtjes
Tabela 35 Realizimi i buxhetit 2023 për Ministrinë e Kulturës
Tabela 36 Realizimi i buxhetit 2023 për Ministrinë e Brendshme..
Tabela 37 Realizimi i buxhetit 2023 për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme .

Grafiku 1 Shpenzimet e përgjithshme publike ndaj PBB-së (në miliardë LEK) .
Grafiku 2 Të Ardhurat e përgjithshme (në miliardë LEK) ndaj PBB
Grafiku 3 Ecuria e zërave kryesorë të të ardhurave..
Grafiku 4 Të ardhurat e përgjithshme (në miliardë LEK), sipas kategorive kryesore.
Grafiku 5 Të ardhura nga pushteti vendor në vite (në miliardë LEK) .
Grafiku 6 Përbërja e të ardhurave nga pushteti vendor sipas zërave kryesorë (në %).
Grafiku 7 Të ardhurat nga fondet speciale në vite (në miliardë LEK).
Grafiku 8 Përbërja e të ardhurave nga fondet speciale (në %)
Grafiku 9 Përbërja e të ardhurave jotatimore (miliardë LEK)
Grafiku 10 Të ardhura nga tatimet dhe doganat në vite (në miliardë LEK) dhe në % të PBB
Grafiku 11 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat sipas llojit .
Grafiku 12 Të ardhurat doganore, rritja vjetore sipas llojit të taksave 2022 - 2021 (në milionë LEK)
Grafiku 13 Të ardhurat tatimore, rritja vjetore sipas llojit të taksave (në milionë LEK) .
Grafiku 14 Të ardhurat tatimore, sipas sektorëve (në %)
Grafiku 15 TVSH brenda vendit, sipas sektorëve (në %)
Grafiku 16 Rimbursimi i TVSH-së në vite (në milionë LEK)
Grafiku 17 Akciza në vite (miliard LEK)
Grafiku 18 TAP sipas zërave (në % ndaj totalit të arkëtuar të vitit 2023)
Grafiku 19 TAP në vite në % ndaj të ardhurave totale .
Grafiku 20 Tatimi mbi fitimin në vite (në miliard LEK)
Grafiku 21 Tatimi mbi fitimin sipas sektorëvë (në %)
Grafiku 22 Kontribuesit aktivë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, sipas llojit të biznesit
Grafiku 23 Kontribuesit aktivë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, sipas sektorit (në %)

Grafiku 24 Shpenzimet e përgjithshme korrente dhe kapitale (mld LEK) dhe ritmi i rritjes vjetore (në %).
Grafiku 25 Shpenzimet korrente dhe kapitale plan dhe fakt ndaj totalit të shpenzimeve (mln LEK)
Grafiku 26 Struktura e shpenzimeve korente, kapitale dhe raporti me PBB-në ndër vite
Grafiku 27 Shpenzimet korente dhe ritmi i rritjes së tyre (milion LEK).
Grafiku 28 Struktura e shpenzimeve korrente (milion LEK).
Grafiku 29 Shpenzimet e personelit në vite dhe ritmi i rritjes (miliardë LEK)
Grafiku 30 Shpenzimet për interesa në vite dhe ritmi i rritjes (miliardë LEK).
Grafiku 31 Shpenzimet operative e të mirëmbajtjes dhe ritmi i rritjes vjetore (miliardë LEK)
Grafiku 32 Shpenzimet per subvencione dhe ritmi i rritjes (miliardë LEK).
Grafiku 33 Shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (miliardë LEK).
Grafiku 34 Shpenzimet per ndihmën ekonomike, PAK dhe papunësinë (miliardë LEK)
Grafiku 35 Shpenzimet Kapitale dhe burimi i financimit të tyre (në miliardë LEK)
Grafiku 36 Transferta e pakushtëzuar dhe ritmi i ndryshimit në vite .
Grafiku 37 Realizimi i të ardhurave tatimore dhe jotatimore (në milion LEK)
Grafiku 38 Të ardhurat e pushtetit vendor në vite dhe ritmi i ndryshimit.
Grafiku 39 Të ardhurat vendore në raport me totalin e të ardhurave publike dhe PBB
Grafiku 40 Të ardhurat e veta të pushtetit vendor sipas burimit në vite..
Grafiku 41 Shpenzimet e buxhetit vendor ndaj PBB, në vite .
Grafiku 42 Shpenzimet e pushtetit vendor në vite dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK) ..
Grafiku 43 Shpenzimet e pushtetit vendor sipas klasifikimit ekonomik (në milionë LEK)
Grafiku 44 Sektori quasi publik sipas numrit të ndërmarrjeve.
Grafiku 45 Ecuria e nivelit të arkëtimeve të OSHEE Group sh.a (në miliardë LEK).
Grafiku 46 Ecuria e nivelit të humbjeve në rrjet për OSHEE Group sh.a (në %).
Grafiku 47 Stoku i detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme, në mln LEK
Grafiku 48 Stoku i detyrimeve të Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës dhe ministrive të tjera…
Grafiku 49 Stoku i detyrimeve të prapambetura qendrore sipas zërave kryesorë
Grafiku 50 Stoku i detyrimeve të prapambetura vendore sipas zërave kryesorë

1. REZULTATI I BUXHETIT TË KONSOLIDUAR

Ekonomia e vendit, deri më tani, ka treguar një rezistencë mjaft të mirë ndaj goditjeve të njëpasnjëshme që kanë impaktuar vendin tonë përgjatë viteve të fundit. Aktiviteti ekonomik ka vijuar me një rritje pozitive dhe relativisht të lartë të veprimtarisë ekonomike, të punësimit dhe pagave, pavarësisht përballë një ambienti sfidues ekonomik, të karakterizuar nga pasiguri dhe kushte më të shtrënguara financimi. Deri më tani fondamentet kryesore ekonomike dhe financiare, si dhe stabiliteti i përgjithshëm makroekonomik i vendit ka rezistuar relativisht mjaft mirë dhe pritet që ekonomia të vazhdojë ecurinë pozitive në periudhën afatmesme.

Gjatë vitit 2023, PBB u zgjerua me rreth 3.4%, përtej pritjeve fillestare. Sipas vlerësimeve të fundit, PBB reale u rrit me 2.8% në terma vjetorë në tremujorin e parë 2023, e ndjekur me 3.2% në tremujorin e dytë dhe një rritje më e fortë prej 3.5% dhe 3.8% në tremujorin e tretë dhe të katërt, krahasuar me tremujorët përkatës të vitit 2022. Rritja e deritanishme është gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi ashtu edhe investimet, me rritje respektivisht prej 3.8% dhe 6.4% krahasuar me vitin 2022. Eksportet totale u rritën në terma real me rreth 10.1% në vitin 2023 dhe kjo rritje pozitive erdhi tërësisht nga eksportet e shërbimeve të cilat u zgjeruan me 20.9% në terma vjetor. Ndërkohë, eksportet e mallrave ranë me rreth 16.6% (në terma real dhe referuar statistikave të Instat), duke reflektuar kryesisht efektin bazë të rritjes së disa kategorive të eksporteve (nafta, mineralet dhe energjia eLEKtrike) në vitin e kaluar, për shkak të goditjes globale të ofertës. Importet totale, gjithashtu, u rritën me rreth 1.33% në 2023 dhe për rrjedhojë, kërkesa e huaj neto pati një kontribut pozitiv në rritjen ekonomike në vitin 2023, në pasqyrim të një sezoni turistik mjaft pozitiv.

Tregu i punës ka vazhduar të përmirësohet gjatë vitit 2023. Punësimi është rritur mesatarisht me 1.6% në vit, mbështetur kryesisht nga punësimi më i lartë në sektorin e shërbimeve. Nga pikëpamja e ofertës, rritja e punësimit mund t'i atribuohet kryesisht rritjes së qëndrueshme të normave të pjesëmarrjes së fuqisë punëtore dhe normës së punësimit, duke arritur përkatësisht 75.1% në tremujorin e katërt (krahasuar me 74.8% në T4-2022) dhe 66.7% (krahasuar në 66.5 për qind në T4-2022). Evidencat tregojnë se ka një interes të përgjithshëm në rritje për të hyrë në fuqinë punëtore, ndoshta nxitur nga trendi rritës i pagave, duke nënvizuar kështu tendencat pozitive në ofertën e punës. Në të njëjtën kohë, shkalla e papunësisë vazhdoi trendin rënës të viteve të fundit dhe është ulur deri në 10.7% në tremujorin e katërt të 2023, nga 11.0% në fund të vitit të kaluar (për moshën 15 vjeç e lart). Kjo paraqet shifrën më të ulët të papunësisë të regjistruar ndonjëherë.

Përgjatë vitit 2023, bilanci i përgjithshëm i pagesave ka vazhduar të përmirësohet ndjeshëm duke rezultuar në rritje të mjeteve të rezervës valutore me rreth 937 milionë EUR. Defiçiti i llogarisë korrente po ashtu u përmirësua në mënyrë thelbësore, duke arritur nivelin më të ulët të shënuar ndonjëherë në më pak se 1% e PBB, duke reflektuar zhvillimet e këtij viti që përfshijnë të hyra më të larta nga turizmi dhe nga remitancat. Më konkretisht, defiçiti u ngushtua në vlerën prej 190.5 milionë EUR, duke shënuar një përmirësim prej rreth 82.1% krahasuar me vitin 2022. Ky përmirësim u ndikua kryesisht nga rritja e eksporteve të shërbimeve (38.4%), e nxitur nga rritja e flukseve hyrëse të turizmit (rritur rreth 47% në terma vjetor). Përsa i përket të dhënave të tregtisë së jashtme, për vitin 2023 eksportet e mallrave arritën vlerën 440 miliardë LEK duke rënë ndjeshëm me 9.5%, ndërsa importet e mallrave arritën vlerën 872.6 miliardë LEK duke u ulur me 8.2%, krahasuar me 2022. Defiçiti tregtar arriti vlerën 432.3 miliardë LEK, duke rënë me 6.7%, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2022. Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 59% të gjithë tregtisë. Në periudhën janar-dhjetor 2023, eksportet drejt vendeve të BE zunë 71.8% të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE zunë 50.9% të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (29.2%), Turqia (6.8%), dhe Greqia (6.5%).

Të ardhurat totale të buxhetit të konsoliduar për vitin 2023 ishin 643.7 miliardë LEK (27.8% e PBB) ose rreth 12.4% më shumë se 2022. Në terma nominal, shpenzimet e përgjithshme publike gjatë 2023 ishin 674.8 miliardë LEK (29.2% e

PBB) ose rreth 3.7% më shumë se 2022. Defiçiti fiskal arriti në 1.3% të PBB, nga një mesatare prej afro 5.0% në tre vitet e mëparshme, ndërsa borxhi publik arriti nivelin prej 58.9% të PBB, në rënie me pothuaj 5.6pp nga 2022.

Grafiku 1 Shpenzimet e përgjithshme publike ndaj PBB-së (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Gjatë vitit 2023, huamarrja në terma bruto u realizua në vlerën 466.0 miliardë LEK, nga të cilat 80.3% (ose 374.1 miliardë LEK) u financuan nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 19.7% (ose 91.9 miliardë LEK) nëpërmjet burimeve të huaja. Financimi i defiçitit u realizua kryesisht nëpërmjet burimeve të jashtme, në nivelin prej 1.7% ndaj PBB. Borxhi publik neto për vitin 2023 ishte 1,304.1 miliardë LEK ose 56.7% e PBB, në rënie nga 63.8% e PBB për vitin 2022. Stoku bruto i borxhit, që përfshin edhe likuiditetin për financimin e borxhit ndaj PBB, arriti nivelin 58.9% e PBB me një rënie me pothuaj 5.6pp nga viti 2022, duke rezultuar kësisoj më i ulët se sa pritshmëritë fillestare.

2. PASQYRË E ZHVILLIMEVE MAKROEKONOMIKE

2.1 Zhvillimet e fundit ekonomike

2.1.1 Sektori real

Ekonomia për vitin 2023 shënoi rritje vjetore në nivelin 3.44%. Kjo rritje ishte e shpërndarë në të gjithë sektorët e ekonomisë, ku ndikimin kryesor e ka pasur sektori i ndërtimit me rritje prej 9.7% dhe kontribut prej 1.04pp, ndjekur nga një rritje e fortë e "*Aktiviteteve të pasurive të paluajtshme*" prej 11.3% dhe kontribut të lartë pozitiv në rritje me 0.74pp, si dhe "*Administrimi publik, arsimi* dhe *shëndetësia*" me rritje prej 6.73% dhe kontribut prej 0.73pp. Ndërkohë që, sipas metodës së shpenzimeve, kontributet në rritje kanë ardhur si nga kërkesa e brendshme ashtu edhe ajo e huaj. Kontributet kryesore në rritje nga kërkesa e brendshme kanë ardhur nga konsumi publik, pasuar nga konsumi privat dhe investimet, përkatësisht me +2.96%, +9.25% dhe +6.4% krahasuar me 2022. Kontributet pozitive nga kërkesa e huaj janë përcaktuar nga ecuria e mirë e eksportit të shërbimeve, në pasqyrim të zgjerimit të aktivitetit të turizmit.

Shifrat faktike 2023 për rritjen nominale të rritjes ekonomike kanë sjellë një rishikim të treguesve kryesorë të borxhit dhe të defiçitit, kur për vitin 2023 treguesi i borxhit shënoi nivelin 58.9% të PBB dhe treguesi i defiçitit shënoi nivelin 1.3%. Ecuria pozitive e aktivitetit ekonomik është mbështetur edhe nga punësimi, ku papunësia për grupmoshën mbi 15 vjeç është ulur në 10.7% në tremujorin e fundit, ndërsa shkalla e punësimit është rritur në 67.2% për popullsinë 15-64 vjeç. Gjithashtu, edhe paga mesatare ka shënuar rritje me 13.7% në krahasim me një vit më parë, duke rezultuar në 75,025 LEK në fund të vitit 2023.

2.1.2 Sektori monetar

Inflacioni ka reflektuar goditjen e fundit të ofertës së jashtme, veçanërisht përgjatë vitit të shkuar për shkak të luftës në Ukrainë, duke u kthyer në një nga çështjet kryesore makroekonomike për ekonominë tonë, ashtu si në shumë vende të tjera të botës. Megjithatë, është me rëndësi dhe në favor të zhvillimeve dhe perspektivës së ekonomisë fakti që inflacioni në vendin tonë ka qenë ndjeshëm më i ulët sesa në vendet e rajonit, si dhe me mesataren e vendeve të Bashkimit Evropian. Norma mesatare e inflacionit për vitin 2023 ishte 4.8%, nga 6.7% që rezultoi një vit më parë. Trendi

rënës i inflacionit gjatë vitit 2023 u diktua nga dobësimi i presioneve të huaja inflacioniste, nga forcimi i monedhës vendase në tregun valutor, si dhe nga impaktit i politikës monetare. Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, ato që ndikuan më tepër në inflacionin e përgjithshëm ishin:

i. *"Ushqime dhe pije joalkolike" me rritje vjetore të çmimit prej +6.7%, duke kontribuar me +2.38pp në inflacionin e përgjithshëm prej +4.0%.*
ii. *"Qera, ujë, lëndë djegëse dhe energji" me rritje vjetore të çmimit prej +2.6%, duke kontribuar me +0.51pp në inflacionin e përgjithshëm prej +4.0%.*
iii. *"Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje", me rritje vjetore +4.6%, duke kontribuar me +0.34pp në inflacionin e përgjithshëm prej +4.0%.*
iv. *"Pije alkoolike dhe duhan" me rritje vjetore të çmimit prej +4.3%, duke kontribuar me +0.21pp në inflacionin e përgjithshëm prej +4.0%.*
v. *"Hotele, kafene dhe restorante" me rritje vjetore të çmimit prej +4.4%, duke kontribuar me +0.20pp në inflacionin e përgjithshëm prej +4.0%.*
vi. *"Mallra dhe shërbime të ndryshme" me rritje vjetore të çmimit prej +3.4%, duke kontribuar me +0.19pp në inflacionin e përgjithshëm prej +4.0%.*

Monedha shqiptare ka vijuar të ketë një kurs këmbimi përgjithësisht të stabilizuar kundrejt valutave kryesore në tregun e këmbimit valutor. Përgjatë vitit 2023, kursi i këmbimit LEK/EUR shënoi mesatarisht nivelin 108.80, ndërsa kursi ndaj dollarit LEK/Dollar arriti në 100.65.

Në vitin 2023, stoku total i kredive bankare pati një rritje me 4.2% krahasuar me vitin 2022. Stoku i kredive në LEK shënoi një rritje prej 14.5%, ndërsa ai në valutë rritje prej 6.8%, krahasuar me muajin dhjetor të vitit të kaluar. Pjesa më e madhe e kontributit në rritjen e stokut total të kredisë gjatë kësaj periudhe ka ardhur prej kredive akorduar bizneseve. Stoku i kredive akorduar bizneseve jo-financiare (private dhe publike) për muajin dhjetor 2023 shënoi një rritje me 0.7%. Kredia vetëm për bizneset *private* jo-financiare u rrit me 2.5%, duke kontribuar negativisht me 1.4pp në ndryshimin e stokut total të kredisë. Ndërsa stoku i kredive akorduar bizneseve *publike* jo-financiare për muajin dhjetor 2023 ka shënuar rënie me 29.3% krahasuar me dhjetor 2022, me kontribut negativ prej -1.0pp. Stoku i kredive akorduar individëve deri në muajin dhjetor 2023, ka shënuar rritje prej 8.8% krahasuar me dhjetor të 2022, duke kontribuar pozitivisht në ndryshimin e stokut total të kredisë me 3.2pp. Në dhjetor 2023 rezulton se rreth 56.8% e totalit të stokut të kredive përbëhet nga kreditë në LEK, ndërsa pjesa tjetër prej 43.2% përbëhet nga kreditë në valutë. Niveli i kredive me probleme ndaj totalit të kredive në fund të muajit dhjetor 2023, arriti në 4.74%.

2.1.3 Sektori i jashtëm

Eksportet e mallrave për 12M 2023 shënuan rënie vjetore prej -9.5% krahasuar me një vit më parë, ndërsa vetëm për dhjetor 2023 shënuan rënie prej -6.6% në krahasim me dhjetor 2022. Në dhjetor 2023, eksportet e mallrave arritën vlerën 37.59 miliardë LEK, duke rënë me 6.6% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u rritur me 14.2% në krahasim me nëntor 2023. Rënia vjetore e eksporteve prej 6.6%, këtë muaj është ndikuar nga grupi: "*Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike*" dhe "*Tekstile dhe këpucë*" me kontribut perkatësisht -10.0pp dhe -4.1pp. Importet e mallrave për periudhën janar-dhjetor 2023 shënuan rënie prej -8.2% krahasuar me një vit më parë, ndërsa vetëm për muajin dhjetor 2023 importet shënuan rënie vjetore prej -23.1% në krahasim me muajin dhjetor 2022. Në dhjetor 2023 importet e mallrave arritën vlerën 72.75 miliardë LEK, duke rënë me 23.1% në krahasim me një vit më parë dhe duke u rritur me 1.57%, në krahasim me nëntor 2023. Rënia vjetore e importeve prej 23.1% këtë muaj, është ndikuar kryesisht nga grupet: "*Makineri dhe pjesë këmbimi*" me kontribut negativ -2.1pp dhe rënie vjetore prej 9.8%, gjithashtu edhe grupi "*Minerale, lëndë djegëse, en.elektrike*" me kontribut negativ 19.7pp dhe rënie vjetore 70.2%.

Për vitin 2023, defiçiti tregtar arriti vlerën 432,37 miliardë LEK, duke u përmirësuar me 6.7% krahasuar me të njëjtën periudhë të 2022. Defiçiti tregtar i dhjetorit 2023 është 35.16 miliardë LEK, duke u përmirësuar me 35.3%, krahasuar me dhjetor 2022 dhe duke u përmirësuar me 9.2%, në krahasim me nëntor 2023. Shkëmbimet tregtare për vitin 2023

me vendet e BE, zënë 57.9% të gjithë tregtisë. Në periudhën janar-dhjetor 2023, eksportet drejt vendeve të BE zënë 71.8% të eksporteve gjithsej, ndërsa importet nga vendet e BE zënë 50.9 % të importeve. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (29.2%), Kina (7.9%), Turqia (6.8%) dhe Greqia (6.5%).

2.2 Krahasimi me vendet e rajonit

Rritja ekonomike në Ballkanin Perëndimor u moderua në vitin 2023. Rritja reale e PBB së rajonit u ngadalësua në 2.5%, nga 3.3% që ishte në vitin 2022, pasi pothuajse të gjitha ekonomitë shënuan një ritëm më të ngadaltë zgjerimi. Megjithatë, në terma vjetor, rritja mesatare e prodhimit u rrit në gjysmën e dytë të vitit e ndikuar nga Serbia, si ekonomia më e madhe në rajon, ku për pjesën e parë të 2023 u rrit në 3.5%, nga 1.5% që rezultonte në 6M e parë.

Rritja ekonomike në rajon u nxit në përgjithësi nga kërkesa e brendshme. Shpenzimet e konsumatorit mbetën një kontribuues kryesor në rritjen e prodhimit për vitin 2023, megjithëse rritja e tyre nga viti në vit u ngadalësua në shumicën e ekonomive të rajonit. Konsumi i familjeve u mbështet nga rritja e vazhdueshme e pagave nominale në të gjithë rajonin, e cila u përkthye në rritje reale të konsiderueshme të pagave në mes të një inflacioni më të ulët.

Investimet treguan një tablo të përzier teksa u rikuperuan në Kosovë dhe vazhduan të rriten në Shqipëri, Serbi dhe Mal të Zi, ndërsa në Maqedoninë e Veriut u zvogëluan kryesisht për shkak të reduktimit të stokut të inventareve të mbajtura. Dinamika e tregtisë në përgjithësi u ndikua nga ecuria e dobët e eksporteve të mallrave, të cilat megjithatë u kompensuan nga një rritje e vazhdueshme e eksporteve të shërbimeve, veçanërisht në vendet e varura nga turizmi. Importet gjithashtu u tkurrën në shumicën e ekonomive të rajonit.

Në Shqipëri, PBB për tremujorin e katërt të vitit 2023 vlerësohet me rritje prej 3.8%, kundrejt tremujorit të katërt 2022. Ndërkohë, për vitin 2023 Shqipëria është vlerësuar me një rritje prej 3.44% krahasuar me vitin 2022, ndikuar kryesisht nga kërkesa e brendshme, si nga konsumi privat ashtu edhe nga investimet, si dhe nga ecuria mjaft e mirë e eksporteve të shërbimeve.

Tabela 1 Produkti i Brendshëm Bruto

Produkti i Brendshëm Bruto *(rritja vjetore ne %, në terma reale)*	2022	2023
Maqedonia e Veriut	2.2	1.0
Mali i Zi	6.4	6.0
Serbia	2.5	2.5
Shqipëria	**4.9**	**3.4**
Bosnja dhe Hercegovina	3.8	1.6
Kosova	4.3	3.3

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

Shkalla e papunësisë ra në shumicën e ekonomive të rajonit për vitin 2023. Në përputhje me ngadalësimin e aktivitetit ekonomik, rritja mesatare e punësimit u ngadalësua në 1.4% në vitin 2023, ndërsa pjesëmarrja në fuqinë punëtore u rrit në disa vende. Në përgjithësi, normat e papunësisë në rajon ishin në nivele të ulëta historike, por mbetën të larta krahasuar me vendet e BE, duke filluar nga 9.5% në Serbi deri në 13.4% në Mal të Zi.

Tabela 2 Norma e papunësisë

Norma e Papunësisë *(mesatare vjetore, në %)*	2022	2023
Maqedonia e Veriut	14.5	13.2
Mali i Zi	15.1	13.4
Serbia	9.4	9.5
Shqipëria	**11.3**	**11.2**
Bosnja dhe Hercegovina	15.4	13.2
Kosova	12.6	n.a

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

Defiçiti i llogarisë korente të rajonit u ngushtua ndjeshëm në 2.8% të PBB në 2023 nga 6.7% që ishte në 2022, niveli më i ulët në 16 vitet e fundit. Ky përmirësim, i cili ishte me bazë të gjerë në të gjitha vendet, ishte kryesisht për shkak të rritjes së vazhdueshme të eksporteve të shërbimeve (veçanërisht turizmit) si dhe rënies së defiçitit tregtar të mallrave të ndihmuar nga çmimet më të ulëta të importeve, krahasuar me nivelet shumë të larta të vitit 2022. Edhe pse flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte si pjesë e PBB ranë në shumicën e vendeve në vitin 2023, ato vazhduan të mbulonin pjesën më të madhe ose të gjithë defiçitin e llogarisë korente. Rezervat valutore janë rritur në shumicën e vendeve të rajonit.

Tabela 3 Bilanci tregtar

Defiçiti i llogarisë korrente *(në % të PBB)*[1]	2022	2023
Maqedonia e Veriut	-6.1	0.7
Mali i Zi	-12.9	-11.4
Serbia	-6.9	-2.6
Shqipëria	**-6.0**	**-0.9**
Bosnja dhe Hercegovina	-4.3	-2.8
Kosova	-10.2	-7.6

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

Inflacioni mesatar vjetor u ngadalësua në 9.3% në vitin 2023 nga 12% një vit më parë, i nxitur kryesisht nga çmimet më të ulëta të energjisë dhe ushqimeve. Ndërkohë, ritmi i shtrëngimit të politikës monetare për vitin 2023 u ngadalësua pothuajse në të gjitha ekonomitë e rajonit, ku normat bazë kanë mbetur të pa ndryshuara, përkatësisht për Shqipërinë që nga muaji nëntor, në Maqedoninë e Veriut që nga muaji shtator dhe në Serbi që nga muaji korrik.

Tabela 4 Norma e inflacionit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit/Inflacioni *(ndryshimi vjetor në %)*	2022	2023
Maqedonia e Veriut	14.1	9.6
Mali i Zi	11.9	8.9
Serbia	12.0	12.4
Shqipëria	**6.7**	**4.8**
Bosnja dhe Hercegovina	14.0	6.1
Kosova	11.6	4.9

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

Zgjerimi i vazhdueshëm ekonomik mbështeti rritjen e të ardhurave buxhetore dhe balancat fiskale u përmirësuan në shumicën e ekonomive të Ballkanit Perëndimor. Megjithatë, në disa prej tyre (Mal të Zi, Kosovë) përmirësimi ishte i pjesshëm për shkak të shpenzimeve kapitale që mbetën me një diferencë të konsiderueshme më ulët se plani.

Tabela 5 Bilanci fiskal

Balanca e përgjithshme e qeverisë/Defiçiti fiskal *(në % të PBB)*	2022	2023
Maqedonia e Veriut***	-4.4	-4.9
Mali i Zi**	-4.2	0.6
Serbia***	-3.2	-2.2
Shqipëria**	**-3.7**	**-1.3**
Bosnja dhe Hercegovina***	-0.4	N/A
Kosova	-0.5	-0.2

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

Raporti i borxhit publik ndaj PBB u ul në shumicën e ekonomive të rajonit në krahasim me fundin e vitit 2022, pjesërisht për shkak të rritjes së fortë të PBB nominale. Rënia e barrës së borxhit ishte më e theksuar në Mal të Zi dhe Shqipëri.

[1] *Këto shifra i referohen një mesatare rrëshqitëse për 4 tremujorët*
** *Këto shifra i referohen balancës tremujore pjestuar me PBB vjetore të vlerësuar*
*** *Këto shifra i referohen balancës tremujore pjestuar me PBB tremujore*

Tabela 6 Borxhi publik

Borxhi publik total *(në % të PBB)*	2022	2023
Maqedonia e Veriut	51.0	50.0
Mali i Zi	68.0	60.3
Serbia	55.2	52.0
Shqipëria	**64.5**	**58.9**
Bosnja dhe Hercegovina	29.3	26.9
Kosova	20.7	17.2

Burimi: Directorate-General for Economic and Financial Affairs (DG-ECFIN)

3. POLITIKAT FISKALE DHE REZULTATI I MBLEDHJES SË TË ARDHURAVE

3.1 Politika fiskale në vitin 2023 dhe efektet në buxhet e në ekonomi

Synimi i paketës fiskale 2023 ishte përmirësimi i legjislacionit dhe mbështetja me të ardhura e shpenzimeve buxhetore. Kjo paketw përfshinte angazhimet e Qeverisë dhe Ministrisë së Financave për modernizimin e legjislacionit tatimor, si dhe propozimet e ndryshme të marra nga grupet e interesit dhe faktorët e tjerë në vend.

Politika fiskale në vitin 2023 ka vijuar të synojë rimëkëmbjen e ekonomisë, por dhe rishikimin e incentivave tatimore të ndërmarra nga Qeveria me synim sigurimin e një sistemi taksimi të drejtë, të balancuar dhe që nxit produktivitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të ekonomisë. Ndryshimet në paketën fiskale 2023 synuan përgjithësisht korrektime në elementë të veçantë tatimesh dhe taksash, si tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi mbi të ardhurat, akcizat dhe taksat kombëtare. Paketa fiskale 2023 ka pasur si qëllim përmirësimin e politikave në fushën e tatimit mbi vlerën e shtuar dhe akcizave, si dhe angazhimeve në kuadrin e përafrimit gradual të legjislacionit përkatës me direktivat e Bashkimit Evropian që lidhen me këto tatime. Ndryshimet kryesore paraqiten si më poshtë:

3.1.1 Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Në kuadër të paketës fiskale 2023 është miratuar Ligji nr.82/2022 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar*", sipas të cilit, me efekt nga 1 Janari 2023:

- Furnizimi dhe importimi i artikujve të përfshirë në kreun 4401 (dru zjarri) të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar, për një periudhë një vjeçare (deri më 31 dhjetor 2023).
- Përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar në import, mallrat e destinuara për realizimin e projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshjeje donacioni/granti, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, nëse në marrëveshje është parashikuar se fondet e marra nuk do të përdoren për të paguar tatime.
- Furnizimi i mallrave/shërbimeve, të destinuara për realizimin e projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshjeje donacioni/granti, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, nëse në marrëveshje është parashikuar se fondet e marra nuk do të përdoren për të paguar tatime, trajtohet si furnizim i ngjashëm me eksportet, me TVSH 0%.
- Aplikohet regjimi i veçantë për Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, sipas së cilit përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar, importimi dhe furnizimi brenda vendit i energjisë elektrike të destinuar për t'u shitur nëpërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë, ndërkohë që deri më 31 dhjetor 2026, përgjegjësia për pagesën e TVSH-së i kalon personit të tatueshëm, blerës i energjisë elektrike nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, e cila kryhet nëpërmjet mekanizmit të *reverse-charge*.

Përjashtimi nga tatimi mbi vlerën e shtuar, si në import ashtu edhe brenda vendit për drutë e zjarrit, ka pasur si qëllim mbrojtjen dhe suportimin e individëve në kushtet e një krize energjetike që u shoqërua më një rritje të çmimit të

energjisë elektrike. Ndërsa, aplikimi i një skeme të veçantë për tregtimin e energjisë elektrike përmes Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike ka pasur si qëllim garantimin e tregtimit të energjisë elektrike në një treg të organizuar, sipas dispozitave të Direktivës përkatese.

Përjashtimi nga tatimi mbi vlerën e shtuar në import dhe trajtimi si furnizim i përngjashëm me eksportet për mallrat/shërbimet e destinuara për realizimin e projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshjeje donacioni/granti të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, nëse në marrëveshje është parashikuar se fondet e marra nuk do të përdoren për të paguar tatime, kanë synuar përmirësimin e legjislacionit të fushës lidhur me fondet IPA dhe donacionet e tjera, si dhe shmangien e problematikave të krijuara në *cash-flow* si rezultat i procedurës së rimbursimit.

3.1.2 Tatimi mbi të Ardhurat

Ligji i ri "*Për tatimin mbi të ardhurat*", i miratuar në 3 mujorin e parë të vitit 2023, ka synuar përmirësimin e sistemit të taksimit të individëve dhe entiteteve ligjore në Shqipëri, forcimin e parimit të neutralitetit në sistemin tatimor shqiptar, përafrimin gradual të sistemit të tatimit të të ardhurave në Shqipëri me parimet e Direktivave të BE në lidhje me tatimin e të ardhurave dhe kapitalit, adresimin e mangësive dhe boshllëqeve legjislative të konstatuara gjatë periudhës 22 vjeçare të aplikimit të ligjit ekzistues duke synuar dizenjimin e një sistemi tatimi më të drejtë dhe stimulues, më të ndershëm dhe të gjithëpranuar.

Në kuadrin e këtij ligji kemi ndryshimet më të rëndësishme dhe efektet e mëposhtme:

- Rritja e kufirit të pa tatueshën të pagës nga 40 mijë LEK në 50 mijë LEK, redukton të ardhurat në buxhet për rreth 1 deri 1,2 miliard në vit, por ndërkohë rrit të ardhurat e punëmarrësve me paga deri në 50 mijë LEK në muaj, me mbi 1 miliard LEK, çka do të thotë më shumë konsum. Nga kjo masë përfituan mbi 70 mijë punëmarrës të cilët janë në grupin e pagave nga 40 në 50 mijë LEK në muaj.
- Përfshirja e furnizuesve të shërbimeve si profesione të lira në skemën e taksimit të të ardhurave personale nga 1 Janari 2024, si një masë që synon të kufizojë shmangien e tatimit nëpërmjet kalimit të individëve nga statusi i të punësuarit ku paguan tatim, në statusin e të vetpunësuarit pa tatim.
- Ruajtja e tatimit 0% deri në vitin 2029 për biznesin e vogël familjar, që është burim punësimi në tregti, artizanat, prodhim, shërbime, transport, etj.
- Për kompanitë ky ligj ka parashiuar një sërë ndryshimesh të tilla si:
    - *Zgjatjen e periudhës së mbartjes së humbjeve, nga 3 vjet në 5 vjet;*
    - *Thjeshtimin dhe lehtësimin e shpenzimeve afatgjata nëpërmjet amortizimit linear individual të grupeve makineri/pajisje dhe soft/hardware;*
    - *Njehsimin e rregullave të taksimit për kontratat afatgjata, për riorganizimet e biznesit dhe transferimin e aktiveve të tij;*
    - *Vendosjen e rregullave transparente në lidhje me borxhin e keq, si dhe të rregullave të gjithëpranuara në lidhje me alokimin dhe kufijtë e interesave të kredidhënies.*

3.1.3 Akciza


Me Ligjin nr.81/2022 "*Për disa ndryshime në Ligjin nr.61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar*", i cili ka hyrë në fuqi në janar 2023, është parashikuar:

- Unifikimi i akcizës për birrën e prodhuar nga malto (B000) nga prodhues vendas dhe të huaj, ligjërisht dhe ekonomikisht të pavarur, me sasi më të vogla dhe më të mëdha se 200 000 HL në vit me akcizë 710 LEK/HL/shkallë alkolometrike (ishte 360 leke/HL nën 200 000 HL dhe 710 LEK/HL mbi 200 000 HL). Kjo politikë ka pasur si qëllim eleminimin e hapësirave për shmangie nga detyrimet e akcizës.
- Unifikimin e nivelit të akcizës për Pijet Alkolike (Spirituos Bavarage S200. Vodka, whiskey, Uzo, Rum dhe pije te tjera të përfituara nga destilimi i produkteve te fermentuara nga kallami i sheqerit Gin dhe Geneva), për të dy nivelet e prodhimit deri dhe mbi 20 000 HL me një nivel akcize 84 500 LEK për HL alkool anhidrik (ishte 65 000 LEK/HL anhidër nën 20 000 HL në vit dhe 84500 LEK/HL mbi 20 000 HL në vit). Kjo politikë ka të njëjtin qëllim si në rastin e birrës, duke synuar eleminimin e hapësirave për shmangie nga deyrimet, si dhe stimulimin e prodhuesve të vegjël për rritjen e prodhimit sa kohë që niveli i akcizës nuk do të kushtëzohet nga nivelet e prodhimit.
- Heqja e akcizës për artikullin "Bateri dhe akumulatorë", në kuadër të zbatimit të strategjisë për kursimin e energjisë si dhe subvencionimit të çmimit të paneleve diellore. Kjo masë fiskale është marrë me qëllim nxitjen e përdorimit të mjeteve motorike elektrike (që burimin e tyre të energjisë kanë akumulatorët).

3.2 Të ardhurat e përgjithshme


Të ardhurat totale të buxhetit të konsoliduar për periudhën 12 mujore 2023, arritën në 643.4 miliardë LEK, me një realizim në masën 99% të planit vjetor të rishikuar. Të ardhurat totale rezultuan 0.1% më të larta se plani fillestar 2023 (642.6 miliardë LEK) dhe 12.3% ose 70.6 miliardë LEK më shumë se realizimi vjetor 2022. Rritja e kontributit të të ardhurave të buxhetit të shtetit për vitin 2023, krahasuar me vitin paraardhës është rezultat i ecurisë pozitive ekonomike. Rritja e të ardhurave nga turizmi dhe gjithë sektorëve të tjerë të ekonomisë që lidhen drejtpërdrejt ose indirekt me turizmin (*sektori i shërbimeve dhe i prodhimit*), reforma e rritjes së pagave në administratën publike si dhe efektet e politikave fiskale janë ndër faktorët kryesor që ndikuan në ecurinë e mirë të të ardhurave.

Grafiku 2 Të Ardhurat e përgjithshme (në miliardë LEK) ndaj PBB



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Grafiku 3 Ecuria e zërave kryesorë të të ardhurave



Burimi: Ministria e Financave (2024)


Zërat në të ardhurat totale të buxhetit të shtetit janë: Të ardhura nga ndihmat, të ardhurat nga tatimet dhe doganat, të ardhurat e pushtetit vendor, të ardhurat nga fondet speciale dhe të ardhurat jotatimore të cilat zënë përkatësisht 3.4%, 65.7%, 4.9%, 22.5% dhe 3.5% të të ardhurave të përgjithshme publike në vitin 2023. Kontributin më të madh në realizimin e të ardhurave totale e kanë dhënë të ardhurat nga administratat e tatimeve dhe doganave, ku zërat me performacë shumë të mirë në raport me planin fillestar janë: Tatimi mbi Fitimin (*15.1 miliardë LEK me shumë se plani fillestar*) dhe Tatimi mbi të Ardhurat Personale (*8.9 miliardë LEK me shumë se plani fillestar*).

Tabela 7 Treguesit e të ardhurave kryesore (në miliardë LEK)

	2019	2020	2021	2022	2022 (në % ndaj vitit paraardhës)	2023 (plan fillestar)	2023 (plan i rishikuar)	2023 (fakt)	2023 (në % ndaj planit fillestar)	2023 (në % ndaj planit të rishikuar)	2023 (në % ndaj vitit paraardhës)
Të ardhura nga ndihmat	10.6	8.3	13.1	9.5	**72.9%**	30.6	30.6	22.2	**72.5%**	**72.5%**	**233.1%**
Të ardhura tatimore	426.3	398.7	475.6	541.3	**113.8%**	588.5	595.9	598.7	**101.7%**	**100.5%**	**110.6%**
Tatimi mbi Vleren e Shtuar	132.4	130.4	161.5	191.4	**118.5%**	210.9	200.0	192.3	**91.2%**	**96.2%**	**100.5%**
Tatimi mbi Fitimin	36.6	28.4	35.6	47.7	**133.9%**	49.5	59.0	64.6	**130.5%**	**109.5%**	**135.4%**
Akcizat	46.7	44.5	51.6	53.6	**103.7%**	59.0	59.0	58.4	**99.0%**	**99.0%**	**109.0%**
Tatimi mbi te Ardhurat Personale	46.1	33.7	39.3	45.0	**114.4%**	49.0	56.0	57.9	**118.1%**	**103.4%**	**128.7%**
Taksa Nacionale dhe te tjera	36.4	35.8	42.5	44.8	**105.4%**	54.3	41.0	40.2	**74.0%**	**98.0%**	**89.7%**
Taksa Doganore	6.5	6.2	7.5	8.5	**113.3%**	8.5	8.8	9.1	**107.4%**	**103.8%**	**108.1%**
Të ardhura nga Pushteti Vendor	23.1	22.0	26.7	27.6	**103.6%**	29.2	27.7	31.7	**108.7%**	**114.2%**	**114.6%**
Të ardhura nga fondet speciale	98.4	97.7	110.9	122.8	**110.8%**	128.1	144.4	144.5	**112.8%**	**100.1%**	**117.6%**
Të ardhura jotatimore	23.5	19.0	22.3	21.9	**98.4%**	23.6	23.6	22.6	**95.6%**	**95.6%**	**103.0%**
TOTALI I TË ARDHURAVE	**460.3**	**425.9**	**511.0**	**572.8**	**112.1%**	**642.6**	**650.1**	**643.4**	**100.1%**	**99.0%**	**112.3%**

Burimi: Ministria e Financave (2024)

Grafiku 4 Të ardhurat e përgjithshme (në miliardë LEK), sipas kategorive kryesore



Burimi: Ministria e Financave (2024)

3.2.1 Të ardhurat nga ndihmat

Të ardhurat nga ndihmat për periudhën Janar-Dhjetor 2023 janë 22.2 miliardë LEK, nga 9.5 miliardë LEK të një viti më parë, me një rritje në masën 133.1% ose 12.7 miliardë LEK dhe me realizim ndaj planit të rishikuar në masën 72.5%.


3.2.2 Të ardhurat tatimore

Të ardhurat tatimore, ku përfshihen të ardhurat nga tatimet dhe doganat, të ardhurat nga pushteti vendor si dhe të ardhurat nga fondet speciale, për periudhën 12 mujore arritën në vlerën 598.7 miliardë LEK, me një realizim ndaj planit vjetor të rishikuar në masën 100.5% ose 2.7 miliardë LEK më shumë dhe me realizim kundrejt vitit të kaluar në masën 110.6 % ose 57.3 miliardë LEK më shumë.

3.2.3 Të ardhurat nga pushteti vendor

Për vitin 2023, njësitë e vetëqeverisjes vendore në shkallë kombëtare kanë mbledhur të ardhura tatimore në masën 31,686 milionë LEK, shifër kjo që është rreth 4,048 milionë LEK më shumë ose rreth 15% më e lartë se vlera e të ardhurave të mbledhura gjatë vitit 2022 e cila ka qenë 27,638 milionë LEK. Efektet pozitive në të ardhurat vendore për vitin 2023 dëshmojnë ecurinë pozitive të buxhetit vendor në tërësi. Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat e realizmit të këtyre burimeve dhe ritmi i ndryshimt të tyre, gjatë viteve 2013-2023.


Grafiku 5 Të ardhura nga pushteti vendor në vite (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Referuar përbërjes së tyre sipas zërave kryesorë, që janë Taksat Lokale dhe Taksa mbi pasurinë, grafikisht të ardhurat e pushtetit vendor për vitin 2023 në %je paraqiten si më poshtë:

Grafiku 6 Përbërja e të ardhurave nga pushteti vendor sipas zërave kryesorë (në %)[2]



Burimi: Ministria e Financave (2024)

3.2.4 Të ardhurat nga fondet speciale

Të ardhurat nga "Fondet Speciale" rezultuan 144.5 miliardë LEK, me një realizim ndaj planit të rishikuar në nivelin 100.1% ose 85 milionë LEK më shumë. Të ardhurat nga fondet speciale shënuan rritje në krahasim me parashikimin e të ardhurave në buxhetin fillestar të vitit 2023 prej 12.8 % ose 16.4 miliardë LEK më shumë dhe 21.7 miliardë LEK apo 17.6% më shumë se një vit më parë. Zërat që përbëjnë të ardhurat nga "Fondet Speciale" janë: Sigurimi Shoqëror, Sigurimi Shëndetësor dhe të ardhurat për Kompensimin në vlerë të Pronarëve, përkatësisht në vlerën 124.6 miliardë LEK, 19 miliardë LEK dhe 839 milionë LEK.

Grafiku 7 Të ardhurat nga fondet speciale në vite (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

[2] ***Shënim**: Taksa mbi biznesin e vogël, pas ndryshimeve fiskale ligjore më të fundit, është bërë zero (ligji nr.112/2020 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar"). Nga realizimi faktik gjatë vitit 2022, rezulton se nga ky zë janë mbledhur rreth 72 milion LEK, që përbëjnë vetëm 0.26% të totalit të burimeve tatimore të pushtetit vendor, të cilat përfaqësojnë detyrime të paguara me vonesë.*

Grafiku 8 Përbërja e të ardhurave nga fondet speciale (në %)




Burimi: Ministria e Financave (2024)

3.2.5 Të ardhurat jotatimore

Të ardhurat jotatimore rezultojnë në vlerën 22.6 miliardë LEK krahasuar me 21.9 miliardë të një viti më parë, me një rritje vjetore prej 2.9% ose 640 milionë LEK më shumë dhe me një realizim ndaj planit të rishikuar në masën 95.6% ose 1 miliardë LEK më pak. Ndër zërat kryesor që përbëjnë të ardhurat jotatimore janë: të ardhurat nga institucionet buxhetore dhe tarifat e shërbimeve, të cilat kanë mbledhur përkatësisht 13.2 miliardë LEK dhe 3.2 miliardë LEK.

Grafiku 9 Përbërja e të ardhurave jotatimore (miliardë LEK)




Burimi: Ministria e Financave (2024)

3.2.6 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat

Të ardhurat nga "Tatimet dhe Dogana"[3] janë burimi kryesor i të ardhurave të përgjithshme dhe kontribuojnë në buxhetin e shtetit me rreth 18.3% të PBB. Krahasuar me 2022, ky zë shënon një performancë pozitive prej 31.6 miliardë LEK ose 8.1% më shumë. Në krahasim me planin e rishikuar vjetor, realizimi është 99% ose 1.3 miliardë LEK më pak.


Grafiku 10 Të ardhura nga tatimet dhe doganat në vite (në miliardë LEK) dhe në % të PBB



Burimi: Ministria e Financave (2024)

[3] *Nuk përfshihen të ardhurat nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore*

Grafiku 11 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat sipas llojit



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Këto të ardhura, të cilat administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave(DPD), përfshijnë Tatimin mbi vlerën e shtuar; Tatimin mbi fitimin; Tatimin mbi të ardhurat personale; Akcizat; Taksat Doganore dhe Taksa të tjera kombëtare. DPT administron edhe mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Burimet nga të ardhurat e administruara nga DPT e DPD për vitin 2023, janë realizuar në vlerën 561.7 miliardë LEK, 10.3% ose 52.4 miliardë LEK më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar dhe në masën 99.7% të planit vjetor të rishikuar. Rezultati pozitiv krahasuar me 2022, është një tregues i qartë i rimëkëmbjes së ekonomisë shqiptare pas tejkalimit të pasojave mbi ekonominë të tërmetit të vitit 2019, pandemisë Covid-19 në vitin 2020 dhe me pas pasojave ekonomike të luftës në Ukrainë.


Tabela 8 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat (në milionë LEK)

Lloji i taksave	Fakt 12 mujor 2022	Fakt 12 mujor 2023	Plan Fillestar 2023	Diferenca 2023/ 2022	Ndryshimi në % 2023/2022	Diferenca Fakt/ Plan Fillestar 2023	Ndryshimi në % Fakt/Plan 2023	2023 (plani i rishikuar AN5)	Diferenca fakt 2023/ Plan i rishikuar 2023	Ndryshimi Fakt/ Plan i rishikuar 2023 në %
TVSH TOTAL	**191,412**	**192,322**	**210,900**	**910**	**0.5%**	**-18,578**	**-8.81%**	**200,000**	**-7,678**	**-3.8%**
Tvsh në import	156,898	146,386	167,720	-10,512	-6.7%	-21,334	-12.72%	152,677	-6,291	-4.1%
Tvsh brenda vendit	34,514	45,936	43,180	11,422	33.1%	2,756	6.38%	47,323	-1,387	-2.9%
Rimbursim TVSH	22,482	22,615	18,000	133	0.6%	4,615	25.64%	18,000	4,615	25.6%
Tatimi mbi fitimin	**47,683**	**64,576**	**49,500**	**16,893**	**35.4%**	**15,076**	**30.46%**	**59,000**	**5,576**	**9.5%**
Akciza	**53,547**	**58,394**	**59,000**	**4,847**	**9.1%**	**-606**	**-1.03%**	**59,000**	**-606**	**-1.0%**
Tatimi mbi të ardhurat personale	**44,983**	**57,878**	**49,000**	**12,895**	**28.7%**	**8,878**	**18.12%**	**56,000**	**1,878**	**3.4%**
Taksa Nacional dhe te tjera	44,821	40,188	54,300	-4,633	-10.3%	-14,112	-25.99%	41,000	-812	-2.0%
Taksat nacionale	**40,623**	**37,297**	**49,800**	**-3,326**	**-8.2%**	**-12,503**	**-25.11%**	**37,800**	**-503**	**-1.3%**
Renta Minerare	4,197	2,891	4,500	-1,307	-31.1%	-1,609	-35.76%	3,200	-309	-9.7%
Taksë Doganore	**8,447**	**9,133**	**8,500**	**686**	**8.1%**	**633**	**7.45%**	**8,800**	**333**	**3.8%**
TOTALI TATIME + DOGANA	390,893	422,491	431,200	31,598	8.1%	-8,709	-2.02%	423,800	-1,309	-0.3%
Kontributet e mbledhura (DPT)	**118,467**	**139,255**	**123,800**	**20,788**	**17.5%**	**15,455**	**12.48%**	**139,900**	**-645**	**-0.5%**
TOTALI TATIME + DOGANA (përfshirë kontributet)	**509,360**	**561,746**	**555,000**	**52,386**	**10.3%**	**6,746**	**1.22%**	**563,700**	**-1,954**	**-0.3%**

Burimi: Ministria e Financave (2024)

Të ardhurat nga **Administrata Doganore** për vitin 2023 arritën në 216.8 miliardë LEK, me një realizim në masën 96.9% të planit të rishikuar ose 6.9 miliardë LEK më pak. Në krahasim me vitin 2022, performanca ka qenë negative me rreth 6.3 miliardë LEK ose 2.8% më pak. Paraqiten me ulje, Tatimi mbi vlerën e shtuar në import (-6.7%) dhe Renta minerare (-31.1 %), ndërsa me rritje nga viti paraardhës është Akciza (+9.1 %) dhe Taksa doganore (+8.1 %).


Grafiku 12 Të ardhurat doganore, rritja vjetore sipas llojit të taksave 2022 - 2021 (në milionë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Të ardhurat nga **Administrata tatimore** (përfshirë kontributet DPT) rezultojnë 344.9 miliardë LEK nga 286.3 miliardë LEK të një viti më parë, me një rritje vjetore prej 20.5% ose 58.7 miliardë LEK më shumë. Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të mbledhura nga DPT kanë pësuar rritje në bazë vjetore me 20.8 miliardë LEK. Krahasuar me të dhënat e një viti më parë, pothuajse të gjitha llojet e të ardhurave tatimore kanë pasur një tendencë në rritje, në krahasim me buxhetin fillestar 2023 si dhe me realizimin e një viti më parë.


Grafiku 13 Të ardhurat tatimore, rritja vjetore sipas llojit të taksave (në milionë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Nga të dhënat për 12 mujorin 2023, lidhur me kontributin e sektorëve të ekonomisë në totalin e të ardhurave nga administrata tatimore, rezulton se peshën kryesore e zë sektori i "Shërbimit" me 28%, sektori i "Tregtisë" 26% dhe sektori i "Prodhimit" me 22%.

Grafiku 14 Të ardhurat tatimore, sipas sektorëve (në %)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

3.3 Të ardhurat sipas taksave, tatimeve dhe burimeve të tjera

3.3.1 Taksimi Indirekt

- *Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH)*

Të ardhurat nga T.V.SH janë 192.3 miliardë LEK në vitin 2023, duke zënë sërish peshë të rëndësishme në të ardhurat buxhetore: 8.3% të PBB ose 45.5% e totalit të të ardhurave nga tatime dhe dogana. Pesha e të ardhurave nga TVSH ndaj të ardhurave tatimore gjithsej në 2023, është 32.1% e totalit. Krahasuar me vitin 2022 të ardhurat nga TVSH janë 0.5% ose 911 milionë LEK më shumë. Të ardhurat e mbledhura nga TVSH në import u realizuan në nivelin 146.4 miliardë LEK, me një realizim në masën 95.9% kundrejt planit të rishikuar dhe 6.7% më pak ose 10.5 miliardë LEK më pak se viti i kaluar. Për këtë periudhë, të ardhurat nga TVSH në doganë përbëjnë rreth 76.1% të të ardhurave totale nga TVSH.

Programimi i të ardhurave tatimore për vitin 2023 u ndërtua mbi bazën e supozimeve të kursit të këmbimit EUR/ALL për rreth 120 LEK dhe USD/ALL rreth 110 LEK. Mbi këtë bazë u programuan edhe të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar në importin e mallrave. Por gjatë vitit 2023 ka patur një deviacion të theksuar në ulje nga ky kurs këmbimi i projektuar, çka ka impaktuar ndjeshëm të ardhurat nga TVSH në import. Pra, baza mbi të cilën llogaritet tatimi mbi vlerën e shtuar në import, është impaktuar jo vetëm nga tendenca në rënie e çmimeve të mallrave të importuara në 2023 krahasuar me rritjen e tyre në vitin 2022, por më së shumti sikurse theksuam më lart, nga ulja e vlerës mbi të cilën llogaritet TVSH në import për shkak të kursit të këmbimit.

Në import, mosrealizimi i TVSH u ndikua nga disa faktorë të tillë si:


- *Minus 8,7 miliardë LEK nga mungesa e importit të energjisë elektrike*
- *Minus 2,1 miliardë LEK nga rënia e çmimit të karburanteve*
- *Minus 1,7 miliardë LEK nga rënia e çmimit të gazit të lëngët*
- *Minus 0,7 miliardë LEK nga mungesa e importit të metaleve bazë*
- *Minus 0,6 miliardë LEK nga rënia e çmimeve të vajrave vegjetale dhe yndyrnave.*

Të ardhurat nga TVSH Neto brenda vendit janë 45.9 miliardë LEK, me rritje kundrejt vitit të kaluar në masën 33.1% ose +11.4 miliardë LEK. Kjo rritje reflekton rimëkëmbjen ekonomike dhe implementimin e proçesit të fiskalizimit e të mirëadministrimit nga administrata tatimore. Ndër faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rritjen e të ardhurave të TVSH brenda vendit janë: Rritja e konsumit të brendshëm, ç'ka reflektohet dhe me rritjen e TVSH brenda vendit, TVSH e gjeneruar si rezultat i rritjes ekonomike; TVSH e gjeneruar si rezultat reformës së rritjes të pagës mesatare në administratë.

Të ardhurat e mbledhura nga TVSH Bruto brenda vendit sipas sektorëve, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, janë:


- *Në sektorin e shërbimeve, të ardhurat për periudhën Janar-Dhjetor 2023 janë 22.5 miliardë LEK, me rritje në të ardhura 15% ose 2.9 miliardë LEK më shumë e njëjta periudhë e vitit 2022.*
- *Në sektorin e prodhimit, të ardhurat për periudhën Janar-Dhjetor 2023 janë 14 miliardë LEK, me një rritje në të ardhura 29% ose 3.2 miliardë LEK më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2022.*
- *Në sektorin e ndërtimit, të ardhurat për periudhën Janar-Dhjetor 2023 janë 10.4 miliardë LEK me një rritje në të ardhura 27% ose 2.2 miliardë LEK më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2022.*
- *Në sektorin e transportit, të ardhurat për periudhën Janar-Dhjetor 2023 janë 1.6 miliardë LEK me një rritje në të ardhura 35% ose 409 milionë LEK më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2022.*
- *Në sektorin e tregtisë të ardhurat për periudhën Janar-Dhjetor 2023 janë 20.2 miliardë LEK me një rritje në të ardhura 17% ose 2.9 miliardë LEK më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2022.*

Grafiku 15 TVSH brenda vendit, sipas sektorëve (në %)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Grafiku 16 Rimbursimi i TVSH-së në vite (në milionë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

- *Akciza*

Të ardhurat nga Akciza për periudhën Janar–Dhjetor 2023 arritën 58.4 miliardë LEK ose 606 milionë LEK më pak se plani i rishikuar. Në krahasim me vitin 2022, realizimi ishte 4.8 miliardë LEK ose 9.1% më shumë. Rritja në realizimin e të ardhurave nga akciza ka ardhur kryesisht si rezultat i kërkesës më të lartë për disa mallra kyç, përfshirë:


- ✓ *Rritje e sasisë së cigareve, me 1.3 % krahasuar me 12 mujorin e vitit 2022, me efekt pozitiv 536 milionë LEK.*
- ✓ *Karburant Importi, me një rritje në sasi prej 57.917 tonë ose 10.4% krahasuar me 12 mujorin e vitit 2022, me efekt pozitiv 2.4 miliardë LEK.*

Tabela 9 Performanca e të ardhurave nga akciza: mallrat kryesorë 2021 - 2020

Mallrat e forta	Njësia e matjes	Janar - Dhjetor		Diferenca	
		2023	2022	ne njesi fizike	në %
Cigare	Ton	2,934	3,147	213	11.8%
Karburante	Ton	614,537	556,653	57,884	10.4%
Kafe	Ton	8,612	7,649	963	12.6%
Birrë Importi	Mij/lit	55,558	51,992	3,566	6.9%

Burimi: Ministria e Financave (2024)

Grafiku 17 Akciza në vite (miliard LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

- *Taksat doganore*

Të ardhurat nga taksa doganore për periudhën Janar–Dhjetor 2023 janë rreth 9.1 miliardë LEK; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022, të ardhurat nga kjo taksë janë rritur me 687 milionë LEK ose 8.1% më shumë, me realizim në masën 103.8% e planit të rishikuar. Peshën më të madhe në taksën doganore e zënë cigaret, mish importi, veshjet e këmbës, dhe elektroshtepiaket.

- *Taksat nacionale*

Taksat nacionale në total, mblidhen nga Administrata Doganore dhe Administrata Tatimore. Administrata doganore mbledh rreth 7% të totalit të taksës nacionale dhe administrata tatimore mbledh rreth 93% të totalit të taksës nacionale. Për periudhën 12 mujore 2023 taksat nacionale në total u realizuan në masën 40.2 miliardë LEK, 4.6 miliardë LEK më pak ose 10.3% më pak se 12 mujori 2022, si dhe 812 milionë LEK ose 2% më pak se plani i përcaktuar për 12 mujorin 2023. Peshën kryesore në të ardhura e zë taksa e qarkullimit me 52.6%, taksa vjetore e mjeteve të përdorura të transportit me 15.8% dhe, taksa e ambalazhit + taksa e karbonit + tatimi për lojrat e fatit me rreth 12.6%. Zërat me performancë të mirë krahasuar me vitin 2022 janë:

- *Taksa e qarkullimit me të ardhura në masën 19.5 miliardë LEK me një rritje nga viti i kaluar me 1.3 miliardë LEK ose 7% më shumë.*
- *Të ardhurat nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura të transportit qw u realizua në masën 5.9 miliardë LEK, me një rritje nga viti i kaluar me 450 milionë LEK ose 8% më shumë.*
- *Taksa e karbonit u realizua në masë 2.5 miliardë LEK, me një rritje nga viti i kaluar me 201 milion LEK ose 9% më shumë.*

Mosrealizimi, kryesisht, ka të bejë me planifikimin fillestar ku ishte përfshirë taksa speciale e energjisë elektrike në vlerën e parashikimit prej 8.3 miliardë LEK (ishte përfshirë si taks por u arkëtua në zërin Tatim mbi Fitimin), si dhe performanca e ulët e ndikuar nga disa faktorë si:

- *Rënie e çmimit të naftës bruto në tregjet ndërkombëtare, nga 5 LEK për njësi për vitin 2022 në 4 LEK për njësi për vitin 2023 shoqëruar me rënie e sasisë së naftës bruto të eksportuar me 65,5 mijë ton ose 11% më pak se vitin e kaluar me efekt -1,1 miliardë LEK;*
- *Rënie e çmimit të mineraleve të tjera në tregjet ndërkombëtare, nga 0,6 LEK për njësi për vitin 2022 në 0,4 LEK për njësi për vitin 2023 shoqëruar me rritje të sasisë së eksportuar me 251,9 mijë ton ose 15,1% më shumë se vitin e kaluar, ka sjellë efekt negative -226 milionë LEK*

3.3.2 Taksimi direkt


- *Tatimi mbi të ardhurat personale*

Të ardhurat nga Tatimi mbi të ardhurat Personale arritën në 57.9 miliardë LEK për periudhën janar-dhjetor 2023, me rritje kundrejt vitit të kaluar në masën 28.7% ose 12.9 miliardë LEK dhe me realizim ndaj planit fillestar në masën 118.1%

dhe ndaj planit të rishikuar 103.4% ose 1.9 miliardë LEK më shumë. Ndikim të rëndësishëm në performancën e mirë të këtij zëri, shënuan:

- *Të punësuarit e sektorit privat me arkëtim për periudhën në vlerën 21.2 miliardë LEK, me një rritje prej 16.4% më shumë se 2022.*
- *Tatim mbi të ardhurat në burim me arkëtim për periudhën në vlerën 3.7 miliardë LEK, me një rritje prej 32.6% më shumë se 2022.*
- *Tatim mbi të ardhurat nga qeratë me arkëtim për periudhën në vlerën 4.8 miliardë LEK, me një rritje prej 4.8% më shumë se 2022.*
- *Tatimi mbi të ardhurat nga dividentët dhe aksionet me arkëtim për periudhën në vlerën 5.9 miliardë LEK, me një rritje prej 38.5% më shumë se 2022.*

Grafiku 18 TAP sipas zërave (në % ndaj totalit të arkëtuar të vitit 2023)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Grafiku 19 TAP në vite në % ndaj të ardhurave totale




Burimi: Ministria e Financave (2024)

- *Tatim Fitimi*

Të ardhurat nga Tatimi mbi fitimin për 12 mujorin 2023 arritën në 64.6 miliardë LEK nga 47.7 miliardë LEK të mbledhura një vit më parë. Krahasuar me planin e rishikuar 9.5% ose 5.6 miliardë LEK më shumë. Krahasuar me vitin paraardhës, performanca e të ardhurave nga tatim fitimi ishte 35.4% ose 16.7 miliardë LEK më shumë. Arketimet në buxhetin e shtetit për tatim fitimin bazohen në rikuperimin e ekonomisë dhe rritjen e saj, performaca e mirë e të gjithë sektorve ekonomik si dhe në forcimin e kontrollit të deklaratave, bazuar në kriteret e riskut.

Grafiku 20 Tatimi mbi fitimin në vite (në miliard LEK)




Burimi: Ministria e Financave (2024)

Krahasimi i tatimit mbi fitimin sipas sektorëve me një vit më parë:

- ✓ *Në sektorin e prodhimit të ardhurat për periudhën Janar – Dhjetor 2023 janë 15 miliardë LEK me një rritje në të ardhura 32% ose 3.7 miliardë LEK më shumë se 12-mujori i vitit 2022.*
- ✓ *Në sektorin e shërbimeve të ardhurat për periudhën Janar – Dhjetor 2023 janë 16.8 miliardë LEK me rritje në të ardhura 15% ose 2.2 miliardë LEK më shumë se 12-mujori i vitit 2022.*
- ✓ *Në sektorin e tregtisë të ardhurat për periudhën Janar – Dhjetor 2023 janë 14.3 miliardë LEK me një rritje në të ardhura 5% ose 686 milionë LEK më shumë se 12-mujori i vitit 2022.*
- ✓ *Në sektorin e ndërtimit të ardhurat për periudhën Janar – Dhjetor 2023 janë 6.9miliardë LEK me një rritje në të ardhura 7% ose 472 milionë LEK më shumë se 12-mujori i vitit 2022.*
- ✓ *Në sektorin e transportit të ardhurat për periudhën Janar – Dhjetor 2023 janë 1.9 miliardë LEK me një rritje në të ardhura 13% ose 216 milionë LEK më shumë se 12-mujori i vitit 2022.*

Grafiku 21 Tatimi mbi fitimin sipas sektorëve (në %)




Burimi: Ministria e Financave (2024)

- *Të ardhurat e fondeve speciale*


Të ardhurat nga "Fondet Speciale" rezultuan 144.5 miliardë LEK, me një realizim ndaj planit të rishikuar në nivelin 100.1% ose 85 milionë LEK më shumë. Të ardhurat nga fondet speciale shënuan rritje në krahasim me parashikimin në buxhetin fillestar të vitit 2023 me 12.8% ose 16.4 miliardë LEK më shumë dhe 21.7 miliardë LEK apo 17.6% më shumë se një vit më parë. Zërat që përbëjnë të ardhurat nga "Fondet Speciale" janë: Sigurimi Shoqëror, Sigurimi Shëndetësor dhe të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve, përkatësisht në vlerën 124.6 miliardë LEK, 19 miliardë LEK dhe 0.8 miliardë LEK. Performanca e mirë vjen kryesisht si rezultat i efektit të rritjes së pagave në sektorin shtetëror, e cila ka ndikuar edhe në rritjen e tyre nga sektori privat.

Grafiku 22 Kontribuesit aktivë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, sipas llojit të biznesit



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Grafiku 23 Kontribuesit aktivë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, sipas sektorit (në %)




Burimi: Ministria e Financave (2024)

Peshën më të madhe, për numër mesatar kontribuesish e zë biznesi i madh dhe ndërmarrjet shtetërore buxhetore, përkatësisht 37% dhe 20%. Duke e analizuar nga këndvështrimi i sektorëve të ekonomisë, peshën kryesore në kontribuesit aktivë e zënë punonjësit në sektorin e "Shërbimit" me 60% të totalit, "Prodhimi" me 16% dhe "Tregtia" me 15%. Krahasuar me vitin e kaluar, sektori i "Prodhimit" është rritur me 17% ose 3.2 miliardë LEK, sektori i "Shërbimit" është rritur me 18% ose 12.5 miliardë LEK, sektori i "Tregtisë" është rritur me 16% ose 2.9 miliard LEK, sektori "Ndërtimit" është rritur me 19 % ose 1.4 miliard LEK dhe sektori i "Transportit" është rritur me 21% ose 696 milionë LEK.

4. SHPENZIMET E PËRGJITHSHME

Shpenzimet e përgjithshme publike për vitin 2023, arritën në rreth 674.9 miliardë LEK me një realizim në masën 96.7% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 95.6% të planit vjetor të ndryshuar përmes Aktit Normativ nr.6/2023. Krahasuar me vitin 2022, shpenzimet e përgjithshme publike rezultojnë 3.7% më të larta ose rreth 23.8 miliardë LEK më shumë.

Grafiku 24 Shpenzimet e përgjithshme korrente dhe kapitale (mld LEK) dhe ritmi i rritjes vjetore (në %)




Burimi: Ministria e Financave (2024)

4.1 Shpenzimet sipas natyrës ekonomike


Struktura e shpenzimeve gjatë vitit 2023 paraqet disa ndryshime në krahasim me planin fillestar, kryesisht si rrjedhojë e dy rishikimeve të ligjit të buxhetit, të cilat rezultuan në rishpërndarjen volumeve të qenësishme prej përkatësisht, rreth 46 miliardë LEK (AN 5/2023) dhe rreth 20 miliardë LEK (AN 6/2023) mes zërave të shpenzimeve buxhetore korente e kapitale, me synimin e realizimit sa më të plotë të shpenzimeve publike për vitin 2023.

Grafiku 25 Shpenzimet korrente dhe kapitale plan dhe fakt ndaj totalit të shpenzimeve (mln LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Grafiku 26 Struktura e shpenzimeve korente, kapitale dhe raporti me PBB-në ndër vite



Burimi: Ministria e Financave (2024)


Shpenzimet korrente për vitin 2023 rezultuan në rreth 547 miliardë LEK ose 100.1% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar, 99.7% të planit të ndryshuar me AN nr.6/2023 dhe 96.5% të planit përfundimtar me ndryshime dhe shpërndarje rezervash. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shpenzimet korente për vitin 2023 rezultuan 9.4% më të larta ose rreth 47 miliardë LEK më shumë. Kategoritë kryesore që kanë ndikuar në realizimin e shpenzimeve korente ishin kryesisht:

- ✓ *Shpenzimet për subvencione me 119.1% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar (118.6% të planit të ndryshuar me AN nr.6/2023 dhe 85.9% të planit përfundimtar me ndryshime dhe shpërndarje rezervash).*
- ✓ *Shpenzimet operative mirëmbajtje me 108.1% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar (96.6 % të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.6/2023 dhe 91.6% të planit përfundimtar me ndryshime dhe shpërndarje rezervash).*
- ✓ *Shpenzimet e personelit me 103.6% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar (104.5% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.6/2023 dhe 98.7% të planit përfundimtar me ndryshime dhe shpërndarje rezervash).*

Shpenzimet korente për vitin 2023 rezultuan në nivelin rreth 23.7% të PBB nominale vjetore, kundrejt një mesatare prej rreth 24.4% të këtij raporti në vitet pararendëse. Krahasuar me 2022, ato rezultuan 9.4% më të larta ose rreth 47 miliardë LEK më shumë. Zërat kryesorë që ndikuan në rritjen e shpenzimeve korrente për vitin 2023 janë:


- ✓ *Shpenzimet e personelit të cilat, krahasuar me 2022, rezultuan 18.6% më të larta ose rreth 15.8 miliardë LEK më shumë, kushtëzuar kjo nga efekti financiar i rritjes së nivelit të pagave sipas VKM-ve përkatëse dhe për rrjedhojë edhe e rritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore.*
- ✓ *Shpenzimet për fondet speciale të cilat, krahasuar me vitin 2022, rezultuan 4.7% më të larta ose rreth 10.3 miliardë LEK më shumë, kushtëzuar kjo nga fondet e akorduara shtesë për shpërblimin e pensionistëve dhe mbështetjen financiare të disa kategorive të personave që përfitojnë pension invaliditeti dhe pension familjar, si dhe akordimi i fondeve shtesë për sigurimet shëndetësore për shkak të rritjes së nivelit të pagave.*
- ✓ *Shpenzimet për buxhetin vendor të cilat, krahasuar me vitin 2022, rezultuan 17.3% më të larta ose rreth 10.1 miliardë LEK më shumë. Kjo vjen kryesisht nga shpenzimet e personelit të cilat rezultojnë me një rritje prej afërsisht 18% ose rreth 4.4 miliardë LEK më shumë se viti 2022, kushtëzuar kjo nga efekti financiar i rritjes së nivelit të pagave. Gjithashtu, vihet re rritje e konsiderueshme edhe e shpenzimeve për investime me rreth 4.6 miliardë LEK ose rreth 39% kundrejt 2022, ndikuar nga rritja e transfertës qendrore duke i dhënë mundësinë NJVQV të financojnë më shumë shërbime publike dhe investime që përmirësojnë drejtpërdrejt jetën e qytetarëve.*
- ✓ *Shpenzimet për interesa të cilat, krahasuar me 2022, janë 20.1% më të larta ose rreth 8 miliardë LEK më shumë.*

Grafiku 27 Shpenzimet korente dhe ritmi i rritjes së tyre (milion LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Grafiku 28 Struktura e shpenzimeve korrente (milion LEK)




Burimi: Ministria e Financave (2024)

Shpenzimet e Personelit për vitin 2023, përfaqësuan 18.4 % të totalit të shpenzimeve korente. Niveli i shpenzimeve faktike të personelit prej rreth 100.5 miliardë LEK, rezulton 103.6 % e planit vjetor sipas buxhetit fillestar, 104.5 % e planit të ndryshuar me AN nr.6/2023 dhe 98.7 % e planit përfundimtar me ndryshime dhe shpërndarje rezervash. Krahasuar me vitin 2022, ky zë është 18.6 % më i lartë ose rreth 15.8 miliardë LEK më shumë.

Fondi "*Për Politika të reja Pagash*", i planifikuar në masën 2.3 miliardë LEK në Ligjin nr.84/2022 "*Për buxhetin e vitit 2023" të ndryshuar",* është përdorur për përballimin e efekteve financiare të ndryshimit të nivelit të pagave, si vijon:

- ✓ *Akorduar MSHMS në masën 1 249 milionë LEK*
- ✓ *Akorduar MAS në masën 1 051 milionë LEK*

Grafiku 29 Shpenzimet e personelit në vite dhe ritmi i rritjes (miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Shpenzimet për Interesa për vitin 2023 kanë arritur nivelin 47.6 miliardë LEK duke përfaqësuar 8.7% të shpenzimeve korente. Niveli faktik i tyre ka rezultuar në masën 78.1% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar, 85% e planit vjetor sipas AN nr.6/2023 dhe po aq e planit përfundimtar me ndryshime dhe shpërndarje rezervash. Krahasuar me vitin 2022, ky zë ka rezultuar 20.1% më i lartë ose rreth 8 miliardë LEK më shumë.


Grafiku 30 Shpenzimet për interesa në vite dhe ritmi i rritjes (miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Shpenzimet Operative & Mirëmbajtje për vitin 2023, kanë shënuar një realizim në masën rreth 70.5 miliardë LEK ose 108.1% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar, 96.6% të planit vjetor sipas AN nr.6/2023 dhe 91.6% e planit përfundimtar me ndryshime dhe shpërndarje rezervash. Krahasuar me vitin 2022, ky zë ka rezultuar 2.9% më i lartë ose rreth 2 miliardë LEK më shumë.


Grafiku 31 Shpenzimet operative e të mirëmbajtjes dhe ritmi i rritjes vjetore (miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Shpenzimet për Subvencione, për vitin 2023, arritën nivelin rreth 1.9 miliardë LEK, me një realizim në masën 119.1% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar, 118.6% e planit vjetor sipas AN nr.6/2023 dhe 85.9% e planit përfundimtar me ndryshime dhe shpërndarje rezervash. Ndërkohë që, krahasuar me vitin 2022 shpenzimet për subvencione rezultojnë 15.5% më të larta ose 256 milionë LEK më shumë.

Grafiku 32 Shpenzimet per subvencione dhe ritmi i rritjes (miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Shpenzimet për Fondet Speciale për vitin 2023 rezultuan në nivelin rreth 226.8 miliardë LEK, me një realizim prej 100.2% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar, 100.9% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.6/2023 dhe 98.4% e planit përfundimtar me ndryshime dhe shpërndarje rezervash. Përkatësisht:


- ✓ *Shpenzimet për Sigurime Shoqërore u realizuan në masën rreth 170.2 miliardë LEK, duke rezultuar 105.4% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar, 106% e planit vjetor sipas AN nr.6/2023 dhe 99.4% e* planit përfundimtar me ndryshime dhe shpërndarje rezervash.
- ✓ *Shpenzimet për Sigurime Shëndetësore u realizuan në masën rreth 55.2 miliardë LEK, duke rezultuar 101.2% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe atij të ndryshuar sipas AN nr.6/2023, si edhe rreth 98.2 % e* planit përfundimtar me ndryshime dhe shpërndarje rezervash.
- ✓ *Shpenzimet për kompensimin e pronarëve u realizuan në masën rreth 1.34 miliardë LEK duke rezultuar 29.7% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar, 46.1% e planit vjetor të ndryshuar sipas AN nr.6/2023 dhe po aq sipas* planit përfundimtar me ndryshime dhe shpërndarje rezervash.

Fondi *"Për politika të reja pensionesh"*, i planifikuar në masën 3.2 miliardë LEK është përdorur në rreth 3 184 milionë LEK, në zbatim të VKM nr.553 datë 28.09.2023 "*Për indeksimin e pensioneve*", si më poshtë:

- ✓ *Akorduar MFE në masën 3 103,7 milionë LEK*
- ✓ *Akorduar MM në masën 80,3 milionë LEK*

Fondi *"Bonusi i pensionistëve",* i parashikuar në buxhetin fillestar në masën 3 530 milionë LEK, është akorduar për MF në zbatim të VKM nr.654 datë 30.11.2023 "*Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit*".

Grafiku 33 Shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2024)


Shpenzimet për Papunësinë për vitin 2023 janë realizuar në masën 858 milionë LEK ose 95.3% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar, 96% e planit vjetor të ndryshuar me AN nr.6/2023 dhe 98.7% e planit përfundimtar me ndryshime dhe shpërndarje rezervash. Krahasuar me vitin 2022, shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 15.1%, ose 112 milionë LEK më shumë.

Shpenzimet për Ndihmën Ekonomike dhe Pagesën e Paaftësisë (PAK) për vitin 2023 u realizuan në masën rreth 25.7 miliardë LEK duke rezultuar 99% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar, 97.6% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.6/2023 dhe 98.2% e planit përfundimtar me ndryshime dhe shpërndarje rezervash. Krahasuar me vitin 2022, shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën rreth 1% ose 222 milionë LEK më shumë.

Shpenzimet për kompensimin e ish-të përndjekurve politik, për vitin 2023 u realizuan në masën rreth 1.1 miliardë LEK duke rezultuar 109.8 % e planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 99.8 % e planit vjetor të ndryshuar me AN nr.6 dhe e planit vjetor me ndryshime, shpërndarje rezervash. Krahasuar me vitin 2022 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje prej 10.2 % ose 101 milionë LEK më shumë.

Shpenzimet për bonusin e lindjeve për vitin 2023 u realizuan në masën rreth 3.3 miliardë LEK duke rezultuar 150.3% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe atij të ndryshyar me AN nr.6/2023, si edhe 100% e planit përfundimtar me ndryshime dhe shpërndarje rezervash. Krahasuar me vitin 2022, shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 6.6% ose 206 milionë LEK më shumë.


Grafiku 34 Shpenzimet per ndihmën ekonomike, PAK dhe papunësinë (miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Shpenzimet kapitale për vitin 2023 (përfshirë Fondin e Rindërtimit) rezultuan rreth 119.1 miliardë LEK ose 96.1% të planit fillestar dhe 88.1% e planit të ndryshuar me AN nr.6/2023. Krahasuar me vitin 2022, ky zë është 6.2% më i lartë ose rreth 6.9 miliardë LEK më shumë. Investimet me financim të brendshëm u realizuan në masën 88.5 miliardë LEK ose rreth 96.4% e planit fillestar. Shpenzimet kapitale për procesin e rindërtimit u realizuan në masën 16.2 miliardë LEK ose 95.3% kundrejt planit të ndryshuar me AN nr.6/2023, prej 17 miliardë LEK. Ndërkohë, investimet me financim të huaj shënuan ulje krahasuar me vitin 2022 me një realizim në masën 13.8 miliardë LEK ose 30% të planit fillestar dhe 54.3% të planit sipas AN nr.6/2023.

Grafiku 35 Shpenzimet Kapitale dhe burimi i financimit të tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Fondet buxhetore të alokuara për investime kanë prekur fusha të rëndësishme të ekonomisë. Prioritetet e buxhetit 2023 për shpenzimet kapitale ishin kryesisht në fushën e: infrastrukturës, ujësjellës-kanalizimeve, transporti rrugor, shëndetësisë, mbrojtjes, etj. Realizimi i investimeve në total ka qenë në nivele të larta, veçanërisht për financimin e brendshëm. Në përgjithësi ecuria e realizimit të shpenzimeve kapitale ka vijuar pa problematika thelbësore që ndikojnë qëndrueshmërinë financiare të buxhetit. Problematikë për vitin 2023 ishte realizimi i projekteve me financim të huaj, kryesisht projekte të financuara me grant. Për pasojë, Qeveria, nëpërmjet dy akteve normative, ndërmori rishikimin në ulje të tavaneve buxhetore të këtij zëri, për institucionet përkatëse.

Me buxhetin e vitit 2023, janë **financuar dhe mbyllur rreth 310 projekte të rëndësishme** investimesh me financim të brendshëm, me vlerë të plotë projektesh me **rreth 28.3 miliardë LEK**. Konkretisht:

- ✓ *Janë mbyllur 12 projekte investimi të transportit rrugor me vlerë totale rreth 7.7 miliardë LEK.*
- ✓ *Janë mbyllur 20 projekte investimi për sisteme armatimi, ndërtim depo për pajisjet e kërkim shpëtimit, fatkeqësi Natyrore të Menaxhuara, etj me vlerë totale rreth 5.2 miliardë LEK.*
- ✓ *Janë mbyllur 10 projekte investimi për ujësjellësa dhe kanalizime me vlerë totale 2.8 miliardë LEK.*
- ✓ *Janë mbyllur 47 projekte të rëndësishme për rikonstruksione/ndërtime shkollash, universitetesh dhe ambientesh me vlerë totale projektesh prej 2.3 miliardë LEK.*
- ✓ *Kanë përfunduar 8 projekte në fushën kulturore me vlerë totale 2.1 miliardë LEK.*
- ✓ *Janë mbyllur 31 projekte investimi për përmirësimin e kanaleve ujitëse në disa zona, ndërtimi i argjinaturave të lumenjve dhe mbrojtja prej tyre, etj me vlerë totale rreth 1.1 miliardë LEK.*
- ✓ *Janë mbyllur 12 projekte për përshtatje mjedisesh pune drejtoritë vendore të Policisë, janë blerë paisje, etj me vlerë totale projektesh prej 1.1 miliardë LEK.*
- ✓ *Në fushën e strehimit social kanë përfunduar 16 projekte në bashkitë Berat, Delvinë, Devoll, Elbasan, Patos, Gjirokaster, Kolonje, Korce, Kucove, Librazhd, Mallakastër, Pogradec, Prrenjas, Këlcyrë, Vau i Dejës, Selenicë në vlerën 955 milionë LEK.*
- ✓ *Janë mbyllur 55 projekte për rikonstruksione të ambieneteve në disa spitale dhe poliklinika, qendra shëndetësore, furnizim dhe vendosje pajisjesh spitalore etj me vlerë totale projektesh prej 832 milionë LEK.*
- ✓ *Në fushën e menaxhimit të mbetjeve ka përfunduar "Hartimi i planeve te Pergjithshme Vendore" me vlerë rreth 400 milionë LEK.*
- ✓ *Janë mbyllur 16 projekte në fushen e Këshillimi i Informacionit Bujqësor për modernizimin e kerkimit teknologjik ne sektorin e bujqesise dhe blegtorise, pajisje e makineri me vlerë totale rreth 304 milionë LEK.*
- ✓ *Janë mbyllur 7 projekte në fushën e zhvillimit rural për sisteme aplikimi online për skemat IPARD e sisteme të tjera dhe përmirësimin e informacionit për skemat kombëtare me vlerë totale rreth 249.6 milionë LEK.*
- ✓ *Janë mbyllur disa projekte kryesisht për përmirësimin e sistemit të ndricimit me efiçencë të lartë energjie me vlerë rreth 240 milionë LEK.*
- ✓ *Janë mbyllur 4 projekte kryesore për ngritjen e infrastrukturës turistike, me vlerë totale 233 milionë LEK*

4.2 Shpenzimet sipas natyrës funksionale

Sektori me peshën më të lartë në shpenzimet buxhetore është 'Mbrojtja sociale', me 31% të shpenzimeve të përgjithshme publike në vitin 2023, e dominuar nga shpenzimet për fondin e pensioneve si edhe programet në mbështetje të familjeve dhe individëve në nevojë (*ndihma ekonomike dhe aftësia e kufizuar*). Ndërkohë, Shëndetësia dhe Arsimi përbëjnë 10% të shpenzimeve të përgjithshme publike në vitin 2023; Çështjet Ekonomike dhe Strehimi përbëjnë përkatësishit 13% dhe 8%; dhe Shpenzimet e përgjithshme publike 16%.

Tabela 10 Shpenzimet sipas funksionit (në milionë LEK)

Nr	Emertimi	Plani fillestar 2023	Plani ne % ndaj totalit	2023 (fakt)	fakti ne % ndaj totalit	2023 (fakt i korrigjuar)	2023 (fakt i korrigjuar)	fakti i korrigjuar (ne % te planit)
01	Sherbimet e Pergjithshme Publike *	50,081	7%	110,444	16%	40,194	8%	80%
02	Mbrojtja	25,920	4%	19,494	3%	19,301	4%	74%
03	Rendi dhe Siguria Publike	37,070	5%	45,191	7%	36,774	7%	99%
04	Ceshtjet Ekonomike	54,511	8%	88,888	13%	67,452	13%	124%
05	Mbrojtja e Mjedisit	1,203	0%	7,185	1%	531	0%	44%
06	Strehimi dhe Komoditetet e Komunitetit	36,190	5%	51,650	8%	32,680	6%	90%
07	Shendetesia	65,728	9%	64,697	10%	61,460	12%	94%
08	Argetimi, Kultura dhe Ceshtjet Fetare	5,432	1%	11,805	2%	5,400	1%	99%
09	Arsimi	51,048	7%	68,220	10%	48,159	10%	94%
10	Mbrojtja Sociale	198,175	28%	207,281	31%	194,364	38%	98%
	Te paklasifikuara	172,757	25%			0	0%	0%
	TOTALI	698,117	100%	674,855	100%	506,315	100%	73%

** Ne zerin "Shpenzime te tjera te paklasifikuara" (Totali) jane perfshire: (i) pagesat per sherbimin e borxhit, (ii) kontigjenca per politika pagash dhe pensionesh, (iii) fondi rezerve, (iv) shpenzimet e pushtetit vendor dhe (v) fondi i rindertimit*

Plani fillestar i vitit 2023 kishte parashikuar po këto nivele, pak a shumë të ngjashme, të peshave relative të shpenzimeve sipas klasifikimit funksional, kundrejt një viti më parë. Në shmangien e vërejtur kundrejt rezultatit faktik 2023, ka ndikuar shpërndarja gjatë vitit 2023 e atyre shpenzime të paklasifikuara të lidhura respektivisht me shërbimin e borxhit, shpenzimet e pushtetit vendor, fondin rezervë, fondin e kontigjencës, fondin e rindërtimit. Në çdo rast, rezultati faktik i korrigjuar tregon nivele të kënaqshme të realizimit të planit sipas funksioneve për vitin 2023.

4.3 Ndryshimet në ligjin e buxhetit 2023

Gjatë vitit 2022, buxheti i shtetit u ndryshua me 2 Akte Normative dhe më specifikisht:

1) <u>Akti Normativ Nr.5 datë 18.10.2023</u> *<u>"Për disa ndryshime në Ligjin nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023":</u>*

Pas vlerësimit të ecurisë 9 mujore të treguesve fiskalë, Qeveria inicioi rishikimin e parë të buxhetit 2023, me fokus realizimin në terma optimal të vitit buxhetor 2023 sa i takon performancës së shpenzimeve, të ardhurave dhe qëndrueshmërisë së parametrave fiskalë. Deri nw atw moment, shpenzimet publike ishin karakterizuar nga kursime të larta si pasojë e situatës të përmirësuar energjitike, shpenzimeve për interesa më të ulëta se pritshmëritë dhe ngadalësisë në disa projekte investimesh publike, sidomos me financim të huaj, të cilat për shkak të vonesave kryesisht proceduriale arritwn disbursimet e planifikuara. Ndërkohë, zbatimi i projekteve të brendshme, në veçanti proçesi i Rindërtimit, tejkaluan pritshmërinë ndaj mund të përshpejtoheshin përmes rialokimit të fondeve shtesë.
Ky Akt Normativ ka patur synim kryesor:

- *Reflektimin në kahun e të ardhurave të një rritje prej rreth 7.5 miliardë LEK, si rezultat i performancës pozitive në realizimin e të ardhurave tatimore për 9 mujorin 2022.*
- *Rishpërndarjen e 45.8 miliardë LEK mes zërave të shpenzimeve buxhetore, korente e kapitale, me synimin e realizimit sa më të plotë të shpenzimeve publike për pjesën e mbetur të vitit 2023.*
- *Ruajtjen të pandryshuar të deficitit buxhetor, kundrejt buxhetit fillestar 2023. Ndërkohë që, borxhi publik reflekton uljen e financimit nga projektet e huaja dhe rritjen e financimit të instrumenteve të tjera financiare si Eurobond dhe mbështetja buxhetore.*

Është me rëndësi të theksohet që ndryshimet e propozuara nuk prekën defiçitin buxhetor, i cili mbeti i pandryshuar.

2) **Akti Normativ Nr.6 datë 14.12.2023** *"Për disa ndryshime në Ligjin nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023, i ndryshuar"*:

Mbështetur në vlerësimin 11 mujor të treguesve fiskalë, Qeveria ndërmori procesin e rishikimit të fundit të buxhetit 2022, i cili pati për qëllim primar shpërndarjen e një pakete të re të fundvitit për shtresat më vulnerabël në formën e shpërblimeve të menjëhershme për disa sërë kategori në nevojë, por njëkohësisht duke mbajtur në fokus garantimin e finalizimit në terma optimal të vitit buxhetor sa i takon performancës së shpenzimeve, të ardhurave dhe qëndrueshmërisë së parametrave makroekonomikë në tërësi. Aspekti i nevojës për këtë AN, lidhej me:

- *Rishpërndarjen e një volumi prej rreth 20 miliardë LEK mes zërave të shpenzimeve buxhetore, korente e kapitale, me synimin e realizimit sa më të plotë të shpenzimeve publike për pjesën e mbetur të vitit 2023. Kjo rishpërndarje pati një efekt neutral në buxhet, pasi u mbulua tërësisht nga fondet e lira të rezultuara pas vlerësimit të realizimit në nivel 11 mujor të shpenzimeve të institucioneve buxhetore. Kursimet konsistonin kryesisht në zërat e shpenzimeve të personelit si rrjedhojë e mosplotësimit të vakancave në numrin e punonjësve, si edhe projekteve të investimeve publike me financim të brendshëm e të huaj si rrjedhojë e performancës më të ulët sesa planifikimi të disa prej tyre.*
- *Drejtimin kryesor të shpenzimeve në këtë AN, ndër të tjera, e zuri alokimi i një fondi prej rreth 1.43 miliardë LEK në zërin 'Kontigjencë' për t'u përdorur me VKM, me qëllim mbështetjen financiare të disa kategorive më vulnerabël të shtresave sociale dhe konkretisht:*
  - *Shpërblimi i kategorive në Ndihmë Ekonomike në masën 5.000 LEK për rreth 64.000 përfitues;*
  - *Shpërblimi i kategorisë PAK në masën 5.000 LEK për rreth 73.000 përfitues;*
  - *Shpërblimi shtesë në masën 5.000 LEK për rreth 36.000 familje me fëmijë në Ndihmë Ekonomike;*
  - *Shpërblimi shtesë në masën 5.000 LEK për rreth 68.000 invalidë të punës;*
  - *Shpërblimi në masën 5.000 LEK për rreth 44.000 pensione familjare.*

Në këndvështrimin e parametrave makroekonomikë, ndryshimet e propozuara në këtë akt normativ ruajtën të pandryshuar nivelin e defiçitit buxhetor kundrejt ligjit të buxhetit fillestar 2023. Kjo, krahas targetimit të një niveli më të ulët të borxhit publik në raport me PBB, krahasuar me nivelin faktik të një viti më parë si dhe me nivelin e parashikuar në buxhetin fillestar 2023, duke siguruar kësisoj vijimësinë e konsolidimit fiskal dhe qëndrueshmërisë afatmesme dhe afatgjatë të financave publike dhe stabilitetin makroekonomik në tërësi

4.4 Rezervat dhe Kontigjencat

Fondi Rezervë i buxhetit të shtetit i planifikuar në ligjin fillestar 2023 për 3.5 miliardë LEK, përkatësisht 1.7 miliardë LEK për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe 1.8 miliard LEK për përballimin e kostos së zgjedhjeve, është rishikuar me aktet normative të miratuara në vitin 2023 dhe konkretisht:

- ✓ *Akti Normativ nr.5 datë 18.10.2023 ndryshoi vlerën e planifikuar për raste të paparashikuara, duke e rritur në nivelin 2 miliardë LEK, ndërkohë që mbajti të pandryshuar fondin prej 1.8 miliardë LEK të parashikuar për përballimin e kostos së zgjedhjeve.*
- ✓ *Akti Normativ nr.6 datë 14.12.2023 ndryshoi sërish vlerën e planifikuar për raste të paparashikuara, duke e rritur në nivelin 2.2 miliardë LEK, krahas ruajtjes po të pandryshuar planin prej 1.8 miliardë LEK për përballimin e kostos së zgjedhjeve.*

Gjatë vitit 2023 rezultoi se:

- ✓ Fondi Rezervë për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme prej 2.2 miliardë LEK është përdorur në masën rreth 2.174 milionë LEK, nga të cilat:
  - *Rreth 536.4 milionë LEK ose 25% e planit janë akorduar për shpenzime personeli,*
  - *Rreth 858.2 milionë LEK ose 39% e planit për shpenzime operative dhe transferta të brendshme e të jashtme,*
  - *Rreth 779.7 milionë LEK ose 36% e planit për shpenzime kapitale.*
- ✓ Fondi Rezervë i Zgjedhjeve prej 1.8 miliardë LEK, është akorduar plotësisht në zbatim të VKM nr.38 datë 07.01.2023 *"Për një shtesë fondi në Buxhetin e vitit 2023, miratuar për KQZ, për organizimin e zgjedhjeve për organet e vetqeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023".*

Fondi i Kontigjencës u miratua në ligjin e buxhetit fillestar në shumën prej 12 miliardë LEK për t'u përdorur me VKM, ndërkohë që është rishikuar me aktet normative të miratuara në vitin 2023 dhe konkretisht:

- ✓ *Me AN nr.5/2023 ky fond arriti në 13.4 miliardë LEK;*
- ✓ *Me AN nr.6/2023 vlera e tij arriti nivelin 14.98 miliardë LEK, nga i cili rreth 1 000 milionë LEK u përdorën për pagesën e një pjese të diferencës së pages së magjistratit nga 1 janar 2019 e në vazhdim, ndërsa rreth 1 430 milionë LEK u përdorën për mbështetjen e shtresave në nevojë.*

Gjatë vitit 2023 ky fond është përdorur në masën rreth 14.96 miliardë LEK dhe konkretisht:

- ✓ *Për shpërblimin e pensionistëve, në masën prej 3 536 735 000 LEK.*
- ✓ *Për përballimin e efekteve financiare shtesë si rezultat i rritjes së pagave në zbatim të VKM përkatëse, në masën 9 006 000 LEK.*
- ✓ *Për pagesën e një pjese të diferencës së pages së magjistratit, në masën 1 miliardë LEK.*
- ✓ *Për mbështetjen e shtresave në nevojë, në masën 1 430 milionë LEK dhe përkatësisht:*
  - *Rreth 939.5 milionë LEK u akorduan për MSHMS, sipas VKM nr.766 datë 20.12.2023 "Për shpërblimin e disa kategorive të veçanta në fund të vitit".*
  - *Rreth 490.5 milionë LEK u akorduan për MF, sipas VKM nr. 819 datë 28.12.2023 "Për shpërblimin e kategorisë së personave që përfitojnë pension invaliditeti dhe pension familjar".*

Fondi i Kontigjencës për risqet e borxhit i planifikuar në masën 4.8 miliard LEK, deri më datë 31.12.2022 rezultoi i papërdorur.

Në mënyrë të detajuar fondet e akorduara paraqiten në ***Aneksin ç) "Tabela analitike e përdorimit të Fondit Rezervë dhe Kontigjencave 2023"****.*

4.5 Programi i Rindërtimit

Një paketë e veçantë ligjore që vijoi tërmetin shkatërrues të nëntorit 2019 përcaktoi rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve për menaxhimin e rindërtimit, si dhe mënyrën e financimit dhe procedurat përkatëse. Ministri i Shtetit për Rindërtim në bashkëpunim të ngushtë më Komisionin Shtëtëror të Rindërtimit, u caktuan si autoriteti përgjegjës për propozimin dhe bashkërendimin e programit. Me Aktin Normativ Nr.9 datë 16.12.2019 u krijua dhe Fondi i Rindërtimit, i cili konsiston në:

- *Një program të veçantë të buxhetit të shtetit, me të ardhura nga buxheti i shtetit dhe donatorë dhe*
- *Kontribute në natyrë nga donatorë*

Fondi i Rindërtimit shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi, si dhe kufijtë e transfertës së pakushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore në përputhje me vendimet përkatëse. Detajimi i tij u krye në përputhje me ecurinë e procedurave të ndërlikuara të identifikimit dhe vlerësimit të dëmeve; verifikimit të kërkesave për dëmshpërblime dhe projektimit e zbatimit të investimeve publike. Fondi i Rindërtimit për vitin 2023 u planifikua në masën 5 miliardë LEK, ku në nenin 7 të Ligjit nr.84/2022 *"Për buxhetin e vitit 2023"* është përcaktuar se:

"Fondi i rindërtimit për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019 prej 5 000 milionë LEKsh përdoret për të përballuar kostot për projektet e miratuara dhe të pafinancuara të viteve të mëparshme dhe pjesa e mbetur për projekte të reja.Ky fond shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi dhe kufijtë e transfertës së pakushtëzuar, të miratuar në tabelat 1 dhe 3, të përmendura në

nenet 11 e 15 të këtij ligji. Çdo e ardhur në formë granti, me destinacion përballimin e pasojave të tërmetit, rrit në të njëjtën masë të ardhurat dhe shpenzimet e fondit të rindërtimit, duke shtuar kufijtë e përcaktuar në nenet 1, 2, 3 e 11, si dhe kufijtë e miratuar në tabelat 1, 3 dhe 4 të përmendura në nenet 11 e 15 të këtij ligji."

Gjatë vitit 2023 fondet e planifikuara për rindërtimin u përdorën me Vendime të Këshillit të Ministrave, si mëposhtë:

- ✓ Fondet e pashpenzuara nga viti 2022 dhe të mbartura në 2023 janë:
  - *6 194 596 mijë LEK për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV)*
- ✓ Fondet e akorduara gjatë vitit 2023 janë 16 998 003 mijë LEK, nga të cilat:
  - *3 920 235 mijë LEK, shpenzime për Njësitë e Qeverisjes Qendrore (NJQQ)*
  - *13 077 768 mijë LEK për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV)*

Nga Fondi i Rindërtimit për njësitë e qeverisjes qendrore (NJQQ) deri në 31 dhjetor 2023, u akorduan fonde në projekte specifike në masën 3.9 miliardë LEK, nga të cilat u realizuan 3.8 miliardë LEK ose 97.4%, dhe konkretisht:

- ✓ FSHZH shpenzoi 3.66 miliardë LEK, nga 3.72 miliardë LEK të akorduara ose në masën 98% të planit.
- ✓ Ministria e Brendshme shpenzoi 147.9 milionë LEK, nga 147.9 milionë LEK të akorduara ose në masën 100%.
- ✓ Ministria e Drejtësisë, për arsye të mos realizimit të procedurës së prokurimit për shkak të mos transferimit të ambienteve të DAP, projekti prej 50.1 milionë LEK nuk u realizua.

Nga Fondi i Rindërtimit për njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVQV) deri në 31 dhjetor 2023, u akorduan fonde në projekte specifike në masën 13 miliardë LEK dhe 6.1 miliardë LEK janë trashëguar në buxhetin e vitit 2023, si fonde të papërdorura nga viti 2022. Nga këto, u shpenzuan nga njësitë zbatuese 12.4 miliardë LEK ose 65% e fondeve të akorduara, ndërsa pjesa tjetër është mbartur në buxhetin e vitit 2024 në formën e transfertës së pakushtëzuar për NJVQV, në përputhje me parashikimet e veçanta ligjore. Shpërndarja e fondit të rindërtimit për vitin 2023, për fondet e akorduara sipas VKM-ve bashkë me pjesën e trashëgimit sipas NJVQV, rezulton si mëposhtë:

- ✓ Bashkia Tiranë ka realizuar 3.8 miliard LEK nga 6.1 miliard LEK ose 63%,
- ✓ Bashkia Durrës ka realizuar 2.7 miliard LEK nga 4.5 miliard LEK ose 60%,
- ✓ Bashkia Kamëz ka realizuar 1.3 miliard LEK nga 1.7 miliard LEK ose 80%,
- ✓ Bashkia Kavajë ka realizuar 1 miliard LEK nga 1.3 miliard LEK ose 81%,
- ✓ Bashkia Krujë ka realizuar 1 miliard LEK nga 1.4 miliard LEK ose 72%,
- ✓ Bashkia Kurbin ka realizuar 902.2 milion LEK nga 1.9 miliard LEK ose 47%,
- ✓ Bashkia Lezhë ka realizuar 279.7 milion LEK nga 477.3 milion LEK ose 59%,
- ✓ Bashkia Rrogozhinë ka realizuar 245.2 milion LEK nga 485.9 milion LEK ose 50%,
- ✓ Bashkia Mirditë ka realizuar 522.7 milion LEK nga 563.1 milion LEK ose 93%,
- ✓ Bashkia Shijak ka realizuar 224.7 milion LEK nga 310 milion LEK ose 73%,
- ✓ Bashkia Vorë ka realizuar 341.1 milion LEK nga 478.1 milion LEK ose 71%.

Në mënyrë të detajuar fondet e akorduara sipas VKM-ve, paraqiten në **Aneksin b) "Tabela analitike e përdorimit të Fondit të Rindërtimit 2023"**.

5. BUXHETI VENDOR

Fokusi kryesor në buxhetin e vitit 2023 për Ministrinë e Financave ka qënë vazhdimi i konsolidimit të procesit të menaxhimit financiar në nivel vendor në funksion të vazhdimit të zbatimit të procesit të decentralizimit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore. Ministria e Financave ka vijuar me reformimin e financave publike vendore, duke u fokusuar në rritjen e investimeve, digjitalizimin e operacioneve të menaxhimit financiar në nivel vendor, dhe nxitjen e rritjes së të ardhurave nga taksat vendore. Gjatë 2023, janë ruajtur ngushtësisht treguesit pozitiv të rritjes së rolit të pushtetit vendor në forcimin e kapacitetit fiskal por gjithashtu edhe në rëndësinë e shërbimeve publike. Kjo është reflektuar në sigurimin për pushtetin vendor të një pakete më të gjerë të mbështetjes financiare për mbulimin e funksioneve të transferuara në nivel vendor, që u reflektua edhe në realizimin e treguesve fiskalë të financave vendore gjatë vitit 2023.

Konsolidimi i buxhetit vendor në 3% të PBB apo mbi 10% të buxhetit të shtetit, tregon qartazi potencialin në rritje të pushtetit vendor për ofrimin e shërbimeve. Një ndër treguesit më të rëndësishëm të konsolidimit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore është rritja e aftësive të tyre për të siguruar të ardhura nga burimet e veta dhe arkëtimin e tyre në mënyrë të qëndrueshme në kohë. Gjatë 2023, u sigurua një rritje e rëndësishme e të ardhurave në raport me planin, tregues ky i kapacitetit në rritje të njësive për të siguruar qëndrueshmërinë e financimit të funksioneve.

Disa prej treguesve më të rëndësishëm gjatë vitit 2023, që mbështetën përmirësimin në proceset e menaxhimit të financave vendore, paraqiten si më poshtë:

- ✓ *Rritja e mbështetjes së dhënë nga buxheti qëndror për pushtetin vendor në formën e transfertave (transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale) nga 29.3 miliard LEK në vitin 2022, në rreth 33.9 miliard LEK në vitin 2023 që do të thotë rreth 15.7% më shumë financim nga pushteti qendror.*
- ✓ *Përmirësimi i menaxhimit të financave vendore nëpërmjet rritjes së peshës së taksave lokale në të ardhurat vendore. Ndërkohë të ardhurat tatimore të pushtetit vendor në tërësi në vitin 2023 kanë pësuar një rritje me mbi 4 miliard LEK ose rreth 15% më shumë se në vitin 2022;*
- ✓ *Akordimi në buxhetin e vitit 2023 për njësitë e vetëqeverisjes vendore, e transfertës për shlyerje detyrimesh në masën 2 miliard LEK, për të mbështetur bashkitë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura si dhe për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve publike ndaj qytetarëve;*
- ✓ *Shpërndarja e Tatimit mbi të Ardhurat Personale për bashkitë në vlerën 1,153 milion LEK;*
- ✓ *Akordimi në buxhetin e vitit 2023 për njësitë e vetëqeverisjes vendore e transfertës së pakushtëzuar për mbulimin e shpenzimeve të veprimtarive dhe të funksioneve të njësive të vetëqeverisjes vendore me veshtirësi financiare, në masën 220 milion LEK;*
- ✓ *Është mbështetur financiarisht rritja pagave sipas VKM-ve përkatëse, për punonjësit e funksioneve sektoriale me një fond prej 400 milion LEK (për funksionin e arsimit parashkollor (edukatorë + punonjës në Qendrat Kulturore të Fëmijëve+punonjës mbështetës), për funksionin e arsimit parauniversitar, funksionin e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, për funksionin e ujitjes dhe kullimit dhe për funksionin e administrimit të pyjeve).*

- ✓ *Është mbështetur financiarisht nga buxheti qendror rritja pagave për pushtetin vendor sipas VKM nr.328 datë 31.5.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", me një fond prej 743.1 milionë LEK.*
- ✓ *Ka vazhduar reforma e iniciuar nga Qeveria në taksën e pasurisë, reflektuar në rritjen e të ardhurave të pushtetit vendor nga kjo taksë, e cila vazhdon e stabilizuar me tendencë rritëse edhe në vitin 2023.*

Nga analiza e treguesve financiarë të pushtetit vendor gjatë vitit 2023, janë evidentuar disa nga arritjet dhe problematikat kryesore si më poshtë:


- ✓ *Konsolidimi fiskal dhe qëndrueshmëria e financave të pushtetit vendor gjatë vitit 2023, një tregues i rëndësishëm i forcimit të aftësisë së pushtetit vendor për ofrimin e shërbimeve publike.*
- ✓ *Konsolidimi i procedurave të buxhetimit dhe sistemi i menaxhimit të financave vendore në të gjithë etapat, që nga hartimi i PBA tek zbatimi dhe monitorimi i tij; harmonizimi dhe unifikimi i procedurave për hartimin, zbatimin, raportimin, monitorimin e buxheteve të NJVQV, në përputhje me standardet ndërkombëtare;*
- ✓ *Zbatimi i metodologjisë për hartimin e PBA në nivel produkti buxhetor; Monitorimi i pilotimit të tre bashkive në përgatitjen e buxhetit me një numër të reduktuar programesh dhe detajimin deri në nivel produkti; Faza e re e pilotimit për hartimin e PBA, arriti në 9 bashki në vitin 2023.*
- ✓ *Prezantimi dhe përdorimi i treguesve të performancës në PBA dhe ndikimi pozitiv në rritjen e cilësisë së monitorimit të zbatimit të buxhetit vendor;*
- ✓ *Monitorimi i vazhdueshëm i treguesve fiskalë të zbatimit të buxhetit, në funksion të zbatimit të politikave buxhetore që do të rrisin efikasitetin dhe efektshmërinë e përdorimit të fondeve publike në nivel vendor;*
- ✓ *Hartimi i raporteve periodike të menaxhimit të vështirësive financiare, si një detyrim ligjor për të monitoruar situatën financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore; publikimi i raportit vjetor "Mbi statusin e vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore";*
- ✓ *Realizimi i trajnimeve, takimeve dhe konsultimeve të vazhdueshme me NJVQV në kuadër të masave të marra nga Ministria e Financave për menaxhimin financiar në nivel vendor, si një hap parapërgatitor për zbatimin e sistemit AFMIS në nivel vendor në një periudhë afatmesme.*

✓ *Detyrimet e prapambetura paraqiten me një përmirësim të dukshëm për vitin 2023, me një ulje rreth 0.59 miliardë LEK nga viti 2022. Gjatë vitit 2023, Ministria e Financave në mënyrë të vazhdueshme ka ndjekur dhe monitoruar procesin e menaxhimit financiar në nivel vendor dhe përmes tij vlerësimin e treguesve të përformacës së NJVQV. Në vitin 2023 Ministria e Financave ka përgatitur dhe publikuar raportin e gjendjes financiare për të 61 bashkitë për vitin 2022, ku ka rezultuar se 49 bashki dhe 9 qarqe janë pa probleme financiare, 8 bashki dhe 1 qark kanë probleme financiare dhe 4 bashki 2 qarqe janë me vështirësi financiare. Për këto të fundit, është hartuar një plan rehabilitimi për daljen nga situata e problemeve/vështirësisë financiare i cili do të vijojë të zbatohet edhe gjatë vitit 2024. Në këtë drejtim, janë përgatitur raporte periodike në funksion të transparencës, përgjegjshmërisë dhe pjesëmarrjes së të gjitha grupeve të interesit në procesin e administrimit financiar vendor. Gjithashtu, është monitoruar periodikisht edhe plani i shlyerjes së detyrimeve për bashkitë me vështirësi financiare për daljen nga kjo situatë. Ky proces monitorimi do të vazhdojë periodikisht edhe në vitin 2024, duke zbatuar me përpikmëri detyrimet ligjore dhe nënligjore mbi statusin e vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.*

5.1 Të ardhurat e njësive të vetëqeverisjes vendore

Rritja e të ardhurave nga burimet e veta të NJVQV është synim i menaxhimit financiar publik në nivel vendor dhe një nga shtyllat më të rëndësishme të decentralizimit fiskal. Megjithatë NJVQV, përveç të ardhurave nga burimet e veta, përfitojnë gjithashtu të ardhura në formën e transfertave nga qeveria qendrore, ku rolin më të rëndësishëm e zë transferta e pakushtëzuar e përgjithshme, që përbën një burim konstant dhe të qëndrueshëm për pushtetin vendor në masën jo më pak se 1% e PBB. Për vitin 2023 transferta e pakushtëzuar e përgjithshme kapi nivelin 1.04% e PBB, me një rritje prej 28% kundrejt vitit 2022, kushtëzuar edhe nga rritja e PBB në vitin 2023, që përkthehet drejtëpërdrejt në më shumë financim për NJVQV. Të dhënat në vlera dhe trendi i ecurisë së saj në vite, paraqiten në grafikun e mëposhtëm:


Grafiku 36 Transferta e pakushtëzuar dhe ritmi i ndryshimit në vite



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Sa i përket të ardhurave e veta vendore të klasifikuara sipas natyrës së burimit të tyre (tatimore dhe jotatimore) për vitin 2023, këto burime kanë vazhduar trendin rritës kundrejt viteve të mëparshme dhe kanë pësuar rritje krahasuar edhe me vitin 2022. Për vitin 2023, NJVQV në shkallë kombëtare kanë mbledhur të ardhura tatimore në masën 31 686 milionë LEK, shifër kjo që është rreth 4 048 milionë LEK më shumë ose rreth 14.6% më e lartë se vlera e të ardhurave të mbledhura gjatë vitit 2022 (27 638 milionë LEK). Ndërkohë, referuar të dhënave mbi të ardhurat jotatimore, për vitin 2023 janë mbledhur rreth 3 265 milionë LEK nga ky burim. Në total, pushteti vendor ka mbledhur të ardhura të veta rreth 4 miliardë LEK më shumë në vitin 2023, kundrejt një viti më parë. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet ecuria e realizmit të këtyre burimeve gjatë viteve 2019-2023:


Grafiku 37 Realizimi i të ardhurave tatimore dhe jotatimore (në milion LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Të ardhurat e pushtetit vendor në vite kanë ruajtur një trend të ndjeshëm rritjeje, duke përcaktuar në këtë mënyrë ecurinë pozitive të aftësisë së pushtetit vendor për të siguruar të ardhura, një konfirmim ky i efekteve pozitive të decentralizimit pavarësisht sfidave të viteve të fundit me të cilat është përballur vendi në tërësi. Nga viti 2015 e në vazhdim, me përjashtim të vitit 2020, të ardhurat tatimore të pushtetit vendor kanë ruajtur tendencën pozitive duke provuar në këtë mënyrë që roli i pushtetit vendor në potencialin fiskal për të ofruar shërbime të rritet ndjeshëm. Duke ju referuar të dhënave të treguesve fiskalë në vite për të ardhurat tatimore të pushtetit vendor, rezultati paraqitet si më poshtë:


Grafiku 38 Të ardhurat e pushtetit vendor në vite dhe ritmi i ndryshimit



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Në të njëjtën kohë, kjo rritje e të ardhurave të pushtetit vendor ka bërë që raporti i tyre kundrejt totalit të të ardhurave publike dhe produktit të brendshëm bruto të ndryshojë dhe të jetë në rritje në vitet e fundit. Konkretisht gjatë vitit 2023, të ardhurat e pushtetit vendor në raport me të ardhurat publike kanë zënë 4.92% nga 4.83% që ishin në vitin 2022. Gjithashtu, pushteti vendor ka rritur rolin e tij në vite përmes kontributit në ekonomi duke ndryshuar raportin nga 0.82% e PBB në vitin 2015, në 1.37 % në vitin 2023. Megjithë rritjen e PBB prej rreth 8.1% në raport më të lartë se një vit më parë, të ardhurat e pushtetit vendor për 2023 zënë 1.37% të PBB nga 1.29% që ishin në vitin 2022 (sipas të dhënave të përditësuara), duke reflektuar kështu edhe rritjen e rolit të pushtetit vendor në drejtim të shërbimeve publike dhe funksioneve që ushtron.


Grafiku 39 Të ardhurat vendore në raport me totalin e të ardhurave publike dhe PBB



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Në lidhje me evidentimin e ecurisë së të ardhurave vendore sipas llojit të burimit të tyre, u vu re se pas ngadalësimit ekonomik gjatë vitit 2020, në vitin 2021 u rikthye trendi rritës i realizimit të këtyre burimeve për NJVQV, trend që ka vazhduar edhe në këto vite, ku reflektohet rritja e të ardhurave vendore në të gjithë llojet e tyre sipas burimit. Kjo ecuri tregohet edhe në grafikun e mëposhtëm, ku konstatohet një rritje me afërsisht 4 miliard LEK i të ardhurave të NJVQV në total, ku"Taksa e ndikimit në infrastrukturë" ka rritjen më të madhe prej rreth 2.9 miliardë LEK ose me rreth 28.7%, "Të ardhurat e tjera vendore" kanë gjithashtu rritje të madhe prej rreth 887 milionë LEK ose me rreth 15.3%, ndërsa "Tarifat e shërbimeve vendore" janë rritur me 1.7% nga viti i kaluar dhe "Taksa mbi pasurinë e paluajtshme" ka një rritje me rreth 0.7%. Kjo ecuri pozitive e të ardhurave të pushtetit vendor ka ndikim të drejtëpërdrejtë në përmirësimin e eficiencës së shërbimeve vendore.

Grafiku 40 Të ardhurat e veta të pushtetit vendor sipas burimit në vite



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Siç konstatohet edhe nga grafiku i mësipërm, ndër vite të ardhurat e pushtetit vendor kanë pësuar ndryshime si në vlerë ashtu edhe në strukturën e burimit të këtyre të ardhurave. Është e dukshme që "taksa mbi pasurinë" është rritur nga viti në vit dhe po ashtu edhe "taksat lokale".

Taksa mbi pasurinë

Taksa mbi pasurinë, është një burim mjaft i rëndësishëm vendor përmes së cilës NJVQV mund të zhvillojnë politika vendore nën diskrecionin e plotë të përdorimit. Vitet e fundit në politikat qeveritare, hartimi i metodologjisë së vendosjes së kësaj takse në bazë vlere, por dhe ndërtimi i një kadastre të detajuar mbi pronën, përbëjnë thelbin e reformës për këtë burim financimi të NJVQV. Duke ju referuar të dhënave të treguesve fiskalë në vite, duke filluar nga

viti 2014 e në vazhdim, kjo taksë ka patur trend rritës duke zënë rreth 19.5 për qind të peshës së të ardhurave tatimore në vitin 2023, ndërkohë që në raport me një vit më parë janë mbledhur 43 milionë LEK më shumë.

Taksa e Biznesit të vogël

Tatimi mbi biznesin e vogël në vite si pasojë e ndryshimeve fiskale, ka patur një rënie në peshën që zë në buxhetin vendor. Taksa mbi biznesin e vogël pas ndryshimeve fiskale ligjore më të fundit, është bërë zero (*Ligji nr.112/2020 "Për disa ndryshime në Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar"*). Nga realizimi faktik gjatë vitit 2023, rezulton se nga ky zë janë mbledhur rreth 60 milionë LEK, që përbëjnë vetëm 0.2% të totalit të burimeve tatimore të pushtetit vendor, të cilat përfaqësojnë detyrime të paguara me vonesë.

Taksat Lokale


Ato janë një ndër burimet më të rëndësishme të financimit. Rritja e të ardhurave nga taksat lokale, gjithmonë e më shumë po dëshmon konsolidimin në këndvështimin financiar të NJVQV. Në total për vitin 2023, të ardhurat nga taksat lokale zënë rreth 80.3% të të ardhurave të veta vendore, të cilat gjatë këtij viti kanë arritur në masën rreth 25.4 miliardë LEK ose rreth 4 miliardë LEK më shumë se një vit më parë. Kjo rritje me rreth 19% kundrejt vitit paraardhës, tregon njëkohësisht stabilitetin e qëndrueshëm të situatës ekonomike pas vështirësive të viteve të kaluara. Burimi që zë peshën më të madhe në të ardhurat nga taksat lokale është "*Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja*", me rreth 41.2 % të totalit të taksave lokale ose me rreth 37.3 % të totalit të të ardhurave të veta të pushtetit vendor.

Të tjera taksa/tarifa që zënë peshë të madhe në të ardhurat tatimore vendore janë *"Taksa e ndërtesës"* dhe "*Tarifat e pastrimit*", përkatësisht me peshë 13.5% dhe 13.6% të totalit të të ardhurave të pushtetit vendor për vitin 2023.

5.2 Shpenzimet e njësive të vetëqeverisjes vendore

Niveli i shpenzimeve për pushtetin vendor për vitin 2023 arriti në masën rreth 68.8 miliardë LEK, nga 58.7 miliardë LEK një vit më parë. Kjo përfaqëson një rritje prej 10.1 miliardë LEK ose rreth 17.3% në krahasim me shpenzimet vendore të vitit 2022 dhe një rritje të lehtë prej 0.23% në raport me PBB. Gjatë vitit 2023, luhatjet e ardhura nga efektet negative të disa viteve më parë tashmë janë stabilizuar dhe proceset e menaxhimit financiar publik në nivel vendor vazhduan në trendin pozitiv, gjë që dëshmohet edhe nga rritja 17.3% e shpenzimeve të buxhetit vendor në krahasim me vitin 2022. Në vitin 2023, shpenzimet e pushtetit vendor zënë rreth 3% të PBB nga 2.7% që ishin në 2022 (*sipas të dhënave të përditësuara*) dhe 10.2% në raport me shpenzimet e përgjithshme publike, nga 9.02% që ishin në 2022. Në mënyrë grafike, këto rezultate paraqiten si më pos:


Grafiku 41 Shpenzimet e buxhetit vendor ndaj PBB, në vite



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Në raport me vitin 2022, pushteti vendor gjatë vitit 2023 ka një rritje rreth 17.3% të shpenzimeve faktike, të cilat janë realizuar në vlerën 68.8 miliard LEK. Grafikisht ecuria e këtyre shpenzimeve në vite dhe raporti i ndryshimit të tyre kundrejt vitit paraardhës, paraqitet si më poshtë:


Grafiku 42 Shpenzimet e pushtetit vendor në vite dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Shpenzimet vendore gjatë vitit 2023, të detajuara sipas klasifikimit ekonomik, japin një panoramë të tillë: peshën më të madhe të shpenzimeve vendore e zënë shpenzimet e personelit me 43% të totalit. Në raport me një vit më parë konstatohet që të gjitha shpenzimet klasifikuar sipas natyrës ekonomike, kanë pësuar rritje. Shpenzimet për investime kanë një rritje me rreth 4,646 milionë LEK, ndërkohë që shpenzimet e personelit dhe ato operative kanë rritje përkatësisht me 4,456 milionë LEK dhe 618 milionë LEK, krahasuar me shpenzimet 2022. Sipas të dhënave në nivel llogarie ekonomike, struktura e shpenzimeve 2023 krahasuar me ato të 2022, rezulton në grafikun si më poshtë:

Grafiku 43 Shpenzimet e pushtetit vendor sipas klasifikimit ekonomik (në milionë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Në vitet e fundit, pavarësisht situatave të ndryshme, shpenzimet e pushtetit vendor sipas strukturës nuk kanë pësuar ndryshime të mëdha, por vihet re një tendencë pozitive e qendrueshmërisë dhe rritjes së shpenzimeve për investime dhe zgjerimi i shpenzimeve të mirëmbajtjes së aseteve që njësitë vendore zotërojnë, përmes shpenzimeve operative. Më poshtë është paraqitur në mënyrë të përmbledhur tabela analitike e ndryshimeve të të ardhurave dhe shpenzimeve në financat publike vendore gjatë 2023 krahasuar me 2022 dhe diferencat mes tyre në vlerë dhe në përqindje.

Tabela 11 Të ardhurat dhe shpenzimet e pushtetit vendor, sipas natyrës

Nr	E M Ë R T I M I	Fakt 12 mujori		Diferenca 2023-2022	
		2023	2022	në vlerë	në %
I.	**Të ardhura nga Pushteti vendor**	**31,686**	**27,638**	**4,048**	**114.6%**
I.1	*Taksa mbi pasurinë*	6,181	6,138	43	100.7%
I.2	*Taksa e biznesit të vogël*	*60*	*72*	*-12*	83.1%
I.3	*Taksa Lokale*	*25,445*	*21,428*	*4,017*	118.7%

II.	**Shpenzime nga Pushtetit Vendor**	**68,841**	58,696	**10,145**	**117.3%**
II.1	***Shpenzime Korente***	52,282	46,783	5,500	111.8%
	Personeli	*29,667*	*25,211*	4,456	117.7%
	Shpenzime Operative dhe Mirëmbajtje	*19,368*	*18,749*	618	103.3%
	Subvencione	*478*	*347*	131	137.7%
	Te tjera	*2,770*	*2,476*	294	111.9%
II.2	***Shpenzime Kapitale***	16,559	11,913	4,646	139.0%

Burimi: Ministria e Financave (2024)

Shpenzimet vendore të personelit përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale të NJVQV. Për vitin 2023, këto shpenzime janë realizuar në masën rreth 29.7 miliardë LEK, që rezulton në rritje prej afërsisht 18% ose rreth 4.4 miliardë LEK më shumë se viti 2022. Rritja e shpenzimeve të personelit nga NJVQV përbën ndryshim të ndjeshëm krahasuar me vitin e kaluar, pasi përveç një trendi natyror të rritjes që njësitë vendore realizojnë me qëllim motivimin e punonjësve për rritjen e cilësisë së shërbimeve, në kuadër të politikës së qeverisë për rritjen e pagave, gjatë vitit 2023 u rrit kufiri i pagës minimale si dhe nivelet e pagave të punonjësve sipas kategorive në tërësi. Këto shpenzime për vitin 2023 zënë rreth 43.1% të totalit të shpenzimeve të pushetit vendor.

Shpenzimet vendore operative zënë gjithashtu një vend të rëndësishëm, pasi janë shumë të nevojshme për mbarëvajtjen dhe ushtrimin e funksioneve. Për vitin 2023, këto shpenzime janë realizuar në masën rreth 19.4 miliardë LEK dhe rezultojnë më një rritje prej 3.3% në raport me një vit më parë ose rreth 618 milionë LEK më shumë. Shpenzimet operative në vitin 2023 përbëjnë rreth 28.1% të shpenzimeve të pushtetit vendor.

Shpenzimet vendore për subvencione dhe të tjera janë shpenzimet që zhvillojnë NJVQV për të subvencionuar dhe mbuluar funksione të tjera administrative. Subvencionet në vitin 2023 kanë pësuar gjithashtu një rritje të konsiderueshme me rreth 38% nga viti 2022 ose rreth 131 milionë LEK më shumë. Tashmë njësitë vendore planifikojnë në periudhë afatgjatë dhe mbështetur mbi strategji të qarta zhvillimi dhe ofrimi të shërbimit publik, që në mënyrë vazhdueshme të mbështesin me subvencione zhvillimin ekonomik të zonës nën juridiksionin e tyre. Kurse shpenzimet e tjera korente janë rritur me rreth 12% ose me 294 milionë LEK krahasuar me vitin 2022.

Shpenzimet kapitale vendore për vitin 2023 rezultojnë të realizuara në një vlerë të konsiderueshme prej rreth 16.6 miliardë LEK, duke zënë kështu rreth 24.1% të totalit të shpenzimeve vendore, që është edhe përqindja më e lartë e investimeve në vitet e fundit. Gjatë vitit 2023 vihet re rritje e konsiderueshme e tyre me rreth 4.6 miliardë LEK ose rreth 39% kundrejt vitit paraardhës, që përbën gjithashtu një tregues tepër pozitiv të stabilitetit ekonomik. Rritja e shpenzimeve për investime të pushtetit vendor në raport me buxhetin vendor dhe të ardhurat që NJVQV krijojnë, është një tregues i qartë i eficiencës së menaxhimit financiar. Gjithashtu, rritja e transfertës i ka dhënë mundësinë NJVQV që të financojnë më shumë shërbime publike dhe investime që përmirësojnë drejtpërdrejt jetën e qytetarëve. Projektet kryesore të investimeve janë përqëndruar kryesisht në rikonstruksionin e rrugëve, fushave sportive, palestrave, bibliotekave, shkollave, ndërtim të kopshteve, rikualifikime urbane etj. Rritja e nivelit të shpenzimeve për investime, është shoqëruar me një përmirësim sasior dhe cilësor të ofrimit të shërbimeve publike të transferuara tek bashkitë si: arsimi parashkollor, parauniversitar, ujitja dhe kullimi, administrimi i pyjeve, mbrojtja ndaj zjarrit dhe shpëtimi.

6. MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK

Borxhi publik gjatë 2023 përgjithësisht u karakterizua nga një ecuri pozitive, duke qenë në përputhje me objektivat makro-fiskale, buxhetin e planifikuar dhe objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (SAMB).

Viti 2023 ka qenë një vit mjaft pozitiv përsa i përket sigurimit të financimit, si në tregun e brendshëm dhe në atë të huaj. Huamarrja u realizua në linjë me buxhetin e vitit, si edhe në linjë me Planin e Huamarrjes së vitit 2023. Në ndryshim nga viti 2022, i cili u karakterizua nga një pasiguri në tregun primar vendas si dhe ulje të kërkesës për tituj shtetërorë, gjatë 2023 situata u përmirësua ndjeshëm dhe kërkesa për tituj shtetërorë u rikthye në nivele të kënaqshme, duke tejkaluar ofertën e Qeverisë për tituj shtetërorë. Nëpërmjet huamarrjes u mundësua rifinancimi i borxhit ekzistues, si dhe financimi i pjesshëm i defiçitit të planifikuar për vitin 2023.

Huamarrja në terma bruto u realizua në vlerën 466 miliardë LEK, nga të cilat 80.3% (ose 374.1 miliardë LEK) u financuan nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 19.7% (ose 91.9 miliardë LEK) nëpërmjet burimeve të huaja. Ministria e Financave emetoi tituj shtetërorë në vlerën 374.1 miliardë LEK në tregun e brendshëm, nga të cilët 225.6 miliardë LEK Bono Thesari dhe 148.5 miliardë LEK Obligacione. Huamarrja neto për vitin 2023 rezultoi në vlerën 20.8 miliardë LEK, ndërsa huamarrja e huaj bruto u realizua në nivelin 91.9 miliardë LEK. Huamarrja e huaj u realizua nëpërmjet emetimit të instrumentit të Eurobondit dhe disbursimit të huave për projekte dhe mbështetje buxhetore.

Në Qershor 2023 Qeveria emetoi Eurobondin e gjashtë me vlerë 600 milionë EUR, kupon 5.9%, yield 6.125% dhe me një ofertë finale (*final book*) prej 1.3 miliardë EUR.

Gjatë vitit 2023, Ministrisë së Financave ka vijuar përpjekjet në drejtim të reduktimit të ekspozimit ndaj risqeve duke mbajtur koston në nivelin më të ulët të mundshëm. Gjatë kësaj periudhe, menaxhimi i risqeve të portofolit të borxhit ka mundur të evoluojë në drejtim të objektivave strategjikë afatmesëm, duke shfaqur përmirësim të të gjithë treguesve të riskut në krahasim me fundin e 2022.

Përmirësimi i mëtejshëm i strukturës së borxhit, kryesisht në aspektin e reduktimit të ekspozimit ndaj riskut të rifinancimit dhe riskut të normave të interesit do të vijojë të mbetet fokusi kryesor në menaxhimin e borxhit, në mënyrë që treguesit e këtyre risqeve të përmirësohen në periudhat në vijim.

Në përputhje me objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, gjatë vitit 2023 u vijua me aktivitete në drejtim të zhvillimit të tregut të titujve shtetërorë. Në vazhdim të angazhimit të ndërmarrë në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar dhe zhvillimin e tregut sekondar të titujve shtetërorë, përgjatë vitit 2023 është vijuar me praktikat që kontribuojnë në krijimin e madhësive referencë dhe konsolidimin e kurbës së yield-it. Në drejtim të krijimit të madhësive benchmark, është vijuar me konsolidimin e numrit të ankandeve të titujve shtetërorë, duke ulur frekuencën e emetimeve të titujve të rinj dhe duke përdorur rihapjet e titujve ekzistues.

Gjithashtu, në vijim të masave të marra për zhvillimin e tregut, Ministria e Financave për të dytin vit radhazi hartoi dhe publikoi në muajin Dhjetor 2023 Planin Vjetor të Huamarrjes për vitin e ardhshëm 2024. Ky plan synon të mbështesë aktivitetin e huamarrjes vjetore, si dhe të rrisë transparencën kundrejt investitorëve dhe palëve të treta të interesuara.

Informacion më të detajuar dhe gjithëpërfshirës për këtë qëllim, do të gjeni në "***Raporti për borxhin publik dhe përbërjen e tij, për vitin 2023***" që i bashkëlidhet këtij relacioni.

7. RISQET FISKALE DHE DETYRIMET KONTIGJENTE

Me qëllim ndjekjen e performancës të zbatimit të buxhetit të shtetit, Ministria e Financave me mbështetjen e FMN dhe BB që prej vitit 2017 ka nisur monitorimin e risqeve që shoqërojnë zbatimin e tij. Ky proces ka për qëllim që, në bazë të analizave të thelluara, të rekomandojë zbutjen dhe/apo parandalimin në kohë të rreziqeve fiskale, pasuar nga një vendimarrje koherente. Risqet fiskale janë faktorë që mund të shkaktojnë devijim nga parashikimet fiskale dhe buxhetore gjatë ciklit të buxhetit, si rrjedhojë e disa ngjarjeve të paparashikuara. Ato mund të lindin si pasojë e supozimeve dhe zhvillimeve makroekonomike, vendimeve *ad-hoc* mbi politikën fiskale dhe/ose materializimin e detyrimeve kontingjente. Vlerësimi i probabilitetit dhe ndikimit të risqeve fiskale kryhet në bazë të analizave të thelluara dhe parashikimeve në kuadër të buxhetit afatmesëm, duke vlerësuar dy kategori risqesh:

- *Eksplicite", Detyrime të njohura nga qeveria dhe të bazuara në legjislacionin në fuqi apo kontrata të ndryshme të cilat mund të lidhen me supozimet dhe zhvillimet makroekonomike, të ardhurat e qeverisë, shpenzimet e përgjithshme të qeverisë, shpenzimet dhe menaxhimin e borxhit, etj.*
- *"Implicite", kontingjente, Detyrime (indirekte) që mund të lindin si pasojë e presionit politik apo presionit të grupeve të ndryshme të interesit si detyrimet e lidhura me PPP-të, ato të vetëqeverisjes vendore, ndërmarrjet publike me kapital shtetëror, risqe të tjera si vendime gjyqësore, fatkeqësi natyrore dhe sektori financiar apo risqet afatgjata.*

Tabela 12 Matrica e riskut

Lloji i rrezikut	Skenarët e mundshëm
Risqet dhe detyrimet eksplicite	
Goditje Makroekonomike	Zhvillime makroekonomike të paparashikuara, që mund të ndryshojnë perspektivën e rritjes ekonomike dhe pozicionin fiskal
Parashikimi i të ardhurave	Mosrealizimi i të ardhurave, që mund të sjellë përkeqësimin e bilancit fiskal
Shpenzime të paplanifikuara	Detyrime ligjore ose presione politike, që mund të sjellin rishpërndarje të shpenzimeve
Borxhi publik	Zhvillime të papritura të tregut, ndryshime në normën e interesit ose në kursin e këmbimit, që mund të rrisin nivelin e borxhit publik
Risqet implicite dhe detyrimet kontigjente	
Pagesat për PPP	Pagesat vjetore për PPP-të, mund të tejkalojnë nivelin e lejuar ligjor prej 5% të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës
Vështirësia financiare e Ndërmarrjeve Shtetërore (NSH)	Qeverisë mund t'i duhet të ndërhyjë për të mbështur financiarisht NSH-të
Të tjera	Vendime gjyqësore, arbitrazhe ndërkombëtare, fatkeqësi natyrore, etj, që mund të sjellin kosto buxhetore shtesë në buxhetin e shtetit

Burimi: Ministria e Financave (2024)


Për vitin 2023, Ministria e Financave vijoi monitorimin e risqeve kryesore buxhetore sipas Udhëzimit nr.35 datë 29.12.2022 "*Për procedurat standarde të raportimit dhe monitorimit të risqeve fiskale nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe njësi të tjera të sektorit publik*", Udhëzimit nr.37 datë 06.10.2020 "*Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme*" dhe Udhëzimit Plotësues nr.2 datë 19.01.2023 "*Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2023*".

7.1 Ndërmarrjet shtetërore

Referuar publikimit më të fundit të Instat (Shtator 2023) mbi sektorin publik në Shqipëri, numri total i institucioneve jashtëbuxhetore është 212. Këto institucione ndahen si më poshtë:

- ✓ *59 Extra-buxhetore Qeveria qendrore*
- ✓ *122 Extra-buxhetore Qeveria lokale*
- ✓ *28 Ndërmarrje publike jo-financiare*
- ✓ *2 Ndërmarrje publike financiare*
- ✓ *1 Banka e Shqipërisë*

Grafiku 44 Sektori quasi publik sipas numrit të ndërmarrjeve



Burimi: INSTAT (2024)

Në zbatim të Ligjit Organik të Buxhetit "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar*", specifikisht nenit 4/2 sipas së cilit: *"...Planet financiare vjetore dhe pasqyrat financiare mbi bazë tremujori, të çdo njësie jo të qeverisjes së përgjithshme përfituese të fondeve buxhetore dhe/ose garancive shtetërore, dorëzohen në Ministrinë e Financave..."*, dhe në zbatim të Udhëzimit Plotësues nr.2/2023 "*Për zbatimin e buxhetit 2023*", kanë detyrimin e ndarjes së planeve financiare vjetore dhe pasqyrave financiare mbi bazë 3M me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.


Mbi këtë bazë, MF monitoron dhe përgatit periodikisht mbi baza tremujore, analizat financiare të performancës së NSH-ve kryesore bazuar në potencialin e tyre për të impaktuar financat publike dhe buxhetin e shtetit. Monitorimi është fokusuar kryesisht në performancën financiare dhe jofinanciare të tre kompanive të sektorit energjetik, që është thelluar në kuadër të reformës të këtij sektori, si edhe në performancën financiare të disa ndërmarrjeve shtetërore me relevancë të konsiderueshme si: Ujësjellës-Kanalizime Tiranë (UKT) sh.a, Hekurudha Shqiptare sh.a, AlbGaz sh.a, Albcontrol sh.a, Albpetrol sh.a dhe Posta Shqiptare sh.a, krahas edhe dy entiteteve të tjera (jo me status sh.a) si Radio Televizioni Shqiptar (RTSH) dhe Autoriteti Portual Durrës (APD).

Këto analiza monitorimi, të cilat përgatiten rregullisht në bazë tremujore, bëhen pjesë/publikohen në të gjitha raportet periodike të MF si Buxheti Faktik, Raporti i Mesvitit, dhe Projektbuxheti.

7.1.1 Ndërmarrjet e Sektorit Energjetik.


Ky sektor strategjik ka qenë dhe mbetet nën monitorimin e Ministrisë së Financave, duke patur parasysh ndikimin e konsiderueshëm fiskal dhe impaktin e ndjeshëm të tij në ekonomi. Ky monitorim, i cili është kryer periodikisht mbi bazë tremujore, ka konsistuar në analizimin e treguesve të performancës financiare të secilës prej tre kompanive: KESH sh.a, OSHEE Group sh.a dhe OST sh.a.

Grafiku 45 Ecuria e nivelit të arkëtimeve të OSHEE Group sh.a (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Grafiku 46 Ecuria e nivelit të humbjeve në rrjet për OSHEE Group sh.a (në %)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Gjatë vitit 2023, sektori energjitik ka shënuar një përmirësim të ndjeshëm të performancës financiare, si rezultat i: (i) *përmirësimit të situatës meteorologjike në vend* dhe si rrjedhojë, (ii) *e rritjes së prurjeve në kaskadën e Drinit, që ka rritur nivelin e prodhimit të energjisë vendase nga KESH sh.a përgjatë 2023*. Konkretisht, niveli i basenit të Fierzës deri

në muajin Dhjetor 2023 ishte në kuotën 284.5 metra, me një nivel më të lartë sesa kuota mesatare e 30 viteve të fundit për të njëjtën periudhë, prej 277.5 metra.

Në nivel sektori, krahasuar me vitin 2022, vërehet se:

- ✓ *Rezultati financiar (fitim/humbje) i sektorit energjitik ka rezultuar pozitiv me një fitim prej 22.51 miliardë LEK, duke pësuar një rritje të ndjeshme me rreth 42.45 miliardë LEK më shumë, krahasuar me vitin 2022.*
- ✓ *Marzhi i fitimit për 12 mujorin e vitit 2023 është rritur me 36.9% kundrejt 2022, duke rezultuar në nivelin 17.45%.*
- ✓ *Niveli i përgjithshëm i prodhimit neto vendas (8.80 TWh) është rritur me rreth 25.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Konkretisht, gjatë 12M 2023 vetëm KESH sh.a realizoi një nivel prodhimi neto publik prej rreth 5.13 TWh, kundrejt 3.86 TWh realizuar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke rezultuar me një rritje rreth 32.9%. Ky tregues dëshmon situatën e favorshme hidrike gjatë vitit 2023.*
- ✓ *Sa i përket humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, për vitin 2023 ato rezultuan në nivelin 18.9%, duke shënuar një rënie prej kundrejt një viti më parë, ku humbjet ishin në nivelin 19.7%.*
- ✓ *Niveli i arkëtimeve për vitin 2023 (operuar nga OSHEE Group sh.a) arriti vlerën prej 99.4%, një shifër mjaft e mirë dhe në rritje krahasuar me 98% që ishte një vit më parë, gjë që dëshmon stabilitetin e shoqërisë në këtë drejtim.*

Në mbështetje të VKM nr.650 datë 10.10.2022 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.584 datë 08.10.2021 "Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, të ndryshuar*", me qëllim përmbushjen e detyrimit për vazhdimin e furnizimit të pandërprerë të konsumatorëve (*në zbatim të VKM nr.757 datë 09.12.2021*) në kuadër të parashikimeve për rritjen e çmimit të energjisë në bursën ndërkombëtare, në buxhetin e vitit 2023 u planifikua fondi 12 miliardë LEK si mbështetje buxhetore për sektorin e energjisë. Fatmirësisht, nisur nga situata e qëndrueshme që shënoi ecuria e vitit 2023, nëpërmjet Aktit Normativ nr.5 datë 18.10.2023 u miratua pakësimi i këtij fondi dhe rishpërndarja e tij fondi në zëra të tjerë të shpenzimeve publike.

Në terma të riskut fiskal, impakti i sektorit si kosto financiare apo të ardhura të munguara në financat publike për vitin 2023, vlerësohet rreth 5.3 miliardë LEK nga rreth 33 miliardë LEK në vitin 2022, duke treguar një përmirësim të gjendjes së detyrimeve. Kjo situatë është ndikuar nga kushtet e favorshme atmosferike që rritën ndjeshëm nivelin e prodhimit të energjisë vendase nga KESH sh.a. Projektet e investimeve me financim të huaj për sektorin e energjisë për vitin 2023 u miratuan në nivelin 2 miliardë LEK sipas buxhetit fillestar të miratuar me Ligjin nr.84/2022 "*Për buxhetin e vitit 2023*", dhe nuk pësuan rishikime gjatë vitit buxhetor.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet në mënyrë të përmbledhur ndikimi i sektorit të Energjisë në financat publike:

Tabela 13 Të dhënat mbi impaktin e sektorit të energjisë në financat publike sipas periudhave përkatëse (në milion LEK)

	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Ndikimi në financat publike (në mln LEK):	**9,358**	**6,824**	**5,240**	**5,504**	**33,017**	**5,286**
1. Garancitë dhe nënhuatë e paguara nga MF	***7,322***	***6,153***	***5,240***	***5,407***	***32,973***	***5,285***
Garanci të paguara nga MF	*2,624*	*2,011*	*2,069*	*1,504**	*2,989*	*1,149*
Projekte me financim të huaj të nënhuazuara	*4,698*	*4,142*	*3,172*	*3,903*	*2,077*	*4,136*
Hua e dhënë për energjinë	-	-	-	-	*7,907***	-
2. Mbështetje buxhetore për sektorin energjitik					*20,000***	*-****
3. Detyrimet Tatimore (Vjetore)	***2,036.3***	***670.9***	***0.1***	***97.3***	***43.4***	***0.1***

** "Mbështetje buxhetore për sektorin e energjisë" (OSHEE Group Sh.a.) nëpërmjet instrumentit të garancisë sovrane në shumën 10 000 milionë LEK për vitin 2021 me anë të Aktit Normativ nr.31 datë 27.10.2021.*

*** "Hua e dhënë për energjinë" planifikuar në shumën 8 000 milionë LEK për vitin 2022 (realizimi faktik 7 907 milionë LEK) dhe "Mbështetje buxhetore për sektorin e energjisë" planifikuar në shumën 20 000 milionë LEK për vitin 2022 (realizimi faktik 20 000 milionë LEK).*

**** "Mbështetja buxhetore për sektorin e energjisë" planifikuar në shumën 12 000 milionë LEK për vitin 2023 nuk u përdor dhe, nëpërmjet Aktit Normativ nr.5 datë 18.10.2023 u rishpërnda për zërat e tjerë të shpenzimeve publike, bazuar në situatën e qëndrueshme të sektorit.*

Burimi: Ministria e Financave (2024)

Në kuadër të reformës në sektorin e energjisë, Ministria e Financave dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bashkëfirmosën Urdhërin e Përbashkët nr.379/2021 datë 30.09.2021 "*Mbi zbatimin e planit të masave për reduktimin e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike*", nëpërmjet së cilit ndërmarrjet e sektorit energjitik raportojnë në mënyrë periodike mujore mbi shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të ndërsjella, si mes tyre ashtu edhe ndërmjet sektorit të energjisë dhe entiteve të tjera publike. Përgjatë vitit 2023, në përputhje me udhëzimin e sipërcituar, MF ka monitoruar periodikisht mbi bazë mujore detyrimet e ndërsjella të raportuara nga ndërmarrjet e

sektorit të energjisë dhe entiteve të tjera publike. Nga ana e ndërmarrjeve të sektorit energjetik raportohet se, një pjesë e detyrimeve të ndërsjella janë shlyer sipas planit të masave për reduktimin e tyre. Por, pavarësisht rezultatit financiar pozitiv të vitit 2023, shoqëritë vazhdojnë të përballen me një situatë likuiditeti të pamjaftueshme, të mbartur nga vitet e kaluara, e cila ka bërë të pamundur shlyerjen e tyre sipas planit vjetor. Një faktor që ka ndikuar në situatën aktuale, janë edhe vonesat e ndërmarrjeve U-K në shlyerjen e detyrimeve të ndërsjella. Sidoqoftë, ndërmarrjet e sektorit energjetik konfirmojnë se angazhimi i tyre mbetet maksimal në drejtim të përmbushjes me sukses të marrëveshjeve për likujdimin tërësor të stokut të detyrimeve të ndërsjella.

Tabela 14 Detyrimet e ndërsjella midis ndërmarjeve të sektorit energjitik, ML/IB,MF dhe DPT

Deri në Dhjetor 2023 (ne mld LEK)	KESH	OST	OSHEE	MF	DPT	Total
KESH ndaj:		0*		35.82		35.82
OST ndaj:	11.35*		0.95	8.13		20.43
OSHEE ndaj:	59.6**	9.90**		2.73	4.36	76.59
Ndermarrjet UK ndaj:			30.90	10.28		41.18
ML/IB ndaj:			6.1			6.10
Total	70.95	9.90	37.95	56.97	4.36	180.13

** Vlera e detyrimeve të ndërsjellta varion nga 0-0.11 mld LEK për KESH ndaj OST dhe nga 11.35-15.06 mld LEK për OST ndaj KESH, për arsye të mosrakordimit mes kompanive.*

*** Vlera e detyrimeve të ndërsjellta varion nga 59.6-59.91 mld LEK për OSHEE ndaj KESH dhe nga 9.9-18.07 mld LEK për OSHEE ndaj OST, për arsye të mosrakordimit mes kompanive.*

Burimi: MF, KESH sh.a, OST sh.a, OSHEE Group sh.a, AKUK (2024)

Të Dhëna Financiare për Sektorin Energjetik

Në zbatim të Udhëzimit Plotësues nr.2/2023 "*Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2023*", Ministria e Financave, periodikisht mbi bazë tremujore, ka mbledhur, përpunuar dhe analizuar informacionin e nevojshëm në lidhje me treguesit e performancës financiare të tre kompanive të sektorit energjitik. Kjo, me qëllim identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e risqeve buxhetore që rezultojnë nga ndërmarrjet publike me kapital shtetëror në tërësi dhe nga sektori energjetik në veçanti, duke konsideruar rëndësinë strategjike të tij dhe problematikat sensitive që e karakterizojnë. Bazuar në të dhënat më të fundit të raportuara pranë MF-së për vitin 2023, mëposhtë paraqitet performanca financiare e tre ndërmarrjeve të sektorit energjitik (KESH sh.a, OSHEE Group sh.a dhe OST sh.a) mbi bazë krahasimore për të njëjtat periudha pararendëse:

Tabela 15 Të dhënat financiare për Sektorin Energjitik (në mijë LEK)[4]

Zërat/Periudha	12M 2021	12M 2022	12M 2023
Të ardhurat	*94,924,507*	*124,741,172*	*129,034,087*
Shpenzimet	*104,350,648*	*148,977,394*	*106,523,718*
Humbje/Fitim	**(9,426,141)**	**(24,236,222)**	**22,510,369**
Aktivet Afatshkurtra	*131,113,020*	*139,599,295*	*151,849,188*
Aktivet Afatgjata	*213,716,732*	*207,108,598*	*218,104,086*
Total Aktive	**344,829,751**	**346,707,894**	**369,953,273**
Detyrimet afatshkurtra	*173,099,190*	*178,171,974*	*176,565,419*
Detyrimet afatgjata	*110,130,474*	*117,149,326*	*96,904,273*
Total Detyrime	**283,229,665**	**295,321,299**	**273,469,693**
Kapital	**61,600,087**	**51,386,595**	**96,483,581**

Burimi: OSHEE Group sh.a, OST sh.a, KESH sh.a. (2024)

➢ *Performanca financiare e OSHEE Group sh.a.*

Tabela 16 Të dhënat financiare 12 mujore për OSHEE Group Sh.a (në mijë LEK)

Zërat/Periudha	12M 2021	12M 2022	12M 2023
Të ardhurat	*66,341,264*	*75,822,651*	*74,744,965*
Shpenzimet	*81,879,114*	*73,847,058*	*70,102,634*
Humbje/Fitim	**(15,537,850)**	**1,975,593**	**4,642,332**
Aktivet Afatshkurtra	*35,298,082*	*30,962,125*	*34,108,340*
Aktivet Afatgjata	*57,608,845*	*58,889,773*	*67,709,815*
Total Aktive	**92,906,927**	**89,851,899**	**101,818,155**

[4] *Deri në certifikimin final të bilanceve respektive, të dhënat financiare janë paraprake për për OSHEE Group sh.a (vitet 2021-2022) dhe OST sh.a (2022).*

Detyrimet afatshkurtra	*83,335,129*	*71,487,583*	*70,079,746*
Detyrimet afatgjata	*63,129,728*	*69,171,166*	*64,118,991*
Total Detyrime	**146,464,856**	**140,658,749**	**134,198,736**
Kapital	**(53,557,929)**	**(50,806,851)**	**(32,380,582)**

Burimi: OSHEE Group sh.a.

- *Performanca financiare e KESH sh.a.*

Tabela 17 Të dhënat financiare 12 mujore për KESH sh.a (në mijë LEK)

Zërat/Periudha	12M 2021	12M 2022	12M 2023
Të ardhurat	*19,200,426*	*36,728,325*	*41,973,808*
Shpenzimet	*13,197,021*	*63,438,249*	*28,478,190*
Humbje/Fitim	**6,003,405**	**(26,709,924)**	**13,495,618**
Aktivet Afatshkurtra	*79,178,996*	*89,400,954*	*99,764,401*
Aktivet Afatgjata	*92,097,503*	*90,150,652*	*85,349,460*
Total Aktive	**171,276,498**	**179,551,606**	**185,113,860**
Detyrimet Afatshkurtra	*62,759,012*	*80,902,658*	*79,805,047*
Detyrimet Afatgjata	*27,142,997*	*29,178,768*	*17,545,032*
Total Detyrime	**89,902,009**	**110,081,426**	**97,350,079**
Kapital	**81,374,489**	**69,470,180**	**87,763,782**

Burimi: KESH sh.a.

- *Performanca financiare e OST sh.a.*

Tabela 18 Të dhënat financiare 12 mujore për OST Sh.a (në mijë LEK)

Zërat/Periudha	12M 2021	12M 2022	12M 2023
Të ardhurat	*9,382,818*	*12,190,196*	*12,315,313*
Shpenzimet	*9,274,514*	*11,692,087*	*7,942,894*
Humbje/Fitim	**108,304**	**498,109**	**4,372,419**
Aktivet Afatshkurtra	*16,635,942*	*19,236,216*	*17,976,448*
Aktivet Afatgjata	*64,010,384*	*58,068,174*	*65,044,811*
Total Aktive	**80,646,326**	**77,304,390**	**83,021,258**
Detyrimet Afatshkurtra	*27,005,050*	*25,781,732*	*26,680,627*
Detyrimet Afatgjata	*19,857,749*	*18,799,391*	*15,240,251*
Total Detyrime	**46,862,799**	**44,581,124**	**41,920,878**
Kapital	**33,783,526**	**32,723,266**	**41,100,381**

Burimi: OST Sh.a.

7.1.2 Ndërmarrjet e Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve

Në kuadër të përmirësimit të monitorimit të ndërmarrjeve shtetërore, Ministria e Financave ka monitoruar disa tregues kryesorë financiarë të ndërmarrjeve të Ujësjellës Kanalizime. Treguesit kryesorë të performancës për vitin 2023, për ndërmarrjet e U-K të analizuara, tregojnë për një vijimësi të gjendjes ekzistuese financiare dhe vështirësi në pagimin e detyrimeve dhe mbledhjen e të ardhurave, duke sinjalizuar probleme potenciale të likuiditetit në periudhën afashkurtër. Pasojat nga pandemia COVID19 dhe faktorë të tillë si efektet e krizës globale energjetike, lufta në Ukrainë, luhatjet e çmimeve të energjisë, karburanteve dhe inputeve, kanë patur impakt të konsiderueshëm në vështirësitë financiare të ndërmarrjeve U-K.

Për vitin 2023, buxheti i shtetit ka alokuar një vlerë totale subvencioni prej 310 milionë LEK në strukturën buxhetore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, i cili detajohet nga AKUK/MIE bazuar në kriteret e përcaktuara në Udhëzimin "*Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat, për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore, për shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve...*", miratuar nga Ministri përgjegjës për Infrastrukturën dhe Energjinë. Ky subvencion shkon kryesisht për ndërmarrjet të cilat nuk arrijnë të mbulojnë koston/shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes.

Sa i takon stokut të detyrimeve të akumuluara nga ndërmarrjet UK sh.a ndaj sektorit të energjisë, vlen për t'u theksuar se në kuadër të reformës në sektorin e energjisë, janë intensifikuar marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me institucionet dhe aktorët kryesorë. Plani i masave për reduktimin e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me Urdhërin e Përbashkët MIE/MF nr.304/2020 "*Për miratimin e planit të masave të reduktimit të detyrimeve*

të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike", përfshin në procesin e shlyerjes së detyrimeve të ndërsjella edhe sektorin e ujit.

Me qëllim zbatimin me sukses të këtij plani, MIE dhe MF bashkëfirmosën Urdhërin e dytë të Përbashkët nr.379/2021 "*Mbi zbatimin e planit të masave për reduktimin e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike*", i cili ngarkon (krahas ndërmarrjeve të sektorit energjitik) edhe AKUK për raportim mujor mbi ecurinë e shlyerjen së detyrimeve të prapambetura të ndërsjella.

Kështu, deri në Dhjetor 2023, OSHEE Group sh.a. raporton se detyrimet e akumuluara të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve rezultojnë të jenë në vlerën rreth 30.9 miliardë LEK. Nga këto, rreth 16 miliardë LEK janë detyrime të faturuara ndaj kompanisë dhe rreth 15 miliardë LEK janë detyrime për kamatëvonesa. Nga totali i detyrimeve principal (pa kamatëvonesa), vetëm ndërmarrja e UK Durrës sh.a ka 5.46 miliardë LEK detyrime të akumuluara në vite. Në tabelën e mëposhtme listohen pesë ndërmarrjet U-K që kanë pjesën më të madhe të detyrimeve (pa kamatëvonesa) ndaj OSHEE Group sh.a, deri në Dhjetor 2023.

Tabela 19 Stoku i detyrimeve të prapambetura e Sektorit Ujësjellës-Kanalizime ndaj OSHEE Group Sh.a (në mld LEK)

	(miliardë/LEK)
Ndërmarrjet U-K kryesore me detyrime ndaj OSHEE Group sh.a	**9.56**
Njësia Durrës UK sh.a	5.46
Njësia Vlorë UK sh.a	1.68
Njësia Patos UK sh.a	0.87
Njësia Fier UK sh.a	0.79
Njësia Kavajë UK sh.a	0.77

Burimi: AKUM (2024)

Procesi i reformimit dhe riorganizimit të sektorit të Ujit vazhdon, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2020-2030. Përmes kësaj reforme, në zbatim të VKM nr.302 datë 11.05.2022 "*Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura*", synohet ridimensionimi i 58 ndërmarrjeve U-K aktuale nëpërmjet rigrupimit të tyre në 15 shoqëri SKP-UK (*Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta*) rajonale. Kjo, me qëllim rritjen e mirëmenaxhimit dhe performancës së tyre financiare, që pashmangshmërisht do të gjenerojë të ardhura të mjaftueshme në dobi të mbarëvajtjes së proceseve të punës dhe sidomos shlyerjes së detyrimeve të akumuluara, duke siguruar kësisoj mos krijimin e tyre në të ardhmen.

7.2 Detyrimet e prapambetura të Qeverisjes së Përgjithshme

Bazuar në VKM nr.50 datë 05.02.2014 "*Për miratimin e Strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit*", Ministria e Financave ka ndërmarrë hapa konkretë në drejtim të monitorimit, raportimit dhe parandalimit të detyrimeve të prapambetura. Vlen për t'u theksuar se tashmë monitorimi i detyrimeve të prapambetura është një proçes i konsoliduar në kohë dhe cilësi, përmes monitorimit periodik intensiv të të gjitha detyrimeve të pashlyera të institucioneve buxhetore.
Duke nisur nga muaji Dhjetor 2020, ky proçes i cili më parë kryhej mbi bazë tremujore nëpërmjet raportimit shkresor të institucioneve, tashmë gjenerohet automatikisht nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr.37 datë 06.10.2020 "*Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme*", gjë që përveçse ka rritur saktësinë e të dhënave dhe sigurimin e tyre në kohë reale, ka unifikuar njëkohësisht edhe modalitetin e raportimit për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Në zbatim të Ligjit Organik të Buxhetit nr.9936 datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar*", në nenin 52 përcaktohet qartë se: "*...Shpenzimet që rezultojnë nga angazhimet e ndërmarra gjatë viteve të mëparshme, në përputhje me dispozitat e veçanta të ligjit të buxhetit vjetor, përfshihen në buxhetin e vitit pasardhës. Shlyerja e angazhimeve, me përfundimin e afatit, kryhet me fondet e miratuara për vitin buxhetor pasardhës...*". Nisur nga sa më sipër, shlyerja e detyrimeve të prapambetura përbën një detyrim ligjor për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.


Parë në një aspekt më të gjerë dhe gjithëpërfshirës, Ministria e Financave i ka sugjeruar të gjitha njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik që në "*Planin strategjik dhe vjetor të veprimtarisë audituese për vitet 2021 – 2023*" të

përfshijnë angazhime auditimi për analizimin dhe vlerësimin e situatës së detyrimeve të prapambetura të njësive publike. Kjo, përsa kohë që detyrimet e prapambetura janë përcaktuar si fushë me risk të lartë dhe duhet të trajtohen me përparësi nga auditimi i brendshëm i njësive publike, për të paraqituar gjendjen aktuale dhe për të dhënë rekomandime sa më të vlefshme në këtë drejtim. Njëkohësisht, për të parandaluar akumulimin dhe ulur stokun total të detyrimeve të prapambetura ndër vite, si në rastin e detyrimeve të prapambetura nga vendimet gjyqësore, Ministria e Financave krahas monitorimit periodik të tyre, apelon edhe tek institucionet buxhetore që të ulin edhe më tej barrën e tyre, nëpërmjet aplikimit në kohë të kësteve të pagesave ose implementimin e instrumente të tjera lehtësuese ndaj përfituesve të Vendimeve Gjyqësore.

Prioriteti kryesor i Ministrisë së Financave në periudhën afatmesme, mbetet reduktimi i stokut të detyrimeve të prapambetura dhe parandalimi i akumulimit të tyre. Përcaktimi i objektivave specifike ndër vite (psh. treguesi i performancës për Mirëqeverisjen dhe Programin e Reformave Ekonomike-ERP), ka ndikuar pozitivisht në drejtim të reduktimit progresiv të stokut total të detyrimeve të prapambetura në vitet e fundit, trend i cili pritet të vazhdojë. Në terma të targetit të sipërcituar, niveli i detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve për vitin buxhetor 2023 rezultoi rreth 1.16% të totalit të shpenzimeve të përgjithshme faktike 2023, duke përmbushur plotësisht targetin vjetor të Mirëqeverisjes/ERP (<2.4%).

Këto dhe masa të tjera të ndërmarra nga Ministria e Financave, kanë ndihmuar në mbajtjen nën kontroll të stokut të detyrimeve të prapambetura dhe në arritjen e të gjithë objektivave të vendosur në fillim të vitit 2023.

Grafiku 47 Stoku i detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme, në mln LEK



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Konkretisht, deri në fund të muajit Dhjetor 2023 u regjistrua një stok kumulativ i detyrimeve të prapambetura të njësive të qeverisjes së përgjithshme prej 7.85 miliardë LEK[5], nga të cilat:

- ✓ *Totali detyrimeve qendrore ishte rreth 3.01 miliardë LEK*
- ✓ *Totali detyrimeve vendore ishte rreth 4.84 miliardë LEK.*

Krahasuar me stokun e detyrimeve të prapambetura të raportuara për të njëjtën periudhë të vitit 2022, rezulton se niveli i përgjithshëm i tyre është rreth 4.35 miliardë LEK më i ulët ose me një rënie prej 35.6%. Konkretisht,

- ✓ *Detyrimet e prapambetura qendrore janë ulur me rreth 3.76 miliardë LEK, ndërsa ato vendore janë ulur me rreth 0.59 miliardë LEK.*
- ✓ *Ndërkohë që, ashtu si për 12M 2022, vijon të mos rezultojnë detyrime për rimbursimin e TVSH-së.*

Në total, gjatë vitit 2023 janë shlyer rreth 4.35 miliardë LEK detyrime të prapambetura nga periudhat e mëparshme. Duke konsideruar që procesi i shlyerjes së detyrimeve nga ana e institucioneve kryhet në respektim të parimit FIFO, rezulton se detyrimet që mbeten për t'u shlyer në vijim karakterizohen nga një "moshë mesatare" e re e krijimit të tyre.


[5] *Pa përfshirë detyrimet e prapambetura të Ujësjellës-Kanalizime dhe Universiteteve*

7.2.1 Detyrimet e prapambetura për njësitë e Qeverisjes Qendrore

Sipas informacionit të gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) për periudhën deri në Dhjetor 2023, stoku i detyrimeve të prapambetura të njësive të qeverisjes qendrore është rreth 3.01 miliardë LEK, ose rreth 3.76 miliardë LEK më i ulët krahasuar me stokun e regjistruar në Dhjetor 2022. Sipas kategorive të shpenzimeve rezulton se:


- *Vendimet Gjyqësore zënë peshën më të madhe të stokut të detyrimit rreth 39.6%,*
- *Investimet zënë rreth 31.2%,*
- *Detyrime të prapambetura të tjera zënë rreth 17.5%,*
- *Detyrimet për sigurimet shoqërore me rreth 5.1%,*
- *Mallra me rreth 1.8%,*
- *Shërbimet me rreth 1.4%,*
- *Të Ardhurat Personale me rreth 1.4%,*
- *Rimbursimi i TVSH-së 0.8%,*
- *Detyrimet për sigurimet shëndetsore me rreth 0.6%,*
- *Mirëmbajtje me rreth 0.5%.*

Grafiku 48 Stoku i detyrimeve të Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës dhe ministrive të tjera



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Grafiku 49 Stoku i detyrimeve të prapambetura qendrore sipas zërave kryesorë



Burimi: Ministria e Financave (2024)


Siç vërehet, një zë me peshë të konsiderueshme mbetet ai i vendimeve gjyqësore administrative, të cilat:

- ✓ *Kanë kryesisht në sfond largimet e padrejta nga puna të ish-punonjësve, të cilat në çdo rast implikojnë kosto buxhetore të paparashikuara. Deri në Dhjetor 2023, detyrimet e prapambetura për vendime gjyqësore për njësitë e qeverisje qendrore rezultuan në rreth 1.19 miliardë LEK ose rreth 39.6% e stokut total të detyrimeve të prapambetura të njësive të qeverisjes qendrore, nga 3.24 miliardë LEK që ishin deri në Dhjetor 2022.*
- ✓ *Ministria e Financave, për t'i paraprirë akumulimit të tyre në kohë, përveç një monitorimi periodik, vazhdimisht i ka bërë apel aftësisë menaxhuese të vetë institucioneve buxhetore, përmes aplikimit me këste të pagesës për përfituesit apo instrumenteve të tjerë të lehtësimit dhe/ose zhvendosjes në kohë të të barrës së tyre buxhetore.*

7.2.2 Detyrimet e prapambetura për njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV)

Stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të muajit dhjetor 2023, i cili parashikohet të shlyhet në një periudhë afatmesme bazuar në planin e shlyerjes së dërguar në Ministrinë e Financave nga të gjitha bashkitë, është rreth 4.8 miliardë LEK. Vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura është ulur me rreth 3 milard LEK, krahasuar me stokun e detyrimit në fund të tremujorit të tretë të vitit 2023, dhe me rreth 0.59 miliard LEK krahasuar me stokun në fund të vitit 2022, që ishte 5.4 miliard LEK. Stokun më të lartë të detyrimeve e ka bashkia Kavajë në vlerën rreth 794 milion LEK, e cila përbën 16.7% të totalit të detyrimeve. Më pas, bashkia Tiranë me rreth 788 milion LEK, e cila përbën 16.6% të totalit të detyrimeve; bashkia Vorë me rreth 363 milion LEK, e cila përbën 7.6% të totalit të detyrimeve; bashkia Durrës me rreth 311.5 milion LEK, e cila përbën 6.6% të totalit të detyrimeve; bashkia Pogradec me rreth 224 milion LEK, e cila përbën 4.7% të totalit të detyrimeve. Më pas renditen bashkia Dibër dhe Lezhë.

Grafiku 50 Stoku i detyrimeve të prapambetura vendore sipas zërave kryesorë



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Sipas kategorive, rezulton që:

- *Investimet zënë peshën më të madhe të stokut të detyrimit me rreth 47.4%,*
- *Detyrime të prapambetura të tjera me rreth 25.6%,*
- *Shërbimet rreth 11.3%,*
- *Vendimet Gjyqësore rreth 7.2%,*
- *Mallra me rreth 4.5%,*
- *Mirëmbajtje rreth 2.5%, etj.*

Tabela 20 Detyrimet e prapambetura në nivel vendor sipas kategorive

Llog. Ekonomike	Kategoria	Bashki	Qarqe	Pesha ne % Bashki	Pesha ne % Qarqe
4864100	Vendime Gjyqesore	341,989,762	84,091,807	7.2%	97.1%
4864200	Det.Prap. Sherbime	538,755,636	1,347,121	11.3%	1.6%
4864300	Det.Prap.Mirembajtje	119,176,415	0	2.5%	0.0%
4864400	Det.Prap. Investime	2,250,987,434	576,220	47.4%	0.7%
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH	758,305	0	0.0%	0.0%
4864600	Mallra	213,369,474	160,040	4.5%	0.2%
4864900	Det.Prap.Te Tjera	1,216,281,798	395,100	25.6%	0.5%
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore	47,215,259	0	1.0%	0.0%
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet	2,827,678	0	0.1%	0.0%
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal	17,138,048	0	0.4%	0.0%
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera	4,254,223	0	0.1%	0.0%
TOTAL		**4,752,754,032**	**86,570,288**	100.0%	100.0%

Burimi: Ministria e Financave (2024)

7.3 Koncesionet/PPP-të

Sa i takon ecurisë së pagesave faktike për kontratat koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP) me mbështetje buxhetore, për vitin 2023 monitorimi dhe raportimi i tyre është institucionalizuar përmes përfshirjes në Udhëzimin Plotësues nr.2 datë 19.01.2023 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023*", i cili përcakton skedulin e detyrueshëm kohor të raportimit të tyre nga çdo autoritet kontraktor, krahas formateve standarde për këtë qëllim.

Në nivel total për 2023:

- ✓ *Rezultojnë 11 kontrata koncesionare/PPP të miratuara me mbështetje buxhetore.*
- ✓ *Janë realizuar pagesa faktike për 10 kontrata koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore[6].*
- ✓ *Fondet buxhetore të planifikuara, sipas planit vjetor me ndryshime, me destinacion mbështetjen nga buxheti për kontratat koncesionare/PPP, rezultojnë rreth 12.88 miliardë LEK.*
- ✓ *Pagesat faktike vjetore, në total rezultuan në rreth 12.66 miliardë LEK ose 98.3% e planit me ndryshime.*

Respektimi i rregullit fiskal, për vitin 2023:

- ✓ Kufiri i lejuar i pagesave neto për kontratat koncesionare/PPP, prej 5% i të ardhurave tatimore faktike të vitit pararendës 2022, përllogaritet në rreth 27.07 miliardë LEK.
- ✓ Referuar tabelës së mëposhtme, pagesat vjetore neto të realizuara (faktike) nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për kontratat koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore, rezultuan në rreth 12.66 miliardë LEK.
    - *Rrjedhimisht, për vitin 2023 është respektuar kufizimi ligjor i sipërcituar në zbatim të rregullit fiskal respektiv, pasi vlera e realizuar prej rreth 12.66 miliardë LEK e pagesave vjetore të kontratave koncesionare/PPP, përbën vetëm 2.34% të totalit të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2022 prej rreth 541.34 miliardë LEK.*

Tabela 21 Koncesionet/PPP-të aktive me mbështetje nga buxheti i shtetit (në mijë LEK)

Autoriteti Kontraktor	Nr.	Emërtimi i Kontratës PPP	Viti i fillimit	Viti i mbarimit	Programi	Lloji i Shpenzimit	Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2023	Fakt 2023	% e realizimit Fakt/Plan 2023
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë		Ndërtimi, operimi dhe transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Fier	2016	2022	06220	Investime	690,040	376,385	-	-	-
		Ndërtimi, operimi dhe transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë së Elbasanit	2015	2021	06220	Investime	40,292	-	-	-	-
	1	Përmirësimi, Ndërtimi, Operimi dhe Mirëmbajtja e Rrugës së Arbrit	2018	2031	04520	Investime	3,392,727	2,940,000	2,844,000	2,844,000	100%
	2	Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e autostradës Milot - Morinë	2017	2047	04520	Investime	790,027	740,978	666,600	666,563	100%
	3	Përmirësim, Ndërtim, Operim, Mirëmbajte e Rrugës Porti i Jahteve – By Pass Orikum – Dukat (Ura e Shën Elizës)	2021	2034	04520	Investime	47,069	224,698	726,787	726,787	100%
		Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës Milot - Balldren	2020	2033	04520	Investime	3,100	-	-	-	-
	4	Për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e "Portit të Integruar" në Triport Vlorë	2023	2032	04540	Investime	-	-	-	-	-
Ministria e Financave	1	Financimi, ngritja dhe operimi i shërbimit të skanimit të konteinerve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë	2013	2030	01150	Korente	1,660,686	1,925,903	1,541,732	1,540,310	99.9%
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1	Për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë (Check-up)	2015	2025	07220	Korente	219,021	876,083	876,090	876,083	100%
	2	Koncesioni/PPP (Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale)	2016	2026	07330	Korente	1,500,924	1,699,975	1,750,000	1,749,982	100%
	3	Koncesioni/PPP (Ofrimi i shërbimit të hemodializës)	2016	2026	07330	Korente	747,195	802,583	875,000	849,129	97%
	4	Ofrimi i shërbimeve laboratorike mjekësore	2020	2030	07330	Korente	1,103,199	1,612,914	1,799,800	1,718,879	95.5%
Bashkia Tiranë/Ministria e Arsimit dhe Sportit	1	Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës "Për Projektimin, Financimin,Ndërtimin,Mobilimin,Mirëmbajtjen,Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e pesë objekteve arsimore në Zonën Tirana 1 dhe për 4 objektet arsimore në zonën Tirana 4"	2018	2026	09230	Investim	-	395,074	729,994	698,074	95.6%
MIE / Bashkia Tiranë	1	Ndërtimi i Landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimit të venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike"	2017	2047	06220	Korente	1,249,399	1,046,397	1,065,093	989,797	92.9%
	11	TOTALI					11,443,679	12,640,991	12,875,095	12,659,602	98.3%
Totali i të Ardhurave Tatimore							475,611,880	541,342,220	598,661,930		
Respektimi i Rregullit Fiskal (përpjesa e pagesave të PPP ndaj totalit të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës buxhetor më pak se 5%)							2.87%	2.66%	2.34%		

Burimi: Ministria e Financave, Autoritetet Kontraktore (2024)

[6] *Për kontratën "Për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e 'Portit të Integruar' në Triport Vlorë", referuar modelit financiar të kësaj kontrate, për tre vitet e para nuk parashikohen të kryhen pagesa nga buxheti i shtetit.*

7.4 Detyrime të tjera Kontigjente:

7.4.1 Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ)

Këto vendime kanë të bëjnë kryesisht me çështje që lidhen me kthimin dhe kompensimin e pronave tek ish-pronarët. Ministria e Financave ka respektuar në vazhdimësi të gjitha vendimet e miratuara nga GJEDNJ, përmes likujdimit të VKM respektive miratuar në mbështetje të tyre, me përpikmëri dhe brenda afateve strikte të përcaktuara prej këtij organi. Kjo, duke konsideruar faktin se kur pagesat nuk kryhen brenda afatit tre mujor nga data kur vendimi përkatës merr formën e prerë, shteti shqiptar ngarkohet me pagesën e një kamatë-vonese për çdo ditë vonesë. Sidoqoftë, për garantimin e shlyerjes në kohë të këtyre vendimeve, MF ka rekomanduar vazhdimisht përdorimin e të gjitha kanaleve të mundshme institucionale dhe proceduriale, brenda hapësirave që siguron kuadri ligjor në fuqi, duke sugjeruar skedulimin e detyrimit financiar, sipas mundësive të buxhetit të shtetit me këste, në negocim me përfituesit. Ndërkohë, hyrja në fuqi më datë 30.12.2018 e ndryshimeve në ligjin "*Për Avokaturën e Shtetit*", përmban një kre të veçantë dedikuar ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ, ku specifikisht në nenin 19/5 përcaktohen 2 mënyra ekzekutimi:

- ✓ *Detyrimet financiare që burojnë nga vendimet e GJEDNJ-së mbulohen nga buxheti i shtetit, sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM përkatëse për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ.*
- ✓ *Përjashtimisht, për detyrimet financiare deri në 10 000 (dhjetë mijë) EUR, pagesa ekzekutohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ministria përgjegjëse për financat, pas njoftimit nga Avokatura e Shtetit.*

Gjatë vitit 2023,rezultoi se:

- ✓ Këshilli i Ministrave ka miratuar 2 (dy) VKM me një vlerë totale prej 48.650 EUR (rreth 5.3 milionë LEK) të cilat janë përballuar nga Fondi Rezervë i buxheti i shtetit i miratuar për vitin 2023 dhe konkretisht:
  - *VKM nr.445 datë 26.07.2023 "Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ datë 13.12.2022 për çështjen 'Sevdari kundër Shqipërisë'" (kërkesa nr.40662/19), në vlerën 24.600 EUR.*
  - *VKM nr.548 datë 28.09.2023 "Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ datë 06.07.2023 për çështjen 'Elgakoti sh.p.k dhe të tjerë kundër Shqipërisë'" (kërkesa nr.63986/10 dhe 5 kërkesa të tjera), në vlerën 24.050 EUR.*
- ✓ Ndërkohë, Ministria e Financave ka ekzekutuar gjatë 2023 edhe 14 (katërmbëdhjetë) vendime të GJEDNJ, me vlera nën 10.000 EUR, për një total prej 56.984 EUR (rreth 6.1 milionë LEK).

Deri në fund të vitit 2023, detyrimet e materializuara dhe ato kontigjente për vendimet e GJEDNJ, paraqiten mëposhtë:

Tabela 22 Detyrimet faktike dhe kontigjente nga vendimet e GJEDNJ (në EUR)

Vendimet e GJEDNJ	Detyrimi sipas vendimit të GJEDNJ/VKM	Detyrimi kontigjent	Totali i detyrimit
Delijorgji kundër Shqipërisë	15,600 €		15,600 €
Rista dhe të tjerë kundër Shqipërisë (Kërkesa: Dhimërtika dhe Nika k. Shqipërisë)	4,417,750 €		4,417,750 €
Sharxhi kundër Shqipërisë	13,447,300 €		13,447,300 €
Durdaj kundër Shqipërisë	170,000 €		170,000 €
Vjola sh.p.k kundër Shqipërisë	6,000 €		6,000 €
Kokalari kundër Shqipërisë	2,500 €		2,500 €
Vicktoria sh.p.k kundër Shqipërisë	1,450 €		1,450 €
Iliria S.R.L kundër Shqipërisë	10,800 €		10,800 €
Milo kundër Shqipërisë	2,500 €		2,500 €
Sovjani kundër Shqipërisë		3,600 €	3,600 €
Danushi kundër Shqipërisë		5,000 €	5,000 €
Totali	**18,073,900 €**	**8,600 €**	**18,082,500 €**

Shënim: Detyrimi sipas vendimit të GJEDNJ/VKM është detyrimi përkatës nga një vendim i formës së prerë të GJEDNJ/VKM-së respektive, i cili rezulton ende i papaguar deri në momentin e raportimit.

Shënim: Detyrim kontigjent është detyrimi i pritshëm/potencial nga një vendim në pritje i GJEDNJ-së, i raportuar nga Avokatura e Shtetit.

Burimi: Ministria e Financave, Avokatura e Shtetit (2024)

7.4.2 Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit

Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit kanë të bëjnë me vendimet e formës së prerë për zgjidhjen e konflikteve në mosmarrëveshjet dy/shumëpalëshe, në ngarkim të shtetit shqiptar. Duke patur parasysh efektet e qënësishme financiare që rëndom shoqërojnë këto vendime, ato vlerësohen me risk të konsiderueshëm për buxhetin e shtetit.

Në pjesën më të madhe, efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtyre vendimeve janë përballuar nga buxheti i vetë institucioneve buxhetore (kryesisht ministri linje), të cilat kanë qenë edhe palë e paditur në gjykimet respektive. Ndërkohë që, në rastet kur palë e paditur cilësohet 'shteti shqiptar' apo 'qeveria shqiptare', këto vendime likujdohen përmes buxhetit të Ministrisë së Financave dhe/ose Fondit rezervë të buxhetit të shtetit, nëse lind nevoja.

Ministria e Financave, në vazhdimësi ka rekomanduar forcimin e rolit negociues të institucioneve buxhetore dhe Avokaturës së Shtetit në çështjet e kësaj natyre, si edhe disiplinimin e proçesit të shlyerjes financiare të përfituesve. Kjo, me qëllim final lehtësimin, reduktimin dhe shmangien e barrës financiare mbi buxhetin e shtetit

Për vitin 2023, vlera totale e kostove të paguara nga buxheti i shtetit në kuadër të: përfaqësimit ligjor, mbrojtjes sipas shkallëve së gjykimit, shpenzimeve gjyqësore apo të tjera lidhura me vendime të arbitrazhit ndërkombëtar, rezultoi në masën 562.7 milionë LEK. Mëposhtë jepet tabloja e pagesave buxhetore, sipas institucioneve shtetërore përgjegjëse:

- ✓ *Rreth 189.9 milionë LEK Ministria e Financave, për pagesën shërbimeve juridike dhe kostove të tjera ligjore për përfaqësimin dhe mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë në vendime të arbitrazhit ndërkombëtar.*
- ✓ *Rreth 113 milionë LEK nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për pagesën e kostove ligjore, administrative, për përfaqësim dhe mbrojtje lidhur me vendime të arbitrazhit ndërkombëtar.*
- ✓ *Rreth 99.8 milionë LEK Autoriteti Portual Durrës, për kosto administrative dhe ligjore për çështje të arbitrazhit ndërkombëtar.*
- ✓ *Rreth 76.6 milionë LEK Albpetrol Sh.a, për pagesën e shpenzimeve gjyqësore, kostove administrative/ligjore për përfaqësim dhe mbrojtje për çështje të arbitrazhit ndërkombëtar.*
- ✓ *Rreth 57.7 milionë LEK Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për pagesën e kostove ligjore dhe administrative lidhur me një vendim të arbitrazhit ndërkombëtar.*
- ✓ *Rreth 19.5 milionë LEK Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve (AKUK), për pagesën e kostove ligjore për shërbime konsulence, shërbime juridike për përfaqësim dhe mbrojtje për çështje të arbitrazhit ndërkombëtar.*
- ✓ *Rreth 6.2 milionë LEK Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, për pagesën e kostove ligjore për përfaqësim dhe mbrojtje për çështje të arbitrazhit ndërkombëtar.*

Në vijim paraqiten të dhënat përmbledhëse të detyrimeve për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar:

Tabela 23 Detyrime për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar (në EUR)

Detyrimet për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar

në Euro

Ministria e Linjës	Përshkrimi i Vendimeve të Arbitrazhit	Totali i detyrimit fillestar	Detyrimi i Faturuar	Likuidimi	Nga të cilat: Likuidimi 2023	Detyrimi i mbetur nga vendimet e Arbitrazhit/kosto ligjore (A)	Detyrime Kontigjente (B)	Totali i detyrimit (C=A+B)
MIE/ARRSH	ICC Case no. 23998/MHM (c-24011/MHM/HBH). *JV Copri-Aktor vs ARRSH.*	42,472,629	42,472,629	0	0	42,472,629	0	42,472,629
	Kosto ligjore dhe shpenzime gjyqësore ICC Case no. 23998/MHM (c-24011/MHM/HBH)	691,400	466,400	466,400	0	225,000	0	225,000
MIE/AKUK	ICC Case 24140/MHM	13,492,241	13,492,241	0	0	13,492,241	0	13,492,241
	Kostot administrative, të përfaqësimit dhe kosto ligjore për çështjen ICC Case no.24140/MHM/HBH *Construzioni DONDI S.P.A*	2,281,133	2,252,633	2,252,633	182,861	28,500	0	28,500
MIE	ICC Case No. 20564/EMT/GR Hydro srl	142,976	0	0	0	142,976	0	142,976
	Kosto ligjore për procedurat e përfaqësimit dhe mbrojtjes së RSH për rrëzimin e kërkesës për rishikimit të vendimit datë 04.06.2019 ICC Case no.22919/GR.	491,400	380,250	380,250	21,794	0	111,150	111,150
APD	Kosto administrative dhe ligjore për çështjen ICSID Case no.ARB/20/37 (*Durrës Kurum Shipping dhe të tjerë kundër Shqipërisë*)	2,343,805	2,143,805	1,653,805	600,000	690,000	0	690,000
	Kosto Administrative në çështjen ICSID Case no.ARB/23/9 (EMS Shipping &Trading GMBH kundër Shqipërisë)	332,500	332,500	332,500	332,500	0	0	0
MIE/AKBN/ Albpetrol Sh.a	ICC Case no.22676/GR GBC Oil Company LTD vs MIE, AKBN dhe Albpetrol	12,241,533				12,241,533	0	12,241,533
	Kosto ligjore për procedurat e përfaqësimit të MIE/AKBN në çështjen ICC Case 21349/EMT/GR (BPAL v MIE/AKBN dhe Albpetrol)	6,679,616	6,638,506	6,288,852	1,808,555	390,764	0	390,764
Albpetrol Sh.a	Kosto përfaqësimi në çështjen ICC Case Phoenix Petroleum Sha kundër Albeptrol Sh.a	1,790,000	156,868	0	0	1,790,000	0	1,790,000
MF	Kosto paraprake dhe kosto ligjore për çështjen SCC Arbitration 2021/155 *IVICOM Holding Gbmbh*	2,536,716	2,022,034	1,562,831	1,090,281	973,886	0	973,886
	Përfaqësimi i Shqipërisë në çështjen e arbitrazhit Mimoza Ndroqi kundër RSH	775,000	130,000	130,000	130,000	250,000	395,000	645,000
	Kosto ligjore për këshillime ligjor dhe shërbime konsulence për mosmarrëveshjet dhe arbitrazhet ndërkombëtare	600,000	450,000	450,000	150,000	150,000	0	150,000
	Arbitrazhi ICSID nr.ARB/15/28 "Hydro dhe të tjerët kundër Shqipërisë"	108,000,000	0	0		0	108,000,000	108,000,000
	Kosto ligjore lidhur me vendimin e Arbitrazhit ICSID nr.ARB/15/28 "Hydro dhe të tjerët kundër Shqipërisë"	5,128,754	3,394,082	3,291,082	370,487	748,637	949,780	1,698,417
MBZHR	Kosto administrative dhe ligjore për çështjen PCA Case 2018-49 *Valeria Srl vs RSH*	1,944,950	1,744,950	1,744,950	541,075	200,000	0	200,000
	Total	201,944,653	76,076,897	18,553,303	5,227,552	73,796,165	109,455,930	183,252,095

Sqarojmë se, për kontratat të cilat zgjidhen përpara përfundimit të shërbimit të kontraktuar, subjekti likujdohet vetëm për shërbimet e realizuara në funksion të kontratës. Rrjedhimisht nuk ezaurohet e gjithë vlera e përcaktuar në kontratë.

Shënim: Informacioni i mësipërm bazohet në të dhënat më të fundit (Prill 2024) të raportuara në MF nga Avokatura e Shtetit dhe nga Ministritë e Linjës/Institucionet Buxhetore. Për pasojë, vlerësimet tona janë të sakta për aq sa informacion disponojmë. Tagrin për valdimin e tyre e ka vetëm Avokatura e Shtetit.

Shënim: Në tabelën e mësipërme përfshihen detyrime nga vendime përfundimtare të gjykatës së Arbitrazhit dhe detyrime që rjedhin nga kontratat e lidhura mes shtetit shqiptar dhe studiove ligjore/ekspertëve të pavarur etj (kryesisht për procedura të përfaqësimit dhe mbrojtjes, kundërshtimit/rishikimit/anulimit të një vendimi arbitrazhi apo kosto të tjera administrative/aplikimi/përkthimi etj).

Shënim: Totali i detyrimit fillestar është vlera e detyrimit të përcaktuar në një vendim përfundimtar të gjykatës së Arbitrazhit apo vlera totale e përcaktuar në një kontratë të lidhur mes shtetit shqiptar dhe një studio ligjore/ekspert të pavarur etj (kryesisht për procedura të përfaqësimit dhe mbrojtjes, kundërshtimit/rishikimit/anulimit të një vendimi arbitrazhi apo kosto të tjera administrative/aplikimi/përkthimi etj.

Shënim: Detyrimi i mbetur nga vendime të Arbitrazhit Ndërkombëtar/kosto ligjore është detyrimi i papaguar nga një vendim përfundimtar i gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar ose detyrimi i mbetur (i papaguar) nga kontratat e lidhura mes shtetit shqiptar dhe studiove ligjore/ekspertëve të pavarur, për pjesën e detyrimit që është faturuar nga Avokatura e Shtetit dhe rezulton e papaguar ose detyrimi i cili, bazuar në kontratë, duhet të likujdohet sipas fazave të përcaktuara në kontratë, në nenin përkatës për 'tarifat dhe mënyrën e pagesës'.

Shënim: Detyrim kontigjent është detyrimi i pritshëm/potencial i cili ka gjasa të materializohet në periudhat e ardhshme, konkretisht për vendime të gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar të cilat janë subjekt i procedurave juridike të kundërshtimit/rishikimit/pezullimit/anulimit ose detyrime të pritshme nga kontratat e lidhura mes shtetit shqiptar dhe studiove ligjore/ekspertëve të pavarur, për fazat proceduriale të përcaktuara në kontratë të cilat vazhdojnë në rastet kur Tribunali gjen juridiksion dhe vazhdon me fazat e tjera të përcaktuara në kontratë, faza të cilat implikojnë kosto financiare.

MINISTRI I FINANCAVE

ERVIN METE

8. SHTOJCAT

8.1 Shtojca 1 - Zbatimi dhe monitorimi i parimeve dhe rregullave fiskale

Ligji Nr.57 datë 02.06.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar" (referuar në vijim si Ligji Organik i Buxhetit - LOB), në nenin 4/1 sanksionon disa parime dhe rregulla fiskale për mirëmenaxhimin e financave publike në Shqipëri. Ky seksion paraqet zbatueshmërinë e këtyre parimeve dhe rregullave fiskale përgjatë vitit 2023.

Përcaktimi ligjor (1):

Neni 4/1, pika (1.a) i LOB sanksionon që në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe qendrojë poshtë nivelit 45% të PBB.

Zbatimi i ligjit (1):

Ligji fillestar i buxhetit vjetor 2023 (Ligj nr.84/2022 datë 24.11.2022) ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Më specifikisht, raporti i borxhit ndaj PBB për vitin 2022, i vlerësuar në kohën e hartimit dhe miratimit të ligjit fillestar të buxhetit vjetor 2022, ishte 68.8% e PBB. Ndërsa niveli i borxhit që planifikohej në ligjin fillestar të vitit 2023 ishte 67.5% e PBB, pra më i ulët se sa niveli i vlerësuar për vitin 2022.

Shënim: *Niveli i borxhit faktik i rezultuar në fund të 2023 nuk është relevant për sa i përket zbatueshmërisë ligjore të këtij neni/pike të LOB. Ky nen sanksionon vetëm nivelin e planifikuar të borxhit dhe jo atë të rezultuar faktikisht në fund të vitit. Niveli faktik i rezultuar në fund të vitit është informues mbi efektshmërinë e LOB sa i takon uljes faktike të borxhit, por nuk është relevant sa i takon zbatueshmërisë/përputhshmërisë me ligjin.*

Sa i takon vlerësimit të borxhit faktik gjatë vitit 2023 (*sipas shifrave të disponueshme deri në momentin e hartimit të këtij raporti*) ai rezulton 58.9% e PBB. Kjo konsiston në një rënie prej 5.6pp të borxhit publik total nga niveli faktik prej 64.5% që ishte në 2022. Ndërsa, nëse në konsideratë do të merrej treguesi i borxhit publik total *neto* nga gjendja e depozitës së Qeverisë në Bankën e Shqipërisë (Llogarisë Unike të thesarit), atëherë rënia e borxhit sipas këtij treguesi (*borxhi neto*) rezulton me 7.4pp, nga 63.8% në 2022 në 56.4% në 2023.

Përcaktimi ligjor (2):

Neni 4/1, pika (1.b) i LOB përcakton që përjashtim nga sanksionet e pikës së mësipërme të këtij neni (pikës "a") mund të bëhet vetëm në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme, të përcaktuara në nenin 4/4 të këtij LOB.

Zbatimi i ligjit (2):

Gjatë vitit 2023 nuk ka qenë rasti i aplikimit të kësaj klauzole përjashtuese.

Përcaktimi ligjor (3):

Neni 4/1, pika (1.c) i LOB sanksionon që vlera e Produktit të Brendshëm Bruto, nominale në LEK, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj PBB për vitet buxhetore që planifikohen dhe vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin "Perspektiva Ekonomike Botërore" (*World Economic Outlook*) të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqërues të ligjit vjetor të buxhetit.

Zbatimi i ligjit (3):

Çdo ligj vjetor i buxhetit 2023 hartuar dhe miratuar për vitin 2023 (ligj fillestar ose i ndryshuar) ka qenë në përputhje të plotë me përcaktimet ligjore të LOB.

Shënim: *Në ndryshimet e fundit të ligjit të buxhetit 2023 me anë të AN nr.5 dhe AN nr.6, si vlera referencë të projeksioneve të FMN janë marrë ato të misionit më të fundit të FMN në atë kohë (projeksionet më të rifreskuara dhe relevante) në vend të projeksioneve që gjendeshin në WEO në atë kohë. Sipas shënimit të bërë në WEO më të fundit të publikuar në muajin Tetor 2023[7], thuhet se "Projeksionet e WEO u përgatitën përpara fillimit të misionit të Artikullit IV që përfundoi më datë 10 Tetor 2023 dhe kështu nuk pasqyrojnë përditësimet e bëra gjatë misionit".*

Tabela më poshtë paraqet shifrat konkrete në kohën e hartimit dhe miratimit të ligjit fillestar dhe secilit ndryshim pasues përgjatë 2023 dhe përputhshmërinë respektive me këtë përcaktim të LOB.

[7] *World Economic Outook, October 2023, https://www.imf.org/en/Publications/WEO/Issues/2023/10/10/world-economic-outlook-october-2023*

Ligjet për Buxhetin e Vitit 2023

Ligji Nr. 84/2022, dt. 24.11.2022				AN. Nr. 5, dt. 18.10.2023				AN. 6, dt. 14.12.2023			
PBB sipas FMN (1) (miliardë lekë)		PBB e përdorur në planifikim (miliardë lekë)		PBB sipas FMN (3) (miliardë lekë)		PBB e përdorur në planifikim (miliardë lekë)		PBB sipas FMN (2) (miliardë lekë)		PBB e përdorur në planifikim (miliardë lekë)	
2022	**2023**	**2022**	**2023**	**2022**	**2023**	**2022**	**2023**	**2022**	**2023**	**2022**	**2023**
2,059.0	2,176.7	2,058.2	2,176.1	2,138.3	2,312.5	2,138.3	2,176.1	2,138.3	2,312.5	2,138.3	2,176.1

(1) WEO - Tetor 2022; (2) WEO - Prill 2023; (3) WEO - Tetor 2022

Shënim: *Vlerat faktike të PBB 2023 të vlerësuara dhe publikuara nga INSTAT, nuk janë relevante për sa i përket zbatueshmërisë ligjore të këtij neni/pike të LOB. Ky nen/pikë sanksionon vetëm limitin e sipërm sa i takon PBB të parashikuar dhe përdorur gjatë planifikimeve të çdo ligji vjetor buxheti (pra, jo më i lartë se sa parashikmi respektiv i FMN). Ndërkohë që PBB faktike (pra, sipas INSTAT) e rezultuar në fund të vitit, është informuese sa i takon efektshmërisë së LOB lidhur me "realizmin" e parashikimeve të PBB dhe veçanërisht, eleminin e devijimeve "optimiste" sistematike (të përsëritura disa vite rresht).*

Përcaktimi ligjor (4):

Neni 4/1, pika (1.ç) i LOB sanksionon që në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontigjencë e veçantë prej jo më pak se 0.7% e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.

Zbatimi i ligjit (4):

Çdo ligj vjetor i buxhetit hartuar dhe miratuar për vitin 2023 (ligj fillestar ose i ndryshuar) ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Tabela mëposhtë paraqet shifrat konkrete në kohën e hartimit e miratimit të ligjit fillestar dhe secilit ndryshim pasues përgjatë 2023 dhe përputhshmërinë respektive me këtë përcaktim të LOB.

Ligjet për Buxhetin e Vitit 2023

Vlera e Buxhetuar e zërit "Kontigjencë për luhatjet e normave të interesit"

Ligji Nr. 84/2022, dt. 24.11.2022	AN. Nr. 5, dt. 18.10.2023	AN. 6, dt. 14.12.2023
4.9 miliardë Lekë ose 0.7% e shpenzimeve totale sipas këtij ligji	4.9 miliardë Lekë ose 0.7% e shpenzimeve totale sipas këtij ligji	4.9 miliardë Lekë ose 0.7% e shpenzimeve totale sipas këtij ligji

Përcaktimi ligjor (5):

Neni 4/1, pika (1.d) i LOB sanksionon që në çdo ligj vjetor fillestar të buxhetit, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, kur rritja reale e Produktit të Brendshëm Bruto, e parashikuar në raportin respektiv "Perspektiva Ekonomike Botërore", të FMN-së, është të paktën 5%, atëherë defiçiti i përgjithshëm nuk mund të jetë më i lartë se 2% e Produktit të Brendshëm Bruto, përveç rasteve të rrethanave të jashtëzakonshme, të përcaktuara në shkronjat "a", "b" dhe "c", të nenit 4/4, të këtij ligji.

Zbatimi i ligjit (5):

Në çdo fazë të hartimit dhe miratimit të ligjeve vjetore të buxhetit për vitin 2023 kjo pikë nuk ka qenë rasti të jetë kufizuese për sa i takon sanksionit ligjor që ajo përcakton, pasi në raportet respektive *"Perspektiva Ekonomike Botërore"* të FMN, nuk parashikohej një rritje reale për vitin 2023 prej të paktën 5%. Rrjedhimisht, të gjitha ligjet vjetore të buxhetit të hartuara dhe miratuara për vitin 2023 kanë qenë në përputhje me këtë pikë.

Ligjet për Buxhetin e Vitit 2023

Ligji Nr. 84/2022, dt. 24.11.2022		AN. Nr. 5, dt. 18.10.2023		AN. 6, dt. 14.12.2023	
Rritja reale e PBB (e parashikuar nga FMN) (1) (në %)	Deficiti i targetuar (në % të PBB)	Rritja reale e PBB (e parashikuar nga FMN) (3) (në %)	Deficiti i targetuar (në % të PBB)	Rritja reale e PBB (e parashikuar nga FMN) (3) (në %)	Deficiti i targetuar (në %të PBB)
2023	**2023**	**2023**	**2023**	**2023**	**2023**
2.5	2.6	3.6	2.6	3.6	2.6

Shënim: *Kjo pikë ka si synim të ankorojë në mënyrë kundra-ciklike politikën fiskale. Pra, nëse ekonomia parashikohet të rritet "përtej potencialit të natyrshëm" të saj, që në rastin konkret ky prag është kuantifikuar në LOB si "rritja reale e parashikuar nga FMN të paktën 5%", atëherë në këtë*

rast kjo pikë ankoron politikën fiskale drejt një konsolidimi më të lartë në terma të borxhit publik, duke vendosur një limit direkt mbi defiçitin e targetuar në jo më shumë se 2% e PBB. P.sh., një rast hipotetik, ilustrues, nëse do të ndodhte që në një vit të caktuar rritja reale do të ishte 5% dhe nëse defiçiti do të ankorohej sipas kësaj pike 2% (maksimumi i lejueshëm në këtë rast), duke supozuar një normë inflacioni (deflator) 3% dhe variablat e tjerë të pandryshuar, atëherë borxhi publik përgjatë vetëm atij viti do të reduktohej me rreth 4pp. Ndërkohë pika (ç) në nenin 4/4 përcakton rastin e kundërt të pikës më sipër, pra përcakton një opsion manovrimi ekspansionist të politikës fiskale për të ndikuar në stabilizimin e ciklit të ekonomisë nëse do të ndodhte një rast ku ekonomia të gjendej "në një pikë tejet të dobët të saj", e cila është kuantifikuar në LOB si "rritje reale e parashikuar nga FMN në 1% ose më e ulët". Por në këtë rast, që të mund të përdoret ky opsion lehtësues për stabilizim kundra-ciklik duhet që gjithashtu të jetë siguruar një farë niveli relativisht i qëndrueshëm i borxhit publik, që në këtë pikë të LOB kuantifikohet si niveli nën 60% të PBB.

Përcaktimi ligjor (6):

Neni 4/1, pika (1.dh) i LOB sanksionon që në fazat monitoruese të buxheteve faktike, nëse për shkak të rishikimeve të mundshme të PBB-së nominale ose për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit, që përdoren për vlerësimin e stokut faktik të borxhit publik, rezulton se raporti i borxhit publik ndaj PBB-së nuk është më i ulët, kundrejt nivelit të vitit pararendës, atëherë, si rregull këto devijime duhet të kompensohen në planifikimet e viteve buxhetore pasuese.

Zbatimi i ligjit (6):

Në fund të vitit 2023 niveli i borxhit faktik ka rezultuar më i ulët se niveli që shënoi në vitin 2022 (*deri në këtë moment të përgatitjes së këtij raporti*), specifikisht borxhi në vitin 2022 shënoi 64.5% ndërsa në fund të 2023 shënoi 58.9%. Rrjedhimisht, kjo pikë nuk është relevante për sa i takon planifikimeve në buxhetet pasuese.

Shënim: *Kjo pikë nuk është relevante sa i takon përputhshmërisë me LOB për vitin që analizohet aktualisht, konkretisht viti 2023, por ajo ka implikime që duhen adresuar në ligjet e buxheteve të viteve të tjera në vijim nëse ndodh rasti që parashikohet në këtë pikë të LOB.*

Përcaktimi ligjor (7):

Neni 4/1, pika (2) i LOB sanksionon që të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rastet e arkëtimit ato përdoren, jo më pak se 50%, për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër për investime publike. Pas arritjes së nivelit të borxhit publik, sipas përcaktimeve të shkronjës "a", të pikës 1, të këtij neni, përdorimi i të ardhurave të arkëtuara nga privatizimet përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit.

Zbatimi i ligjit (7):

Çdo ligj vjetor i buxhetit hartuar dhe miratuar për vitin 2023 ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Së pari, në asnjë ligj vjetor të buxhetit 2023 nuk janë parashikuar të ardhura shtesë nga privatizimet. Së dyti, të ardhurat nga privatizimet të realizuara gjatë vitit 2023 kanë qenë në vlerën e rreth 47 milionë LEK, e cila është një vlerë marxhinale, pa rëndësi relative, krahasuar me ndryshimet e pësuara përgjatë vitit (në ndryshimet ligjore, si dhe rezultatet faktike) të zërit të shpenzimeve kapitale totale, si dhe atij të huamarrjes totale neto. Pra, pjesa e dytë e kësaj pike (*lidhur me përdorimin e këtyre të hyrave në rast arkëtimi*) nuk gjen aplikim (*nuk është relevante*) në këtë rast.

Përcaktimi ligjor (8):

Neni 4/1, pika (3) i LOB sanksionon që ndryshimet e ligjeve tatimore, me efekte në të ardhurat buxhetore, bëhen një herë në vit, jo më vonë se tre muaj përpara fillimit të vitit të ri fiskal. Ligjet tatimore konsultohen paraprakisht me përfaqësuesit e biznesit dhe grupe të tjera interesi, në strukturat e ngritura për këtë qëllim.

Zbatimi i ligjit (8):

Amendimet kryesore të ligjeve tatimore me efekt në të ardhurat e buxhetit për vitin 2023, kanë nisur në fillim të katërmujorit të tretë 2022. Ndryshimet kryesore ligjore për TVSH-në, për tatimin mbi të ardhurat, për taksat kombëtare dhe për akcizat, i janë nënshtruar diskutimit dhe marrjes së mendimeve nga ministritë e linjës, si dhe nga organizatat përfaqësuese dhe grupet e interesuara të biznesit, duke reflektuar kërkesat dhe sugjerimet e tyre. Këto ndryshime janë miratuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave dhe më pas nga Kuvendi në Nëntor 2022, me efekte që fillojnë nga viti 2023. Efektet e ndryshimeve fiskale përgjithësisht janë marrë në konsideratë në planifikimin e të ardhurave tatimore të buxhetit 2023, buxhet i cili u miratua pas miratimit të ndryshimeve ligjore të legjislacionit fiskal.

Përcaktimi ligjor (9):

Neni 4/1, pika (4) i LOB sanksionon që masa e defiçitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit, përveç në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme, që parashikohen në nenin 4/4 të këtij ligji.

Zbatimi i Ligjit (9):

Çdo ligj vjetor i buxhetit hartuar dhe miratuar për vitin 2023 ka qenë në përputhje të plotë me këtë përcaktim ligjor. Tabela më poshtë paraqet me shifra specifike përputhshmërinë e secilit ligj të buxhetit 2023 me këtë përcaktim të LOB.

Ligjet për Buxhetin e Vitit 2023

Ligji Nr. 84/2022, dt. 24.11.2022		**AN. Nr. 5, dt. 18.10.2023**		**AN. 6, dt. 14.12.2023**	
Deficiti i targetuar (miiardë lekë)	Shpenzimet Kapitale të targetuara (miliardë lekë)	Deficiti i targetuar (miiardë lekë)	Shpenzimet Kapitale të targetuara (miliardë lekë)	Deficiti i targetuar (miiardë lekë)	Shpenzimet Kapitale të targetuara (miliardë lekë)
55.5	123.9	55.5	136.6	55.5	135.1

Shënim: *Edhe kjo pikë e LOB jep përcaktime ligjore të detyrueshme për fazën planifikuese të buxhetit, ndërkohë që nuk është sanksionuese për rezultatin faktik në mbyllje të vitit.*

Përcaktimi ligjor (10):

Neni 4/3 sanksionon që në vitet buxhetore, gjatë të cilave mbahen zgjedhjet e përgjithshme, ekzekutimi i defiçitit buxhetor të qeverisjes së përgjithshme, përveç rasteve të jashtëzakonshme të parashikuara në nenin 4/4 të këtij ligji, bëhet në përputhje me përcaktimet e këtij neni, si më poshtë:

a) *ekzekutimi i defiçitit deri në fund të tremujorit të parë të vitit buxhetor, nuk mund të jetë më i lartë se 30% e defiçitit vjetor të përcaktuar në ligjin e buxhetit vjetor;*
b) *ekzekutimi i defiçitit deri në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit buxhetor, nuk mund të jetë më i lartë se 55% e defiçitit vjetor të përcaktuar në ligjin e buxhetit vjetor;*
c) *ekzekutimi i defiçitit deri në fund të nëntëmujorit të parë të vitit buxhetor, nuk mund të jetë më i lartë se 80% e defiçitit vjetor të përcaktuar në ligjin e buxhetit vjetor.*

Zbatimi i ligjit (10):

Gjatë vitit 2023, nuk janë mbajtur zgjedhje të përgjithshme dhe rrjedhimisht nuk aplikohet përcaktimi ligjor i mësipërm.

8.2 Shtojca 2 – Efektet e paketës fiskale 2023

Masat	Efekti i parash. i paketës	Të ardhura të mbledhura si efekt i masës fiskale	Diferenca Parash/Të ardhura të mbledhura	Faktorët	Efektet
Taksa e energjisë (on off)	8.30 miliardë LEK	9.74 miliardë LEK	1.44 miliardë LEK	Marrja e masave të jashtëzakonshme dhe të kufizuara në kohë për të përballuar krizën energjetike dhe për të mbrojtur konsumatorët, veçanërisht shtresat në nevojë, nga ndikimet e rritjes së çmimeve nga lufta Rusi–Ukrainë	Shpërdarja e fondit në dy keste për pensionistet dhe shtresat në nevojë
Kalendari i akcizes. Rritja sipas kalendarit për të gjithë kategoritë e "Duhan dhe nën produkteve të tij	0.8 miliardë LEK	0.78 miliardë LEK	-0.02 miliardë LEK	Kalendari progresiv i rritjes së nivelit të akcizave për duhanin dhe nënproduktet e tij, i cili përfshin periudhën 2022-2026.	Përmbushja e objektivave shtesë të shëndetit publik dhe anëtarësimit në BE, por edhe për t'u përafruar me nivelin minimal.

Indeksimi i akcizës me normën e inflacionit	1.00 miliardë LEK	1.17 miliardë LEK	0.17 miliardë LEK	Indeksimi automatik çdo dy vjet i tarifave specifike të akcizës së mallrave bazuar në normen e rritur te inflacionit.	Në kushtet e një viti jo normal me një nivel të lartë inflacioni, përkatësisht për 2022 u propozua me qëllim shmangien e rritjeve jo normale në nivelin e akcizave, të përcaktohet një nivel maksimal normë rritjeje i nivelit të akcizës, që nuk kalon 3% për dy vitet paraardhëse për efekt të llogaritjes së nivelit të akcizës.
Unifikimi i tarifës për Birrën	0.26 miliardë LEK	0.54 miliardë LEK	0.28 miliardë LEK	Ky propozim vjen në kuadër të hartimit të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave, si dhe rekomandimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar	Rregullon në mënyrën efikase administrimin. unifikon tarifën e akcizës për Birrën e bërë nga malto nga prodhues vendas e të huaj.
Unifikimi i tarifës për Pijet alkoolike	0.00 miliardë LEK	0.00 miliardë LEK	0.00 miliardë LEK	Ky propozim vjen për të shmangur mundësinë e evazionit mbështetur edhe në rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar.	Shmangja e evazionit
Akumulatorët pa akcizë	-0.05 miliardë LEK	-0.08 miliardë LEK	-0.03 miliardë LEK	Në kuadër të zbatimit të strategjisë për kursimin e energjisë si dhe subvencionimit të çmimit të paneleve diellore, heqja e akcizës për akumulatorët për panelet diellore dhe makinerit eklektrike	Stimulimi i përdorimit të makinave me akumulatorë tashmë në të gjithë Europën, si pjesë e politikave të mbrojtjes së mjedisit.
Drute e zjarrit pa tvsh	-0.00 miliardë LEK	0.00 miliardë LEK	0 miliardë LEK	Me qëllim mbrojtjen dhe suportimin e individëve në kushtet e një krize energjitike si kjo e tanishmja. Artikujt të destinuara për ngrohje janë një zëvëndësues i afërt i ngrohjes me energji elektike. Për këtë qëllim, këto artikuj propozohet të jenë pa TVSH si në import ashtu dhe brenda vendit, duke mos rënduar konsumatorin final vetem per 2023.	Për shkak të krizës botërore energjitike, gjatë 2022 është konstatuar një rritje e jashtëzakonshme e çmimit të energjisë në treg, që ka sjellë pasoja negative në shumë sektorë të ekonomisë, me impakt të drejtpërdrejtë në koston e të gjitha mallrave/çmimeve në treg, rrjedhimisht në një rritje të kostos së jetesës
Rrita e pages minimale nga 36 ne 40 mije leke	1.00 miliardë LEK	1.04 miliardë LEK	0.04 miliardë LEK	Rritja e pagës minimale duke barazuar vendet e rajonit	Nënkupton të ardhurat të përshtatura me nivelin e çmimeve
TAP nga rritja e pages në Ad.Publike	1,067 miliardë LEK	1.17 miliardë LEK	0.10 miliardë LEK	Më qëllim rritjen e pages mesatare në administraten publike	Rritja e pagave në administratën shtetërore, që ndikoi edhe rritjen e tyre nga sektori privat.

8.3 Shtojca 3 – Treguesit kryesorë të performancës sipas ministrive të linjës

Buxheti i vitit 2023, financoi 130 programe buxhetore dhe synonte realizimin e 1034 produkteve të 11 ministrive të linjës. Gjithashtu, këto shpenzime kanë financuar edhe buxhetin e institucioneve të pavarura, fondeve speciale dhe njësive të vetëqeverisjes vendore në 61 bashki dhe 12 qarqe. Në përgjithësi, evidentohet një performancë relativisht e mirë e realizimit të produkteve buxhetore nga ministritë e linjës, ku nga 1034 produkte të planifikuara për vitin 2023, janë realizuar plotësisht 884 produkte ose 85.4%, pjesërisht 77 produkte ose 7.4% dhe nuk janë realizuar vetëm 73 produkte ose 7%. Konkretisht:

Tabela 24 Treguesit kryesorë të performancës 2023, sipas ministrive të linjës

Nr	Ministria e Linjës	Produktet (në numër)			
		Realizuar			
		Planifikuar	Plotesisht	Pjeserisht	Pa realizuar
1	Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	128	122	4	2
2	Ministria e Infrastruktures dhe Energjise	142	116	3	23
3	Ministria e Financave dhe Ekonomise	129	115	12	2
4	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise	94	89	0	5
5	Ministria e Kultures	51	36	12	3
6	Ministria e Shendetesise dhe Mbrotjes Sociale	138	125	10	3
7	Ministria e Drejtesise	51	46	2	3
8	Ministria per Evropen dhe Punet e Jashtme	25	19	5	1
9	Ministria e Brendshme	91	79	8	4
10	Ministria e Mbrojtjes	135	93	16	26
11	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	50	44	5	1
	TOTALI	**1034**	**884**	**77**	**73**

Tabela 25 Realizimi i buxhetit 2023 në disa institucione kryesore qendrore (në 000/LEK)

Institucioni	2023 Plan fillestar	2023 Plan i rishikuar	2023 (fakt)	2022 (fakt)	Shpenzime korrente (fakt/plan)	Shpenzime kapitale (fakt/plan)	Total Gjithsej (fakt/plan 2023)	Fakti 2023 /Fakti 2022
Presidenca	279,400	253,500	228,323	222,716	81%	98%	82%	103%
Kuvendi	1,294,266	1,495,107	1,427,061	1,165,938	112%	76%	110%	122%
Kryeministria	576,500	627,731	569,678	453,050	105%	66%	91%	126%
Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	14,247,832	15,435,877	12,784,611	13,574,067	121%	59%	91%	94%
Ministria e Infrastruktures dhe Energjise	54,757,489	68,543,039	63,309,861	45,328,484	141%	113%	116%	140%
Ministria e Financave dhe Ekonomise	65,992,432	60,049,953	57,251,652	75,752,062	91%	33%	87%	76%
Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinise	47,174,000	38,494,430	37,851,149	44,128,463	91%	68%	103%	86%
Ministria e Kultures	3,972,481	4,441,017	4,025,177	4,046,351	107%	77%	102%	99%
Ministria e Shendetesise	78,045,728	53,071,651	52,221,885	77,224,495	123%	59%	98%	68%
Ministria e Drejtesise	12,327,665	11,579,768	11,038,629	8,328,365	100%	23%	90%	133%
Ministria per Evropen dhe Punet e Jashtme	2,972,048	3,046,991	2,562,310	2,578,178	96%	116%	86%	99%
Ministria e Brendshme	24,129,147	26,619,356	26,213,720	22,245,726	86%	88%	109%	118%
Ministria e Mbrojtjes	40,256,139	35,257,751	30,534,740	25,847,561	111%	53%	76%	118%
Sherbimi Informativ Kombetar	1,876,900	2,276,600	2,243,630	1,674,750	94%	83%	120%	134%
Akademia e Shkencave	189,000	212,847	195,400	143,230	121%	99%	104%	136%
Kontrolli Larte i Shtetit	509,100	563,300	545,164	427,564	111%	66%	109%	128%
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	2,302,600	2,629,020	2,163,142	2,106,208	105%	74%	94%	103%
Prokuroria e Pergjithshme	2,620,500	3,505,772	3,436,718	2,205,906	139%	43%	131%	156%
Keshilli I Larte Gjyqesor	4,362,600	4,847,957	4,664,457	3,233,944	119%	48%	107%	144%
Gjykata Kushtetuese	170,500	238,102	203,723	166,701	119%	120%	119%	122%
Fondi i Zhvillimit Shqipetar	17,835,128	21,092,389	18,870,198	22,277,646	-	106%	106%	85%
Veprimtaria e Mbikëqyrjes dhe Rivleresimit ne sistemin e Drejtesise	861,300	1,066,766	1,015,078	687,753	129%	9%	118%	148%
Institucione te tjera Qeveritare	14,515,253	14,448,454	12,495,714	10,115,456	97%	72%	87%	124%

8.3.1 Shëndetësia dhe Mbrojtja Sociale

Në përputhje me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2023, performanca e treguesve buxhetorë për programet kryesore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, paraqitet si më poshtë:

Tabela 26 Realizimi i buxhetit 2023 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (në mijë LEK)

Programi buxhetor	Plani fillestar 2023		Plani i rishikuar 2023		Fakti 2023		Realizimi në % me planin fillestar		Realizimi në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	358,500	18,000	335,822	17,200	299,724	13,537	84%	75%	89%	79%
Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë	1,036,500	-	1,138,200	0	1,135,013	-	110%	-	100%	-
Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor	7,855,933	509,318	6,544,533	405,818	6,540,602	440,030	83%	86%	100%	108%
Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor	31,933,667	2,556,204	32,807,214	1,718,904	32,387,614	1,563,338	101%	61%	99%	91%
Shërbime të Shëndetit Publik	4,037,428	150400	3,647,083	51,700	3,621,730	51,545	90%	34%	99%	100%
Përkujdesja Sociale	29,212,000	377,778	30,597,119	88,778	30,111,654	75,351	103%	20%	98%	85%
Gjithsej	74,434,028	3,611,700	75,069,971	2,282,400	74,096,336	2,143,802	100%	59%	99%	94%
Shpenzime nga të ardhura jashtë limitit	-	-	387,727	0	387,727	0	-	-	100%	-
Gjithsej	74,434,028		75,457,698		74,484,063		100%		99%	

Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u rishikua në rritje për shpenzimet korente gjatë vitit 2023, në kuadër të efektit të rritjes së pagave dhe me efekt zbrites për shpenzimet kapitale. Më konkretisht:

Programi **"Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Parësor"** ka realizuar qëllimin, i cili synon mbulim universal të nevojave të popullatës për kujdes mjekësor parësor. Personeli shëndetësor u angazhua maksimalisht nëpërmjet vizitave në qendra shëndetësore. Qëllimi i programit u realizua nëpërmjet objektivit, sa më poshtë:

- *Përmirësimi i shërbimeve parandaluese dhe të diagnostikimit të hershëm të sëmundjeve.*

Ky objektiv u realizua nëpërmjet produkteve, performanca e të cilave për vitin 2023, është si më poshtë:

- ✓ *7.3 milionë vizita në kuadër të "Mbulimi me kujdesin parësor", me kosto faktike prej 1,29 miliardë LEK.*
- ✓ *467,663 individë të moshës 35 - 70 vjeç, kanë kryer kontrollin bazë (Chek-up), "Kryerja e Check-Up", u realizua me një kosto faktike prej 750 milionë LEK.*
- ✓ *382,456 "Pacientë të trajtuar me recetë me rimbursim nga mjeku i familjes", u realizua me një kosto faktike prej 4.5 miliardë LEK.*

Programi **"Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor"**, i cili synon mbulim universal të nevojave të popullatës për kujdes mjekësor të specializuar. Gjatë vitit 2023 janë trajtuar në shërbimet me shtretër rreth 307,808 pacientë (rreth 29 mijë më shumë nga e njëjta periudhë e një viti më parë).

U kryen normalisht këto shërbime:

- ✓ *307,808 pacientë të shtruar në spitale, me kosto faktike prej rreth 25.4 miliardë LEK.*
- ✓ *200,245 seanca për trajtimin e pacientëve me dializë, me kosto faktike rreth 2.57 miliardë LEK.*
- ✓ *1,647 pacientë të trajtuar në spitalet psikiatrike, me një kosto prej 842.8 milionë LEK.*
- ✓ *10,908 pacientë të trajtuar nga paketat spitalore të kardiologjisë dhe kardiokirurgjisë, me një kosto faktike prej 1.18 miliard LEK;*
- ✓ *22 pacientë nga paketat e transplanteve renale, me një kosto faktike prej 36 milionë LEK.*
- ✓ *4,138 pacientë me katarakte, shoqëruar me një kosto prej 76.8 milionë LEK.*
- ✓ *26,686 pacientë me radioterapi, me një kosto faktike 110.5 milionë LEK.*
- ✓ *4,388,583 ekzaminime laboratorike, shoqëruar me një kosto prej 1.73 miliardë LEK.*

Programi **"Shërbime të Shëndetit Publik"** ofrohet nëpërmjet programeve kombëtare të imunizimit, TBC, HIV/AIDS dhe IST, të survejancës epidemiologjike dhe ndjekjes së sëmundshmërisë infektive (sëmundshmërisë kronike me pasoja në shëndet publik të ndikuara nga kushtet e mjedisit) si dhe të programeve të sigurisë ushqimore, kontrollit të ujit të pijshëm dhe shëndetit riprodhues. Gjatë vitit 2023:

- ✓ *170 mijë fëmijë të vaksinuar të moshës 0-18 vjeç me një kosto faktike prej 314.6 milionë LEK.*
- ✓ *3,503 monitorime të situatave epidemilogjike, me një kosto faktike prej rreth 2.4 miliardë LEK.*
- ✓ *5,136 grave të depistuara për kancerin e gjirit dhe 9,232 grave për kancerin e qafës së mitrës, me një kosto faktike prej 38 milionë LEK.*
- ✓ *23,241 kontrolle dhe inspektime, shoqëruar me një kosto prej prej 153 milion LEK 419.5 milionë LEK.*
- ✓ *248,097 persona të vaksinuar me vaksinën e gripit sezonal me një kosto faktike prej 132 milionë LEK.*

Programi **"Përkujdesi Social"** mbështet nëpërmjet pagesave në cash dhe shërbimeve sociale, familjet në nevojë dhe individët me aftësi të kufizuara, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe mundësive personale, për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara social ekonomike.Gjatë vitit 2023, programi i ndihmës ekonomike u zgjerua për të mbështetur me ndihmë ekonomike shtesë për familjet që ishin përfituese nëpërmjet 3 paketave të miratuara gjatë vitit 2023. Më hollësisht, produktet e financuara nga programi përfshijnë:

- ✓ *62,399 "Familje dhe individë në nevojë që përfitojnë nga skema e Ndihmës Ekonomike (NE)" shoqëruar me një kosto faktike 6 miliard LEK.*
- ✓ *163,298 "Persona me aftësi të kufizuar nga programi i aftësisë së kufizuar", është realizuar me një kosto faktike prej 18.3 miliard LEK.*
- ✓ *116 persona "Përfitues të shërbimeve të përkujdesit social të ofruara në qëndrat rezidenciale publike", është realizuar me një kosto faktike prej rreth 382.2 milionë LEK.*
- ✓ *42,740 bebe kanë përfituar nga "Shpërblimi i lindjes", me një kosto faktike totale rreth 3.3 miliardë LEK.*

Programi **"Shërbime të Shëndetit Publik"** ofrohet nëpërmjet programeve kombëtare të imunizimit, TBC, HIV/AIDS dhe IST, të survejancës epidemiologjike dhe ndjekjes së sëmundshmërisë infektive (sëmundshmërisë kronike me pasoja në shëndet publik të ndikuara nga kushtet e mjedisit) si dhe të programeve të sigurisë ushqimore, kontrollit të ujit të pijshëm dhe shëndetit riprodhues. Gjatë vitit 2023:

- ✓ *Janë vaksinuar rreth 170 mijë fëmijë të moshës 0-18 vjeç me një kosto faktike prej 314.6 milionë LEK.*
- ✓ *Janë kryer 3,503 monitorime të situatave epidemilogjike, me një kosto faktike prej rreth 2.4 miliardë LEK.*
- ✓ *Është kryer depistimi i 5,136 grave për kancerin e gjirit dhe 9,232 grave për kancerin e qafës së mitrës, me një kosto faktike prej 38 milionë LEK.*
- ✓ *Janë kryer rreth 23,241 kontrolle dhe inspektime nga inspektoriatet, shoqëruar me një kosto prej prej 153 milion LEK 419.5 milionë LEK.*
- ✓ *Janë vaksinuar rreth 248,097 persona me vaksinën e gripit sezonal për vitit 2023 me një kosto faktike prej 132 milionë LEK.*

Programi **"Përkujdesi Social"** mbështet nëpërmjet pagesave në cash dhe shërbimeve sociale, familjet në nevojë dhe individët me aftësi të kufizuara, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe mundësive personale, për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara social ekonomike.Gjatë vitit 2023, programi i ndihmës ekonomike u zgjerua për të mbështetur me ndihmë ekonomike shtesë për familjet që ishin përfituese nëpërmjet 3 paketave të miratuara gjatë vitit 2023. Më hollësisht, produktet e financuara nga programi përfshijnë:

- ✓ *"Familje dhe individë në nevojë që përfitojnë nga skema e Ndihmës Ekonomike (NE)", gjatë vitit 2023 kanë përfituar rreth rreth 62,399 familje dhe individë në nevojë që përfitojnë nga skema e NE shoqëruar me një kosto faktike 6 miliard LEK.*
- ✓ *"Persona me aftësi të kufizuar nga programi i aftësisë së kufizuar", është realizuar me një kosto faktike prej 18.3 miliard LEK për rreth 163,298 persona me aftësi të kufizuar.*
- ✓ *"Përfitues të shërbimeve të përkujdesit social të ofruara në qëndrat rezidenciale publike", është realizuar me një kosto faktike prej rreth 382.2 milionë LEK dhe janë trajtuar 116 persona.*
- ✓ *"Shpërblimi i lindjes" kanë përfituar shpërblimin e lindjes 42,740 bebe, me një kosto faktike totale prej rreth 3.3 miliardë LEK.*

Për sa u përket **investimeve publike,** realizimi në vitin 2023 ishte 77.8% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (1.5 milardë LEK) ose 95.9% e planit vjetor të ndryshuar me AN nr.6/2023 dhe 37.5% e buxhetit fillestar për projektet me financim të huaj (0.64 miliardë LEK) ose 86.7% e planit vjetor të ndryshuar

me AN nr.6/2023. Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi disa ndryshime duke pakësuar fonde për projekte që nuk mund të realizoheshin gjatë vitit, me financim të huaj dhe të brendshëm, përfshirë edhe disa rialokime. Janë mbyllur rreth 55 projekte investimi në vlerën e rreth 832 milionë LEK, ku ndër më kryesoret veçojmë:

- ✓ *Ndërtimi i Spitalit të Ri të Sëmundjeve të Brendshme në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza, me vlerë 18 milionë euro pjesa ndërtimore dhe 281 milionë LEK pajisjet mjekësore dhe mobilimit;*
- ✓ *Rikonstruksion i QKTGJ së bashku me pajisjet me vlerë 178 milionë LEK;*
- ✓ *Rikonstruksion i qendrave shëndetësore për vitet 2022-2023" ku u rikonstruktuan gjithsej 25 objekte me vlerë 102 milionë LEK;*
- ✓ *Rikonstruksioni i qendrës së gruas dhe krijimi i paketës së fertilizimit in - Vitro pranë Spitalit Universitar Koço Gliozheni në vlerën 83 milionë LEK përfshirë dhe pajisjet mjekësore;*
- ✓ *Rikonstruksion i Urgjencës së spitalit Vlorë në bashkëpunim me kooperacionin Italian, 76 milionë LEK;*
- ✓ *Ngritja e modulit shtesë për kontrollin e menaxhimit të rastit në kuadër të projektit PAK nga BB me vlerë 60 milionë LEK;*
- ✓ *Unite dentare për kujdesin dentar te fëmijët me vlerë rreth 30 milionë LEK;*

8.3.2 Arsimi

Në përputhje me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2023, performanca e treguesve buxhetorë për këto katër programe kryesore në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, paraqitet si më poshtë:

Tabela 27 Realizimi i buxhetit 2023 për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (në mijë LEK)

Programi buxhetor	Plani fillestar 2023		Plani i rishikuar 2023		Fakti 2023		Realizimi në % me planin fillestar		Realizimi në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	740,879	55,000	886,562	46,000	856,304	45,022	116%	82%	97%	98%
Zhvillimi i Sportit	276,000	170,000	952,100	150,000	838,849	149,208	304%	88%	88%	99%
Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	23,853,434	1,437,000	25,481,987	1,207,000	25,402,482	1,144,238	106%	80%	100%	95%
Arsimi i Mesem i Larte (AML)	6,868,687	1,162,000	7,126,153	1,022,000	7,037,664	986,225	102%	85%	99%	96%
Arsimi Universitar	10,400,000	1,180,000	13,048,700	645,000	10,961,806	514,942	105%	44%	84%	80%
Fonde per Shkencen	481,000	550,000	593,486	277,000	444,849	259,838	92%	47%	75%	94%
Gjithsej sipas natyrës	42,620,000	4,554,000	48,088,987	3,347,000	45,541,954	3,099,472	107%	68%	95%	93%
Totali	47,174,000		51,435,987		48,641,426		103%		95%	

Në programin **"Arsimi Bazë"** është ofruar shërbimi i mësimdhënies për mbi 251 000 fëmijë në arsimin parashkollor dhe arsimin bazë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar uljes së braktisjes shkollore; tërheqjes së fëmijëve romë/egjiptianë dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara. Përgjatë vitit 2023, për arritjen e qëllimit kanë kontribuar produktet, performanca e të cilave është realizuar, si më poshtë:

- ✓ *38 000 nxënës që kanë vendbanimi mbi 2 km nga shkolla si dhe 12,000 mësues që punojnë mbi 5 km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës, iu ofrua shërbimi i transportit me kosto 1.17 miliard LEK.*
- ✓ *250 000 nxënës nga klasa e parë në klasën e nëntë përfituan tekste shkollore falas për përdorim për vitin shkollor 2022-2023, me një efekt financiar prej 989 milionë LEK.*
- ✓ *1 200 nxënës me aftësi të veçanta kanë marrë shërbim arsimor, më një kosto prej 101 milionë LEK për vitin 2023.*

Në programin **"Arsimi Mesëm i Përgjithshëm"**, afërsisht 73 000 nxënës që përfunduan arsimin e detyrueshëm u regjistruan në arsimin e mesëm.

- ✓ *5 300 mësuesve e nxënësve të AML ju ofrua shërbimi i transportit me fonde të buxhetit, për të mbuluar shpenzimet për transportin për vitin shkollor 2022-2023, shoqëruar me një kosto prej 82 milionë LEK.*
- ✓ *Nxënës të grupeve sociale në nevojë kanë përfituar tekste mësimore falas, për vitin shkollor 2022-2023, shoqëruar me një kosto prej 96 milionë LEK.*
- ✓ *Realizimi i veprimtarisë së maturës shtetërore, provimet e shtetit, si dhe testime kombëtare dhe ndërkombëtare me një kosto prej 28 milionë LEK.*

Në programin **"Arsimi Lartë",** gjatë vitit 2023, tashmë me një reformë tërësore të sistemit të arsimit të lartë, që synon rritjen e cilësisë në të gjithë sistemin, pa cënuar aspak mundësitë e të rinjve për t'u arsimuar, numri i studentëve në ciklin e parë të studimeve është në rreth 74,419.

- ✓ *18 800 studentë kanë përfituar bursa dhe mbështetje financiare për akomodim në shtëpitë e studentëve me një kosto vjetore prej 1.57 miliardë LEK.*
- ✓ *Përjashtimi 100% nga tarifa vjetore e shkollimit apo reduktimi në masën 50% nga tarifa vjetore e shkollimit për studentët e ciklit të dytë, me rezultate të larta për kategoritë sociale në nevojë.*

Për sa u përket **investimeve publike,** realizimi në vitin 2023 ishte 71.1% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (2.8 miliardë LEK) (94.4% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.6) dhe 44.4% e buxhetit fillestar për projektet me financim të huaj (0.27 miliardë LEK) (71.9% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.6). Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi disa ndryshime, duke shkurtuar fonde për projekte të cilat nuk mund të realizoheshin gjatë vitit. Janë mbyllur rreth 47 projekte investimi në vlerën e rreth 2.3 miliardë LEK, ku ndër më kryesoret veçojmë:

- ✓ *Rindërtimi i Godinës së Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit, Universiteti Bujqësor Tiranë, godina dëmtuar nga tërmeti me vlerë rreth 306 milionë LEK;*
- ✓ *Rikonstruksion dhe palestër Shkolla Artistike "Onufri" me vlerë rreth 191 milionë LEK;*
- ✓ *Rikualifikimi i shkollës së mesme të bashkuar "Havzi Nela", Kukës me vlerë rreth 127 milionë LEK;*
- ✓ *Rikostruksion, shkolla fillore "Myrteza Sala", Bilisht, Devoll me vlerë rreth 109 milionë LEK;*
- ✓ *Rikostruksion Gjimnazi "28 Nëntori", Mat me vlerë rreth 115 milionë LEK;*
- ✓ *Rikonstruksiond Shkolla e Mesme e Përgjithshme "Themistokli Gërmenji" me vlerë rreth 91 milionë LEK;*
- ✓ *Rikonstruksion i palestrës shkollat e mesme "Asim Zeneli" dhe "Drita" me vlerë rreth 85 milionë LEK;*
- ✓ *Rikonstruksion i shkollës "Muhamet Shehu" dhe ndërtimi i palestrës me vlerë rreth 85 milionë LEK.*
- ✓ *Ndërtim palestër e mbuluar Shkolla e Mesme e Bashkuar bashkia Divjakë me vlerë rreth 76 milionë LEK.*

8.3.3 Bujqësia dhe Zhvillimi Rural

Performanca e treguesve buxhetorë për shtatë programet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, paraqitet si mëposhtë:

Tabela 28 Realizimi i buxhetit 2023 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (në mijë LEK)

Programi buxhetor	Plani fillestar 2023		Plani i rishikuar 2023		Fakti 2023		Realizimi në % me planin fillestar		Realizimi në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikim menaxhim administrimi	401,300	7,000	423,952	6,700	419,967	6,482	105%	93%	99%	97%
Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,720,300	275,409	1,754,734	115,409	1,732,757	114,085	101%	41%	99%	99%
Financim i huaj	-	161,529	-	197,529	0	199,578	-	-	-	101%
Mbeshtetje per peshkimin	133,500	100,000	155,060	112,000	154,297	108,328	116%	108%	100%	97%
Financim i huaj	-	169,423	-	62,423	-	50,059	-	-	-	80%
Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes	904,600	1,165,000	904,220	1,272,000	895,955	1,255,750	99%	108%	99%	99%
Zhvillimi rural duke mbështetur bujqësinë, ...	3,762,600	1,601,863	5,684,682	957,863	5,201,969	839,749	138%	52%	92%	88%
Financim i huaj	-	3,329,308	-	3,166,008	-	1,412,669	-	-	-	45%
Këshillimi dhe informaioni bujqësor	471,000	20,000	550,997	48,000	533,823	47,518	113%	238%	97%	99%
Menaxhimi i qendrueshëm i tokes bujqësore	25,000	0	24,300	0	22,807	0	91%	-	94%	-
Gjithsej sipas natyrës	7,418,300	6,829,532	9,497,945	5,937,932	8,961,575	4,034,218	121%	59%	94%	68%
Totali	14,247,832		15,435,877		12,995,793		91%		84%	

Buxheti vjetor fillestar i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural u rishikua në rritje të lehtë (+8%) gjatë vitit 2023 nëpërmjet 2 Akteve Normative për rishikimin e buxhetit si edhe efektit te rritjes së pagave. Realizimi faktik ishte 12.9 miliardë LEK ose 91% e buxhetit fillestar dhe 84% e buxhetit të rishikuar. Realizimi i shpenzimeve korrente ishte 94% dhe investimeve 68% e planit të rishikuar.

Në programin e **"Zhvillimi Rural duke mbështetur bujqësinë, blegtorinë dhe agroindustrinë",** me një kosto faktike prej 7.4 miliard LEK është mundësuar:

- ✓ *68,657 aplikantë në skemat kombëtare, nga të cilët 54,691 aplikantë kanë qenë për skemën e mbështetjes për naftë për bujqësinë.*
- ✓ *Fondi për vitin 2023, arriti në rreth 5.1 miliardë LEK në total, (nga 3.3 miliardë të planifikuar në fillim të vitit) pra pati një rritje të ndjeshme për masat e mbështetjes.*
- ✓ *13,214 përfitues (ose rreth 95 % e aplikantëve) u disbursuan me fonde. Për herë të parë, të gjitha aplikimet e rregullta kanë përfituar dhe janë disbursuar 100% e tyre. Disbursimi më i madh i fondeve ishte tek masa "Mbështetje për tufën bazë të matrikulluar, krerë/dele/dhi" me rreth 46% të fondit të disbursuar.*
- ✓ *69 investime të plota/të përfunduara kanë përfituar nga programi IPARD II, dhe janë paguar 33 pagesa paraprake, me një total disbursimi prej 1,308 milion LEK. Nga këta përfitues rreth 29 % kanë qenë gra (30 kontrata).*

Në programin **"Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit",** janë realizuar produkte me një kosto faktike prej 2 miliardë LEK (ose 94.8% e planit fillestar dhe 95.8% e të rishikuarit), përfshirë:

- ✓ *257.023 krerë "Kafshë të vaksinuara dhe të gjurmuara" nga të cilat 158.857 krerë janë vaksinuar kundër sëmundjes të Brucelozës dhe 98.166 krerë janë vaksinuar kundër sëmundjes të Plasjes është realizuar në masën 99% me një kosto faktike prej 73.3 milionë LEK.*
- ✓ *95.717 krerë/ gjedhë të gjurmuar për Tuberkulozin dhe Brucelozën;*
- ✓ *9,409 "Kafshë të shëndetshme dhe të kontrolluara" në fermat e kafshëve të gjalla si dhe kontrolle në farmacitë veterinare dhe depot farmaceutike, me një kosto faktike prej 650.5 milionë LEK;*
- ✓ *462,040 "Matrikuj të blera për kafshët" e llojit gjedhë dhe të imta me fondin prej 30.5 milionë LEK është realizuar në masën 97%.*
- ✓ *103.813 "Inspektimi dhe menaxhimi i riskut në fushën e sigurisë ushqimore", nga Drejtoritë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (DRAKU) me një kosto faktike prej 621 milionë LEK.*
- ✓ *14.389 analiza për tregues analitikë si dhe në kuadër të planit të monitorimit të qumështit lëndë e parë laboratorët e AKU janë pranuar 1.678 mostra që janë analizuar për 3,356 tregues analitik.*
- ✓ *560 hektar gështenjë janë kryer "Kontrolle dhe mbrojtja nga parazitët në fushën e bujqësisë", kundër dëmtuesit grerëz Galeformuese (Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae), me kosto prej 32.9 milionë LEK.*

Në programin "**Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit**", janë realizuar produkte me një kosto faktike prej 2.15 miliardë LEK (ose 96.2% e planit fillestar dhe 98.9% e të rishikuarit), përfshirë:

- ✓ *10,000 ha "Rehabilitim i infrastrukturës kryesore të ujitjes" me impakt në përmirësimin e ujitjes kryesisht në bashkitë Peqin, Rrogozhinë, Kavajë, Shkodër, Malësi e Madhe, Lezhë, Korçë, Elbasan, etj.*
- ✓ *11,600 ha "Përmirësim i kullimit me ngritje mekanike (hidrovore) dhe rritja e sigurisë nga përmbytjet për zonën e Divjakës dhe Vlorës.*
- ✓ *18 km "Rehabilitim/ndërtim" për mbrojtjen nga gërryerja dhe përmbytja të tokave bujqësore dhe zonave të banuara, kryesisht në disa segmente në lumenjtë kryesor Buna, Drini, Vermoshi, Vjosa, Osumi, Shkumbini, Devoll, Suha, Erzen etj;*
- ✓ *270 km kanale kryesor kullues të pastruar, duke lëvizur rreth 2 milion m kub dhera si dhe janë mbajtur në funksion të plotë të 27 hidrovorët për garantimin e kullimit për rreth 70,000 ha;*
- ✓ *100,000 ha (kryesisht në ultësirën perëndimore) janë mbajtur në funksion kanalet kryesorë ujitës dhe veprat e marrjes së ujit në administrim të MBZHR, duke garantuar furnizimin me ujë të rrjetit sekondar të kanaleve ujitëse në administrim të bashkive.*

Për sa u përket **investimeve publike** realizimi në vitin 2023 ishte 74.7% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (2.4 milardë LEK) ose 94.3% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.6/2023, si dhe 45.4% e buxhetit fillestar për projektet me financim të huaj (1.7 miliardë LEK) ose 48.5 % të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.6/2023. Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi disa ndryshime gjatë vitit. Janë mbyllur rreth 69 projekte investimi në vlerën e 2.4 miliardë LEK, ku ndër më kryesoret veçojmë:

- ✓ Në programin "**Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit"** kanë përfunduar 10 projekte me vlerë 262.3 milionë LEK, ku veçojmë kontratat e mëposhtme:
  - *Blerje pajisje laboratorike për Autoriteti Kombetar i Ushqimit (AKU) në vlerën e 32.2 milionë LEK;*

- *Fuqizim i laboratorëve diagnostitk të shëndetit të kafshëve dhe rritja e kapacitetit analitik të tyre. (Incubator për izolimin M.turbeculosis) në vlerën e 21.5 milionë LEK:*
- *Implementimi i planit kombëtar të monitorimit të molusqeve dhe zonave të tyre të rritjes në vlerën 18 milionë LEK.*

✓ Në programin e ***Menaxhimi i Infrastrukturës së kullimit dhe Ujitjes*** kanë përfunduar 31 projekte me vlerë të plotë investimi prej rreth 1.1 miliardë LEK, ku veçojmë kontratat e mëposhtme:

- *Mbrojtja nga Lumi Vjosa në Kafaraj, Bashkia Fier në vlerën 91.4 milionë LEK;*
- *Rehabilitim i kanalit ujitës krahu i djathtë rezervuari Gjanç në vlerën 81.6 milionë LEK;*
- *Mbrojtje nga Lumi Vjose krahu I Majte Lumi Vjose, 500 m poshte stacionit te ujit te pijshem dhe bishti malit Armen në vlerën 76.7 milionë LEK;*
- *Mbrojtje nga lumi Shkumbin tek Pularia Elbasan në vlerën 60.5 milionë LEK;*
- *Rehabilitim i Argjinaturës së Tones, segmenti Tarin – Perlat në vlerën 59.7 milionë LEK;*
- *Mbrojtje nga gerryerjet e lumit Osum, bregu i majte te tokes bujqesore ne fshatin Arrez, bashkia Dimal në vlerën 56.2 milionë LEK;*
- *Mbrojtje nga geryerja e lumit Shkumbin, Bashkia Elbasan në vlerën 55.7 milionë LEK;*
- *Mbrojtje nga përmbytja nga lumi Osum në Gegë, Berat në vlerën 52.1 milionë LEK;*
- *Argjinatura lumit Buna, Dajç-Shirgj në vlerën 49.3 milionë LEK;*

✓ Programi "**Zhvillimi rural**" kanë përfunduar 7 projekte me vlerë totale 522.1 milionë LEK konkretisht:

- *Sisteme aplikimi online per skemat IPARD dhe sisteme te tjera në vlerën 249.6 milionë LEK;*
- *Permiresimi i sistemit te menaxhimit te informacionit per skemat kombetare, 183.9 milionë LEK;*
- *Krijimi I programit WEB-GIS për te dhenat e tokes për QTTB Fushe-Kruje në vlerën 46.8 milionë LEK;*
- *Blerje pajisjesh të ndryshme dhe pajisje elektronike AZHBR në vlerën 26.7 milionë LEK;*

✓ Programi "**Mbështetja për peshkimin**" kanë përfunduar 2 projekte në vlerën e 215 milionë LEK dhe konkretisht:

- *Shtim kapacitete ankoruese Porti i Peshkimit Durres (Bankine) LOT I me vlerë 176.9 milionë LEK;*

✓ Në programin "**Këshillimi i Informacionit Bujqësor**" kanë përfunduar 16 projekte me vlerë 304 milionë LEK.

8.3.4 Infrastruktura dhe Energjia

Performanca e treguesve buxhetorë për programet kryesore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, paraqitet si më poshtë:

Tabela 29 Realizimi i buxhetit 2023 për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (në mijë LEK)

Programi buxhetor	Plani fillestar 2023		Plani i rishikuar 2023		Fakti 2023		Realizimi në % me planin fillestar		Realizimi në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	540,900	13,000	1,647,344	3,600	1,564,541	3,547	289%	27%	95%	99%
Mbështetje per Energjinë	103,380	3,510,000	143,040	2,596,112	140,313	1,270,503	136%	36%	98%	49%
Mbështetje për Burimet Natyrore	239,550	91,000	235,190	112,500	234,248	112,484	98%	124%	100%	100%
Mbështetje për Industrinë	290,585	84,000	337,635	59,800	335,452	59,541	115%	71%	99%	100%
Transporti Rrugor	2,829,883	23,407,901	3,995,781	38,157,901	3,971,844	37,027,137	140%	158%	99%	97%
Transporti Detar	117750	68,630	124,624	68,630	119,763	33,570	102%	49%	96%	49%
Transporti Hekurudhor	515,027	3,928,349	515,150	4,118,878	503,027	1,856,997	98%	47%	98%	45%
Transporti Ajror	20,300	2,012,700	22,185	11,700	21,779	11,693	107%	1%	98%	100%
Mbështetje për rrjetet e komunikacionit	-	120,000	-	20,000	-	0	-	0%	-	0%
Planifikimi Urban	73,760	104,000	71,030	25,000	69,291	20,863	94%	20%	98%	83%
Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	200,000	1,318,223	97,000	200,000	73,965	200,000	37%	15%	76%	100%
Furnizimi me uje dhe kanalizime	422,305	14,746,246	407,694	15,572,246	401,493	15,508,982	95%	105%	98%	100%
Gjithsej sipas natyrës	**5,353,440**	**49,404,049**	**7,596,673**	**60,946,366**	**7,435,717**	**56,105,317**	**139%**	**114%**	**98%**	**92%**
Totali	**54,757,489**		**68,543,039**		**63,541,034**		**116%**		**93%**	

Buxheti vjetor fillestar i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë fillestar u rishikua në rritje gjatë vitit 2023 nëpërmjet akteve normative për rishikimin e buxhetit, duke arritur në 68.5 miliardë LEK, nga të cilat u realizuan 63.5 miliardë LEK, ose 93 % e planit të rishikuar.

Në programin "Transporti Rrugor" ka vijuar puna për zhvillimin më tej të sistemit kombëtar të transportit, përmirësimin e ndjeshëm të qëndrueshmërisë, ndërlidhjes, ndërveprimit dhe integrimin e tij me gjerë, me sistemin ndërkombëtar dhe evropian të transportit dhe rajonin si dhe mbulimin me financim dhe zgjerimin, rritjen e standarteve dhe mirëmbajtjen e rrjetit kombëtar të rrugëve, me synim krijimin e një transporti të qëndrueshëm. Në këtë kuadër, janë realizuar objektivat dhe produktet si vijon:

Produkti *"Ndërtim dhe rehabilitim sipas standarteve të projektimit, rrugë të rrjetit kombëtar"*, janë realizuar fondet në masën 100% të planit vjetor të akorduar për vitin 2023. Disa nga produktet kryesore të realizuara përgjatë periudhës janë:

- ✓ Tipi i rrugës A me katër korsi (2x2) sipas standarteve të reja, për të cilin fondet e planifikuara për vitin 2023 paraqiten të realizuar në masën 6.7 miliard LEK apo 100% e fondeve të planifikuara për këtë qëllim. Disa nga objektet e rëndësishme, që janë në proces paraqiten si më poshtë:
  - *"Rehabilitimi i segmentit rrugore mbikalimi pallati me shigjeta rrethrrotullimi Shqiponja Loti1, Loti 2, Loti 3";*
  - *"Ndërtimi rruga mbikalimi TEG dhe rrugët lidhëse të tij";*
  - *"Ndërtimi i Unazës së jashtme të Tiranës, Loti 4, Loti 5, Loti 6, Loti 7".*
- ✓ Rruga tip B1' me dy korsi, për të cilën janë realizuar fondet në masën prej 2.3 miliard LEK ose 99.4% ndaj totalit të planifikuar për vitin 2023. Objekti, në të cilin punohet me ritme të parashikuara është:
  - *"Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë Loti 4 dhe Loti 8",*
  - *"Zgjerimi i rrugës Elbasan-Qafë Thanë (faza I dhe II)"*
- ✓ Për rrugën tip C2 me dy korsi, janë realizuar fondet përgjatë vitit 2022 në masën 7.8 miliard LEK ose 100% e fondeve të planifikuara. Disa nga objektet e rëndësishme, në të cilat punohet normalisht dhe që janë në proces janë:
  - *Ndërtim rruga Korcë – Ersekë, Loti 2 (pjesa e parë dhe e dytë);*
  - *Ndërtim rruga Palas – Dhërmi;*
  - *Rikonstruksion i rrugës Maliq – Lozhan i ri Strelcë;*
  - *Ndërtim rruga lidhëse e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA)-Autostrada Fier-Vlorë.*
- ✓ Për rrugën Tip A e modifikuar, janë realizuar fondet në masën 887.7 milionë LEK ose 100% e fondeve të planifikuara për këtë qëllim. Objekti që përfshihen në këtë kategori rruge është Ndërtim rruga Porto Romano Durrës, Loti 3.

Për programin **"Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime",** për të mundësuar ofrimin e shërbimit me furnizim me ujë dhe kanalizime për të gjithë popullsinë me cilësi dhe sipas standarteve ndërkombëtare u realizuan shpenzime në masën 15.9 miliardë LEK, ose 99.5% kundrejt planit të rishikuar.

- ✓ *262 558 ml ujësjellës u rikonstruktuan apo 92% e sasisë së planifikuar për vitin 2023, me një kosto prej 1,045 milionë LEK.*
- ✓ *873 702 ml linja të reja ujësjellësi për furnizimin me ujë, u realizuan me një kosto prej 8,891 milionë LEK.*

Për programin **"Mbështetje për Burimet Natyrore"**, është realizuar qëllimi i programit lidhur me realizimin e politikave të promovimit, mbikëqyrjes, monitorimit dhe transparencës në fushën e gjeologjisë, minierave, ambientit dhe ujërave. Në këtë kuadër:

- ✓ *695 leje të përditësuar për minerare gjeohapsinor, me kosto prej 4.5 milionë LEK.*
- ✓ *360 mbikqyrje e burimeve të shfrytëzimit minerare, metalore dhe jometalore, me kosto 15.7 milionë LEK.*
- ✓ *U realizua promovimi i kërkimeve teknologjike e mjedisore me kosto prej 3.5mln LEK.*
- ✓ *U krye monitorimi i fenomeneve të post-shfrytezimit në minierat e mbyllura me kosto prej 6.4mln LEK.*

Në programin **"Mbështetje për Energjinë"** u realizuan fonde në masën 1.4 mld LEK me qëllim krijimin e kushteve dhe mundësive për zhvillimin e politikave/strategjive për një ecuri të qëndrueshme dhe të sigurt të sektorit të energjisë, në zbatim të programit/prioriteteve të qeverisë. Projektet kyç të realizuara përfshijnë:

- ✓ *8 studime për përmirësimin e sektorit energjitik, përmirësimin e efiçencës së energjisë, zhvillimin e burimeve të rinovueshme, me realizim rreth 53% e sasisë së planifikuar për vitin 2023.*
- ✓ *12 ndërtime/rikonstruksione për promovimin e efiçencës së energjisë, me realizim rreth 36% të sasisë së planifikuar për vitin 2023.*

Për sa i përket **investimeve publike,** realizimi në vitin 2023 për projektet me financim të brendshëm rezultoi rreth 99.4% e planit vjetor të ndryshuar dhe rreth 50.6% për projektet me financim të huaj. Janë mbyllur projektet e investimit si më poshtë, ku veçojmë:

- ✓ ***Transporti rrugor*** janë financuar plotësisht 12 projekte investimi me vlerë totale rreth 7.7 miliard LEK ku ndër më kryesoret përmendim:
  - *Ndërtim rruga Korçë - Ersekë Loti 2, (pjesa e parë) me vlerë 2.8 mld LEK;*
  - *Sistemimi dhe rivitalizimi i skarpatave në Plani i Bardhë me vlerë 1.4 mld LEK;*
  - *Ndërtim rruga By Pass Perëndimor Shkodër, Loti 1 me vlerë 876 milionë LEK ;*
  - *Ndërtim rruga Kardhiq - Delvinë Loti 4, Shtesë punimesh me vlerë 558 milionë LEK;*
  - *Përmirësimi i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Verior, Loti 1 (2023) me vlerë 438.2 milionë LEK;*
  - *Përmirësimi i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Jugor, Loti 3 (2023) me vlerë 392.4 milionë LEK;*
  - *Përmirësimi i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Qendror, Loti 2 (2023) me vlerë 370.2 milionë LEK;*
  - *Rehabilitim i segmentit rrugore mbikalimi pallati me shigjeta rrethrrotullimi Shqiponja Loti 2 (shtese punimesh) me vlerë 368.5 milionë LEK;*
  - *Mbrojtje lumore në aksin Milot - Morinë me vlerë 192.8 milionë LEK;*

- ✓ Programi ***"Ujësjellës kanalizime"*** janë financuar 10 projekte investimi me vlerë rreth 2.8 miliardë LEK, konkretisht përmendim:
  - *Ndërtim linje e re në tubacionin d=700mm te Bovillës së vjetër, L=6.0km (Zëvendësimi i tubacionit ekzistues-hekuri nga liqeni i Zallherit deri te Kafja e Rremës) me vlerë rreth 738.2 milionë LEK;*
  - *Furnizimit me ujë për Bashkine Pustec me vlerë rreth 540.8 milionë LEK;*
  - *Furnizimi me ujë për zonat bregdetare të bashkise Divjake dhe njësisë administrative Rremas Loti I-njësisë administrative Rremas me vlerë rreth 416.7 milionë LEK;*
  - *Ndërtimi i rrjetit të Ujësjellësit në Zonën Fushë Kamëz, me vlerë rreth 307.9 milionë LEK;*
  - *Furnizimi me uje i zonave turistike Drimadhes,Dhermi dhe permiresimi I rrjetit te ujesjellesit te fshatit Dhermi me vlerë rreth 271.2 milionë LEK;*
  - *Paisje për Impiantin e ujërave të zeza Kavajë dhe Ujësjellesi i fshatit Luz, lidhjet +matësat familjare, Bashkia Kavajë me vlerë rreth 174.3 milionë LEK;*
  - *Ndertimi i Ujesjellesit ne fshatrat Pllane, Zejmen,Markatomaj,Spiten, Tresh ne njesine administrative Shengjin,Bashkia Lezhe Loti i II me vlerë rreth 160.6 milionë LEK;*
  - *Ndërtim i sistemit të KUZ, rrjet sekondar dhe terciar, Ksamil, Sh.a.Ujësjellës kanalizime Sarandë me vlerë rreth 94.7 milionë LEK;*

- ✓ **Programi *"Mbështetje për energjinë"*** kanë përfunduar 14 projekte me vlerë rreth 239.8 milionë LEK:
  - *Projekt Pilot për "Vendosjen e sistemit të ndricimit me efiçencë të lartë energjie, ne stacionet e parkimit të makinave elektrike, paneleve fotovoltaik" Shkodër, me vlerë rreth 50.7 milionë LEK;*
  - *Projekt Pilot "Auditim, çertifikim,hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për rinovim të godinave ekzistuese të banimit shumëfamiljare" me efiçencë të lartë të energjisë në qytetin e Tepelenës me vlerë 75.9 milionë LEK;*
  - *Projekt Pilot "Auditim, çertifikim, hartim projekt zbatimi dhe realizim punimesh për rinovim të godinave ekzistuese të banimit shumëfamiljare" me efiçencë të lartë të energjisë, në qytetin e Korçës me vlerë 44.5 milionë LEK etj;*
  - *Auditim çertifikim dhe projekt zbatimi për rinovimin e godinave ekzistuese shumëfamiljare (blloqe banimi) me efiçencë energjie në qytetet Elbasan, Belsh, Cërrik, Rrogozhinë, Librazhd, Prrenjas, Peqin, Kavajë, Fier, Lushnje dhe Divjake me vlerë 24.5 milionë LEK.*

- ✓ **Programi *"Menaxhimi i mbetjeve urbane"*** përfunduar "Hartimi i planeve te Pergjithshme Vendore" me vlerë rreth 400 milionë LEK.

8.3.5 Turizmi dhe Mjedisi

Performanca e treguesve buxhetorë për programet kryesore në Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit paraqitet si mëposhtë:

Tabela 30 Realizimi i buxhetit 2023 për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Programi buxhetor	Plani fillestar 2023		Plani i rishikuar 2023		Fakti 2023		Realizimi në % me planin fillestar		Realizimi në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikim, Menaxhim, Administrim	207,590	3,000	223,560	3,000	209,552	2,201	101%	73%	94%	73%
Administrimi i Pyjeve	367,450	158,600	425,822	47,300	409,077	45,410	111%	29%	96%	96%
Zhvillimi i Turizmit	457,560	137,500	552,403	414,500	516,545	413,665	113%	301%	94%	100%
Financimi i huaj	-	-	-	10,000	-	18,311	-	-	-	183%
Mbrojtja e Mjedisit	460,900	120,000	444,435	128,000	427,337	96,266	93%	80%	96%	75%
Financimi i huaj	-	390,000	0	380,000	-	24,471	-	6%	-	6%
Gjithsej sipas natyrës	1,493,500	809,100	1,646,220	982,800	1,562,511	600,325	105%	74%	95%	61%
Gjithsej	2,302,600		2,629,020		2,162,836		94%		82%	

Buxheti vjetor fillestar i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit u rishikua në rritje 14%, ose 326 milionë LEK më shumë. Realizimi faktik ishte rreth 2.16 miliardë LEK ose 94% e buxhetit fillestar dhe 82% e buxhetit të rishikuar. Realizimi i shpenzimeve korrente ishte 105% e planit fillestar apo 95% e planit të rishikuar, ndërsa i investimeve 74% e planit fillestar ose 61% e të rishikuarit.

Në programin **"Mbrojtja e Mjedisit"** për vitin 2023, fondet e akorduara nga buxheti i shtetit për shpenzimet korrente janë realizuar në masën 96% kundrejt fondeve vjetore te planifikuara, dhe konkretisht:

- ✓ *712 inspektime për parandalimin e përkeqësimit të shfrytëzimit pa kriter të burimeve ujore, të ndotjes se ujit, ajrit dhe tokës me ndikim në përmirësimin e cilësisë së mjedisit, ajrit, mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit*
- ✓ *825 aplikime për leje mjedisore janë shqyrtuar ose 63% përkundrejt parashikimit.*
- ✓ *7 143 raporte monitorimi me një kosto faktike prej 93.4 milionë LEK.*

Në programin **"Administrimi i Pyjeve"** me fondet e akorduara nga buxheti i shtetit gjatë vitit 2023, është realizuar objektivi i politikës së këtij programi nëpërmjet hartimit të planeve të menaxhimit për 90% të zonave të mbrojtura dhe 100% të planeve të mbarështrimit për sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullosor. Gjatë vitit 2023:

- ✓ *4.56 milionë turistë hynë në zonat e mbrojtura,*
- ✓ *28 197 monitorime për vlerësimin e biodiversitetit dhe vlerave natyrore në zonat e mbrojtura,*
- ✓ *484 orë mësimore të zhvilluara për ndërgjegjësimin dhe informimin e nxënësve mbi zonat e mbrojtura.*

Në programin **"Zhvillimi i Turizmit"** është realizuar objektivi i kthimit të Shqipërisë në një destinacion tërheqës turistik, cilësor dhe të qëndrueshëm, duke shfrytëzuar potencialet dhe burimet lokale. Gjatë vitit 2023:

- ✓ *10.1 milionë turistë kanë hyrë në Shqipëri, 35% më shumë krahasuar me vitin 2022.*
- ✓ *32 projekte për zhvillimin e turizmit janë financuar, me një kosto faktike prej 102.8 milionë LEK.*
- ✓ *Është realizuar në masen 86% produkti për mbështetjen e 6 bashkive (Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Vlorë, Himarë, dhe Sarandë) në procesin e pastrimit të vijës bregdetare, me kosto faktike 167 milion LEK.*

Për sa i përket **investimeve publike,** realizimi në vitin 2023 ishte 132.9% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (0.56 miliardë LEK) (94 % të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.6) dhe 11 % e buxhetit fillestar për projektet me financim të huaj (0.043 miliardë LEK) (11 % të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.6). Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi disa ndryshime gjatë vitit, duke rritur shpenzimet me financim të brendshëm. Janë mbyllur projektet e investimit si më poshtë, ku ndër më kryesoret veçojmë:

- ○ *Mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ekzistuese me vlerë 180.2 milionë LEK;*
- ○ *Hartim projekti "Qendra Multifunksionale ne Luginen e Vjoses" me vlerë 20 milionë LEK;*
- ○ *Hartim projekti "Shtigjet ne rrjetin e zonave te mbrojtura" me vlerë 16 milionë LEK;*
- ○ *Studim mbi rendesine e Ekosistemeve të Lagunave me vlerë 17 milionë LEK;*

8.3.6 Drejtësia

Performanca e treguesve buxhetorë për nëntë programet kryesore në Ministrinë e Drejtësisë, paraqitet si mëposhtë:

Tabela 31 Realizimi i buxhetit 2023 për Ministrinë e Drejtësisë

Programi buxhetor	Plani fillestar 2023		Plani i rishikuar 2023		Fakti 2023		Realizimi në % me planin fillestar		Realizimi në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	467,770	711,800	586,250	180,898	541,112	13,597	116%	2%	92%	8%
Publikimet Zyrtare	56,500	5,000	55,746	2,000	43,100	1,293	76%	26%	77%	65%
Mjekësia Ligjore	91,072	101,000	101,972	33,100	92,682	31,787	102%	31%	91%	96%
Shërbimi për Çështjet e Birësimit	15,560	200	16,460	200	14,849	117	95%	58%	90%	58%
Sherbimi i Kthimit dhe Kompensimit te Pronave	3,759,517	6,000	2,139,544	0	2,095,282	0	56%	0%	98%	-
Ndihma juridike	89,950	2,000	64,550	2,000	49,720	1,512	55%	76%	77%	76%
Shërbimi i Përmbarimit gjyqësor	160,300	5,000	218,100	0	212,462	0	133%	0%	97%	-
Sistemi i Burgjeve	6,434,600	220,000	7,792,852	218,800	7,599,082	195,130	118%	89%	98%	89%
Shërbimi i Provës	199,396	2,000	164,996	2,300	159,241	2,000	80%	100%	97%	87%
Tatali sipas natyres	11,274,665	1,053,000	11,140,470	439,298	10,807,529	245,436	96%	23%	97%	56%
Totali	12,327,665		11,579,768		11,052,965		90%		95%	

Buxheti vjetor fillestar i Ministrisë së Drejtësisë u rishikua në ulje gjatë vitit 2023 (6% më pak se buxheti fillestar). Realizimi faktik ishte 11 miliardë LEK ose 90% e buxhetit fillestar dhe 95% e buxhetit të rishikuar. Realizimi i shpenzimeve përkundrejt planit fillestar ishte 96% për shpenzimet korrente dhe 23% për shpenzimet kapitale. Në krahasim me buxhetin e rishikuar realizimi ishte më i lartë, rreth 97% për shpenzimet korente dhe 56% për investimet.

Në programin "**Sherbimi i Kthimit dhe Kompensimit te Pronave**" janë realizuar produkte me kosto faktike prej 2 miliard LEK ndër të cilat përmendim:

- ✓ *156 subjekte nga 1,600 të planifikuara në fillim të vitit janë kompensuar nga "Shpërndarje e fondit fizik dhe financiar", me një kosto faktike prej 2 miliardë LEK.*
- ✓ *399 çështje nga 1,021 të planifikuara ka qenë "Numri i vendimeve të ankimuara në gjykatë" dhe janë depozituar 271 padi në të gjitha gjykatat e vendit.*
- ✓ *707 aplikantë janë likuiduar nga "Shpërndarja e fondit të ish-ALUIZNI-it" dhe 1017 aplikime të pranuara.*

Në programin "**Shërbimi i Provës**" janë realizuar produkte me një kosto faktike prej 161.2 milionë LEK raportohet të jenë realizuar :

- ✓ *779 "Gra të përfshira në programin e ri-integrimit",me një kosto faktike prej 6.9 milionë LEK.*
- ✓ *247 "Të mitur në mbikëqyrje në shërbimin e provës" janë trajtuar me një kosto faktike 2.7 milionë LEK.*
- ✓ *10,174 burra të "Mbikëqyrur me dënim alternativ" në të gjitha Degët e Shërbimit të Provës në rrethe dhe nga Drejtoria e Përgjithshme, me një kosto faktike prej 149 milionë LEK.*

"Sistemi i Burgjeve" disa nga produktet e këtij programi masin performancën e sistemit të burgjeve, ndërsa të tjerë lidhen me përmirësimin e kushteve në sistemin penitenciar, me një kosto faktike prej 7.8 miliard LEK për arritjen e këtyre treguesve:

- ✓ *5,243 burra të dënuar të trajtuar me një kosto faktike prej 2 miliardë LEK dhe 79 të dënuara femra të trajtuara në kushte të veçanta të vuajtjes së dënimit me një kosto faktike prej 7.8 milianë LEK.*
- ✓ *427 ka rezultuar " Numri i të dënuarve të trajtuar me shërbim shëndetësor" dhe është realizuar me një kosto faktike prej 88.4 milionë LEK.*
- ✓ *32 të mitur të dënuar të cilët vuajnë dënimin në ambientet të përshtatshme për vuajtjen e dënimi me një kosto faktike prej 4.5 milionë LEK.*

Programin **"Mjekësia Ligjore"** me një kosto prej 124.4 milionë LEK, për vitin 2023 ka realizuar:

- ✓ 16,579 akte ekspertimi mjeko-ligjore, me një kosto faktike prej 85.7 milionë LEK.
- ✓ 56 akte ekspertimi të rasteve të dhunës seksuale me një kosto faktike prej 6.9 milionë LEK.

Për sa i përket **investimeve publike,** realizimi në vitin 2023 ishte 26% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (0.24 miliardë LEK) (74.5 % të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.6). Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi disa ndryshime gjatë vitit, duke pakësuar shpenzimet me financim të brendshëm në kuadër të mirëmenaxhimit të fondeve publike duke pakësuar fondet në ato projekte të cilat nuk mund të realizoheshin përgjatë 2023. Janë mbyllur projektet e investimit me vlerë totale 980 milionë LEK, ku ndër më kryesoret veçojmë:

- ✓ *Rikonstruksion i godinave Pojske, Pogradec per te denuarit e moshes se trete (hartim projekti, rikonstruksion, supervizion dhe kolaudim) me vlerë prej 324.3 milionë LEK;*
- ✓ *Sistemi elektronik i menaxhimit te denoncimeve mbi rekordet korruptive, me vlerë 54 milionë LEK;*

8.3.7 Institucionet e Sistemit të Drejtësisë

Shpenzimet e planifikuara dhe ato faktike si dhe realizimi për vitin 2023 për **Institucionet e Mbikqyrjes dhe Rivlerësimit në sistemin e Drejtësisë**, paraqiten si më poshtë:

Tabela 32 Realizimi i buxhetit 2023 për Institucionet e Drejtësisë

Programi buxhetor	Plani fillestar 2023		Plani i rishikuar 2023		Fakti 2023		Realizimi në % me planin fillestar		Realizimi në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Inspektoriati i Larte i Drejtesise	215,400	73,000	209,124	36,000	202,604	5,891	94%	8%	97%	16%
Komisioni I Pavarur I Kualifikimit	273,300	2,000	415,422	2,000	412,861	0	151%	0%	99%	0%
Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar	205,400	2,000	270,819	2,000	264,022	954	129%	48%	97%	48%
Komisionerët Publikë	88,700	1,500	129,900	1,500	128,746	0	145%	0%	99%	0%
Gjithsej sipas natyrës	782,800	78,500	1,025,266	41,500	1,008,233	6,845	129%	9%	98%	16%
Totali	861,300		1,066,766		1,015,078		118%		95%	

- ✓ Janë shortuar 805 subjekte rivlerësimi dhe për vitin 2023 janë marrë në shqyrtim rreth 200 dosje, janë dhënë 119 vendime nga **Komisionin i Pavarur i Kualifikimit** që prej fillimit të veprimtarisë.
- ✓ Janë shqyrtuar 126 çështje të njoftuara nga **Komisionerët Publikë**, shoqëruar me kosto 128.7 milionë LEK.
- ✓ 1,622 ankesa të depozituara pranë zyrës së **Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë**.

Për sa u përket **investimeve publike**, me fondet e realizuara për investime (në total për 4 institucionet) prej 21.4 milionë LEK në vitin 2023, janë realizuar blerje pajisje kompjuterike dhe blerje licensash.

8.3.8 Financat, Ekonomia, Punësimi dhe Arsimi Profesional

Shpenzimet e planifikuara dhe ato faktike si dhe realizimi për vitin 2023 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për të gjithë programet, paraqiten si më poshtë:

Tabela 33 Realizimi i buxhetit 2023 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Programi buxhetor	Plani fillestar 2023		Plani i rishikuar 2023		Fakti 2023		Realizimi në % me planin fillestar		Realizimi në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
PMA	600,000	892,000	856,850	365,800	767,206	291,080	128%	33%	90%	80%
Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	419,630	0	422,868	0	377,159	0	90%	-	89%	-
Ekzekutimi i Pagesave të Ndryshme	697,830	100,000	940,040	43,858	354,687	0	51%	0%	38%	0%
Menaxhimi i të ArdhuraveTatimore	2,683,597	395,080	2,683,937	245,080	2,509,481	165,942	94%	42%	94%	68%
Menaxhimi i të Ardhurave Doganore	3,862,010	339,910	3,844,853	251,260	3,724,344	102,202	96%	30%	97%	41%
Lufta KundërTransaksioneve Financiare Jo-Ligjore	107,690	55,000	118,769	16,000	109,617	4,104	102%	7%	92%	26%
Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	320,500	262,000	222,470	22,000	193,115	1,842	60%	1%	87%	8%

Mbështetje për Mbikëqyrjen e Tregut, ...	356,000	22,000	354,963	11,650	339,938	2,551	95%	12%	96%	22%
Inspektimi në Punë	187,670	5,000	199,083	4,500	196,675	4,274	105%	85%	99%	95%
Strehimi	1,140,000	1,350,000	1,190,000	450,000	1,141,774	351,946	100%	26%	-	30%
Arsimi i Mesëm Profesional	2,468,380	925,779	2,331,980	969,279	2,229,902	459,700	90%	50%	96%	47%
Sigurimi Shoqëror	46,368,350	-	41,453,277	-	41,447,216	-	89%	-	100%	-
Tregu i Punës	2,303,006	131,000	2,883,689	131,000	2,408,778	80,839	105%	62%	84%	62%
Gjithsej sipas natyrës	61,514,663	4,477,769	57,502,779	2,510,427	55,799,893	1,464,481	91%	33%	97%	58%
Totali	65,992,432		60,013,206		57,264,374		87%		95%	

Buxheti i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, gjatë vitit 2023 u rishikua në zbritje (prej 9%), në krahasim me planin fillestar të përgjithshëm. Realizimi faktik ishte 57.2 miliardë LEK, ose 86.7% e buxhetit fillestar dhe 95.4% e buxhetit të rishikuar. Realizimi i shpenzimeve përkundrejt planit fillestar ishte 91% për shpenzimet korrente dhe 33% për shpenzimet kapitale. Në krahasim me buxhetin e rishikuar, realizimi ishte më i lartë, rreth 97% për shpenzimet korente dhe 58% për investimet.

Në programin "**Tregu i Punës**, i cili synon nxitjen e mundësive për punë të denjë dhe rritjen e punësueshmërisë së forcave të punës, fondet sipas planit vjetor të rishikuar janë në vlerën e 2.4 miliardë LEK, nga 2.43 miliardë të parashikuara në planin fillestar. Gjatë vitit 2023, shpenzimet në këtë program janë realizuar në masën 82.5 % të buxhetit të rishikuar. Në veçanti, disa nga rezultatet kryesore të arritura nëpërmjet këtij programi ishin:

- ✓ *Janë trajtuar punëkërkues të papunë me pagesë papunësie, kjo realizuar në vlerën 857.2 milionë LEK.*
- ✓ *Janë realizuar ndërmjetësime për punëkërkues të papunë të punësuar, në vlerën 395.2 milionë LEK.*
- ✓ *Punëkërkues të papunë pjesëmarrës në formimit profesional realizuar në vlerën 345.9 milionë LEK.*
- ✓ *Punëkërkues të papunë të mbështetur sipas VKM-ve të nxitjes së punësimit për të cilët janë shpenzuar rreth 77 milionë LEK.*

Në programin "**Strehimi**", i cili mbështet zbatimin dhe monitorimin e politikave për sigurimin e strehimit të përballueshëm dhe të përshtatshëm për kategoritë në nevojë; fondet e parashikuara u ulën në 1.64 miliardë LEK, nga 2.49 miliardë në buxhetin fillestar. Gjatë vitit 2023 u shpenzuan 1.49 miliardë LEK, ose 91 për qind e buxhetit të rishikuar. Në përputhje me objektivat e programit të strehimit:

- ✓ *5,218 familje kanë përfituar "Subvencion të interesave për kreditë ekzistuese" me vlerë të realizuar 330,797 mijë LEK ose 99.8% e fondit vjetor të planifikuar për këtë program.*
- ✓ *8,500 familje kanë përfituar "Subvencionim të qirasë për familjet e prekura nga tërmeti" me një vlerë prej 496,240 mijë LEK.*
- ✓ *30 përfitues të përgjedhur për "Grant të Menjëhershëm", nga të cilët 27 janë të kategorisë persona me aftësi të kufizuar (PAK), 2 përfitues të kategorisë "Grua kryefamiljare e vetme viktimë e dhunës në familje" dhe 1 përfitues i komunitetit egjipitian, me kosto faktike 4,958 mijë LEK për 7 bashki.*
- ✓ *289 familje janë trajtuar me "Subvencionim qiraje për banorë të shpronësuar nga Unaza Madhe, Tiranë", me një kosto prej 55,073 mijë LEK.*

Në programin "**Sigurimi Shoqëror**", fondet e parashikuara sipas planit vjetor të rishikuar janë në vlerën e 41.4 miliardë LEK. Për 12 mujorin 2023 janë realizuar 100% e fondeve të buxhetit të ndryshuar dhe 89.4% të buxhetit fillesar. Nëpërmjet këtij programi është realizuar:

- ✓ *Shpenzimet për skemën e detyrueshme kanë patur tejkalim të lehtë në masën 0.03% krahasuar me planin ose tejkalim në masën 48,873 milionë LEK më shumë se programi.*
- ✓ *Shpenzimet në skemën suplementare kanë patur mosrealizim në masën 10.38% krahasuar me planin,ose me një mosrealizim prej 785 milionë LEK.*
- ✓ *Shpenzimet për programe të veçanta kanë patur mosrealizim në masën 0.62% krahasuar me planin, ose në vlerë absolute mosrealizim në masën 100 milion LEK.*
- ✓ *Në mënyrë të veçantë është bërë kujdes për respektimin e treguesve të programuar për shpenzimet administrative korente apo edhe për investime, ku programi u realizua në masën 7.13% krahasuar me planin, ose nga 3,550 milionë LEK të programuara u realizuan 3,297 milionë LEK, pra me një mosrealizim prej 253 milionë LEK.*

Fondet e parashikuara për programin e "**Arsimit të mesëm profesional**", sipas planit vjetor të rishikuar janë në vlerën e 2.64 miliardë LEK, nga 2.86 miliardë të parashikuara në planin fillestar. Për 12-mujorin 2023 janë realizuar në masën 79.2 % të buxhetit të akorduar në fillim të vitit dhe 81.4% të planit të ndryshuar. Për sigurimin e aksesit të nxënësve në Arsimin Profesional, për 12 mujorin 2023, janë mundësuar kushtet për:

- ✓ *15 141 nxënës kanë ndjekur shkollat e arsimit profesional, me një kosto faktike 1.85 miliard LEK.*
- ✓ *3 360 bursa të përfituara nga nxënësit e arsimit profesional, me një kosto faktike 261.2 milionë LEK.*
- ✓ *100 nxënës që përfitojnë subvencion të teksteve mësimore me një kosto prej 20 milionë LEK.*

Në programin **"Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore",** objektivi i të cilit është progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore, aplikimi i metodave dhe sistemeve të reja; modernizimi, ofrimi i shërbimeve cilësore dhe reduktimi i barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore si rrjedhojë e rritjes së ndërgjegjësimit publik duke ndihmuar në zhvillimin e kulturës për përmbushje vullnetare më të lartë; Implementimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore; hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor; zbatimi i strategjisë së përmbushjes së menaxhimit të riskut; përmirësimi i mëtejshëm i kontrollit tatimor dhe gjurmimi i mashtrimeve tatimore; mbledhja efikase dhe efektive e borxhit, gjatë vitit 2023 u realizuan këto produkte:

- ✓ *151,400 "Tatimpagues të asistuar" me një kosto faktike rreth 2.2 miliard LEK;*
- ✓ *110 "Vendime gjyqësore të ekzekutuara", me kosto faktike 276.8 milionë LEK.*

Në programin **"Menaxhimit i të Ardhurave Doganore",** qëllimi i politikës është menaxhimi efektiv, efikas, i drejtë dhe transparent i të ardhurave doganore, garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare nga kontrabanda, trafiqet paligjshme, mallrat e ndaluara e fallsifikuara, evazioni fiskal. Për vitin 2023, ky program realizoi këto produkte:

- ✓ *667,977 "Deklarata doganore të procesuara", me një kosto faktike prej 1.89 miliard LEK.*
- ✓ *38 "Vendime Gjyqësore të Ekzekutuara", me një kosto faktike prej 114.7 milionë LEK nga 100 milionë të planifikuara në buxhetin fillestar.*
- ✓ *3,872 "inspektime "Inspektime doganore të kryera", me kosto faktike prej 164.9 milionë LEK;*

Përsa i përket **investimeve publike**, realizimi në vitin 2023 ishte 87% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (1.9 miliardë LEK) (83.8 % të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.6) dhe 15.9 % e buxhetit fillestar për projektet me financim të huaj (0.37 miliardë LEK) (35.1 % të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.6). Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi disa ndryshime gjatë vitit, duke shtuar shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe duke pakësuar ato me financim të huaj. Janë mbyllur 47 projekte investimi në vlerën e rreth 1.9 miliardë LE004B, ku ndër më kryesoret veçojmë:

- ✓ *Për programin DPT ka përfunduar kontratat me vlerë totale 494.3 milionë LEK,*
  - *Hapesira hardëare për kapacitetin e serverave, me vlerë 425.7 milionë LEK;*
  - *Rikonstruksion Drejtoria Rajonale Elbasan, me vlerë 30 milionë LEK;*
  - *Rikonstruksion DRT Diber, me vlerë 28.7 milionë LEK;*
- ✓ *Për DPD ka përfunduar disa* projekte *rikonstruksioni dhe blerje pajisje për degët në vlerën 106.5 milionë LEK, ku ndër më kryesoret veçojmë:*
- ✓ Në programin Strehimi, *i cili konsiston në sigurimin e strehimit të përballueshëm dhe të përshtatshëm për individë e familje që nuk përballojnë dot kostot e strehimit në treg,* gjatë vitit 2023 përfunduan 16 projekte investimi (Faza e dytë, Viti 2022), me vlerë rreth 955 miionë LEK. Në përputhje me objektivat e programit të strehimit u mundësua *Përmirësim i kushteve të banimit për komunitetin Rom/Egjiptian (FAZA II, 2022) në bashkitë Berat, Delvinë, Devoll, Elbasan, Patos, Gjirokaster, Kolonje, Korce, Kucove, Librazhd, Mallakastër, Pogradec, Prrenjas, Këlcyrë, Vau i Dejës, Selenicë.*
- ✓ *Për programin "Arsimi i mesëm profesional" kanë përfunduar* projekte *me vlerë totale 361 milionë, konkretisht:*
  - *Rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale "NAZMI RUSHITI" Peshkopi, me vlerë rreth 148 milionë LEK;*
  - *Ndertim rikostruksion i reparteve të praktikave profesionale, shkolla "Beqir Cela" Durres, me vlerë 136 milionë LEK;*
  - *Ndertim /rikonstruksion i shkolles "Hoteleri -Turizem" Tirane, me vlerë 44 milionë LEK;*
  - *Rikostruksion /shtim ambjentesh ne Shkollen "Herman Gmainer" Tirane, me vlerë 33 milionë LEK*

8.3.9 Mbrojtja

Shpenzimet e planifikuara dhe ato faktike si dhe realizimi për vitin 2023 për Ministrinë e Mbrojtjes, paraqiten si më poshtë:

Tabela 34 Realizimi i buxhetit 2023 për Ministrinë e Mbrojtjes

Programi buxhetor	Plani fillestar 2023		Plani i rishikuar 2023		Fakti 2023		Realizimi në % me planin fillestar		Realizimi në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,403,724	200,000	1,487,880	200,000	1,416,314	182,656	101%	91%	95%	91%
Forcat e Luftimit	5,936,000	8,224,500	6,255,782	8,479,800	5,841,331	7,465,100	98%	91%	93%	88%
Financimi i huaj	-	4,100,000	-	-	-	-	-	-	-	-
Mbështetja e Luftimit	6437159	1,222,500	5,541,708	1,091,100	5,438,217	740,756	84%	61%	98%	68%
Mbështetja për Shëndetësinë	1,227,836	380,700	1,309,390	170,700	1,297,872	166,622	106%	44%	99%	98%
Arsimi Ushtarak	863,420	500,000	761,559	260,000	725,845	256,671	84%	51%	95%	99%
Mbështetje për Ushtarakët	5,200,000	0	5,280,308	0	5,280,308	0	102%	-	100%	-
Emergjencat Civile	1,301,000	1359300	1,376,224	1,143,300	1,051,048	686,657	81%	51%	76%	60%
Financimi i huaj	-	1,900,000	0	1,900,000	0	51,882	-	3%	-	3%
Gjithsej sipas natyrës	**22,369,139**	**17,887,000**	**22,012,851**	**13,244,900**	**21,050,935**	**9,550,344**	**94%**	**53%**	**96%**	**72%**
Gjithsej	**40,256,139**		**35,257,751**		**30,601,279**		**76%**		**87%**	

Ministria e Mbrojtjes ka synuar që nëpërmjet zhvillimit të politikave të nevojshme në fushën e personelit, promovimit në karrierë, trajtimit të ushtarakut, rritjes së transparencës, llogaridhënies, si dhe eliminimin e korrupsionit në Forcat e Armatosura, të arrijë realizimin e treguesve kryesorë të përformancës, ku renditen:

- ✓ *Lartësimi i figurës dhe integritetit të ushtarakut.*
- ✓ *Implementimi në mënyrë cilësore i detyrimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja dhe anëtarësia në organizma të niveleve të larta ndërkombëtare si: NATO, EAPC, RACVIAC, Karta e Atlantikut, etj; i realizuar nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në kuadër të partneritetit mes vendeve, rritjes së sigurisë në rajon e më gjerë.*
- ✓ *Modernizimi me armatim të lehtë dhe municione për Forcat e Armatosura, sistemet e mbështetjes për zjarr apo vendosja e kamerave Infra të Kuqe stacionare të integruara me sistemin SIVHD.*

Projektet prioritare në aspektin e ndërveprueshmërisë me strukturat e NATO-s, si dhe në kuadër të rritjes së sigurisë kombëtare, janë:

- ✓ *Sistemet e Integruara të vëzhgimit të hapësirës ajrore e detare.*
- ✓ *Kompletimi i Forcave të Armatosura me pajisje individuale të luftimit, në funksion të certifikimit të Batalionit të dytë të këmbësorisë si një komponent i gatshëm i NATO Response Force.*
- ✓ *Shpenzimet operacionale u përdoren me efikasitet për kryerjen e misionit të Forcave të Armatosura si në rang kombëtar ashtu dhe në kuadër të misioneve paqeruajtëse, duke rritur prezencën e Forcave të Armatosura në Detin Egje, Afganistan, KFOR, etj.*

Programi **"Forca e Luftimit",** i cili synon mbajtjen në gadishmëri të kapaciteteve operacionale të forcës tokësore, detare e ajrore, ka shpenzuar 5.8 miliardë LEK (shpenzime korrente) në vitin 2023, ose 93% të planit të rishikuar. Konkretisht për vitin 2023:

- ✓ *2,223 personel i forcave toksore i mbajtur në gadishmëri, me një kosto faktike prej 2,631 milionë LEK.*
- ✓ *634 personel i forcave ajrore, i mbajtur në gadishmëri, me një kosto faktike prej 1,193 milionë LEK.*
- ✓ *627 personel i forcave detare, i mbajtur në gadishmëri, me një kosto faktike prej 1,053 milionë LEK.*
- ✓ *200 kontigjent ushtarak pjesmarrës në misione paqeruajtëse jashtë vendit, me kosto faktike prej 962 milionë LEK.*

Programi **"Mbështetja e Luftimit"** siguron logjistikën dhe inteligjencën strategjike për operacione të ndryshme si dhe kapacitete operacionale për reparte të veçanta. Realizimi ishte 5.4 miliardë LEK (shpenzime korrente), ose 84% e planit fillestar dhe 98% e atij të rishikuar.

- ✓ *1,566 Kapacitete Operacionale që sigurojnë mbështetjen logjistike të Forcave të Armatosura të RSH, realizuar me një kosto faktike prej 2.5 miliardë LEK.*
- ✓ *128 metër linear dokumenta të proçesuara dhe arkivuara sipas legjislacionit ne fuqi, me një kosto faktike prej 31.1 milionë LEK.*

Për programin **"Mbështetje për Shëndetësinë"**, janë planifikuar 4 (kater) produkte me buxhet 1,48 miliardë LEK. Këto produkte u realizuan në vlerën 1.46 miliardë LEK, ose 98% e planit të rishikuar, nga të cilat përmendim:

- ✓ *13,922 pacientë të trajtuar ambulator dhe të shtruar në urgjencë, me kosto faktike prej 1.29 miliardë LEK.*
- ✓ *198 pajisje mjeksore të blera me një kosto faktike prej 96.7 milionë LEK.*

Programi **"Emergjenca Civile"** lidhet me veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile. Gjatë vitit 2023 u realizuan shpenzime në masën 1,78 miliardë LEK ose 40% e planit të rishikuar, ndër to përmendim:

- ✓ *4,303 orë pune që kontribuojnë në mbrojtjen e jetës, pronës, trashëgimisë kulturore e pyjeve, me një kosto faktike prej 444 milionë LEK.*
- ✓ *260 milionë LEK të shpenzuara nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese për parandalimin e fatkeqësive natyrore.*
- ✓ *173 familje të ndihmuara, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme me një kosto faktike prej 248.9 milionë LEK.*

Për sa i përket **investimeve publike** realizimi në vitin 2023 ishte 79.9% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (9.5 miliardë LEK) (83.7% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.6). Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi ndryshime gjatë vitit 2023, duke pakësuar shpenzimet me financim të brendshëm. Janë mbyllur projektet e investimit si më poshtë, ku ndër më kryesoret veçojmë rreth 20 projekte me vlerë totale *rreth 5.2 miliardë LEK, konkretisht:*

- ✓ *Armatim i lehtë, municion dhe pajisje e makineri pë forcat e Armatosura me vlerë rreth 4.6 miliardë LEK;*
- ✓ *Disa projekte "Fatkeqësi Natyrore të Menaxhuara" të implementuara nga disa bashki në territoret e tyre respektive me vlerë rreth 267 milionë LEK (Bashkia Poliçan, Bashkia Përmet, Bashkia Fusë-Arrëz,, Bashkia Fier, Bashkia Lushnjë etj.);*
- ✓ *Ndërtim i grupdepo për pajisjet e kërkim shpëtimit me vlerë rreth 108.5 milionë LEK;*
- ✓ *Përmirësimi në hardëare/softëare dhe ndërtime të dhomave të serverave me vlerë rreth 34 milionë LEK;*
- ✓ *Rikonstruksion i rrethimit të jashtëm/VR dhe portës hyrëse në RU 4030 me vlerë rreth 24.6 milionë LEK;*
- ✓ *Rikonstruksion i rrethimit të jashtëm/ VR dhe postobllokut të DMR Korçë me vlerë rreth 22.4 milionë LEK;*

8.3.10 Kultura

Performanca e treguesve buxhetorë për programet kryesore të Ministrisë së Kulturës paraqitet si mëposhtë:

Tabela 35 Realizimi i buxhetit 2023 për Ministrinë e Kulturës

Programi buxhetor	Plani fillestar 2023		Plani i rishikuar 2023		Fakti 2023		Realizimi në % me planin fillestar		Realizimi në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi Administrimi	176408	-	307,448	0	280,702	0	159%	-	91%	-
Trashëgimia kulturore dhe muzetë	707135	69,500	883,645	103,086	759,576	42,375	107%	61%	86%	41%
Financimi i huaj	-	50,000	-	26,000	-	4,324	-	9%	-	17%
Arti dhe Kultura	1276938	1,642,500	1,757,338	1,343,500	1,609,085	1,333,558	126%	81%	92%	99%
Financimi i huaj	-	50,000	0	20,000	-	11,997	-	24%	-	60%
Gjithsej sipas natyrës	2,160,481	1,812,000	2,948,431	1,492,586	2,649,363	1,392,254	123%	77%	90%	93%
Totali	3,972,481		4,441,017		4,041,617		102%		91%	

Buxheti i Ministrisë së Kulturës u rishikua në rritje gjatë vitit 2023, ndryshime këto që kanë pasur të bëjnë me akordimin e fondeve shtesë nga Fondi Rezervë i buxhetit të shtetit, Fondit të Kontigjencës, Fondit të Veçantë si edhe ndryshimet e planit të miratuara me akt normativ. Ky buxhet u rrit me rreth 12% në krahasim me planin fillestar, ndërsa sipas programeve buxheti eshte rritur perkatësisht me 74% për "Planifikim menaxhim administrimi", me 23% për "Trashëgima Kulturore dhe Muzetë" dhe me 5% për "Arti dhe Kultura".

Në programin **"Trashëgimia Kulturore**, gjatë vitit 2023, është synuar realizimi i objektivit "*Reabilitimi i trashëgimisë arkitektonike, muzeve dhe peisazhit përmes rritjes së numrit të monumenteve dhe muzeve të rehabilituara*", nëpërmjet realizimit të produkteve si më poshtë:

- ✓ *Punime mirembajtje, restaurime, ndërhyrje konsoliduese, pastrime nga vegjetacioni në objektet monument kulture, me një kosto 299.1 milione LEK.*
- ✓ *Mirëmbajtje në muzete e vizitueshme nga publiku, me një kosto prej 191 milionë LEK.*

- ✓ *Aktivitete edukuese dhe promovuese, ekspozita, të zhvilluara me nje kosto prej 186.2 milionë LEK.*
- ✓ *Është realizuar "Kthimi i objekteve ne qendra historike, në modele biznesi", me kosto 69 milionë LEK.*
- ✓ *Është realizuar produkti "Trashegimia materiale e jo materiale e inventarizuar", me kosto 13.3 milionë LEK.*
- ✓ *Restaurim dhe mezealizimi i ish baneses se Toptanasve (pasuri shteti) me një kosto rreth 9.6 milionë LEK.*
- ✓ *Restaurimi "Shën Mehilli, Mingul" Lunxheri, Gjirokaster, me një kosto rreth 9 milionë LEK.*

Programi **"Arti dhe Kultura** ka për qëllim, edukimin, zhvillimin dhe promovimin e skenes artistike dhe vlerave kulturore kombëtare dhe ka objektiv rritjen e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të shërbimeve në infrastrukturë si dhe rritjen e cilësisë artistike. Kështu gjatë vitit 2023 janë realizuar:

- ✓ *Premiera dhe shfaqje artistike të zhanrit skenik operistik, koreografik e folklorik kombëtar, 558.4 milion LEK.*
- ✓ *Projekte dhe programe në mbështetje të skenës së pavarur me një kosto rreth 357.6 milionë LEK.*
- ✓ *Premiera dhe shfaqie artistike të zhanrit teatror klasik dhe bashkëkohor me një kosto rreth 136 milion LEK;*
- ✓ *Është realizuar produkti " Javët kulturore të huaja në Shqipëri, me një kosto rrreth 120.7 milionë LEK.*
- ✓ *Aktivitete për qytetarët përdorues dhe frekuentues të koleksioneve bibliotekare me kosto 117.5 milionë LEK.*
- ✓ *Është realizuar promovimi i veprave të artit në hapësirat publike me një kosto rreth 77 milionë LEK.*
- ✓ *Veprimtari artistike ne zhanrin e cirkut dhe eksperimentimin e formave te reja te shprehjes skenike bashkekohore me një kosto rreth 57.9 milion leke.*
- ✓ *Veprimtari edukuese të teatrit me dhe për fëmijë me një kosto 44 milionë LEK.*
- ✓ *Ekspozita me vepra pjesë e fondit të GKA, të përkohshme të traditës dhe bashkëkohore, autorë të diasporës dhe të huaj me një kosto rreth 40.5 milionë LEK,*

Për sa i përket **investimeve publike** realizimi në vitin 2023 ishte 80% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (1.4 miliardë LEK) (95.1% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.6) dhe 16.3% e buxhetit për projektet me financim të huaj (46 milionë LEK). Janë mbyllur projektet e investimit si më poshtë, ku ndër më kryesoret veçojmë rreth 8 projekte me vlerë totale rreth 2.1 miliardë LEK nga të cilat veçojmë:

- ✓ *Rijetesimi i Piramides Tirane me vlerë të plotë investimi prej 1.5 miliardë LEK;*
- ✓ *Restaurim, Rikonstruksion dhe Rinovim i salles Koncerteve ne Universitetin e Arteve, 363.7 milionë LEK;*
- ✓ *Projekti me Rajonin e Pulias per rikualifikimin e hapesires se Parkut te Kinostudios "Parku i Artit" me vlerë 104.7 milionë LEK;*
- ✓ *Restaurimi per ndertesen e Fondit te Biblotekes Kombetare (Faza1) me vlerë 91.9 milionë LEK.*

8.3.11 Rendi dhe Siguria Publike

Performanca e treguesve buxhetorë për programet kryesore të Ministrisë së Brendshme paraqitet si mëposhtë:

Tabela 36 Realizimi i buxhetit 2023 për Ministrinë e Brendshme

Programi buxhetor	Plani fillestar 2023		Plani i rishikuar 2023		Fakti 2023		Realizimi në % me planin fillestar		Realizimi në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,349,400	122,849	1,526,621	94,359	1,490,883	91,903	110%	75%	98%	97%
Prefekturat dhe funksionet e deleguara	520,370	5,000	612,606	12,996	556,070	12,388	107%	248%	91%	95%
Financimi i huaj	-	-	-	7,000	-	12,218	-	-	-	175%
Shërbimi i Gjendjes Civile	517,700	130,000	620,498	130,000	566,580	130,000	109%	100%	91%	100%
Policia e Shtetit	17,901,300	1,162,151	20,006,382	1,070,017	19,960,032	1,065,586	112%	92%	100%	100%
Financimi i huaj	-	460,077	0	453,077	-	343,928	-	75%	-	76%
Garda e Republikës	1,950,300	10,000	2,082,300	3,500	2,078,688	3,498	107%	35%	100%	100%
Gjithsej sipas natyrës	22,239,070	1,890,077	24,848,406	1,770,949	24,652,254	1,659,522	111%	88%	99%	94%
Gjithsej	24,129,147		26,619,356		26,311,776		109%		99%	

Buxheti i Ministrisë së Brendshme u rishikua në rritje të lehtë gjatë vitit 2023 duke arritur në 26.6 miliardë LEK, nga të cilat u realizuan 26.3 miliardë LEK, ose 99%. Rritja i atribuohet kryesisht programit të shpenzimeve për Policinë e Shtetit, ku fondet u shtuan me rreth 2 miliardë LEK në shpenzimet korrente, ndërsa buxheti për investime u pakësuar me rreth 119 milion LEK.

Në programin **"Policia e Shtetit"**, u realizuan 99% e shpenzimeve ndaj planit vjetor për:

- ✓ *40,846 operacione policore të hetuara apo shërbime , me një kosto faktike prej 10.1 miliardë LEK.*
- ✓ *624 shërbime të Forcave Speciale/NSH për sigurimin e rendit publik, me kosto totale prej 1.2 miliardë LEK.*
- ✓ *214 operacione të posaçme që kontribuojnë në rriten e hetimeve proaktive në luftën kundër krimit të organizuar, trafiqeve, korrupsionit, terrorizmit si dhe forcimi i koordinimit ndërinstitucional ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar e terrorizmit, me një kosto faktike 382 milionë LEK.*
- ✓ *63 objekte dhe personalitete të siguaruara, me një kosto totale prej 349 milionë LEK.*
- ✓ *7,323 shërbime të policisë rrugore të kryera në rrugët nacionale me një kosto totale prej 322 milionë LEK që kontribuojnë tek rritja e sigurisë publike dhe sigurisë rrugore përmes patrullimeve në rrugë dhe forcimi i kontrollit të territorit me policimin në komunitet.*
- ✓ *118 persona me cilësin e veçantë të mbrojtur, me një kosto faktike prej 163.3 milionë LEK.*
- ✓ *59 operacione të sigurisë në kufirin blu që kontribuojnë tek forcimi i masave për luftën kundë krimit ndërkufitar dhe trafiqeve të paligjshme me synim rritjen e standardeve të sigurisë së kufijve duke realizuar, me një kosto totale prej 141 milionë LEK.*
- ✓ *425 rekrutë të rinj të trajnuar për përafrimi të standardeve të shërbimeve policore me ato të BE-së, me një kosto totale prej 142 milionë LEK.*
- ✓ *52 operacione policore ndaj ekstremisteve e grupeve terroriste, me një kosto faktike 130.3 milionë LEK.*

Programi **"Garda e Republikës"**, me realizimin e fondeve me rreth 100% ndaj planit vjetor me ndryshime, ka realizuar ruajtjen e 110 Personaliteteve VIP vendas dhe të huaj, me një kosto faktike prej 2,078 milionë LEK.

Në programin **"Shërbimi i Gjendjes Civile"** ka realizim të fondeve rreth 93% ndaj planit vjetor, duke realizuar kështu regjistrimin e 1 050 000 akteve dhe dokumenteve të lëshuara nga shërbimi i Gjendjes Civile, me kosto prej 506 milionë LEK.

Programi **"Prefektura dhe Funksionet e Deleguara"**, ka realizuar fondet për vitin 2023 në masën 92%, për:

- ✓ *12,300 akte normative të verifikuara me një kosto faktike prej 384 milionë LEK.*
- ✓ *1,820 monitorime të kryera në nivel qarku me një kosto faktike prej 74.9 milionë LEK.*
- ✓ *465 kërkesa të trajtuara për administrimin dhe mbrojtjen e tokës me kosto faktike prej 76.9 milionë LEK.*

Për sa u përket **investimeve publike** realizimi në vitin 2023 ishte 91% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (1.3 miliardë LEK) (99.4 % të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.6) dhe 77.4% e buxhetit fillestar dhe të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.6 për projektet me financim të huaj (0.35 miliard LEK). Janë mbyllur 12 projekte investimi me vlerë rreth 1.1 miliardë LEK, ku ndër më kryesoret veçojmë:

- ✓ *Ndërtim/Rikonstruksion i Godinës së DVP Dibër me vlerë rreth 411.2 milionë LEK;*
- ✓ *Blerje mjete lundruese "Krijimi dhe kompletimi i njësisë Policore Detare"me vlerë rreth 104 milionë LEK;*
- ✓ *Rikonstruksion i Sallave operative të NUE në DVP-të dhe Komisariatët e Policës, me vlerë 59 milionë LEK;*
- ✓ *Rikostruksion/ndërtim I Parkut të Antenave Dajt me vlerë rreth 33.5 milionë LEK;*
- ✓ *Mur rrethues dhe punime sistemimi të sheshit për objektin Q.K.P.A. me vlerë rreth 22 milionë LEK;*

8.3.12 Politika e Jashtme

Performanca e treguesve buxhetorë për katër programet kryesore në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme paraqitet si më poshtë:

Tabela 37 Realizimi i buxhetit 2023 për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme

Programi buxhetor në 000/LEK	Plani fillestar 2023		Plani i rishikuar 2023		Fakti 2023		Realizimi në % me planin fillestar		Realizimi në % me planin e rishikuar	
	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korrente	Investime	Korr.	Inv.	Korr.	Inv.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	279,773	37,999	311,715	12,000	282,872	7,077	101%	19%	91%	59%
Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	2,393,776	15,000	2,427,776	15,000	2,002,569	15,000	84%	100%	82%	100%
Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ	245,500	0	280,500	0	218,305	0	89%	-	78%	-
Tatali sipas natyres	2,919,049	52,999	3,019,991	27,000	2,503,745	22,077	86%	42%	83%	82%
Totali	2,972,048		3,046,991		2,525,822		85%		83%	

Programi "**Mbështetje diplomatike jashtë shtetit**", zë vendin kryesor në realizimin e shpenzimeve për MEPJ me një vlerë prej 2 miliardë LEK. Në përmbushje të objektivave të këtij programi gjatë vitit 2023, janë realizuar aktivietet si mëposhtë:

- ✓ *325 punonjës të trajtuar me "Mbështetje e përfaqësive diplomatike dhe konsullore me personel dhe kushte të përshtatshme pune dhe jetese", me një kosto prej 1.6 miliardë LEK.*
- ✓ *48 "Kuota ndërkombëtare" të paguara ku vendi ynë është palë, si detyrimet ndaj Organizatës së Kombeve të Bashkuara; Misioneve Paqeruajtëse; Frankofonisë; ANEA; UNIDO; UNESCO; Këshilli i Evropës, NATO; OSBE, etj, me një kosto prej 317 milionë LEK.*

Programi **"Aktiviteti diplomatik dhe konsullor"**, ka për qëllim zgjerimin, intensifikimin, diversifikimin, thellimin dhe pasurimin e marrëdhënieve dypalëshe me vendet fqinje, partnerët strategjikë, në rajon, Europë, dhe vende të tjera të botës. Në këtë program janë realizuar disa produkte me kosto faktike 218.3 milionë LEK, ku përmendim:

- ✓ *22 akte ligjore dhe nënligjore të hartuara në kuadër të intensifikimit të punës, përpjekjeve dhe koordinimit ndërinstitucional në procesin e përmbushjes së detyrimeve për hapjen e negociatave të anëtarësimit në BE me një kosto faktike prej 169.2 milionë LEK.*
- ✓ *78 takime të zhvilluara dypalëshe dhe shumëpalëshe, në kuadër të zhvillimit dhe forcimit të marrëdhënieve me partnerë strategjik, vendet e rajonit, me një kosto faktike prej 35.9 milionë LEK.*
- ✓ *108 aktivitete promovuese brenda dhe jashtë vendit në funksion të objektivave të diplomacisë ekonomike publike dhe diasporës, me një kosto faktike prej 11.3 milionë LEK.*

Për sa i përket **investimeve publike**, realizimi në vitin 2023 ishte 41.7% e buxhetit fillestar për projektet me financim të brendshëm (22 milionë LEK) (81.8% të planit vjetor të ndryshuar me AN nr.6). Përsa i përket financimit të huaj Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme nuk ka patur financim. Buxheti i shpenzimeve kapitale pësoi ndryshime gjatë vitit 2023, duke pakësuar shpenzimet me financim të brendshëm. Ndërkohë që, janë paguar disa projekte për blerje paisjesh për përfaqësitë diplomatike, dhe pagesa në kuadër të projekteve të asistencës teknike.

*Informacion më i detajuar analitik sa i takon realizimit të shpenzimeve buxhetore në nivel programi/produkti për ministritë e linjës, gjendet në **Anekset 2.0** shoqërues të këtij Raporti, të gjeneruara nga sistemi AFMIS i monitorimit të buxhetit.*

ANALIZA
E
BORXHIT PUBLIK

(Viti 2023)

PËRMBAJTJE

PËRMBLEDHJE

1. Ecuria e Borxhit Publik

2. Borxhi Shtetëror

3. Borxhi Shtetëror i Garantuar

4. Huamarrja

4.1. Huamarrja e Brendshme

4.2. Huamarrja e Huaj

5. Kosto dhe Risqet

5.1. Kosto

5.2. Risqet

6. Zhvillimet e Tregut Primar të Titujve Shtetërorë

6.1. Ecuria e ankandeve dhe kërkesa për titujt shtetërorë

6.2. Ecuria e normave të interesit.

ANEKSI I AKRONIME DHE FJALOR SHPJEGUES

ANEKSI II TË DHËNA SHTESË

PËRMBLEDHJE

Borxhi publik gjatë vitit 2023 përgjithësisht u karakterizua nga një ecuri pozitive, duke qenë në përputhje me objektivat makro-fiskale, buxhetin e planifikuar për vitin 2023 dhe objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit *(SAMB)*.

Viti 2023 ka qenë një vit mjaft pozitiv përsa i përket sigurimit të financimit, si në tregun e brendshëm dhe në atë të huaj. Huamarrja gjatë vitit 2023 u realizua në linjë me buxhetin e vitit 2023 si edhe në linjë me Planin e Huamarrjes së vitit 2023. Në ndryshim nga viti 2022, i cili u karakterizua nga një pasiguri në tregun primar vendas si dhe ulje të kërkesës për tituj shtetërorë, gjatë vitit 2023 situata u përmirësua ndjeshëm dhe kërkesa për tituj shtetërorë u rikthye në nivele të kënaqshme, duke tejkaluar ofertën e Qeverisë për tituj shtetërorë. Nëpërmjet huamarrjes u mundësua rifinancimi i borxhit ekzistues, si edhe financimi i pjesshëm i deficitit të planifikuar për vitin 2023. Huamarrja në terma bruto u realizua në vlerën 466.0 miliard Lekë, nga të cilat 80.3% (ose 374.1 miliard Lekë) u financuan nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 19.7% (ose 91.9 miliard Lekë) nëpërmjet burimeve të huaja. Ministria e Financave emetoi tituj shtetërorë në vlerën 374.1 miliardë Lekë në tregun e brendshëm, nga të cilët 225.6 mld Lekë Bono Thesari dhe 148.5 mld Lekë Obligacione. Huamarrja neto për vitin 2023 rezultoi në vlerën 20.8 miliardë Lekë. Huamarrja e jashtme bruto u realizua në nivelin 91.9 miliardë Lekë. Huamarrja e huaj është realizuar nëpërmjet emetimit të instrumentit të Eurobondit dhe disbursimit të huave për projekte dhe mbështetje buxhetore. Në Qershor 2023, Qeveria emetoi Eurobondin e gjashtë me vlerë 600 milionë euro, kupon 5.9%, yield 6.125% dhe me një ofertë finale (final book) prej 1.3 miliard Euro.

Gjatë vitit 2023, strukturat e Ministrisë së Financave përgjegjëse për menaxhimin e borxhit kanë vijuar përpjekjet në drejtim të reduktimit të ekspozimit ndaj risqeve duke mbajtur koston në nivelin më të ulët të mundshëm. Gjatë kësaj periudhe, menaxhimi i risqeve të portofolit të borxhit ka mundur të evoluojë në drejtim të objektivave strategjikë afatmesëm duke shfaqur përmirësim të të gjithë treguesve të riskut në krahasim me fundin e vitit 2022. Përmirësimi i mëtejshëm i strukturës së borxhit, kryesisht në aspektin e reduktimit të ekspozimit ndaj riskut të rifinancimit dhe riskut të normave të interesit do vijojë të mbetet fokusi kryesor në menaxhimin e borxhit, në mënyrë që tregues të këtyre risqeve të tregojnë përmirësim të mëtejshëm në periudhat në vijim.

Në përputhje me objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, gjatë vitit 2023 u vijua me aktivitete në drejtim të zhvillimit të tregut të titujve shtetërorë. Në vazhdim të angazhimit të ndërmarrë në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar dhe zhvillimin e tregut sekondar të titujve shtetërorë, përgjatë vitit 2023 është vijuar me praktikat që kontribuojnë në krijimin e madhësive referencë dhe konsolidimin e kurbës së yield-it. Në drejtim të krijimit të madhësive benchmark është vijuar me konsolidimin e numrit të ankandeve të titujve shtetërorë, duke ulur frekuencën e emetimeve të titujve të rinj dhe duke përdorur rihapjet e titujve ekzistues.


Gjithashtu, në vijim të masave të mara për zhvillimin e tregut, Ministria e Financave, për të dytin vit radhazi, hartoi dhe publikoi në muajin Dhjetor 2023 Planin Vjetor të Huamarrjes për vitin e ardhshëm, konkretisht për vitin 2024. Plani Vjetor i Huamarrjes për vitin 2024, synon të mbështesë aktivitetin e huamarrjes vjetore të Ministrisë së Financave, si dhe të rrisë transparencën kundrejt investitorëve dhe palëve të treta të interesuara.

1. Ecuria e Borxhit Publik

Në fund të viti 2023, borxhi publik u vlerësua në nivelin 1,362.8 miliard Lekë ose 58.9% e PBB[1], duke shënuar një ulje të konsiderueshme krahasuar me fundin e vitit 2022 (5.5 pp ulje), ndërkohë krahasuar me fundin e vitit 2021, raporti borxh/pbb është ulur me 15.6 pp. Në terma nominal, stoku i borxhit publik është ulur me 15.8 miliard Lekë krahasuar me fundin e vitit 2022, nga i cili 9.0 miliard Lekë i korrespondojnë rritjes së borxhit të brendshëm dhe 24.8 miliard Lekë i korrespondon uljes së borxhit të jashtëm.

Është llogaritur një efekt i kursit të këmbimit në portofolin e borxhit të shprehur në valutë prej rreth 69.5 miliardë lekësh, ose rreth 3.0% të PBB-së. Në vitet në vijim, raporti i borxhit ndaj PBB-së do të vazhdojë të planifikohet më i ulët se niveli i parashikuar për vitin e kaluar, derisa niveli i borxhit të arrijë dhe të qëndrojë nën 45% të PBB-së, kjo në përputhje me parimin përkatës fiskal të përcaktuar në kuadrin ligjor.

Paraqitje Grafike 1 (a): *Borxhi publik në vlerë absolute dhe relative ndaj PBB (2018- 2023)*




Burimi: *Ministria e Financave (2024)*

Niveli i borxhit të brendshëm në raport me totalin e borxhit publik eshte 54.4%, dhe ai i jashtëm 45.6%. Për sa i përket kompozimit të portofolit të borxhit sipas instrumenteve, më shumë se 70% përbëhet nga instrumentet e tregtueshme (bono thesari, obligacione, eurobond), ndjekur nga huatë e huaja me destinacion financimin e projekteve dhe huatë në formën e mbështetjes buxhetore. Pesha e instrumenteve të tregtueshme vlerësohet të jetë në rritje nga viti në vit kryesisht për shkak të emetimeve më të shpeshta në tregjet ndërkombëtare, por edhe për shkak të rritjes së huamarrjes në tregun e brendshëm për arsye të nevojave të larta për financim gjatë viteve të fundit duke filluar nga viti 2020.

[1] Niveli i borxhit të fundvitit 2023 ndryshon nga raporti i dërguar pranë Komisionit për Ekonomine dhe Financat, në përputhje me Buletinin Statistikor të Borxhit për T1 2024 https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2024/04/Buletini-Statistikor-i-Borxhit-T1-2024.pdf

Paraqitje Grafike 1 (b): *Përbërja e borxhit publik sipas instrumenteve (2018- 2023)*




Burimi: *Ministria e Financave (2024)*

Borxhi i pushtetit lokal vazhdon të qëndrojë në nivele të ulëta *(rreth 101.0 milion Lekë)*. Gjatë vitit 2023 nuk ka pasur asnjë kërkesë nga njësitë e qeverisjes vendore për huamarrje të re.

2. Borxhi Shtetëror

Gjatë vitit 2023 portofoli i borxhit shtetëror vazhdon të dominohet me mbi 50% nga titujt shtetërorë të tregtuar në tregun vendas, në përputhje me objektivat strategjikë për mbajtjen nën kontroll të riskut të kursit të këmbimit.


Paraqitje Grafike 2 (a): *Kompozimi i portofolit të borxhit shtetëror sipas instrumenteve (2018–2023)*



Burimi: *Ministria e Financave (2024)*

Për sa i përket strukturës së maturimit, në portofolin e borxhit të brendshëm shtetëror, referuar të dhënave të vitit 2023, peshën më të madhe e mbajnë titujt afatmesëm (2-5 vite) me 38.1% të peshës. Në përputhje me objektivin strategjik për rritjen e jetëgjatësisë së portofolit të borxhit të brendshëm, pesha e titujve afatshkurtër është ulur me 3.7 pp ndërsa peshat e titujve me afat të gjatë maturimi (mbi 5 vite) si dhe atyre afat-mesme kanë shënuar rritje në krahasim me atë të fundit të vitit 2022 respektivisht me rreth 1.92 pp dhe 1.8 pp. Ndërkohë, pesha e titujve me norma interesi të ndryshueshme është reduktuar edhe përgjatë këtij viti, pasi edhe gjatë kësaj periudhe nuk ka patur emetime të titujve me norma interesi të ndryshueshme, në përputhje me objektivat për reduktimin e riskut të normave të interesit dhe shmangien e fragmentimit të kërkesës për titujt me maturitet të ngjashëm.


Paraqitje Grafike 2 (b): *Kompozimi i borxhit të brendshëm shtetëror sipas maturitetit të titujve dhe tipit të interesit (2018–2023)*



Burimi: *Ministria e Financave (2024)*

Në portofolin e borxhit të jashtëm, mbi 60% të peshës e mban borxhi me normë interesi fikse. Për sa i përket kompozimit sipas instrumenteve, pesha e Eurobondit vlerësohet të jetë në rritje nga viti në vit për shkak të emetimeve më të shpeshta në tregjet ndërkombëtare, ku Eurobondi më i fundit është emetuar në muajin qershor 2023 në vlerën prej 600 milion Euro. Aktualisht në portofolin e borxhit shtetëror janë 4 Eurobonde të pamaturuar në vlerën totale prej 236 miliard Lekë. Pas kategorisë së Eurobondit, një peshë të konsiderueshme në portofolin e borxhit të jashtëm shtetëror mbajnë huatë me burim kreditorët dypalësh dhe shumëpalësh, me destinacion financimin e projekteve me natyrë zhvillimore.

Paraqitje Grafike 2 (c): *Kompozimi i borxhit të jashtëm shtetëror sipas tipit të instrumenteve dhe tipit të interesit (2018–2023)*




Burimi: *Ministria e Financave (2024)*

Përsa i përket kompozimit të portofolit të borxhit shtetëror sipas valutave, pjesën më të madhe të portofolit e zë valuta vendase me 54.4% të totalit, ndjekur nga valuta EUR me 36.2% dhe USD me 6.8%.

Portofoli i borxhit të brendshëm përbëhet kryesisht nga valuta vendase, dhe vetëm 1.0% është në monedhën EUR. Ndërkohë, portofoli i borxhit të jashtëm kompozohet terësisht nga valuta të huaja, ku mbizotëron me 79.0% valuta EUR, e ndjekur nga USD me 15.2% dhe më pas JPY me 1.7%.

Paraqitje Grafike 2 (d): *Kompozimi i borxhit shtetëror sipas valutës Dhjetor 2023*




Burimi: *Financave dhe Ekonomisë (2024)*

3. Borxhi Shtetëror i Garantuar

Në fund të vitit 2023, portofoli i borxhit të garantuar vlerësohet në 41.3 miliard Lekë ose 398 milion Euro (1.8% e PBB), duke shënuar një rënie me 10.9 miliard Lekë krahasuar me fundin e vitit 2022. Garancitë në tregun e brendshëm zënë rreth 39.6% të stokut total të borxhit të garantuar ose 16.4 miliardë lekë, ndërsa garancitë e dhëna në favor të kreditorëve të huaj përfaqësojnë 60.4% të stokut të borxhit të garantuar ose 25.0 miliardë lekë.


Paraqitje Grafike 3 (a): *Portofoli i borxhit të garantuar sipas rezidencës së kreditorit (2018–2023)*



Burimi: *Ministria e Financave (2024)*

Mbi 75% e totalit të garancive shtetërore i përkasin sektorit të energjisë, duke reflektuar politikat e qeverisë në drejtim të mbështetjes së sektorit të energjisë.

Paraqitje Grafike 3 (b): *Garancitë shtetërore sipas sektorëve ekonomikë (2018–2023)*



Burimi: *Ministria e Financave (2024)*

Gjatë vitit 2023 Ministria e Financave ka paguar rreth 54.6% (2.9 miliard Lekë) nga detyrimet (pagesa e principalit dhe interesat) që rrjedhin nga borxhi i jashtëm i garantuar. Gjatë kësaj periudhe, huamarrësit (përfituesit e garancive) i kanë kthyer Ministrisë një pjesë të detyrimeve për garancitë që janë paguar nga Ministria e Financave, gjë që bën që pagesat neto nga Ministria e Financave të përbëjnë rreth 25.3% të detyrimeve që rrjedhin nga garancitë e jashtme gjatë vitit 2023.

Përsa i përket borxhit të brendshëm të garantuar, gjatë vitit 2023, pothuajse të gjitha detyrimet përkatëse janë shlyer nga përfituesit/huamarrësit e garancive të brendshme shtetërore dhe vetëm 0.17% të detyrimeve që rrjedhin nga borxhi i brendshëm i garantuar përgjatë vitit 2023 janë bërë nga Ministria e Financave. Këto pagesa i përkasin skemave të garancive për bizneset të lëshuara gjatë situatës së pandemisë Covid 19).

4. Huamarrja

Gjatë viteve të fundit, huamarrja është realizuar në përputhje me nevojat buxhetore dhe në përputhje me objektivat strategjikë për ruajtjen e stabilitetit të marrëdhënies ndërmjet raporteve të kostos dhe risqeve, krahas nevojave të rritura për financim.

Viti 2023 ka qenë një vit mjaft pozitiv përsa i përket sigurimit të financimit, si në tregun e brendshëm dhe në atë të huaj. Huamarrja gjatë vitit 2023 u realizua në linjë me buxhetin e vitit 2023 si edhe në linjë me Planin e Huamarrjes së vitit 2023. Nëpërmjet huamarrjes u mundësua rifinancimi i borxhit ekzistues si dhe financimi i pjesshëm i deficitit të planifikuar për vitin 2023.

Huamarrja në terma bruto u realizua në vlerën 466.0 miliard Lekë, nga të cilat 80.3% (ose 374.1 miliard Lekë) u financuan nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 19.7% (ose 91.9 miliard Lekë) nëpërmjet burimeve të huaja.

Tabela 4: Realizimi i Huamarrjes (2022-2023)

Burimet e Huamarrjes	2022		2023	
	Vlera *(në mld Lekë)*	%/Total	Vlera *(në mld Lekë)*	%/Total
Burime të Brendshme	**357.9**	**92.7%**	**374.1**	**80.3%**
Bono Thesari	245.5	63.6%	225.6	48.4%
Obligacione	112.3	29.1%	148.5	31.9%
Burime të Jashtme	**28.3**	**7.3%**	**91.9**	**19.7%**
Hua për financimin e projekteve	11.2	2.9%	9.4	2.0%
Mbështetje Buxhetore	17.1	4.4%	19.7	13.5%
Eurobond	-	0.0%	62.8	13.5%
Total Huamarrja	**386.1**	**100.0%**	**466.0**	**100.0%**

Burimi: *Ministria e Financave (2024)*

4.1. Huamarrja e Brendshme

Gjatë vitit 2023, Ministria e Financave ka emetuar në tregun e brendshëm tituj shtetërorë në vlerën 374.1 miliard Lekë, nga të cilat 225.6 miliard Lekë i përkasin titujve afatshkurtër dhe 148.5 miliard Lekë titujve afatgjatë. Në përputhje me Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, gjatë vitit 2023 është rritur frekuenca dhe vlera e emetimeve të instrumenteve afatgjata dhe si rrjedhojë borxhi i ri është mundësuar tërësisht nëpërmjet titujve afatgjatë, si edhe është shoqëruar me maturime të instrumenteve afatshkurtër.

Kërkesa për tituj shtetërorë ka qenë më e lartë se oferta e Qeverisë pothuajse në të gjitha ankandet e realizuara gjatë vitit dhe huamarrja neto në tregun e brendshëm në fund të vitit 2023 rezultoi 20.8 miliard Lekë. Nga totali i financimit neto, 41.8 miliard Lekë financim neto është realizuar nëpërmjet obligacioneve, ndërsa sa i takon instrumenteve afatshkurtër, financimi neto rezulton negativ prej -20.9 miliard Lekë, që do të thotë se gjatë vitit 2023 janë maturuar instrumente afatshkurtër më shumë se sa janë emetuar.


Tabela 4.1: *Huamarrja shtetërore nga burime të brendshme në terma neto dhe bruto (Janar-Dhjetor 2023)*

Lloji i Titullit	2023		
	Emetim (në mld Lekë)	Maturim (në mld Lekë)	Huamarrja Neto (në mld Lekë)
Tituj Afatshkurtër	**225.6**	**246.6**	**-20.9**
Bono Thesari në Lekë	225.6	246.6	-20.9
Tituj Afatgjatë	**148.5**	**106.7**	**41.8**
Obligacione 2 vjeçare	46.6	45.6	0.9
Obligacione 2 vjeçare në Euro	0.0	0.0	0.0
Obligacione 3 vjeçare	27.5	16.8	10.7
Obligacione 5 vjeçare	38.1	27.7	10.4
Obligacione 7 vjeçare	18.6	8.3	10.3
Obligacione 10 vjeçare	12.3	8.3	4.0
Obligacione 15 vjeçare	5.4	0.0	5.4
Gjithsej Instrumenta Shtetëror	**374.1**	**353.3**	**20.8**

Burimi: *Ministria e Financave (2024)*

Për sa i përket raportit të huamarrjes së brendshme me të ardhurat tatimore vërehet një ulje e këtij raporti krahasuar me vitin e mëparshëm, i ndikuar kryesisht nga rritja e nivelit te ardhurave tatimore krahasuar me vitin e kaluar.

Paraqitje Grafike 4.1: *Huamarrja e brendshme në terma bruto në raport me të ardhurat tatimore (2018-2023)*



Burimi: *Ministria e Financave (2024)*

4.2. Huamarrja e Huaj

Përsa i përket huamarrjes së huaj, në fund të viti 2023, huamarrja e jashtme bruto arriti në 91.9 miliard Lekë. Peshën kryesore në huamarrjen e huaj gjatë këtij viti e mban Eurobondi. Në qershor 2023, Republika e Shqipërisë emetoi eurobondin e saj të gjashtë, në vlerën 600 milionë euro, me maturim pesëvjeçar, me kupon 5.9%, yield 6.125% dhe me një ofertë përfundimtare (*final book*) prej mbi 1.3 miliardë Euro. Gjithashtu gjatë vitit 2023 janë disbursuar mbështetje buxhetore me terma të favorshme në vlerën totale rreth 185 milion Euro nga insitucionet financiare ndërkombëtare dhe partnerët bilateral si Banka Botërore, KfW dhe AFD. Pjesa tjetër e huamarrjes është realizuar nëpërmjet disbursimit të kredive për financimin e projekteve kryesisht në transport, infrastrukturë urbane, si dhe furnizim me ujë dhe kanalizime.

Tabela 4.2: *Huamarrja e huaj në terma bruto (2022-2023)*

Huajamarrja e Huaj Bruto	2022		2023	
	Vlera *(në mld Lek)*	%/Total	Vlera *(në mld Lek)*	%/Total
Kredi për financim projektesh	**11.2**	**39.5%**	**9.4**	**10.3%**
Energjia	0.6	2.2%	0.9	0.9%
Transporti	5.6	19.7%	3.5	3.8%
Ujësjellës Kanalizime	1.3	4.7%	2.0	2.2%
Infrastruktura Urbane	2.0	7.2%	2.3	2.5%
Shëndetësia	1.4	5.0%	0.6	0.7%
Të Tjera	0.2	0.7%	0.1	0.1%
Mbështetje Buxhetore	**17.1**	**60.5%**	**19.7**	**21.5%**
Eurobond	**0.0**	**0.0%**	**62.8**	**68.3%**
Total Huamarrja e Huaj	**28.3**	**100.0%**	**91.9**	**100.0%**

Burimi: *Ministria e Financave (2024)*


5. Kosto dhe Risqet

Për sa i përket raporteve të kostos dhe riskut, Ministria e Financave në kuadër të mirëmenaxhimit të borxhit ka vijuar përpjekjet në drejtim të reduktimit të ekspozimit ndaj risqeve duke mbajtur koston në nivelin më të ulët të mundshëm sipas kushteve aktuale të tregut. Në ndryshim nga viti 2022, ku për shkak të kushteve të shtrënguara të tregjeve treguesit e riskut nuk ecën në drejtim të objektivave strategjikë, gjatë vitit 2023, menaxhimi i risqeve të portofolit të borxhit ka mundur të evoluojë në drejtim të objektivave strategjikë afatmesëm duke shfaqur përmirësim në të gjithë treguesit, krahasuar me fundin e vitit 2022.

5.1. Kosto

Për vitin 2023, shpenzimet për interesa të borxhit përllogariten në vlerën prej 47.6 miliard Lekë, përkatësisht 29.0 miliard Lekë për interesa të borxhit të brendshëm dhe 18.6 miliard Lekë për interesa të borxhit të jashtëm. Ripagesat e borxhit të jashtëm për vitin 2023 ishin 53.2 miliard Lekë (pagesa për principalin). Krahasuar me vitin 2022, shpenzimet për interesa vlerësohen rreth 8.0 miliard Lekë më të larta (20.1% më shumë se viti 2022), kryesisht si rezultat i rritjes së normave të interesit në tregun e brendshëm dhe atë të huaj. Rritja e shpenzimeve për interesa ka qenë brenda fondit të parashikuar në Projektbuxhetin e Vitit 2023.
Gjithashtu, kosto mesatare për borxhin e brendshëm në fund të vitit 2023 rezultori në nivelin 4.48%, duke u rritur me 43 bp krahasuar me fundin e vitit 2022 ku u vlerësua në nivelin 4.05%.

Paraqitje Grafike 5.1 (a): *Shpenzimet për interesa të borxhit shtetëror (2018- 2023)*



Burimi: *Ministria e Financave (2024)*

5.2. Risqet


Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit synon të përmirësojë më tej strukturën e borxhit (*kryesisht strukturën e portofolit të borxhit të brendshëm*), në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve, si dhe mbajtjes së kostos në nivelet më të ulëta të mundshme, bazuar në kushtet aktuale të tregut. Gjatë vitit 2022, në kushtet e shtrënguara të tregjeve, huamarrja ishte jo e lehtë për tu realizuar dhe në rrethanat e një kërkese të orientuar kryesisht drejt instrumenteve afatshkurtra, treguesit e riskut nuk shënuan përmirësim krahasuar me vitet e mëparshme. Ndërkohë, viti 2023 ka qenë një vit mjaft pozitiv sa i përket ecurisë së huamarrjes, dhe si rrjedhojë indikatorët e riskut kanë shfaqur përmrësim në të gjitha kategoritë krahasuar me fundin e vitit 2022, madje edhe në krahasim me fundin e vitit 2021 kjo pavarësisht përkeqësimit të ndodhur gjatë 2022.

Risku i Rifinancimit

Një ndër objektivat kryesore të SAMB është reduktimi i riskut të rifinancimit kryesisht në portofolin e borxhit të brendshëm, pasi borxhi i jashtëm paraqet më pak risk duke qenë se është i përbërë nga instrumente me afat të gjatë maturimi dhe me profile amortizimi të shtrira gjatë në kohë. Gjatë vitit 2023, në përputhje me Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, Minstria e Financave ka rritur peshën e emetimeve të instrumenteve afatmesme dhe afatgjata në tregun e brendshëm dhe si rezultat, treguesit e riskut të rifinancimit kanë shfaqur përmirësim të ndjeshëm krahasuar me fundin e vitit 2022. Konkretisht, jetëgjatësia e borxhit të brendshëm (ditët mesatare në maturim) është rritur me 55 ditë, nga 780 ditë në fund të vitit 2022 në 835 ditë në fund të vitit 2023. Ndërkohë, pesha e borxhit që maturohet brenda një viti ka shënuar

përmirësim krahasuar fundin e vitit 2022, ku konkretisht, ky tregues është ulur nga 47.9% në dhjetor 2022 në 44.7% në dhjetor 2023.

Paraqitje Grafike 5.2 (a): Treguesit e Riskut të Rifinancimit




Burimi: *Ministria e Financave (2024)*

Risku i Normave të Interesit

Risku i normave të interesit, gjithashtu ka shfaqur përmirësim gjatë vitit 2023, kjo në rrethanat e përdorimit të shtuar të titujve afatmesëm dhe afatgjatë si edhe emetimit vetëm të titujve më norma interesi fikse në tregun e brendshëm. Konkretisht, pesha e borxhit që rivlerëson normën e interesit brenda vitit është ulur ndjeshëm nga 49.0% në fund të vitit 2022 në 45.4% në fund të vitit 2023. Gjithashtu, është rritur koha mesatare në rifiksim nga 2.17 vite në dhjetor 2022 në 2.33 vite në muajin dhjetor 2023.

Paraqitje Grafike 5.2 (b): Treguesit e Riskut të Normave të Interesit




Burimi: *Ministria e Financave (2024)*

Risku i Kursit të Këmbimit

Risku i kursit të këmbimit është mbajtur nën kontroll duke qëndruar nën tavanin e përcaktuar në strategji. Konkretisht, totali i stokut të borxhit në valutë ndaj stokut të borxhit total rezultoi 45.4% në fund të vitit 2023, duke u ulur me 1.4 p.p krahasuar me fundin e vitit 2022, si dhe është ulur me 4.4 p.p, krahasuar me fundin e vitit 2021, një përmirësim i ndjeshëm. Gjatë vitit 2023 ky tregues është ndikuar kryesisht nga nënçmimi i pjesës më të madhe të valutave të huaja, kryesisht Euros dhe USD, kundrejt Lekut.

Paraqitje Grafike 5.2 (c): Risku i Kursit të Këmbimit



Burimi: *Ministria e Financave (2024)*

6. Zhvillimet e Tregut Primar të Titujve Shtetërorë


Tregu primar i titujve shtetërorë gjatë vitit 2023 përgjithësisht është karakterizuar nga zhvillime pozitive, ku vlen të përmenden rikthimi i kërkesës së tregut në nivele të kënaqshme në raport me nevojat e qeverisë për huamarrje dhe vijimi me projektin market maker për emetimin e obligacionit 5-vjeçar dhe 3-vjeçar referencë.

6.1. Ecuria e ankandeve dhe kërkesa për titujt shtetërorë

Gjatë vitit 2023, Ministria e Financave ka organizuar ne total 98 ankande, nga të cilët 41 ankande për tituj afatshkurtër, 51 ankande për tituj afatgjatë dhe 6 ankande buyback (blerje mbrapsht) për titujt referencë 3 dhe 5 vjecar. Kërkesa gjatë këtij viti ka rezultuar në vlerë 552.1 miliard Lekë, nga e cila 329.5 miliard Lekë i korespondon Bonove të Thesarit dhe 222.6 miliard Lekë i korespondon Obligacioneve.

Në ndryshim nga viti 2022, i cili u karakterizua nga një pasiguri në tregun primar vendas si dhe ulje të kërkesës për tituj shtetërorë, gjatë vitit 2023 situata u përmirësua ndjeshëm dhe kërkesa për tituj shtetërorë u rikthye në nivele të kënaqshme, duke tejkaluar ofertën e Qeverisë për tituj shtetërorë. Raporti i mbulimit ka qenë mbi 1 në shumicën e ankandeve të realizuara si në kategorinë e titujvë afatshkurtër dhe në kategorinë e titujve afatgjatë. Kërkesa për tituj shtetërore ka vazhduar të mbështetet tek investitorët vendas (rezidentë), ndërkohë që sektori bankar mbetet burimi kryesor i kërkesës me mbi 60% të peshës.

Paraqitje Grafike 6.1: Ecuria e ankandeve në tregun primar



Burimi: *Ministria e Financave (2024)*


Në kuadër të zhvillimit të infrastrukturës së tregut primar dhe stimulimit të tregut sekondar, kanë vazhduar të ndërmerren aktivitete, të cilat kanë pasur si objektiv reduktimin e fragmentimit të kërkesës, si dhe konsolidimin e madhësive *benchmark* për titujt afatgjatë. Titujt referencë 3 dhe 5 vjecar janë emetuar me sukses në dy linja emetimi gjatë vitit 2023: konkretisht Obligacioni referencë 3 vjecar është emetuar në shumën totale 27.3 miliard Lekë dhe Obligacioni referencë 5 vjecar është emetuar në shumën totale 34.1 miliard Lekë.

Në drejtim të krijimit të madhësive *benchmark* është vijuar me konsolidimin e numrit të ankandeve të titujve shtetërorë, duke ulur frekuencën e emetimeve të titujve të rinj dhe duke përdorur rihapjet e titujve ekzistues.

6.2. Ecuria e normave të interesit

Normat mesatare të ponderuara gjatë vitit 2023 kanë shënuar rritje krahasuar me fundin e vitit 2022, pothuajse në të gjitha kategoritë e instrumenteve, e ndikuar kjo nga rritja e normave të interesit, kryesisht gjatë vitit 2022, dhe për rrjedhojë zëvendësimit të titujve me norma interesi më të ulëta të cilat maturohen, me tituj të emetuara në kushtet me norma interesi të rritura. Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë normalizuese monetare gjatë vitit 2023 duke rritur normën bazë të interesit me 0.5 pikë përqindje, përkatësisht nga 2.75% në fund të vitit 2022 në 3.25% në fund të vitit 2023

Paraqitje Grafike 6.2: *Yield-et titujve shtetërorë*[2] *(2021- 2023)*



Burimi: *Ministria e Financave dhe Eknoomisë (2024)*

[2] I referohet normës mesatare të ponderuar të titujve shtetërorë të emetuar vetëm në tregun primar.

ANEKSI I

AKRONIME DHE FJALOR SHPJEGUES

AKRONIME

BSH	Banka e Shqipërisë
DMM	Ditët Mesatare në Maturim
EUR	Monedha e Bashkimit Evropian
JPY	Monedha kombëtare e Japonisë
KMM	Koha Mesatare në Maturim
KMR	Koha Mesatare në Rifiksim
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PP	Pikë Përqindje
PB	Pikë Bazë
SAMB	Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit
USD	Monedha Shteteve të Bashkuara të Amerikës
NMP	Norma Mesatare e Ponderuar

FJALOR SHPJEGUES

Ankande shkëmbimi *(exchange auctions)* – Parablerja e titujve shtetërorë më përpara datës së maturimit, ndërkohë që transaksioni kryhet duke e paguar mbajtësin e titullit të parablerë me një titull të emetuar rishtazi.

Borxh – Referuar si "Borxh Total" ose "Totali i detyrimeve të borxhit", konsiston në të gjitha detyrimet që janë instrumente borxhi.

Borxh afatgjatë – Borxh me afat maturimi më të lartë se një vit.

Borxh i brendshëm – Detyrimet e borxhit të rezidentëve të një vendi ndaj rezidentëve të po atij vendi.

Borxh i jashtëm – Detyrimet e borxhit të rezidentëve të një vendi ndaj jo rezidentëve.

Borxhi publik i garantuar – Detyrimet e borxhit të sektorit publik dhe privat, shërbimi i të cilit është i garantuar me marrëveshje nga njësitë e sektorit publik.

Buyback – Është forma e ndërsjellë e emetimit të titujve shtetërorë, e cila mundëson maturimin e parakohëshëm të një titull shtetëror.

Disbursim – Transaksioni i vënies në dispozicion të burimeve financiare.

Eurobond – Një obligacion (*titull financiar*) me afat maturimi më shumë se një vit i emetuar dhe tregtuar në tregjet ndërkombëtare financiare, jashtë kufijve të vendit që e emeton atë.

Kreditor dypalësh – Tipi i kreditorëve si qeveritë dhe agjencitë e tyre.

Kredi koncesionale – Kredi me terma më të favorshme se ato të tregut.

Kreditor shumëpalësh – Tipi i kreditorëve që përfshinë institucionet financiare si Banka Botërore, FMN, etj..

Kreditorë privatë – Kreditorët që nuk janë as qeveri dhe as agjenci të sektorit publik. Këto përfshijnë mbajtësit privatë të titujve shtetërorë, bankat private dhe institucionet e tjera financiare.

KMM – Tregues i riskut të ri-financimit për borxhin. KMM është periudha mesatare e shprehur në ditë ose në vite, që i duhet portofolit të borxhit për t'u maturuar. Sa më larg në kohë të jetë e projektuar data e maturimit të një instrumenti, aq më i ulët është risku i ri-financimit dhe aq më e lartë është vlera e këtij treguesi. KMM për instrumentet financiarë të borxhit përllogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{KMM} = \frac{\sum_{t \in T} t\ Nt}{\sum_{t \in T} Nt}$$

Nga ku:

t – data e maturimit;
T – bashkësia e të gjitha datave të maturimit;
N_t – Vlera nominale që do të paguhet në datën t.

KMR – Tregues i riskut të normave të interesit për borxhin. Jep informacion lidhur me ekspozimin e portofolit të borxhit kundrejt ndryshimit të normave të interesit. KMR interpretohet si koha mesatare (në vite) që i duhet portofolit të borxhit për të ripërcaktuar normën e interesit. Sa më e madhe të jetë sasia e instrumenteve afatshkurtër dhe sasia e instrumenteve me norma interesi të ndryshueshëm në portofolin e borxhit, aq më i madh është risku i normave të interesit dhe aq më i vogël ky tregues dhe anasjelltas. KMR për instrumentet financiarë të borxhit përllogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{KMR} = \frac{\sum_{r \in R} r\,Nr + \sum_{t \in T} t\,Nt}{\sum_{r \in R} Nr + \sum_{t \in T} Nt}$$

Nga ku:

r – data e pagesës së kuponit të instrumentit me norma interesi të lëvizshme;
t – data e maturimit të instrumentit me norma interesi fikse;
N_r – vlera nominale e instrumentit me norma interesi të lëvizshme;
N_t – vlera nominale e instrumentit me norma interesi fikse;
R – bashkësia e të gjitha datave të maturimit për instrumente me norma interesi të lëvizshme;
T – bashkësia e të gjitha datave të maturimit për instrumente me norma interesi fikse.

PBG – Është garanci e emetuar nga Banka Botërore, e cila garanton vlerën e plotë ose të pjesshme të një huaje, me qëllim mundësimin e saj me kosto më të favorshme se ajo e ofruar nga tregu.

Raport mbulimi – Raporti ndërmjet shumës së kërkuar *(nga investitorët)* dhe shumës së ofruar *(nga shteti)* në ankandet e titujve shtetërorë. Shërben për të vlerësuar nivelin e plotësimit të ankandeve dhe gjendjen e likuiditetit.

Risku i kursit të këmbimit – I referohet ndikimit të lëvizjes së kursit të këmbimit të një va;ute, mbi nivelin e borxhit dhe shërbimin e tij në një masë të caktuar mbi pritshmëritë. Psh.: "Mbiçmimi ose nënçmimi i monedhës vendase kundrejt një monedhe të huaj, e cila është pjesë përbërëse e portofolit të borxhit, mund të rezultojë në rënie ose rritje proporcionale të volumit të borxhit ose shërbimit të tij (*të denominuar në monedhë vendase*)".

Risku i likuiditetit – Risku që lidhet me humbjen e aftësisë së buxhetit të shtetit për të likuiduar detyrimet korrente dhe ekzektutimin në kohë të shpenzimeve buxhetore. Me qëllim minimizimin e këtij risku, shteti duhet të ketë akses mbi një sasi të caktuar asetesh likuide me qëllim garantimin e fondeve në raste krizash të përkohshme, gjatë të cilave bëhet e vështirë ose me kosto të lartë, sigurimi i tyre.

Risku i normave të interesit – Risku që pagesat e shërbimit të borxhit të ndryshojnë si rrjedhojë e lëvizjes së normave të interesit. Ky risk krijohet nga nevoja për të shërbyer borxhin që maturohet dhe pagesat e kuponëve të instrumenteve me norma interesi të ndryshueshme në të ardhmen.

Risku operacional – Risku që ka të bëjë me rritjen e kostos së menaxhimit të borxhit ose me rritjen e nivelit të risqeve të tjera si rezultat i gabimeve njerëzore, dëmtimit të pajisjeve elektronike, dëmeve natyrore, etj. Risku operacional është një risk relativisht i vështirë për t'u matur dhe vlerësuar. Ulja e ekspozimit të riskut operacional mund të arrihet nëpërmjet integrimit të procedurave të menaxhimit të borxhit në një strukturë organizative, duke pasur strukturën, infrastrukturën dhe procedurat të drejtuara nga aktivitete operacionale efiçente për menaxhimin e administratës shtetërore dhe tregjeve financiare.

Risku i rifinancimit – Risku që lidhet me aftësinë për të emetuar instrumente ose marrë hua me qëllim ri-financimin dhe shërbimin e borxhit aktual. Sa më i madh të jetë volumi i shumave që

maturohen dhe sa më i afërt në kohë, aq më i lartë është risku i ri-financimit dhe anasjelltas. Risku i ri-financimit ndikohet nga niveli i borxhit ekzistues dhe profili i amortizimit. Rritja e maturitetit të borxhit dhe shpërndarja në kohë e maturimeve ndikon në reduktimin e riskut të ri-financimit.

Stoku i borxhit – Balanca e principalit të borxhit në një moment të dhënë të kohës.

Shërbim i borxhit – Pagesat e principalit dhe interesit në përputhje me termat e përcaktuara në marrëveshje.

Sistemi Primary Dealer – Është një marrëveshje institucionale ndërmjet strukturës përgjegjëse për menaxhimin e borxhit dhe disa ndërmjetësve financiarë *(që kanë funksione të specializuara në tregun e titujve shtetërorë),* me qëllim zbatimin e një strategjie që ka për funksion sigurimin e nevojave për financim të qeverisë dhe zhvillimin e tregut të titujve.

Tregu primar – Është hapësira fizike ose funksionale në të cilin Shteti Shqiptar emeton për herë të parë titujt.

Tregu sekondar – Është hapësira fizike ose funksionale ku kryhen transaksionet me titujt pasi janë emetuar në tregun primar.

Tituj afatmesëm – I referohet titujve të borxhit shtetërorë me afat maturimi nga 2 deri në 5 vite.

Tituj afatgjatë – I referohet titujve të borxhit shtetërorë me afat maturimi mbi 5 vite.

Tituj referencë *(benchmark)* – Është emetimi më i fundit i titujve të shtetit shqiptar për një maturitet të caktuar. Ankandi për titullin referencë mund të rihapet periodikisht deri në arritjen e një vlere të paracaktuar nga Ministria e Financave. Ky titull përdoret si pikë referimi për vlerësimin e titujve të tjerë shtetërorë me maturitet, shumë emetimi dhe normë kuponi të ngjashëm.
Përgjithësisht, titujt referencë gëzojnë likuiditet më të lartë se emetimet e zakonshme, për shkak të detyrimit që kanë Zhvilluesit e Tregut për të kuotuar çmime blerjeje/shitjeje në tregun sekondar sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e lidhur me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Tituj shtetërorë – Janë bonot e thesarit dhe obligacionet shtetërore të emetuara nga Ministria e Financave në përputhje me ligjin Nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; ligjin Nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për titujt"; si edhe aktet nënligjore.

ANEKSI II

TË DHËNA SHTESË

1. STOKU I BORXHIT PUBLIK DHE QEVERISJES QENDORE

Tabela 1.0: *Stoku i borxhit publik (2018- 2023)* *(në milion Lekë)*

	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Borxhi Publik	1,107,284.5	1,112,625.7	1,224,470.4	1,382,939.7	1,378,625.8	1,362,827.6
Borxhi i Qeverisjes Qendrore	1,106,568.8	1,112,044.2	1,224,038.2	1,382,624.9	1,378,421.5	1,362,726.6
Borxhi i Pushtetit Lokal	715.7	581.5	432.1	314.9	204.4	101.0
PBB	1,636,731.0	1,691,903.4	1,647,431.1	1,856,172.1	2,138,339.1	2,312,588.4
Borxhi Publik/PBB	67.7%	65.8%	74.3%	74.5%	64.5%	58.9%
Borxhi i Qeverisjes Qendrore/PBB	67.6%	65.7%	74.3%	74.5%	64.5%	58.9%
Borxhi i Pushtetit Lokal/PBB	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%

Tabela 1.1: *Stoku i borxhit të qeverisjes qendrore (2018- 2023)* *(në milion Lekë)*

	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Borxhi i Qeverisjes Qendrore	1,106,568.8	1,112,044.2	1,224,038.2	1,382,624.9	1,378,421.5	1,362,726.6
Borxhi i Brendshëm	580,310.3	597,290.0	644,087.8	702,255.5	732,653.9	741,778.1
Borxhi i Jashtëm	526,258.5	514,754.2	579,950.4	680,369.3	645,767.6	620,948.5

Tabela 1.2: *Stoku i borxhit të qeverisjes qendrore (2019- 2023)* *(në milion Lekë)*

	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Borxhi i Qeverisjes Qendrore	**100.0%**	**100.0%**	**100.0%**	**100.0%**	**100.0%**	**100.0%**
Borxhi i Brendshëm	52.4%	53.7%	52.6%	50.8%	53.2%	54.4%
Borxhi i Jashtëm	47.6%	46.3%	47.4%	49.2%	46.8%	45.6%

2. HUAMARRJA SHTETËRORE

Tabela 2.0: *Huamarrja shtetërore nga burime të brendshme dhe të jashtme në terma bruto (2022-2023)*

Burimet e Huamarrjes	2022		2023	
	Vlera *(në mld Lekë)*	%/Total	Vlera *(në mld Lekë)*	%/Total
Burime të Brendshme	**357.9**	**92.7%**	**374.1**	**80.3%**
Bono Thesari	245.5	63.6%	225.6	48.4%
Obligacione	112.3	29.1%	148.5	31.9%
Burime të Jashtme	**28.3**	**7.3%**	**91.9**	**19.7%**
Hua për financimin e projekteve	11.2	2.9%	9.4	2.0%
Mbështetje Buxhetore	17.1	4.4%	19.7	13.5%
Eurobond	-	0.0%	62.8	13.5%
Total Huamarrja	**386.1**	**100.0%**	**466.0**	**100.0%**

3. KOSTOT

Tabela 3.0: *Shërbimi i borxhit shtetëror (2019 –2023)* *(në milion Lekë)*

	2019	2020	2021	2022	2023
Sherbimi I Borxhit	**64,933.4**	**96,091.7**	**68,986.4**	**78,009.7**	**100,828.9**
Interesa	**35,142.8**	**34,393.4**	**35,822.3**	**39,624.0**	**47,590.9**
Interesa të brendshme	22,837.9	22,350.9	23,470.4	24,210.3	29,030.3
Interesa të Huaja	12,304.9	12,042.5	12,351.9	15,413.7	18,560.6
Principal	29,790.6	61,698.3	33,164.1	38,385.7	53,238.0
PBB	1,691,903.4	1,647,431.1	1,856,172.1	2,138,339.1	2,312,588.4
Sherbimi I Borxhit/PBB	**3.8%**	**5.8%**	**3.7%**	**3.6%**	**4.4%**
Interesa/PBB	**2.1%**	**2.1%**	**1.9%**	**1.9%**	**2.1%**
Interesa të Brendshme/PBB	1.3%	1.4%	1.3%	1.1%	1.3%
Interesa të Huaja /PBB	0.7%	0.7%	0.7%	0.7%	0.8%
Principal/PBB	**1.8%**	**3.7%**	**1.8%**	**1.8%**	**2.3%**
Të ardhura tatimore	**426,270.7**	**398,657.7**	**475,611.9**	**541,342.2**	**598,661.9**
Interesa/Të ardhura tatimore	8.2%	8.6%	7.5%	7.3%	7.9%

** Krahas shërbimit të borxhit shtetëror përfshihet edhe shërbimi i borxhit që qeveria ka paguar në favor të entiteteve për të cilat ka lëshuar garanci shtetërore.*


4. TREGUESIT E TREGUT PRIMAR TË TITUJVE SHTETËRORË

Tabela 4.0: *Treguesit e ecurisë së kërkesës dhe ofertës në tregun primar të titujve shtetërorë (2022-2023)*


Periudha	Treguesi	B.Thesari	Obligacione	Gjithsej
2022	**Nr i ankandeve**	48	39	**87**
	Kërkesa (në mld Lekë)	297.6	153.7	**451.2**
	Oferta (në mld Lekë)	259.9	150.6	**410.5**
	Raporti i mbulimit	1.14	1.02	**1.10**
2023	**Nr i ankandeve**	41	57	**98**
	Kërkesa (në mld Lekë)	329.5	222.6	**552.1**
	Oferta (në mld Lekë)	232.5	160.0	**392.5**
	Raporti i mbulimit	1.42	1.39	**1.41**

5. KOMPOZIMI I BORXHIT TË JASHTËM

Paraqitje Grafike 5.0: *Stoku i borxhit të jashtëm shtetëror sipas valutës (2022- 2023)*




Paraqitje Grafike 5.1: *Stoku i borxhit të jashtëm sipas tipit të interesit (2018- 2023)*



	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Interes Fiks	2,218.1	2,170.9	2,504.7	3,397.6	3,458.2	3,825.2
Interes Variabël	2,045.9	2,056.4	2,183.6	2,236.8	2,194.9	2,152.4

**Përfshihet borxhi shtetëror dhe borxhi shtetëror i garantuar*


Paraqitje Grafike 5.2: *Stoku i borxhit të jashtëm sipas koncesionalitetit (2018- 2023)*



	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Koncensionale	1,952.7	1,927.5	1,834.8	1,951.82	1,811.37	1,642.14
Jo-koncensionale	2,311.3	2,299.7	2,853.6	3,682.55	3,841.71	4,335.42

**Përfshihet borxhi shtetëror dhe borxhi shtetëror i garantuar*

Paraqitje Grafike 5.3: *Stoku i borxhit të jashtëm sipas kreditorëve (2018- 2023)*



	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Shumëpalësh	2,417.5	2,426.3	2,532.8	2,754.9	2,745.4	2,597.3
Dypalësh	735.2	739.1	723.5	825.4	879.4	910.9
Kreditorë privat	1,099.6	1,054.2	1,429.7	2,054.0	2,028.3	2,469.4
Borxh i riskeduluar	11.7	7.6	2.5	-	-	-

**Përfshihet borxhi shtetëror dhe borxhi shtetëror i garantuar*

6. DISBURSIMET E BORXHIT TË JASHTËM

Tabela 6.0: *Disbursimet sipas kreditorëve (2018- 2023)* *(në milion Euro)*

	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Shumëpalësh	229.0	135.9	375.9	339.5	187.5	171.8
Dypalësh	42.9	49.2	48.7	152.0	112.8	115.4
Kreditorë Privat	498.5	0.0	646.2	636.7	0.0	594.3
TOTAL	**770.4**	**185.1**	**1,070.8**	**1,128.2**	**300.3**	**881.5**

**Përfshihet borxhi shtetëror dhe borxhi shtetëror i garantuar*

Tabela 6.1: *Disbursimet sipas sektorëve ekonomik (2018-2023)* *(në milion Euro)*

Sipas sektorëve ekonomikë	2018	2019	2020	2021	2022	2023
ADMINISTRATA SHTETËRORE	0.6	0.8	0.9	0.6		0.0
ARSIMI	-	-	0.2	0.4	0.7	0.8
BUJQËSI, UJITJE	0.1	-	-	-	0.4	0.0
ENERGJETIKË	153.8	14.2	105.7	19.6	68.8	16.3
INFRASTRUKTURË URBANE DHE RURALE	21.1	25.5	5.6	14.0	17.4	21.4
KLUBI I PARISIT DHE RISKEDULIME TË TJER	-	-	-	-		0.0
MBËSHTETJE PËR BUXHETIN	506.1	14.1	834.9	984.0	142.6	784.9
MBROJTJA E MJEDISIT	2.2	0.4	2.1	1.4	0.0	0.0
SHËNDETËSI	12.4	7.1	8.5	15.2	11.7	5.9
TRANSPORT	44.3	77.6	72.5	60.6	41.8	23.2
TRANSPORTI HEKURUDHOR	-	-	0.4	3.8	5.2	9.7
UJËSJELLËSA/KANALIZIME	29.9	44.6	37.9	28.6	11.1	18.9
TË TJERA	-	0.9	-	-	0.0	0.0
ZHVILLIMI RURAL	-	-	-	-	0.0	0.0
FURNIZIMI DHE TREGTIA	-	-	1.0	-	0.5	0.4
MEDIA TELEVIZIVE	-	-	1.2	-		0.0
TOTAL	**770.4**	**185.1**	**1,070.8**	**1,128.2**	**300.3**	**881.5**

**Përfshihet borxhi shtetëror dhe borxhi shtetëror i garantuar*

RAPORT

MBI PËRDORIMIN E FONDEVE REZERVË TË BUXHETIT TË SHTETIT DHE KONTIGJENCAVE GJATË PERIUDHËS 1 JANAR - 31 DHJETOR 2023

I. FONDI REZERVË

Në mbështetje të nenit 5 të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar"*, buxheti i shtetit përfshin edhe një fond rezervë i cili përdoret për rastet e financimit të shpenzimeve, që nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Miratimi i përdorimit të tij bëhet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

1. Ligji nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", miratoi Fondin Rezervë të buxhetit të shtetit në masën 3.5 miliardë LEK, ndërkohë që Neni 14 përcakton përdorimin i tij si mëposhtë:
   a) 1 700 milionë LEK për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme;
   b) 1 800 milionë LEK për përballimin e kostos së zgjedhjeve.

2. Me Aktin Normativ Nr.5 datë 18.10.2023 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023"*, Fondi Rezervë u rrit në masën 3.8 miliardë LEK, ku Neni 8 përcakton përdorimin i tij si më poshtë :
   a) 2 000 milionë LEK për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme;
   b) 1 800 milionë LEK për përballimin e kostos së zgjedhjeve.

3. Me Aktin Normativ Nr.6 datë 14.12.2023 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023, i ndryshuar"*, Fondi Rezervë u rrit në masën 4 miliardë LEK, ku Neni 5 përcakton përdorimin i tij si më poshtë :
   a) 2 200 milionë LEK për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme;
   b) 1 800 milionë LEK për përballimin e kostos së zgjedhjeve.

a) Fondi Rezervë i buxhetit të shtetit, i planifikuar në masën 2.2 miliardë LEK për raste të paparashikuara, deri në datën 31.12.2023 është përdorur nëpërmjet 19 Vendimeve të Këshillit të Ministrave (VKM) me vlerë totale prej 2 174.4 milionë LEK ose në rreth 98.8% të planit.

Tabela 1: Përdorimi i fondit rezervë deri më 31.12.2023 (në milionë LEK)

Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit 2023	Miratuar me ligj për vitin 2023	Përdorur me VKM deri 31.12.2023	Mbetur pa përdorur me 31.12.2023	Përdorur vs Planifikuar (në %)
	2 200	2 174.4	25.58	98.8%


Burimi: Ministria e Financave (2024)

Më konkretisht:

- *Rreth 536.4 milionë LEK ose 25% e planit, janë akorduar për shpenzime personeli.*
- *Rreth 858.2 milionë LEK ose 39% e planit, për shpenzime operative dhe transferta të brendshme/të jashtme;*
- *Rreth 779.7milionë LEK ose 36% e planit, janë akorduar për shpenzime kapitale.*

Grafiku i mëposhtëm paraqet strukturën e përdorimit të Fondit Rezervë, deri më 31.12.2023:

Grafiku.1 Përdorime të Fondit Rezervë, deri më 31.12.2023 (në 000/LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Përdorimi i Fondit Rezervë sipas ministrive dhe institucioneve qendrore, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2: Përdorimi i fondit rezervë, sipas institucioneve përfituese (në 000/LEK).

Kodi instit.	Emërtimi i institucionit	Numri i VKM te miratuara	Fondi i përdorur	
			Vlera e akorduar	Në %
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	1	800,000	36.8%
10	Ministria Financave	3	25,434	1.2%
11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	1	106,000	4.9%
12	Ministria e Kulturës	2	187,581	8.6%
14	Ministria e Drejtësisë	1	380,000	17.5%
15	Ministria e Punëve të Jashtme	1	115,800	5.3%
16	Ministria e Brendshme	1	20,000	0.9%
17	Ministria e Mbrojtjes	1	83,400	3.8%
30	Gjykata Kushtetuese	1	35,000	1.6%
40	Partite Politike	1	100,000	4.6%
63	Institucionet e Drejtësisë	1	40,000	1.8%
87	Institucione të tjera Qeveritare	6	281,205	12.9%
	TOTALI		**2,174,420**	**100%**

Burimi: Ministria e Financave (2023)

Në mënyrë analitike, në rend zbritës, rezulton se:

- ✓ 800 milionë LEK për **Komisionin Qendror të Zgjedhjeve** nëpërmjet VKM nr.38 datë 27.01.2023 "*Për një shtesë fondi në Buxhetin e vitit 2023, miratuar për KQZ, për organizimin e zgjedhjeve për organet e vetëqeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023*".
- ✓ 380 milionë LEK për **Ministrinë e Drejtësisë** nëpërmjet VKM nr.834 datë 28.12.2023 *"Për një ndryshim në VKM nr.929 datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë" të ndryshuar dhe për shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, miratuar për disa institucione".*
- ✓ 187.5 milion LEK për **Ministrinë e Kulturës** dhe konkretisht:
  - *130.1 milionë LEK me VKM nr.228 datë 13.04.2023"Për një shtesë fondesh në buxhetin e vitit 2023, miratuar për Ministrinë e Kulturës dhe Radio Televizionin Shqiptar, për mbulimin e shpenzimeve për realizimin e projektit "Festivali Folklorik Kombëtar, Gjirokastër, 24 Qershor-2 Korrik 2023".*
  - *57.5 milionë LEK me VKM nr.202 datë 07.04.2023 "Për një shtesë fondi në buxhetin e MK për vitin 2023, për financimin e projektit teknik të ndërhyrjes emergjente në objektin monument kulture, kategoria e I, ura e Matit".*

- ✓ 106 milionë LEK për **Ministrinë e Arsimit dhe Sportit** me VKM nr.638 datë 15.11.2023 *"Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023 miratuar për MAS për Bashkinë Pogradec, për financimin e tarifës së pjesëmarrjes për organizimin e aktivitetit ndërkombëtar "Kampionati Boteror i Formula 1 H2O"*.
- ✓ 115.8 milionë LEK për **Ministrinë e Punëve të Jashtme** me VKM nr.97 datë 22.02.2023 *"Për dhënien e ndihmës financiare humanitare nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për mbështetjen e qeverisë së Turqisë për dëmet e shkaktuara nga tërmeti i datës 7 Shkurt 2023"*.
- ✓ 100 milion LEK për **Partitë Politike** në zbatim të VKM nr.269 datë 28.04.2023 *"Për një shtesë fondi në programin "Mbështetje për partitë politike", për financimin e fushatës zgjedhore të subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore të vitit 2023"*.
- ✓ 83.4 milionë LEK janë akorduar nëpërmjet VKM nr.834 datë 28.12.2023 *"Për një ndryshim në VKM nr.929 datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të vecantë" të ndryshuar dhe për shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, miratuar për disa institucione"*.
- ✓ 40 milionë LEK për **Komisionin e Pavarur të Kualifikimit** nëpërmjet VKM nr.834 datë 28.12.2023 "Për një ndryshim në VKM nr.929 datë 17.11.2010 "*Për krijimin dhe përdorimin e fondit të vecantë" të ndryshuar dhe për shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, miratuar për disa institucione*".
- ✓ 35 milionë LEK për **Gjykatën Kushtetuese** me VKM nr.405 datë 05.07.2023 *"Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, miratuar për Gjykatën Kushtetuese nga Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit për vitin 2023, për mbulimin e shpenzimeve kapitale"*.
- ✓ 25.4 milion LEK janë akorduar për **Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë** me 3 VKM, përkatësisht:
  - *20 milionë LEK me VKM nr.531 datë 07.09.2023 "Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" sha, për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë".*
  - *2.77 milionë LEK me VKM nr.445 datë 26.07.2023 "Për ekzekutimin e vendimit të gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut datë 13.12.2022, për çështjen "SEVDARI kundër Shqipërisë" (për kërkesën nr.40662/19).*
  - *2.66 milionë LEK me VKM nr.548 datë 28.09.2023 "Për ekzekutimin e vendimit të gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut datë 13.12.2022, për çështjen "ELGAKOTI kundër Shqipërisë" (për kërkesën nr.63986/10 dhe 5 kërkesa te tjera.)*
- ✓ 20 milion LEK janë akorduar për **Ministrinë e Brendshme** me VKM nr.80 datë 14.02.2023*"Për krijimin e shoqërisë aksionare për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike"*.
- ✓ 281.2 milionë LEK janë akorduar për **"Institucionet e tjera Qeveritare"**, nëpërmjet 6 VKM dhe konkretisht:
  - *61 milionë LEK me VKM nr.142 datë 08.03.2023 "Për një shtesë fondi* ***për DSHQ*** *për "Një shtesë fondi nga Fondi rezervë në buxhetin e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare për financimine infrastrukturës mbështetëse, në kuadër të organizimit në Tiranë të Samitit të Procesit të Berlinit".*
  - *62 milionë me VKM nr.481 datë 01.08.2023 "Për një shtesë në numrin e punonjësve organikë në NJQQ, për vitin 2023 dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023".*
  - *51 milionë LEK me VKM nr.569 datë 06.10.2023 "Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar të vitit 2023* ***për DSHQ****, për përballimin e shpenzimeve të organizimit në Tiranë të 'Samitit të procesit të Berlinit' të datës 16 Tetor 2023".*
  - *43.5 milion LEK me VKM nr.769 datë 26.12.2023 "Për një shtesë nga Fondi Rezervë në Buxhetin e vitit 2023, miratuar për* ***Agjencinë për Dialog e Bashkëqeverisje****".*
  - *40 milionë LEK me VKM nr.223 datë 13.04.2023 "Për një shtesë në numrin e punonjësve në organikë në NJQQ, për vitin 2023", për "****Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor****".*
  - *23.1 milionë LEK me VKM nr.512 datë 30.08.2023 "Për ngarkimin e* ***Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit****, si organ qendror blerës për realizimin e konkursit të projektimit për projekt-idetë e TiranaExpo dhe një shtesë fondi në buxhetin e AKPT miratuar për vitin 2023".*

Mbështetur në sa mësipër, gjendja e papërdorur e Fondit Rezervë (të planifikuar) të buxhetit të shtetit në datën 31.12.2023, është 25.58 milionë LEK.

Sa i takon ekzekutimit të VKM-ve, evidentojmë se:

- ✓ *VKM nr.269 datë 28.04.2023 është ekzekutuar për 2 935 000 LEK më pak se sa shuma e miratuar, sipas kërkesës së institucionit.*
- ✓ *VKM nr.531 datë 07.09.2023 me efekt 20 milion LEK dhe VKM nr.481, datë 01.08.2023 me efekt 62 milionë LEK nuk janë ekzekutuar, pasi nuk është paraqitur kërkesa për akordimin e fondit nga institucioni përkatës.*
- ✓ *VKM nr.834 datë 28.12.2023 është ekzekutuar për 580 000 LEK më pak për Ministrinë e Mbrojtjes, sipas kërkesës së institucionit.*

Mbështetur në sa mësipër, gjendja e papërdorur efektive (duke patur parasysh ekzekutimin) e Fondit Rezervë në datën 31.12.2023, është 111.1 milionë LEK.

b) Fondi Rezervë për përballimin e kostos së zgjedhjeve i planifikuar në masën 1 800 milionë LEK, është përdorur me VKM nr.38 datë 07.01.2023 "*Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, miratuar **për KQZ**, për organizimin e zgjedhjeve për organet e vetëqeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023*".

II. FONDI KONTIGJENCË

Ky fond u miratua në vlerën 12 miliardë LEK në Ligjin nr.84/2022 "*Për Buxhetin e vitit 2023*", për t'u përdorur për raste të paparashikuara me VKM. Me AN nr.5/2023 ai u rrit në 13.4 miliardë LEK dhe me AN nr.6/2023 ky fond kapi nivelin 14.98 miliardë LEK, nga i cili:

- ✓ *Fondi prej 1 000 milionë LEK përdoret për pagesën e një pjese të diferencës së pagës së magjistratit nga 1 Janar 2019 e në vazhdim, sipas arsyetimit të bërë nga Gjykata Kushtetuese në Vendimin nr.35 datë 22.11.2022. Për institucionet e Rivlerësimit Kalimtar të Magjistratit, kjo diferencë paguhet që nga momenti i krijimit të tyre.*
- ✓ *Fondi prej 1 430 milionë LEK përdoret për mbështetjen e shtresave në nevojë, sipas përcaktimeve të miratuara me VKM.*

Fondi Kontigjencë prej 14.98 miliardë LEK, deri më 31.12.2023 është përdorur në masën 14 968 975 mijë LEK, dhe konkretisht:

- ✓ 3 536 735 mijë LEK akorduar MFE/ISSH me VKM nr.187 datë 31.03.2023 "*Për shpërblimin e pensionistëve*".
- ✓ 9 006 239 mijë LEK akorduar për përballimin e efekteve financiare shtesë në zbatim të:
  - *VKM nr.114 datë 01.03.2023 "Për përdorimin e Fondit të Kontigjencës për kompensimin financiar të rritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për cdo të punësuar me pagë minimale, për shkak të rritjes së kësaj page në shkalle vendi", me vlerë 452 milionë LEK.*
  - *VKM nr.238-245 datë 20.04.2023 për miratimin e ndryshimit të nivelit të pagave për disa kategori punonjësish, me vlerë 2 354 363 mijë lekë.*
  - *VKM nr.324-327 datë 31.05.2023 për miratimin e niveleve të reja të pagave për kategoritë e tjera të punonjësve, me vlerë 6 199 866 mijë lekë.*
  - *VKM nr.437 datë 19.07.2023 "Për shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për disa institucione të pavarura të krijuara me ligj", me vlerë 886.1 milionë LEK.*
- ✓ 1 000 milionë LEK akorduar me VKM nr.755 datë 20.12.2023 "*Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023 për disa institucione të pavarura të krijuara me ligj*", ekzekutuar për 996 milionë LEK.
- ✓ 1 430 milionë LEK për mbështetjen e shtresave në nevojë sipas:
  - *VKM nr.766 datë 20.12.2023 "Për shpërblimin e disa kategorive të veçanta ne fund te vitit", me vlerë 939.5 milionë LEK, akorduar për MSHMS.*
  - *VKM nr.819 datë 28.12.2023 "Për një shpërblim për kategorinë e personave që përfitojnë pension invaliditeti dhe pension familjar për vitin 2023", me vlerë 490.5 milionë LEK, akorduar për MFE.*

Mbështetur në sa mësipër, gjendja e Fondit të Kontigjencës e papërdorur deri më datë 31.12.2023, pas ekzekutimit të VKM-ve të miratuara,rezulton 11.02 milionë LEK.

III. FONDI KONTIGJENCË PËR RISQET E BORXHIT

Fondi i Kontigjencës për risqet e borxhit në masën 4.9 miliardë LEK, deri më datë 31.12.2023 rezulton i papërdorur.

Raport mbi Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik për vitin 2023

Ky raport është përgatitur nga:

Drejtoria e Përgjithshme e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Raportimit Financiar pranë Ministrisë së Financave

Tiranë, Maj 2024

PËRMBAJTJA

LISTA E TABELAVE

LISTA E GRAFIKËVE

LISTA E FIGURAVE

LISTA E SHKURTIMEVE

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

KAPITULLI I. VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË NJËSIVE PUBLIKE RAPORTUESE

1.1 ANALIZA PËR TREGUESIT E PERFORMANCËS PËR NJQP-TË:
1.2 ANALIZA PËR TREGUESIT E PERFORMANCËS PËR SHA-TË

KAPITULLI II. MENAXHIMI FINANCIAR DHE KONTROLLI

2.1 ANALIZA E SISTEMIT SIPAS 5 KOMPONENTËVE TË NDARË NË 17 PARIME TË MFK BAZUAR NË VETËVLERËSIMIN E NJËSIVE PUBLIKE
2.2 VLERËSIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT NË BASHKITË E PËRZGJEDHURA PËR ASISTENCË TEKNIKE NGA PROJEKTI I FINANCAVE LOKALE

KONKLUZION I DH/MFKK PËR VLERËSIMIN E SISTEMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT PËR VITIN 2023

KAPITULLI III. VLERËSIMI I CILËSISË SË SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM.

KAPITULLI IV- MBËSHTETJA E MF-SË PËR ZHVILLIMIN E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM

4.1. AKTIVITET MBËSHTETËSE TË MF TË NDËRMARRA PËRGJATË VITIT 2023
4.2 IMPAKTI PËR VITIN 2023

KAPITULLI V. REZULTATET KRYESORE DHE PROGRESI NË ARRITJEN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË TË VEPRIMTARISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM PUBLIK

5.1 ANALIZË E VEPRIMTARISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
5.2 TREGUESIT KRYESORË TË PERFORMANCËS NGA ANGAZHIMET E AUDITIMIT TË BRENDSHËM. GJETJET DHE REKOMANDIMET E AUDITIMIT.
5.3.VLERËSIMI I SISTEMEVE TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM
5.4 KAPACITETET AUDITUESE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL
5.5 VLERËSIMI I JASHTËM I CILËSISË SË VEPRIMTARISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
5.6 ZHVILLIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK
5.7 PROCESI I CERTIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM PËR SEZONIN 2022-2023
5.8 PYETËSORI I VETËVLERËSIMIT TË NJAB

ANEKSI I. TREGUESIT E PERFORMANCËS SË NJQP-VE

ANEKSI II. VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË SISTEMIT TË MFK-SË NË NJËSITË SHPENZUESE ME BUXHET TË MADH

ANEKSI III. ANALIZA E 17 PARIME TË MFK BAZUAR NË VETËVLERËSIMIN E NJËSIVE PUBLIKE

ANEKSI VI. OPINIONET E DHËNA GJATË VLERËSIMIT TË JASHTËM TË CILËSISË

SHTOJCA I. LISTA E NJËSIVE PËR TË CILAT NUK KA TË DHËNA PËR DISA TREGUES PERFORMANCE

LISTA E TABELAVE

TABELA 1. TREGUESIT E PERFORMANCËS DHE BURIMET E TË DHËNAVE SIPAS DREJTORIVE NË MINISTRINË E FINANCAVE .

TABELA 2. RANKIMI I INSTITUCIONEVE TË PAVARURA SIPAS TREGUESVE TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2023 DHE KRAHASIMI ME VITIN 2022
TABELA 3. RANKIMI I INSTITUCIONEVE TË GRUPIT 87 NË VARËSI TË KRYEMINISTRISË SIPAS TREGUESVE TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2023 DHE KRAHASIMI ME VITIN 2022
TABELA 4. RANKIMI I MINISTRIVE TË LINJËS SIPAS TREGUESVE TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2023 DHE KRAHASIMI ME VITIN 2022
TABELA 5. RANKIMI I BASHKIVE QENDËR QARKU, SIPAS TREGUESVE TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2023 DHE KRAHASIMI ME VITIN 2022
TABELA 6. RANKIMI I BASHKIVE TË TJERA SIPAS TREGUESVE TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2023 DHE KRAHASIMI ME VITIN 2022
TABELA 7. RANKIMI I KËSHILLAVE TË QARKUT SIPAS TREGUESVE TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2023 DHE KRAHASIMI ME VITIN 2022
TABELA 8. RANKIMI I NJËSIVE SHPENZUESE ME BUXHET TË MADH SIPAS TREGUESVE TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2023 DHE KRAHASIMI ME VITIN 2022
TABELA 9. LLOJI I ANGAZHIMIT TË AUDITIMIT
TABELA 10. VLERËSIMI I RISKUT NË NJËSITË PUBLIKE
TABELA 11. GJETJET ME EFEKT FINANCIAR NEGATIV SIPAS SISTEMEVE PËR VITIN 2023
TABELA 12. REKOMANDIME SIPAS LLOJIT PËR VITIN 2023
TABELA 13. TË DHËNA PËR AUDITUESIT E BRENDSHËM
TABELA 14. LISTA E INSTITUCIONEVE PËR TË CILAT MUNGOJNË TË DHËNAT PËR TREGUESIT E PERFORMANCËS

LISTA E GRAFIKËVE

GRAFIKU 1. NUMRI I NJQP-VE QË KANË PLOTËSUAR PYETËSORIN E VETËVLERËSIMIT PËR VITIN 2023
GRAFIKU 2. AUDITIME TË PLANIFIKUARA DHE TË REALIZUARA NË VITE
GRAFIKU 3. REALIZIMI I AUDITIMEVE TË PLANIFIKUARA SIPAS LLOJIT PËR VITIN 2023
GRAFIKU 4. NUMRI I GJETJEVE SIPAS SISTEMEVE
GRAFIKU 5. STRUKTURA E SHKELJEVE FINANCIARE SIPAS SISTEMEVE KRYESORE
GRAFIKU 6. REKOMANDIME TË PRANUARA DHE ZBATUARA NË VITE
GRAFIKU 7. REKOMANDIMET E AUDITIMIT SIPAS LLOJIT
GRAFIKU 8. OPINIONI PËRGJITHSHËM MBI KONTROLLIN E BRENDSHËM
GRAFIKU 9. STRUKTURAT E AUDITIMIT TE BRENDSHEM DHE PUNESIM
GRAFIKU 10. OPINIONET E VLERËSIMIT TË JASHTËM TË CILËSISË NË VITE.
GRAFIKU 11. PËRPUTHSHMËRIA E NJAB ME KËRKESAT E AKTEVE LIGJORE
GRAFIKU 12. IDENTIFIKIMI, VLERËSIMI DHE MENAXHIMI I RISQEVE
GRAFIKU 13. VLERËSIMI PËR KONTROLLET E VENDOSURA DHE FUNKSIONIMI I TYRE
GRAFIKU 14. VLERËSIMI I BRENDSHËM I CILËSISË SË VEPRIMTARISË AUDITUESE

LISTA E FIGURAVE

FIGURA 1. SHTYLLAT E VEPRIMTARISË SË DH/AB

LISTA E SHKURTIMEVE

AB	Auditimi i Brendshëm
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian
DP/KBFPRF	Drejtoria e Përgjithshme e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Raportimit Financiar
DH/AB	Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm
DH/MFKK	Drejtoria e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar, Kontrollin dhe Kontabilitetin
GMR	Grupi i Menaxhimit të Riskut
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
KAB	Komiteti i Auditimit të Brendshëm
KBFP	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik
KB	Kontrolli i Brendshëm
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MF	Ministria e Financave
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NPA	Nëpunës i Parë Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
NJAB	Njësi e Auditimit të Brendshëm
NJQP	Njësi e Qeverisjes së Përgjithshme
NJQQ	Njësi e Qeverisjes Qendrore
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
RSH	Republika e Shqipërisë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Vizioni i qeverisë shqiptare, përmes zbatimit të plotë të reformave në financat publike, është edhe sigurimi i zhvillimit të mëtejshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik, si një mjet që duhet të përdoret nga drejtuesit dhe stafi i njësive publike për një menaxhim të përgjegjshëm, të suksesshëm dhe transparent të fondeve kombëtare dhe të huaja. Synimi kryesor është krijimi i një kuadri bashkëkohor të kontrollit të brendshëm, të përshtatshëm për funksionimin e sektorit publik duke parashtruar metoda të përshtatshme të planifikimit dhe raportimit financiar, tregues gjithëpërfshirës të performancës, si dhe mekanizma të efektshëm të kontrollit të brendshëm që do të sigurojnë një menaxhim të fortë dhe të qendrueshëm të financave publike.

Ministria e Financave realizon çdo vit vlerësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike, si dhe nivelin e zbatimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditimit të brendshëm, rezultatet e të cilit paraqiten në Raportin Vjetor për Funksionimin e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, nëpërmjet të cilit informohet Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe palët e tjera të përfshira në zhvillimin e kësaj fushe si rrejdhojë e detyrimit ligjor, referuar zbatimit të nenit 18, pika 3 e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

Qëllimi i Raportit Vjetor për Funksionimin e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik për vitin 2023 është prezantimi i plotë i progresit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik drejt qeverisë dhe palëve të interesuara duke vënë në dukje zhvillimet pozitive, mangësitë në funksionimin e tij, si dhe duke identifikuar masat e nevojshme për zhvillimin e mëtejshëm të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditimit të brendshëm. Gjithashtu, pjesë e raportit është dhe informacioni lidhur me vlerësimin e performancës së njësive të qeverisjes së përgjithshme mbi zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm duke realizuar renditjen e këtyre njësive bazuar në 18 (tetëmbëdhjetë) tregues performance gjithëpërfshirës mbi planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit, si dhe zbatimin e kërkesave ligjore të kontrollit të brendshëm.

Baza për analizën dhe përgatitjen e Raportit Vjetor për vitin 2023 është:

- Deklarata e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Pyetësori i vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit;
- Raportet e dorëzuar për aktivitetin e auditimit të brendshëm;
- Vlerësimi i treguesve të performancës për njësitë e qeverisjes së përgjithshme referuar Urdhrit të ministrit përgjegjës për financat nr. 117, datë 01.04.2019 "Për miratimin e Metodologjisë për Monitorimin e Performancës së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar;
- Vlerësimet e bëra nga procesi i vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, në mbështetje të metodologjisë së vlerësimit të cilësisë në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për financat nr. 311, datë 23.12.2020.

Krijimi dhe zbatimi i sistemit të kontrollit të brendshëm financiar në njësitë e sektorit publik është thelbësor për sigurimin e mirëmenaxhimit financiar, që mundëson realizimin e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara në mënyrë etike, duke shfrytëzuar burimet në mënyrë të ligjshme, ekonomike, efektive dhe eficiente. Për shkak të kompleksitetit të tij, sistemi i kontrollit të brendshëm financiar publik kërkon monitorim dhe vlerësim të

vazhdueshëm të përshtatshmërisë dhe funksionalitetit të tij, proces i cili realizohet nëpërmjet vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, realizuar dhe raportuar nga nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes së përgjithshme, si dhe nëpërmjet shërbimeve të auditimit të brendshëm e të jashtëm.

Angazhimi i qeverisë në zbatimin e reformave të koordinuara në fushën e menaxhimit të financave publike, në kuadër të së cilës Ministria e Financave do të vijojë mbështetjen për zbatimin e sistemit të KBFP-së me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë menaxheriale, sigurimin e menaxhimit të shëndoshë financiar publik dhe qeverisjen përmes menaxhimit të fondeve publike me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet, reflektohet edhe në planin e masave 2023-2026 të parashikuara në kuadër të Strategjisë së re të Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030.

Për vitin 2023, për sa i përket vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, evidentohet se, zhvillimet kryesore u fokusuan në drejtim të përmirësimit të funksionalitetit të sistemit nëpërmjet vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe ofrimit të asistencës teknike duke nxitur angazhimin dhe ndërgjegjësimin lidhur me rëndësinë strategjike dhe operacionale të zbatimit të instrumentave të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Pavarësisht rolit dhe ndërhyrjes së Drejtorisë së Harmonizimit për Menaxhimin Financiar, Kontrollin dhe Kontabilitetin në rritjen e ndërgjegjësimit për përmirësimin e funksionalitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm në të gjitha hallkat e tij, përsëri evidentohet nevoja për përmirësim të mëtejshëm, si lidhur me zbatimin korrekt të kërkesave ligjore të fushës ashtu dhe lidhur me cilësinë e realizimit të veprimtarisë dhe përmbushjes së qëllimit për të cilat njësitë publike janë krijuar.

Nga verifikimet e kryera, rezulton se, detyrimin për depozitimin e deklaratës dhe raportit mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm e kanë përmbushur 123[1] njësi nga 140 njësi të qeverisjes së përgjithshme, të cilat kanë ushtruar veprimtarinë e tyre gjatë vitit 2023. Gjthashtu, nga 153[2] njësi të cilave i'u është dërguar për plotësim pyetësori i vetëvlerësimit mbi sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, 140 njësi ose 91.5 % kanë raportuar pranë Ministrisë së Financave.

Gjithashtu, për vitin 2023, në mbështetje të nenit 18 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, si risi, detyrimin për raportim e kanë edhe shoqëritë tregtare të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme. Si rrjedhojë, kërkesa për të raportuar mbi vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, së bashku me pyetësorin e vetëvlerësimit mbi sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe planin e veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, u është dërguar edhe 45 shoqërive tregtare prej të cilave, në total, kanë raportuar gjithsej 29 shoqëri ose 64 % e tyre.

Për sa më lartë, në mbështetje të nenit 18 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, i'u është dërguar kërkesë 198 njësive publike, prej të cilave kanë raportuar 169 njësi.

---

[1] Në vlerësim nuk përfshihet SHISH, pasi informacioni i dërguar klasifikohet si informacion sekret.

[2] Pyetësori i vetëvlerësimit i'u është dërguar për plotësim 140 njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe 13 njësive shpenzuese me buxhet të madh me qëllim sigurimin e një pamje më të qartë të funksionimit dhe progresit të sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2023

Në lidhje me zhvillimet kryesore në fushën e kontrollit të brendshëm për vitin 2023, konstatohet si më poshtë:

- Nga analiza e 169 pyetësorëve të vetëvlerësimit të njësive të sektorit publik, rezulton se në përgjithësi, institucionet kanë pasqyruar një informacion të plotë, gjithëpërfshirës në lidhje me statusin e zbatimit si dhe të arsyetuar me evidenca mbështetëse konkrete, duke treguar një qëndrueshmëri graduale të ndërgjegjësimit të institucioneve përsa i përket plotësimit me cilësi të këtij pyetësori;
- Gjithashtu, nga analiza e pyetësorëve të vetëvlerësimit për të gjitha grupet e njësive të marra në analizë (ministri linje, njësi të vetëqeverisjes vendore, institucione të pavarura, njësi shpenzuese me buxhet të madh dhe Sh.A me kapital shtetëror) rezulton se vlerësim më të lartë merr grupi i ministrive të linjës, ndërkohë që situata vijon të paraqitet në nivel më të ulët në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe tek njësitë e reja raportuese (Sh.A-të me kapital shtetëror);
- Lidhur me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe vlerësimin e treguesve të performancës të lidhur me funksionalitetin e këtyre komponentëve, vijojnë të jenë me një vlerësim më të kënaqshëm komponentët e mjedisit të kontrollit dhe aktiviteteve të kontrollit;
- 399[3] punonjës janë trajnuar në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike për konceptet e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ndërkohë që 38 punonjës kanë ndjekur kursin me certifikim mbi zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut në njësitë publike;
- Gjithashtu, në kuadër të rishikimit të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", nëpërmjet të cilit u bënë pjesë e detyrimit për raportim edhe shoqëritë tregtare të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme (neni 18), u realizua trajnimi i dedikuar mbi mënyrën e raportimit të tyre në MF dhe konceptet bazë të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në të cilën morën pjesë 34 punonjës;
- Gjatë vitit 2023, u asistuan teknikisht 5 institucione të përzgjedhura pas vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, të cilat rezultuan me performancë më të ulët. Në këtë kuadër, u trajnuan 44 punonjës të këtyre institucioneve;
- Në kuadër të përmirësimit të zbatimit të instrumentave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, DH/MFKK u angazhua në përditësimin e bazave ligjore dhe nënligjore të menaxhimit financiar dhe kontrollit në vijim të rishikimit të ligjit të MFK, duke bashkëpunuar në këtë kuadër edhe me ekspertë të projektit të financave lokale;
- Gjithashtu, në bashkëpunim me ekspertët e projektit të financave lokale, iu dha rëndësi zhvillimit të sistemit të menaxhimt të riskut dhe përmirësimit të kapaciteteve të stafit në të gjitha bashkitë;
- Në kuadër të rritjes së përgjegjshmërisë menaxheriale, edhe pse reflektohet një nivel i kënaqshëm tek mjedisi i kontrollit, nevojitet përdorim i shtuar i instrumentit të delegimit të detyrave dhe përgjegjësive për tu bërë pjesë e praktikave të brendshme operacionale të njësisë publike;
- Në lidhje me procesin e menaxhimit të riskut, nga vlerësimi rezultojnë mangësi kryesisht në elementët që lidhen me riskun e mashtrimit duke mos marrë në konsideratë format e ndryshme të mashtrimeve si: falsifikimi i dokumentave, raportimi i informacionit të pasaktë për gjendjen financiare apo performanca në përmbushjen e objektivave të përcaktuar;

[3] 399 punonjës u trajnuan specifikisht për vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm (97 punonjës), për konceptet e KBFP-së (46 punonjës), për përgjegjshmërinë menaxheriale (66 punonjës), për menaxhimin e riskut (190 punonjës, nga të cilët 15 punonjës të njësive publike, u certifikuan mbi menaxhimin e riskut).

- Nga analiza e kryer rezulton se institucionet zbatojnë pjesërisht procedurat monitoruese, vlerësuese e raportuese për sistemin e kontrollit të brendshëm. Në pjesën më të madhe të institucioneve, pyetësori i vetëvlerësimit është instrumenti kryesor për kryerjen e kontrollit nga ana e menaxherëve, ndërkohë që mangësi evidentohen edhe në mekanizma të tjerë monitorues të tillë si shërbimi i auditimit të brendshëm të nevojshëm për vlerësimin e sistemit, dhënien e këshillave apo promovimin e praktikave të mira nëpërmjet dhënies së rekomandimeve.
- Procesi i parashikimit dhe ndërmarrjes së veprimeve korrigjuese i cili ndihmon në procesin e monitorimit të sistemit është finalizuar me hartimin e dokumentit të planit të veprimit për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku 111 nga 185[4] njësi publike kanë paraqitur këtë dokument në formën e saktë, pranë strukturës përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Nga analiza e detajuar e 17 parimeve të kontrollit të brendshëm konstatojmë se, sistemi i kontrollit të brendshëm për vitin 2023 paraqitet *pjesërisht efektiv*. Ky vlerësim vjen si rezultat i moskonkludimit të procesit të lidhjes së objektivave strategjikë dhe operacionale, si dhe detajimit të objektivave në plane konkrete veprimi duke përcaktuar linjat e qarta të përgjegjshmërisë për përmbushjen dhe raportimin e standardizuar të tyre nga të gjithë menaxherët. Ndërkohë, janë marrë masa në zhvillimin e proceseve që lidhen me mjedisin e kontrollit, aktiviteteve të kontrollit dhe menaxhimin e riskut.

Zhvillimet i këtye proceseve përcjellin impaktin e tyre në planifikimin dhe dokumentimin e risqeve për të realizuar në tërësi një proces të strukturuar të menaxhimit të riskut. Ndërkohë, kufizimet në zbatimin e mekanizmave monitorues dhe vlerësues të sistemit të kontrollit të brendshëm ndikojnë në cilësinë e raportimit të informacionit duke sjellë vështirësi në trajtimin e problematikave dhe propozimin e masave korrigjuese.

Progresi i mëtejshëm në zhvillimin e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm në vijim edhe të takimit bilateral për Kapitullin 32, i cili u vlerësua me nota pozitive, u fokusua më tej në bazë edhe të rekomandimeve në këtë kuadër, në rishikimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira, si dhe rritjen e përgjegjshmërisë menaxheriale në funksion të zbatimit të instrumentave të kontrollit të brendshëm dhe në zhvillimin e sistemit të menaxhimit të riskut, të cilat përbëjnë parimet themelore për të vijuar angazhimin e qeverisë për aderimin në Bashkimin Evropian.

Mbështetur në sa më sipër, rekomandimet kryesore lidhur me zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm, paraqiten si më poshtë:

- Ndërgjegjësimi i nivelit të lartë drejtues për ngritjen dhe zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm përmes udhëzimeve dhe metodologjive të përmirësuara nga Ministria përgjegjëse për financat dhe përfshirjes së burimeve të përshtatshme njerëzore;
- Përmirësimi i mëtejshëm i procesit të menaxhimit të riskut nëpërmjet dokumentimit në mënyrën e duhur të risqeve përfshirë dhe riskun e mashtrimit, hartimit të planeve të menaxhimit dhe të trajtimit të risqeve në kuadër edhe të rishikimit të akteve nënligjore të fushës dhe raportimin e tyre në kohë sipas përgjegjshmërisë dhe linjave të

[4] Këtu përfshihen Sh.A. Nga 198 në total, nuk përfshihen 13 njësitë me buxhet të madh të cilat sjellin vetëm pyetësorin e vetëvlerësimit.

raportimit me qëllim sigurimin e informacionit relevant për risqet strategjike të njësisë publike;

- Përmirësimi i mëtejshëm i procesit të monitorimit dhe vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe parashikimi i masave konkrete për adresimin e mangësive nëpërmjet hartimit të një sistemi procedurash, të përfshirë në bazën rregullative të institucionit me qëllim sigurimin e mbikëqyrjes së performancës nga menaxherët/drejtuesit;
- Asistenca e vazhdueshme për zbatimin e elementëve të përgjegjshmërisë menaxheriale (përcaktimi i objektivave, ndarja e përgjegjësive, procedurat e delegimit), përmirësimit të procedurave të vlerësimit dhe monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit për të gjitha njësitë publike;
- Zbatimi me përparësi i planit të veprimit 2023-2026 në kuadër të strategjisë së re të menaxhimit të financave publike 2023-2030;
- Përmirësimi i cilësisë së informacionit financiar dhe jo financiar nëpërmjet integrimit të mëtejshëm të sistemeve të teknologjisë së informacionit;
- Fokusimi tek shoqëritë tregtare të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme, për aftësimin e tyre në mënyrën e raportimit dhe zhvillimit të sistemit të MFK-së;
- Realizimi i trajnimeve të vazhdueshme mbi zbatimin e kërkesave ligjore të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe forcimi i mëtejshëm i objektivitetit dhe cilësisë gjatë procesit të vetëvlerësimit.

Raporti Vjetor i Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm në Sektorin publik ofron një pamje të përgjithshme të performancës së shërbimit të auditimit të brendshëm në sektorin publik gjatë vitit 2023. Drejtoria e Harmonizimit të AB harton këtë Raport si një përmbledhje e konsoliduar e raporteve vjetore te njësive të auditimit të brendshëm, të cilat janë janë instrumenti kryesor i llogaridhënies e menaxhimit brenda njësive të qeverisjes dhe entiteteve të tjera të sektorit publik dhe përbëjnë bazën mbi të cilën ekzekutivi merr përgjegjësinë për vendimarrjet si dhe për funksionet koordinuese, ekzekutive dhe drejtuese që ushtron, siç përcaktohet në kuadrin ligjor dhe autoritetin përkatës.

Qëllimi i Raportit Vjetor të Auditimit të Brendshëm është të ofrojë informacion mbi shërbimet e sigurisë dhe të këshillimit si dhe aktivitetet e tjera të funksionit të auditimit të brendshëm në njësitë e sektorit publik

Raporti Vjetor është mbështetur në analizën dhe shqyrtimin e të dhënave të raporteve vjetore të veprimtarisë së ***128 njësive të auditimit të brendshëm*** që janë funksionale në sektorin publik[5], nga 136 te krijuara. Treguesit e raportuar japin informacion mbi strukturat audituese dhe kapacitetet e tyre, realizimin e planit të angazhimeve, vlerësimin e risqeve, sistemet dhe fushat ku gjetjet e auditimit kanë treguar të kenë dobësi materiale, rekomandimet e dhëna nga auditimi lidhur me to, nivelin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit, si dhe kufizimet me të cilat janë përballur audituesit e prioritetet për të ardhmen.

Analiza e veprimtarisë dhe funksionimit të auditimit të brendshëm tregon se përpjekjet për të siguruar një shërbim të auditimit plotësisht në përputhje me kërkesat e standarteve dhe praktikave profesionale të fushës kanë çuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm dhe drejt forcimit e konsolidimit të rolit të auditimit të brendshëm në mbështetje e ndihmë të menaxhimit, si një qasje sistematike dhe e disiplinuar që synon t'i sjellë vlerë të shtuar njësisë publike.

[5] 8 NJAB janë miratuar në strukturat e njësive publike por nuk janë kompletuar me stafin e nevojshëm.

Zhvillimi i veprimtarisë audituese vijon të shoqërohet me sfida dhe problematika të cilat janë ende prezent në çështje thelbësore dhe tepër të rëndësishme në realizimin e shërbimit të auditimit në pajtueshmëri të plotë me standardet dhe parimet profesionale të fushës së auditimit, qoftë në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel individual institucional, dhe kjo kërkon vëmendje të vendimarrësve dhe politikëbërësve, ndërgjegjësim dhe mbështetje për një auditim të pavarur nga pikëpamja funksionale dhe organizative.

Zhvillimi dhe funksionimi i auditimit të brendshëm gjatë vitit 2023, në njësitë publike përfshin arritje dhe tregues të performancës si vijon:

- Shërbimi i auditimit të brendshëm sigurohet nëpërmjet 136 njësive të auditimit të krijuara si struktura të përhershme dhe/apo në një nga format e përcaktuara në Ligjin nr. 114/2015 " Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", nga të cilat:
  - 11 Ministri të linjës dhe 1 NJAB në Kryeministri (*kjo e fundit mbulon me auditim agjencitë dhe institucionet qëndrore të përfshira në Grupin 87*)
  - 19 Institucione qendore/agjenci dhe/apo Drejtori të Përgjithshme;
  - 3 Fonde Speciale;
  - 9 Institucione të pavarura;
  - 50 Njësi të vetëqeverisjes vendore/Bashki dhe 1 në nivel Drejtori e përgjithshme;
  - 27 Shoqëri aksionere publike;
  - 7 universitete;
  - 8 Qëndra spitalore.
- Ndërmjet institucioneve publike janë lidhur 5 marrëveshje ndërinstitucionale për sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm.

- Raporti Vjetor i AB është bazuar në 128 struktura të auditimit të brendshëm të cilat janë operacionale të cilat realizojnë veprimtarinë audituese në mënyrë të planifikuar, mbështetur në Planin Strategjik dhe Vjetor, ku pasqyrohen objektivat e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, masat që parashikohen të ndërmerren për arritjen e këtyre objektivave si dhe burimet e kërkuara për të arritur këto objektiva.
- Plani i auditimeve për vitin 2023 u realizuar në ***91,4% të Planit Vjetor të Angazhimeve***, nga 1062 angazhime auditime të planifikuara, 971 auditime mundën të mbylleshin plotësisht.
- Në kryerjen e 971 **angazhimeve të auditimit** u identifikuan **8722** ***gjetje*** të shkeljeve të procedurave, devijimeve dhe dobësive në sistemet e administrimit të pronës publike, prokurimit publik, pagesave, shpërblimeve, menaxhimit të aseteve, sistemi i tatim taksave, si dhe sisteme të tjera sipas fushës së përgjegjësisë së njësive publike, etj.;
- Për gjetjet e identifikuara, auditimi i brendshëm ka ***dhënë 7385 rekomandime*** për përmirësim sistemi, ndryshime të kuadrit rregullator dhe masa organizative dhe të qeverisjes;
- Niveli i pranimit të rekomandimeve nga subjektet e audituara vijon të mbahet i lartë në masën **99,8%,** (vetëm 15 *rekomandime nuk janë pranuar*).
- ***Nga 7370 rekomandime të pranuara*, 3911 *rekomandime janë zbatuar plotësisht*** dhe ***2913 rekomandime janë në proces zbatimi***. Kjo përfaqëson një nivel 53.1% të rekomandimeve të zbatuara brenda periudhës raportuese duke ruajtur një trend rritës në përputhje me objektivat në kuadër të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2019 – 2022.

- ***Rekomandimet e dhëna dhe në proces zbatimi nga auditimet e një viti më parë (të vitit 2022), kanë vijuar të zbatohen gjatë vitit 2023 duke arritur në 61.5% të rekomandimeve të dhëna dhe zbatuara gjatë dy viteve;***
- Një pjesë e gjetjeve të auditimit janë konstatuar të kenë shkaktuar efekt financiar negativ në masën ***473.2 milionë lekë***. Struktura e efektit financiar negativ të shkaktuar identifikon peshën specifike më të madhe, në rreth 38.5%, të specifikuar tek zëri *të tjera sipas fushave të përgjegjësisë* së njësisë publike, po ashtu në sistemin e tatim-taksave dhe doganave rreth 23.1%, në sistemin administrim prone dhe pasurie rreth 11.5% dhe në sistemin e prokurimeve me 11%,
- Ka një tendencë në rritje të rasteve të identifikuara për dyshim të parregullsive dhe keqmanaxhimit /keqadministrimit financiar nga strukturat e auditimit të brendshëm. Gjatë vitit 2023, në total janë raportuar në 8 ***njësi shpenzuese për raste të dyshuara të parregullsive dhe shkeljeve te rënda***, të cilat në gjykimin profesional të audituesve janë dërguar për investigim të mëtejshëm tek Titullari përkatës për ndjekje nga Drejtoria e Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe në institucione të tjera: 1 rast Ministria e Brendshme, 1 rast Ministria e Kulturës, 1 rast Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, 1 rast Ujësjellës Kanalizime Tiranë dhe 4 raste Bashkia Shkodër.
- Gjetjet në sistemin e kontrollit të brendshëm, menaxhimit financiar dhe menaxhimit të riskut janë identifikuar kryesisht në:
    - *Rregullore të brendshme jo adekuate*, të papërditësuara;
    - *Mungesa e Regjistrit të riskut,* si dhe në disa raste mos përditësimi dhe mungesa e rishikimit periodik të risqeve;
    - *Mungesë e kapaciteteve administrative dhe profesionale* të njësive publike për të ndërtuar, mbajtur dhe përditësuar elementët e nevojshëm të kornizës së kontrollit të brendshëm (COSO);
    - *Procedura jo efektive dhe mungesë të manualeve të punës*;
    - *Mosekzistenca e Gjurmës së Auditimit* të miratuar për proceset kryesore;
    - *Mungesë të përcaktimit dhe përshkrimit* të saktë të detyrave dhe përgjegjësive, mosekzistencë të ndarjes të qartë të detyrave ndërmjet funksioneve të ndryshme;
    - *Sistem raportimi jo koherent dhe i përshtatshëm, monitorimi dhe mbikqyrje e pamjaftueshme.*

- Dobësi të konsiderueshme janë identifikuar në regjistrimin dhe administrimin ethe aseteve të njësive publike ka treguar të ketë mangësi materiale lidhur me: plotësinë, ekzistencën, përkatësinë, si dhe pasaktësi në hartimin e regjistrit të aseteve, ç'ka përbën një faktor risku potencial në mirëadministrimin e pronës publike;
- Gjithashtu, mosmarrja e masave të nevojshme parandaluese në mënyrë të veçantë në planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit të shtetit, ka ndikuar në krijimin e detyrimeve të reja;
- Sigurimi i cilësisë në auditim, krahas krijimit të Programit të Kontrollit të Cilësise dhe përmirësimit, mbulohet në një masë të gjerë nga vlerësimet e jashtme të cilësisë të cilat kryhen nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në të gjithë strukturat e auditimit të brendshëm publik. Gjatë vitit 2023, u realizuan 19 ***vlerësime të jashtme të cilësisë*** për veprimtarinë e Njësive të Auditimit të Brendshëm, kryesisht në njësi të vetëqeverisjes vendore (13 Bashki), agjenci dhe qendra shërbimi publik të nivelit të dytë të qeverisje qendrore (3 njësi të auditimit të brendshëm), shoqëritë publike (2 shoqëri aksionere) dhe institucion i pavarur (1 njësi të auditimit të

brendshëm), të cilat janë identifikuar nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm të raportimit dhe planifikimit si subjekte në risk të lartë.

- Deri në fund të vitit 2023, Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm Në Ministrinë e Financave ka realizuar 117 vlerësime të njësive të auditimit të brendshëm në një frekuencë të paktën një herë në 5 vite, duke mbuluar rreth 86% të sistemit. Opinionet e dhëna kanë vlerësuar për nivelin e përputhshmërisë së punës audituese me kërkesat e kuadrit ligjor dhe standarteve te auditimit.
- Për vitin 2023, janë dhënë Opinione të Vlerësimeve të cilat përfshijnë:

    - 21% opinion pozitiv: Veprimtaria AB përgjithësisht në përputhje me kërkesat e SNA
    - 26% opinion negativ: Veprimtaria AB përgjithësisht në MOS përputhje e plotë me kërkesat e SNA;
    - 37 % opinion thuajse negativ: Veprimtaria AB në pjesën më të madhe është në MOS përputhje e pjesshme me kërkesat e SNA, përmirësime të rëndësishme janë të nevojshme;
    - 16% opinion pjesërisht pozitiv: Veprimtaria AB në disa fusha është në Mospërputhje me kërkesat e SNA

- Opinionet e dhëna nga vlerësimet tregojnë dobësi të strukturave audituese në nivel të qeverisjes lokale dhe qendrat spitalore lidhur me përmbushjen e kritereve të përcaktuara në Ligjin për auditimin e brendshëm, si në krijimin e njësive të auditimit të brendshëm dhe/apo forma e sigurimit të shërbimit të auditimit, në rekrutimin e audituesve të brendshëm po ashtu dhe zbatimin e standardeve të punës audituese;
- Në strukturat e auditimit, janë të punësuar 441 audites kundrejt 505 të nevojshëm, pra evidentohen ***64 vende vakante***. Gjatë vitit janë punësuar audites të rinj, por për shkak të largimeve, kryesisht për shkaqe natyrale pozicionet vakante mbeten në të njëjtat tendenca;
- Struktura profesionale e audituesve të brendshëm konsiston në: 348 ekonomistë, 69 juristë dhe 24 me profesione të tjera specifike sipas sektorëve të ekonomisë. Kriteri i eksperiencës përmbushet nga 246 audites të brendshëm që kanë vjetërsi pune mbi 5 vjet dhe 195 kanë vjetërsi në auditim deri në 5 vjet;
- Nëpërmjet Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm Profesional për vitin 2023, janë trajnuar 317 audites të brendshëm të certifikuar në 20 tema, të cilat mbuluan: qasjen e auditimit mbi bazë risku, adresimin e rasteve të korrupsionit dhe mashtrimit financiar, sistemin buxhetor, prokurimet publike dhe auditimin e detyrimeve të prapambetura, planifikimin, raportimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit;
- Në Korrik të vitit 2023 përfundoi procesi i certifikimit për sezonin 2022-2023.
- 80 audites të brendshëm në sektorin publik, pas ndjekjes së trajnimeve dhe testimit të suksesshëm të provimeve u pajisën me dëshminë profesionale si "Auditues të Brendshëm në Sektorin publik", dhe tashmë rreth 81% të audituesve të brendshëm publike janë të certifikuar si një kusht thelbësor për ndërtimin dhe zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve audituese;
- Si element i rëndësishëm për mirëqeverisjen në 6 njësi publike janë krijuar dhe funksionojne Komitetet e Auditimit të Brendshëm të cilët kanë raportuar tek titullari përkatës dhe kanë adresuar rekomandime në drejtim të veprimtarisë së auditimit të brendshëm.

Auditimi i brendshëm luan një rol të rëndësishëm në mirëqeverisjen e shëndetshme, dhe për këtë arsye nuk kërkohet vetëm kryerja e shërbimeve të sigurisë të ofruara nëpërmjet

auditimeve të përputhshmërisë dhe auditimeve financiare, por edhe të shërbejë si partner strategjik dhe të shtojë vlerë në veprimtarinë e njësisë publike drejt përmirësimit të proceseve organizative dhe sigurimit të eficences dhe efikasitetit të tyre.
Sfida kryesore e auditimit të brendshëm është mbështetja dhe vlerësimi i punës audituese.

Në këtë këndvështrim, prioritetet për të ardhmen në fushën e auditimit të brendshëm do të përfshijnë:

- Standartet Globale të Auditimit të Brendshëm , të shpallura në 9 Janar 2024 nga IIA, të cilat hyjnë në fuqi në Janar 2025 kërkojnë përgatitjen e kushteve të përshtatshme për audituesit në mënyrë që të sigurohet që puna audituese të mbështetet plotësisht në zbatimin e kërkesave të këtyre standarteve. Kjo kërkon hartimin e një axhende specifike gjithëpërfshirëse si në rishikimin e kuadrit metodologjik dhe procedural që udhëheq auditimin e brendshëm në nivel kombëtar, ashtu dhe trajnimin dhe përgatitjen e kapaciteteve audituese me njohuritë e reja që ofron kuadri i prezantuar së fundmi;
- "Të menduarit në mënyrë strategjike" të audituesve të brendshëm duhet të udhëheqë planifikimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm dhe kjo kërkon aplikimin e qasjeve audituese më të përshtatshme dhe që i përgjigjen nevojave të përdoruesve të punës të auditimit të brendshëm.
- Rritja e numrit të auditimeve të performancës mbështetur në shqyrtim dhe vlerësim të plotë të 3 E: ekonomicitetit, efektivitetit dhe eficencës së njësisë publike.
- Gjithnjë e më shumë puna dhe veprimtaria e njësive publike po realizohen në një ambjent thuajse plotësisht të digjitalizuar dhe kjo ka rritur më shumë nevojën për auditime të sistemeve të teknologjisë së informacionit për të ofruar siguri mbi efektivitetin dhe sigurinë e përpunimit të të dhënave nga sistemet e menaxhimit të informacionit.
- Rritja e efektivitetit të auditimeve nëpërmjet qasjes mbi bazë risku e cila drejton që auditimet të orientohen në vlerësimin e risqeve më të rëndësishme për planifikimin dhe zbatimin e projekteve dhe programeve për arritjen e objektivave strategjikë të njësive publike, duke mundësuar kryerjen me efektivitet dhe eficencë të auditimit;
- Auditimet për vlerësimin e sisteveve të qeverisjes dhe administrimit që përfshijnë vlerësimin e proceseve të vendimmarrjes, vendimeve strategjike dhe operacionale, mbikqyrjen e menaxhimit të riskut, promovimin e etikës dhe vlerave të përshtatshme brenda organizatës, sigurimin e menaxhimit efektiv organizativ të performancës dhe llogaridhënies;
- Auditimi i fushave të rëndësisë së vecantë si dhe sistemeve me risk të lartë të identifikuara në sistemin e menaxhimit buxhetor kërkon aftësi dhe njohuri të thella në analizën dhe vlerësimin e riskut si dhe analizë të hollësishme në rrënjë.
- Krijimi i një rrjeti efektiv të komunikimit ndërmjet njësive publike dhe monitorimi i vazhdueshëm për tu siguruar që shërbimi i auditimit të brendshëm të realizohet në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor, sipas Standardeve Ndërkombëtare të pranuara dhe praktikave të mira profesionale;
- Krijimi i një sistemi të konsoliduar të kontrollit dhe sigurisë së cilësisë së auditimit të brendshëm përfshirë Programin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimet e Jashtme, si një mjet i rëndësishëm në identifikimin e mangësive dhe ndërmarrjen e iniciativave dhe veprimeve për ndryshim pozitiv dhe fuqizim të sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik;

- Zhvillimi i një kuadri ligjor dhe metodologjik adekuat, udhëheqës për auditimin e brendshëm, i mbështetur në një analizë të thellë të realizimit të veprimtarisë audituese duke siguruar përputhshmërinë me *acquis communaitaire*, kërkesat e standardeve dhe rekomandimeve të Komisionit Evropian;
- Forcimi dhe zhvillimi profesional i audituesve të brendshëm nëpërmjet programeve efektive te trajnimit dhe certifikimit, ku të ndërthuren përgjigjet efektive të nevojave individuale dhe institucionale për ndërtimin dhe rritjen e kapaciteteve audituese;
- Programi i Zhvillimit Profesional të ofrojë siguri të arsyeshme që audituesit e brendshëm janë të kualifikuar për të ushtruar funksionin e audituesit me nivel të lartë të aftësive dhe kompetencave profesionale.
- Bashkëpunimi me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare për të sjellë në sistemin e auditimit të brendshëm eksperiencat më të mira dhe praktikat bashkëkohore të profesionit, të vendeve më të zhvilluara anëtare të Bashkimit Evropian;
- Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, duke ndarë mundësi dhe eksperienca të përbashkëta në fushën e zhvillimit profesional, metodologjive dhe qasjeve të auditimit bazuar në marrëdhënie të ndërsjellta bashkëveprimi sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit Ndërinstitucional dhe nën drejtimin e Sekretariatit Teknik të Përbashkët.
- Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm të koordinojë e sigurojë bashkëpunim dhe komunikim me të gjithë këto institucione duke ofruar një qasje të unifikuar auditimi për të gjitha njësitë e auditimit të brendshëm dhe auditimin e jashtëm.

KAPITULLI I. VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË NJËSIVE PUBLIKE RAPORTUESE

Vlerësimi i performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme përcakton stadin aktual të zhvillimit të veprimtarisë së institucioneve duke identifikuar dhe evidentuar progresin e arritur dhe mangësitë në funksionimin e këtij sistemi. Ky proces, i nevojshëm për garantimin e eficiencës dhe cilësisë së elementëve të kontrollit të brendshëm, përbën një nga elementët kryesorë të monitorimit dhe një nga kërkesat kryesore që vendi ynë duhet të ndjekë gjatë procesit të integrimit në Bashkimin Evropian (BE).

Gjatë vitit 2023, Drejtoria e Përgjithshme e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Raportimit Financiar (DPKBFP/RF) në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit u angazhuan në kryerjen e analizave për gjenerimin e të dhënave për 18 (tetëmbëdhjetë) tregues performance mbi planifikimin, zbatimin dhe ekzekutimin e buxhetit, si dhe mbi treguesit për implementimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm. Treguesit e performancës dhe mënyra e vlerësimit të tyre është përcaktuar në Metododologjinë për Monitorimin e Performancës së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë Publike, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 221, datë 01.12.2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin nr.117, datë 01.04.2019 "Për miratimin e metodologjisë për monitorimin e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive publike". Konkretisht, treguesit e performancës klasifikohen si më poshtë vijon:

Tabela 1. Treguesit e Performancës dhe burimet e të dhënave sipas drejtorive përgjegjëse në Ministrinë e Financave

Drejtoria e Pergjithshme e Buxhetit	Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit	Drejtoria e Harmonizimit të MFKK	Drejtoria e Harmonizimit të AB
1. Realizimi i shpenzimeve buxhetore (në %)	1.Të gjitha faturat janë dërguar në kohë për pagesë pranë degës përkatëse të thesarit	1.Hartimi me cilësi i Planit të Veprimit të MFK-së dhe paraqitja brenda afateve kohore të përcaktuara	1.Organizimi i NJAB-ve dhe kapacitetet e AB
2.Realizimi i shpenzimeve buxhetore sipas klasifikimit ekonomik (në %)	2.Faturat e detyrimeve të prapambetura janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit për regjistrimin në SIFQ si shpenzime të periudhave të ardhshme (llogaria ekonomike 486)	2.Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm	2.Cilësia e përgatitjes së planifikimit strategjik dhe vjetor nga NJAB-të
3. Reduktimi i nivelit të detyrimeve të prapambetura	3.Të gjitha kontratat janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit	3.Efektiviteti i mekanizmave bazë të përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë e sektorit publik	3.Cilësia e përgatitjes së Raportit vjetor të NJAB-ve
4.Realizimi i shpenzimeve kapitale	4.Numri i urdhër prokurimeve të paautorizuara		4.Zbatimi i rekomandimeve të AB-së
5. Investimet kapitale shumëvjeçare janë hedhur në sistem sipas planit kontraktual të disbursimit	5.Kufizimi i avancimit të planit mujor të arkës		
	6.Paraqitja, nënshkrimi dhe respektimi i afatit kohor të dorëzimit të pasqyrave financiare sipas kuadrit ligjor në fuqi		

Edhe për vitin 2023, duke marrë në konsideratë natyrën e veprimtarisë së institucioneve, kompleksitetin e proceseve të punës si dhe nivelin e angazhimit të njësive të qeverisjes së përgjithshme (NJQP) të marra në analizë, evidentohen disa mungesa në të dhënat e treguesve të performancës apo tregues të cilët nuk aplikohen në disa prej tyre, të referuar përgjatë analizës së performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi, si dhe janë paraqitur të detajuara në Shtojcën 1 bashkëlidhur këtij raporti. Metodologjia e performancës është në fazë rishikimi, në kuadër të përmirësimit të mëtejshëm të indikatorëve për paraqitjen e informacionit lidhur me vlerësimin, sa më të plotë.

Bazuar në vlerësimet e treguesve të mësipërm nga drejtoritë përkatëse, është realizuar rankimi i institucioneve të pavarura dhe grupit 87, i ministrive të linjës, bashkive dhe njësive shpenzuese me buxhet të madh për vitin 2023.

✓ *Rankimi i institucioneve të pavarura dhe Grupit 87 në varësi të Kryeministrisë*

Tabela 2. Rankimi i Institucioneve të pavarura sipas treguesve të performancës për vitin 2023 dhe krahasimi me vitin 2022

Rankimi për vitin 2023	*Ndryshimi në rankim krahasuar me vitin 2022 (+/-)*	*Institucioni*	*Vlerësimi në pikë për vitin 2023 (nga 72 pikë gjithsej)*
1	(-)	Kryeministria	68
2	⬆ (+3)	Instituti i Statistikave	67
3	⬆ (+8)	Agjensia Telegrafike Shqiptare	64
3	⬇ (-1)	Shkolla e Magjistraturës	64
5	⬆ (+6)	Kontrolli i Lartë i Shtetit	62.5
6	⬆ (+5)	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	59
7	⬆ (+4)	Shërbimi Informativ Shtetëror	58
7	⬇ (-4)	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	58
9	⬆ (+7)	Këshilli i Lartë Gjyqësor	56
9	⬆ (+1)	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile	56
11	⬇ (-5)	Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil	55
12	⬆ (+5)	Gjykata Kushtetuese	53
13	⬇ (-2)	Kuvendi	48.5
13	⬇ (-5)	Prokuroria e Përgjithshme	48.5
15	-	Drejtoria e Përgjithshme e RTSH	47.5
16	⬇ (-12)	Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit	46
17	⬆(+14)	Autoriteti për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet ish-sigurimit	44
18	⬆ (+4)	Kolegji i Posaçëm i Apelimit	43
18	(-)	Komisionerët Publikë	43
18	⬆(+1)	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	43
21	⬆ (+4)	Avokati i Popullit	42
22	⬇(-13)	Zyra e Inspektoriati të Lartë të Drejtësisë	41
23	⬆ (+5)	Këshilli i Lartë i Prokurorisë	40
23	⬇ (-1)	Autoriteti i Konkurrencës	40
23	⬆ (+4)	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	40
26	⬇ (-1)	Akademia e Shkencës	39
26	⬇ (-4)	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	39
28	⬇ (-21)	Komisioni i Prokurimeve Publike	38
29	⬇ (-9)	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	36
30	⬇ (-2)	Byroja Kombëtare e Hetimit	35
31	⬆ (+2)	Presidenca	34
31	⬇ (-1)	Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar	34
31	⬇ (-3)	Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit	34
34	⬇ (-13)	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	33.5

Institucionet, të cilat nuk kanë ngritur njësi të auditimit të brendshëm apo nuk e kanë realizuar shërbimin e auditimit të brendshëm me marrëveshje, janë vlerësuar me 0 pikë. Vlen të theksohet se, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi të fushës, realizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm është i detyrueshëm për të gjitha njësitë publike.

Tabela 3. Rankimi i institucioneve të Grupit 87 në varësi të Kryeministrisë sipas treguesve të performancës për vitin 2023 dhe krahasimi me vitin 2022.

Rankimi për vitin 2023	***Ndryshimi në rankim krahasuar me vitin 2022 (+/-)***	***Institucioni***	***Vlerësimi në pikë për vitin 2023 (nga 72 pikë gjithsej)***
1	⬆ (+4)	Avokatura e Shtetit	64
2	⬆ (+5)	Drejtoria e Informacionit të Klasifikuar	63
3	⬇ (-2)	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor	62
4	⬆ (+12)	Agjencia e Prokurimit Publik	59
4	⬆ (+15)	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike	59
4	(-)	Agjencia e Zhvillimit të Territorit	59
7	⬇ (-6)	Komiteti Shtetëror i Kulteve	57
8	⬇ (-1)	Inspektoriati Qendror	53
8	⬇ (-2)	Agjencia për Hapje, Dialog dhe Bashkëqeverisje	53
10	⬆ (+2)	Komiteti për Pakicat Kombëtare	52
10	⬇ (-3)	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	52
12	⬇ (-2)	Departamenti i Administratës Publike	48
12	⬆ (+6)	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës	48
14	⬇ (-11)	Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare	47.5
15	⬇ (-4)	Autoriteti Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike	47
16	⬆ (+1)	Agjencia Kombëtare e Shoqërise së Informacionit	44
17	⬆ (+5)	Agjencia Autonome e Auditimit të Fondeve të BE	41
17	⬇ (-3)	Agjencia për Media dhe Informim	41
19	(-)	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit	40
20	⬇ (-7)	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore	38
21	⬇ (-2)	Agjencia Kombëtare e Rinisë	32
22	⬇ (-8)	Sekretariati Teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar	20

✓ *Rankimi i Ministrive të Linjës*

Tabela 4. Rankimi i Ministrive të Linjës sipas treguesve të performancës për vitin 2023 dhe krahasimi me vitin 2022.

Rankimi për vitin 2023	***Ndryshimi në rankim krahasuar me vitin 2022(+/-)***	***Institucioni***	***Vlerësimi në pikë për vitin 2023 (nga 72 pikë gjithsej)***
1	⬆ (+1)	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	62
2	⬇ (-1)	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	59
3	⬆ (+3)	Ministria e Brendshme	58

4	(-)	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	57
5	⬇ (-2)	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	56
5	⬇ (-1)	Ministria e Arsimit dhe Sportit	56
7	⬆ (+1)	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	55
8	⬆ (+1)	Ministria e Drejtësisë	51
9	⬆ (+1)	Ministria e Kulturës	50.5
10	⬆ (+1)	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	49.5
11	⬇ (-4)	Ministria e Mbrojtjes	48

✓ *Rankimi i bashkive qendër qarku*

Tabela 5. Rankimi i Bashkive qendër qarku, sipas treguesve të performancës për vitin 2023 dhe krahasimi me vitin 2022.

Rankimi për vitin 2023	*Ndryshimi në rankim krahasuar me vitin 2022 (+/-)*	*Institucioni*	*Vlerësimi në pikë për vitin 2023 (68[6] nga 72 pikë gjithsej)*
1	⬆ (+4)	Bashkia Tiranë	50
2	⬇ (-1)	Bashkia Korçë	47
3	⬇ (-1)	Bashkia Gjirokastër	45.5
3	⬆ (+1)	Bashkia Shkodër	45.5
5	⬆ (+4)	Bashkia Fier	43.5
6	⬆ (+2)	Bashkia Lezhë	38
7	⬆ (+4)	Bashkia Elbasan	37.5
8	⬆ (+2)	Bashkia Kukës	37
9	⬇ (-6)	Bashkia Durrës	35.5
10	⬇ (-5)	Bashkia Vlorë	34
11	⬇ (-4)	Bashkia Berat	33
12	(-)	Bashkia Dibër	30

Tabela 6. Rankimi i Bashkive të tjera sipas treguesve të performancës për vitin 2023 dhe krahasimi me vitin 2022.

Rankimi për vitin 2023	*Ndryshimi në rankim krahasuar me vitin 2022 (+/-)*	*Institucioni*	*Vlerësimi në pikë për vitin 2023 (68 nga 72 pikë gjithsej)*
1	⬆ (+5)	Bashkia Kamëz	54
2	⬆ (+3)	Bashkia Dropull	48
3	(-)	Bashkia Devoll	47
3	⬇ (-1)	Bashkia Lushnjë	47
5	⬆ (+43)	Bashkia Pustec	46
6	⬇ (-2)	Bashkia Mirditë	44.5
7	⬆ (+14)	Bashkia Kuçovë	43.5
8	⬆ (+24)	Bashkia Bulqizë	43
8	⬆ (+24)	Bashkia Librazhd	43

[6] Treguesi i performancës "Investimet kapitale shumëvjeçare janë hedhur në sistem sipas planit kontraktual të disbursimit" nuk është vlerësuar për shkak të mungesës së të dhënave për këtë grup institucionesh

10	(-)	Bashkia Patos	41.5
10	(-3)	Bashkia Maliq	41.5
12	(+14)	Bashkia Libohovë	41
12	(+11)	Bashkia Pogradec	41
12	(+30)	Bashkia Sarandë	41
12	(-)	Bashkia Tepelenë	41
12	(+10)	Bashkia Prrenjas	41
17	(+7)	Bashkia Fushë-Arrëz	40.5
18	(+14)	Bashkia Malësi e Madhe	39
18	(+1)	Bashkia Selenicë	39
20	(-3)	Bashkia Gramsh	38.5
21	(-7)	Bashkia Skrapar	38
21	(-7)	Bashkia Finiq	38
23	(+3)	Bashkia Roskovec	37.5
24	(-23)	Bashkia Kolonjë	37
24	(+7)	Bashkia Memaliaj	37
24	(-12)	Bashkia Dimal	37
27	(-19)	Bashkia Klos	36.5
28	(-4)	Bashkia Cërrik	36
29	(+1)	Bashkia Shijak	35.5
29	(+6)	Bashkia Kurbin	35.5
29	(-19)	Bashkia Divjakë	35.5
32	(-12)	Bashkia Mat	35
32	(+5)	Bashkia Peqin	35
34	(-18)	Bashkia Krujë	34.5
35	(-6)	Bashkia Has	33
35	(-18)	Bashkia Vorë	33
37	(+8)	Bashkia Kavajë	32
37	(-2)	Bashkia Himarë	32
39	(-2)	Bashkia Mallakastër	31
39	(+7)	Bashkia Pukë	31
39	(-)	Bashkia Poliçan	31
42	(-3)	Bashkia Përmet	30
43	(-1)	Bashkia Rrogozhinë	28
44	(-)	Bashkia Delvinë	26
45	(-36)	Bashkia Vau Dejës	24.5
46	(-7)	Bashkia Tropojë	24
46	(+1)	Bashkia Belsh	24
46	(-20)	Bashkia Këlcyrë	24
49	(-)	Bashkia Konispol	20

Tabela 7. Rankimi i Këshillave të Qarkut sipas treguesve të performancës për vitin 2023 dhe krahasimi me vitin 2022

Rankimi për vitin 2023	*Ndryshimi në rankim krahasuar me vitin 2022 (+/)*		*Institucioni*	*Vlerësimi në pikë për vitin 2023 (68[7] nga 72 pikë gjithsej)*
1	↑	(+3)	Qarku Shkodër	41
2	↓	(-1)	Qarku Kukës	37
3	↑	(+3)	Qarku Berat	35
3	↑	(+5)	Qarku Durrës	35
5	↓	(-1)	Qarku Elbasan	34
5	↑	(+7)	Qarku Fier	34
7	↓	(-4)	Qarku Korçë	33
7	↓	(-1)	Qarku Tiranë	33
9	↓	(-7)	Qarku Gjirokastër	30
10	↓	(-1)	Qarku Vlorë	27
11	↓	(-2)	Qarku Dibër	26
12	↓	(-3)	Qarku Lezhë	22

✓ *Rankimi i njësive shpenzuese me buxhet të madh*

Njësitë shpenzuese me buxhet të madh mbeten në fokus të vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe monitorimit të performancës së veprimtarisë së tyre edhe përgjatë vitit 2023. Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit (DH/MFKK), me qëllim sigurimin e një pamje më të qartë të funksionimit dhe progresit të këtij sistemi për vitin 2023, ka vijuar procesin e vlerësimit të treguesve të performancës për 13 njësi shpenzuese me buxhet të madh duke mundësuar krahasimin në përformancë përgjatë dy viteve.

Analiza e detajuar e treguesve të performancës për këto institucione paraqitet në Aneksin nr.I të këtij raporti.

Tabela 8. Rankimi i njësive shpenzuese me buxhet të madh sipas treguesve të performancës për vitin 2023 dhe krahasimi me vitin 2022.

Rankimi për vitin 2023	*Ndryshimi në rankim krahasuar me vitin 2022 (+/-)*		*Institucioni*	*Vlerësimi në pikë për vitin 2023 (nga 72 pikë gjithsej)*
1	↑	(+8)	Agjencia e Trajtimit te Pronave	59
2	↓	(-1)	Garda e Republikës Tiranë	58
3	↑	(+4)	Autoriteti Rrugor Shqiptar	57
4		(-)	Agjencia per Zhvillimin Bujqësor dhe Rural	56
4	↓	(-2)	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	56
6	↑	(+5)	Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	55.5
6	↓	(-2)	Spitali Universitar i Traumës	55.5
8	↑	(+3)	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	55

[7] Treguesi i performancës "Investimet kapitale shumëvjeçare janë hedhur në sistem sipas planit kontraktual të disbursimit" nuk është vlerësuar për shkak të mungesës së të dhënave për këtë grup institucionesh

9	↑	(+1)	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	54.5
10	↓	(-7)	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	53
10	↑	(+3)	Agjensia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime	53
10	↓	(-4)	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	53
13	↓	(-5)	Qendra spitalore universitare "Nënë Tereza"	51

Një analizë e detajuar për treguesit kryesorë të performancës për njësitë e qeverisjes së përgjithshme[8] paraqitet si vijon:

1.1 Analiza për treguesit e performancës për NJQP-të[9]:

Treguesit e Buxhetit

1. Treguesi **"Realizimi i shpenzimeve buxhetore"** përcakton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet buxhetore gjatë vitit kundrejt planit të buxhetit të miratuar nga Kuvendi. Për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar mesatarisht në nivelin 2.42 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 60.5%), duke reflektuar një performancë mesatare në rritje për njësitë e marra në analizë. Në përgjithësi performancë më të mirë kundrejt këtij indikatori kanë ministritë e linjës dhe institucionet e pavarura.
2. Treguesi **"Realizimi i shpenzimeve buxhetore sipas klasifikimit ekonomik"**, mat diferencën midis buxhetit të miratuar dhe buxhetit faktik në fund të vitit për çdo grup të shpenzimeve buxhetore të ndara sipas klasifikimit ekonomik. Nga vlerësimi i kryer për këtë tregues, rezultati është 1.82 pikë ose 45.5%, duke paraqitur një nivel mesatar të performancës së njësive lidhur me këtë tregues, me një rritje të lehtë në krahasim me vitin e kaluar. Performancë më të mirë kundrejt këtij indikatori kanë ministritë e linjës dhe institucionet e pavarura.Njësitë e vetëqeverisjes vendore paraqiten me vlerësimin më të ulët me 0.49 pikë (12.05%).
3. Treguesi **"Reduktimi i nivelit të detyrimeve të prapambetura"** paraqet diferencën e stokut 12 – mujor të detyrimeve të prapambetura të vitit buxhetor korrent me stokun 12-mujor të vitit paraardhës në raport me stokun 12 – mujor të vitit paraardhës. Për vitin 2023, ai është vlerësuar mesatarisht 3.40 pikë (85%), duke treguar një nivel lehtësisht më të lartë në krahasim me vitin e mëparshëm. Në nivel të përgjithshëm stoku 12 mujor i detyrimeve të prapambetura për vitin 2023 është ulur me 35.6% krahasuar me stokun e detyrimeve të vitit paraardhës 2022.
4. Treguesi **"Realizimi i shpenzimeve kapitale"** paraqet devijimin nga plani i realizimit të shpenzimeve kapitale në një vit kundrejt shpenzimeve kapitale totale të planifikuara me ligjin e buxhetit vjetor në Kuvend. Për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar mesatarisht me 0.87 pikë (21.69%), duke shfaqur një performancë jo të kënaqshme të njësive publike, duke qenë se paraqet një nivel të konsiderueshëm devijimi nga fondet e planifikuara.
5. **Treguesi "Investimet kapitale shumëvjeçare janë hedhur në sistem sipas planit kontraktual të disbursimit"** është një tregues tjetër i rëndësishëm, i cili paraqet shumën totale të shpenzimeve për projektet e investimeve në periudhën e vlerësimit (një ose disavjeçare) kundrejt shumës totale të planit shumëvjeçar të parashikuar për projektet. Për shkak të mungesës së të dhënave për vlerësim nga struktura përkatëse

[8] Analiza për Sh.A është bazuar në indikatorët e MFK dhe AB.

[9] Në Ankesin 1, gjeni vlerësimin më i detajuar i indikatorëve të NJQP-ve.

në MF, njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashki dhe këshill qarku), nuk përfshihen në analizë për këtë tregues. Për periudhën analizuese, ky tregues është vlerësuar mesatarisht me 2.51 pikë (ose 62.66%) të nivelit referues, duke reflektuar një ulje të lehtë në krahasim me vitin 2022, ku ka qënë i vlerësuar me 3.35 pikë.

Treguesit e Thesarit

6. **Treguesi "Të gjitha faturat janë dërguar në kohë për pagesë pranë degës përkatëse të thesarit"**, për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar mesatarisht në nivelin 2.41 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 60.13%), duke reflektuar një rritje të lehtë të performancës në krahasim me dy vitet paraardhëse. Pavarësisht rezultatit, realizimi i këtij treguesi mbetet ende mjaft i luhatshëm për të gjitha grupet e njësive të qeverisjes së përgjithshme të marra në analizë.
7. **Treguesi "Faturat e detyrimeve të prapambetura janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit për regjistrimin në SIFQ si shpenzime të periudhave të ardhshme (llogaria ekonomike 486)"** për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar me 1.68 pikë (ose 42%), duke u pozicionuar në të njëjtin nivel në krahasim me vitin 2022. Referuar vlerësimit për këtë vit, rezulton se 42% e faturave të detyrimeve të prapambetura nuk janë kontabilizuar brenda afatit kohor prej 30 ditësh në SIFQ.
8. **Treguesi "Të gjitha kontratat janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit"**, i cili përcakton numrin e kontratave të dërguara pranë degëve të thesarit pas tre ditëve nga data e nënshkrimit të tyre kundrejt numrit total të kontratave të dërguara në thesar, për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar mesatarisht në nivelin 2.12 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 52.91%), duke reflektuar një situatë më të përmirësuar në krahasim me dy vitet e mëparshme.
9. **Treguesi "Numri i urdhër-prokurimeve të paautorizuara"** paraqet numrin e urdhër prokurimeve të paautorizuara kundrejt shumës totale të urdhër prokurimeve të dërguara për pagesë në thesar. Nga analiza e kryer, rezulton se për vitin 2023, ky tregues paraqet një performancë mjaft të kënaqshme për të gjitha grupet e institucioneve, duke u vlerësuar me 3.95 pikë (ose 98.83%), me një performancë në rritje në krahasim me dy vitet paraardhëse.
10. Treguesi **"Kufizimi i avancimit të planit mujor të arkës"**, përcakton vlerën e avancimeve të kryera gjatë vitit nga njësitë shpenzuese kundrejt totalit të planit vjetor të arkës. Për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar në nivelin 3.94 pikë (ose 99%), duke reflektuar për një situatë pozitive për këtë fushë për të gjitha institucionet e marra në analizë.
11. Treguesi **"Paraqitja, nënshkrimi dhe respektimi i afatit kohor të dorëzimit të pasqyrave financiare sipas kuadrit ligjor në fuqi",**i cili mat respektimin e afatit kohor, nënshkrimit, përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore në NJQP, për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar në nivelin 3.52 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 88%), duke reflektuar një performancë të kënaqshme por lehtësisht në ulje në këtë fushë.

Treguesit e menaxhimit financiar dhe kontrollit

12. Treguesi **"Hartimi me cilësi i planit të veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK) dhe paraqitja brenda afateve kohore të përcaktuara**", i cili përcakton respektimin e afatit kohor dhe cilësinë e përmbajtjes së Planit të Veprimit për ngritjen e sistemit të MFK-së në NJQP për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar me 2.73 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 68.32%), duke reflektuar një performancë

të përmirësuar në krahasim me dy vitet paraardhëse për të gjitha grupet e institucioneve.

13. Treguesi **"Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm",** i cili përcakton përmbushjen e kritereve ligjore, cilësinë e raportit vjetor dhe deklaratës së cilësisë si dhe gjithëpërfshirjen e informacionit mbi statusin e implementimit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike (nëpërmjet pyetësorëve të vetëvlerësimit) për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar mesatarisht në nivelin 2.97 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 74.31%), duke reflektuar një performancë mesatarisht të kënaqshme edhe pse me një ulje shumë të lehtë, në këtë fushë kryesisht për ministritë e linjës dhe institucionet e pavarura, të ngjashme me dy vitet paraardhëse. Ndërkohë, vlerësimi për njësitë e vetëqeverisjes vendore vijon të jetë më i ulët se për grupet e tjera të marra në analizë, specifikisht 2.73 pikë.
14. Treguesi **"Efektiviteti i mekanizmave bazë të përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë e sektorit publik",** i cili vlerëson se në çfarë mase dhe sa shpesh njësitë publike përmbushin kriteret themelore të përgjegjshmërisë menaxheriale. për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar mesatarisht në nivelin 2.92 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 73%), duke reflektuar një performancë të mirë në këtë fushë, të ngjashme me atë të dy viteve paraardhëse me një rritje të lehtë.

<u>Treguesit e Auditimit të brendshëm</u>

15. **Treguesi "Organizimi i NJAB-ve dhe kapacitetet e AB".** Ky tregues vlerëson nivelin e përputhshmërisë së krijimit dhe funksionimit të NJAB-ve si dhe të kritereve të punësimit dhe kualifikimit profesional të audituesve të brendshëm me kërkesat ligjore dhe standartet profesionale të pranuara në fushën e auditimit të brendshëm publik. Gjatë vitit 2023 ky indikator vlerësohet me 2.82, (70.57%) duke rezultuar me një rritje të lehtë në krahasim me vitin 2022 (vlerësuar me pikë mesatare 2.38 pikë ose 59.5%).

16. **Treguesi "Cilësia e përgatitjes së planifikimit strategjik dhe vjetor nga NJAB-të".** Ky tregues vlerëson cilësinë e përgatitjes së planit strategjik dhe vjetor të NJAB-ve dhe në çfarë mase NJAB-të përmbushin kriteret e përgatitjes së këtij dokumenti. Vlerësuar për vitin 2023 me pikë 2.79 pikë, 69.7%. Duke rezultuar në një rritje të lehtë në krahasim me vitin 2022 (mesatarja 2.47, pikë ose 61.75%. Cilësia e përgatitjes së Planit Strategjik dhe Vjetor nga NJAB-të e sektorit publik është një tregues që ndihmon të vlerësojmë se deri në çfarë mase puna audituese është e orjentuar të mbulojë zonat me risk më të lartë në njësitë publike si dhe të planifikojë efektivisht burimet e nevojshme për kryerjen e angazhimeve të auditimit të brendshëm në mënyrë të tillë që të ofrojnë siguri të pavarur dhe objektive për titullarin e njësisë publike si dhe të sjellë vlerë të shtuar.
17. **Treguesi "Cilësia e përgatitjes së Raportit vjetor të NJAB-ve",** Ky tregues vlerëson cilësinë e përgatitjes së Raportit Vjetor të NJAB-ve i cili dorëzohet në ministrinë përgjegjëse për financat dhe masën e përmbushjes së kritereve të përgatitjes së këtij dokumenti nga NJAB-të. Vlerësuar me 2.74 pikë, ose 68.5% në krahasim me vitin 2022, vlerësuar me 2.4 pikë, ose 60%. Raportimi është dokumenti ku auditimi i brendshëm ofron rezultatet e punës audituese nëpërmjet të cilit vlerësohet përgjegjshmëria e titullarëve të njësisë publike në vendosjen dhe mbajtjen e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm, qeverisjes dhe menaxhimit të riskut dhe përbën një mjet të fuqishëm për të nxitur ndryshimin pozitiv dhe përmirësimin e performancës të vetë njësisë publike.

18. **Zbatimi i rekomandimeve të AB-së.** Ky tregues vlerëson nivelin e zbatimit të rekomandimeve të AB-së nga subjektet e audituara. Rekomandimet të cilat adresojnë gjetjet nga auditimi janë forma nëpërmjet së cilës auditimi i brendshëm ofron këshillë dhe ndihmon në vlerësimin e risqeve, korrigjimin e shkeljeve dhe parregullsive si dhe përmirësimin dhe forcimin e sistemeve të audituara për dobësitë e identifikuara. Vlerësuar me 1.82 pikë, ose 45.57% në krahasim me vitin 2022, vlerësuar me 1.1 pikë, ose 27.5%.

1.2 Analiza për treguesit e performancës për sha-të.

Duke filluar nga viti 2023 në kuadër të ndryshimeve në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 dhe **ligjin nr. 14/2023,** në bazë të nenit 18, kërkesa për raportim për gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm u është dërguar edhe shoqërive tregtare të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme. Në total iu është kërkuar informacion 45 SHA-ve me kapital shtetëror. Në analizë janë marrë treguesit e MFK dhe AB, pasi përfshirja e këtyre njësive në vlerësim është një risi, dhe jo pjesë e metodologjisë së vlerësimit të performancës së NJQP-ve.

Në total kanë raportuar pranë Ministrisë së Financave 29 Sh.A me kapital shtetëror ose 64% e tyre. Nga këto 17 njësi ose 38% e tyre kanë raportuar në mënyrë të saktë.

Një vështrim i përgjithshëm për treguesit e performancës për dy grupet përkatëse, (MFK dhe AB) për këto njësi varësie paraqitet si më poshtë vijon:

Analiza e treguesve të performancës të menaxhimit financiar dhe kontrollit:

1.Treguesi **"Hartimi me cilësi i Planit të Veprimit të MFK-së dhe paraqitja brenda afateve kohore të përcaktuara"**, paraqet respektimin e afatit kohor dhe cilësinë e përmbajtjes së Planit të Veprimit për ngritjen e sistemit të MFK-së. Për vitin 2023, të dhënat pasqyrojnë një performancë jo të mirë për njësitë e marra në analizë, duke qënë se treguesi është vlerësuar mesatarisht me 1.52 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 38%) të nivelit referues të vlerësimit. Nga analiza e kryer, evidentohet se një pjesë e njësive të vlerësuara nuk kanë dorëzuar formatin e planit të veprimit. Gjithashtu raportimi nuk ka qenë në formatin e duhur dhe saktësia e periudhës për të cilën raportohet, pasi raportimi duhet të bëhet për vitin në vijim, jo për vitin raportues. Ka problematikë vështirësia e këtyre njësive në konkretizimin e rekomandimeve të dhëna nga Njësitë e Auditimit të Brendshëm. apo Kontrolli i Lartë i Shtetit.

2.Treguesi **"Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm"**, përcakton respektimin e afatit kohor për depozitimin e pyetësorit të vetëvlerësimit të njësive të marra në analizë si dhe cilësinë e tij, ku një pyetësor është konsideruar gjithëpërfshirës nëse përmban një informacion të plotë, të saktë, të mbështetur në statistika dhe evidenca. Për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar mesatarisht me 2.73 pikë ose 68%, duke reflektuar një performancë relativisht të mirë. Pjesa më e madhe e njësive të analizuara kanë dorëzuar pyetësorin dhe kanë pasqyruar një informacion të plotë, të arsyetuar me evidenca mbështetëse konkrete, por evidentohet se nuk kanë paraqitur deklaratën dhe raportin.

3.Treguesi **"Efektiviteti i mekanizmave bazë të përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë e sektorit publik"** vlerëson se në çfarë mase dhe se sa shpesh njësitë publike përmbushin kriteret themelore të përgjegjësisë menaxheriale, të specifikuara në ekzistencën e një strukture organizative, të përshatshme me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së saj, hartimin e planit vjetor të punës me objektiva të matshëm e të miratuar nga titullari i njësisë dhe monitorohet të paktën një herë në vit, raportime vjetore mbi nivelin e rezultateve të arritura kundrejt objektivave dhe synimeve të paracaktuara si dhe procedura delegimi sipas bazës ligjore në fuqi. Ky tregues është analizuar duke marrë në konsideratë 31 pyetje të pyetësorit të rishikuar të vetëvlerësimit nga vlerësimi i të cilave, efektiviteti i këtij treguesi është mesatarisht 2.37 pikë ose 59%.
Referuar këtij treguesi, këto njësi kanë reflektuar një performancë relativisht të mirë, por ka problematikë në zbatimin e procedurave të sakta të delegimit çka e bën të nevojshme ndërmarrjen e masave për adresimin e problematikave dhe përcaktimin e qartë të termave, rregullave dhe procedurave që duhet të ndiqen në procesin e delegimit të detyrave brenda njësisë, në përputhje me kuadrin rregullator në fushën e kontrollit të brendshëm. Gjithashtu evidentohet se pjesa më madhe e këtyre njësive nuk kanë Grup për Menaxhimin e Riskut.

Analiza e treguesve të performancës të auditimit të brendshëm në shoqëritë publike:

11.Treguesi "**Organizimi i NJAB-ve dhe kapacitetet e AB".** Nga vlerësimi i treguesit të performancës për krijimin e funksionit të njësive të auditimit të brendshëm dhe kapacitetet e stafit auditues në shoqëritë publike, duket se përgjithësisht shërbimi i auditimit realizohet nëpërmjet krijimit të njësisë së auditimit të brendshëm si strukturë organizative e përhershme. Niveli i përputhshmërisë së krijimit dhe funksionimit të strukturave audituese dhe respektimi i kritereve të punësimit dhe kualifikimit profesional të audituesve të brendshëm me kërkesat ligjore dhe standartet profesionale të pranuara në fushën e auditimit të brendshëm publik në shoqëritë publike, gjatë vitit 2023, është vlerësuar 3.24 pikë ose 81%. dhe faktorët kryesorë në këtë nivel lidhen me qarkullimin e lartë të stafit auditues cka sjell dhe risk të lartë në vazhdimësinë e kapaciteteve dhe humbje të investimit në kapitalin njerëzor.

2.Treguesi **"Cilësia e përgatitjes së planifikimit strategjik dhe vjetor nga NJAB-të".** Planit Strategjik dhe Vjetor nga NJAB-të e shoqërive publike miratohet nga Këshilli Mbikqyrës pasi është vlerësuar nga Komiteti i Auditimit. Niveli i këtij treguesi vlerëson përmbushjen e kërkesave të kuadrit ligjor, manualit të auditimit të brendshëm dhe standarteve profesionale në planifikimin e punës audituese, dhe si ato reflektohen në Planin Strategjik dhe Vjetor të Njësisë së Auditimit në shoqërinë publike. Për vitin 2023, treguesi i performancës së auditimit të brendshëm lidhur me planifikimin e auditimit është vlerësuar të jetë 3.38 pikë ose 84% në një nivel të lehtë përrmirësimi. Faktorët që kanë ndikuar në këtë tregues lidhen kryesisht me njohuritë për vlerësimin e rikut, ambjenti kompleks ku kryhet veprimtaria e shoqërisë aksionere, statusi ligjor kompleks dhe shpesh i interpretueshëm etj.

3. Treguesi **"Cilësia e përgatitjes së Raportit vjetor të NJAB-ve".** Sikurse çdo strukturë audituese e ngritur në njësitë e sektorit publik, edhe në shoqëritë publike ky tregues vlerëson performancën e njësisë së auditimit nëpërmjet cilësisë së Raportit Vjetor të NJAB-ve. Niveli i aplikimit të kërkesave për parimet e raportimit të auditimit për vitin 2023 nga NJAB-të e shoqërive publike vlerësohet në nivelin 3.12 pikë ose78%. Në këtë nivel kanë ndikuar thuajse të njëjtët faktorë si dhe në planifikimin e auditimit të cilët lidhen kryesisht me aftësitë, njohuritë dhe eksperiencën e audituesve në hartimin e raporteve cilësore të auditimit.

4. Treguesi **"Zbatimi i rekomandimeve të AB-së".** Si tregues më i rëndësishëm për matjen e performancës dhe efektivitetit të funksionit të auditimit të brendshëm, zbatimi i rekomandimeve të auditimit ofron një pamje të përgjithshme mbi impaktin e punës audituese në shoqëritë publike. Për vitin 2023, njësitë e auditimit në shoqëritë publike kanë mbajtur një nivel të lartë të pranimit të rekomandimeve, por zbatimi i tyre nga subjektet e audituara është vlerësuar të jetë në masën 1.71 pikë ose 43%, nivel ky më i ulët se mesatarja e përgjithshme. Mjedisi tepër kompleks i veprimtarisë së biznesit të shoqërive publike, vendimmarrje që kërkojnë kohë dhe ndërgjegjësimi i pamjaftueshëm i organeve drejtuese/këshillave mbikqyrës kanë qenë ndër faktorët kryesorë që kanë ndikuar dhe ndikojnë në performancën e impaktit të auditimit të brendshëm.

KAPITULLI II. MENAXHIMI FINANCIAR DHE KONTROLLI

Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli fokusohet në ofrimin e sigurisë që fondet buxhetore përdoren vetëm për qëllimet e parashikuara nga ligji dhe në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Një sistem efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK) është thelbësor për njësitë publike duke ofruar mbështetje për evidentimin e mangësive dhe zbatimin e veprimeve korrigjuese, minimizimin e devijimit nga standardet e kontrollit të brendshëm si dhe mirëfunksionimin e veprimtarisë së njësisë. Duke krijuar një kuadër të përshtatshëm të MFK-së, njësia publike rrit mundësinë e përmbushjes së objektivave dhe qëllimeve të saj.

Konkretisht, një sistem modern i MFK-së mbështetet plotësisht në objektivat e programit buxhetor. Vendimet duhet të jenë të dokumentuara plotësisht dhe implikimet financiare të këtyre vendimeve duhet të regjistrohen qartë dhe të jenë në dispozicion për rishikim nga auditimi i brendshëm, i jashtëm dhe palë të treta. Menaxhimi ka një përgjegjësi të drejtpërdrejtë për përdorimin me efektivitet dhe eficiencë të fondeve buxhetore në dispozicion të tyre, për të arritur objektivat e njësisë publike, duke marrë parasysh prioritetet e qeverisë. Këto masa do të ndikojnë jo vetëm në përmirësimin e procedurave të MFK-së por edhe në veprimtaritë menaxheriale që zbatohen brenda njësisë publike, siç janë përcaktimi i përgjegjësive të menaxherëve në të gjitha nivelet dhe delegimi i përgjegjësive.

Në tërësi, sistemi i kontrollit të brendshëm në tërësi është një pasqyrë e strategjive, masave dhe procedurave të brendshme, krijuar nga institucionet për të siguruar menaxhimin cilësor të objektivave thelbësorë, të cilat garantojnë që njësia publike realizon në mënyrë efektive qëllimin për të cilën është krijuar. Një sistem kontrolli i brendshëm i zhvilluar siç duhet pritet të ekspozojë se si qeveria trajton dhe menaxhon financat e saj duke ofruar gjithashtu transparencë dhe duke krijuar mundësinë për rishikim nga strukturat audituese dhe palë të treta.

Në kuadër edhe të zhvillimeve të Kapitullit 32, dhe pas vlerësimit pozitiv të marrë për zhvillimin e fushës gjatë takimit bilateral të organizuar në fund të muajit Dhjetor 2022, ka vijuar puna në ndjekjen dhe realizimin e aktiviteteve në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve vijuese mbi rritjen e përdorimit të instrumentave të përgjegjshmërisë menaxheriale, të sistemit të menaxhimit të riskut dhe ndjekjes së rekomandimeve të fushës së kontrollit të brendshëm.

Vlen të theksohet se në kuadër të realizimit të angazhimeve të ndërmarra nëpërmjet Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022, mbi zhvillimin e fushës së

menaxhimit financiar dhe kontrollit, rezultoi se vendi ka bërë progres në arritjen dhe realizimin e objektivave të përcaktuara në këtë dokument, dhe kryesisht aktivitetet me impakt më të lartë në zhvillimin e mëtejshëm të sistemit rezultuan, asistenca teknike dhe vlerësimi i cilësisë për NJQP-të, të ofruara nga struktura përgjegjëse për menaxhimin financiar, kontrollin dhe kontabilitetin në përputhje me aktivitetet dhe masat e përcaktuara në strategji, aktivitete këto të cilat janë përfshirë edhe në strategjinë e re.

Për vlerësimin e sistemit të MFK-së në Njësitë Publike (NJP[10]), që kanë detyrimin ligjor për raportim për vitin 2023, janë marrë në konsideratë pyetësorët e vetëvlerësimit, deklaratat dhe raportet mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik, si dhe planet e veprimit për ngritjen e sistemit të kontrollit të brendshëm, të depozituara nga këto njësi sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Pranë DH/MFKK janë depozituar 140 pyetësorë vetëvlerësimi nga 153 pyetësorë të shpërndarë në njësitë e sektorit publik. Ndërkohë që, evidentohet se 5[11] prej njësive të qeverisjes së përgjithshme nuk kanë raportuar në mënyrën e duhur duke pasur mangësi në dokumentacionin e dërguar, ndërsa 9 NJQP nuk kanë raportuar në MF.[12]

Po ashtu, pranë DH/MFKK, janë depozituar 29 pyetësorë vetëvlerësimi nga 45 pyetësorë të shpërndarë në shoqëritë tregtare të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme. Një sërë prej këtyre Sh.a-ve nuk kanë raportuar në mënyrën e duhur, duke pasur mangësi dokumentacioni, konkretisht 10[13]të tilla. Ndërkohë, 15[14] prej tyre nuk raportuan në MF. Si konkluzion, 17 prej këtyre sh.a-ve kanë raportuar në mënyrë e duhur lidhur me deklaratën dhe raportin vjetor të KBFP. Në të njëjtën kohë, lidhur me instrumentin e planit të veprimit të MFK, rezulton se 16 Sh.A kanë dorëzuar plane veprimi të sakta.

Në vazhdim, jepen të dhënat për numrin e subjekteve që kanë plotësuar pyetësorin e vetëvlerësimit:

---

[10] Përfshihen NJQP dhe shoqërive tregtare që cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme.


[11] Bashkia Delvinë, Bashkia Rogozhine,.Bashkia Kurbin,Bashkia Librazhd,Bashkia Finiq.

[12] Sekretariati Teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar, Qarku Lezhë ,Bashkia Cërrik, Bashkia Tropojë, Bashkia Vlorë, Bashkia Konispol, Bashkia Vau Dejës, Bashkia Himarë, Bashkia Vorë.

[13] Albpetrol sh.a Fier, Regjistri Detar Shqiptar,Ujësjellës Kanalizime sh.a Korcë, Ujësjellës Kanalizime sh.a Gjirokastër, Ujësjellës Kanalizime sh.a Lushnjë, Ujësjellës Kanalizime sh.a Vlorë, Rezidenca Studentore Universitare nr 1 sh.a Tiranë, Klubi shumësportësh "Partizani", Klubi i Shumësporteve , Klubi Futbollit Teuta.

[14] Prodhim Mobilje, sh.a Tiranë,Posta Shqiptare sh.a ,Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve sh.a Korçë,Agrokredit sh.a Tiranë,Ujësjellës Kanalizime sh.a Durrës,Ujësjellës Kanalizime sh.a Dibër,Ujësjellës Kanalizime sh.a Kukës,Ujësjellës Kanalizime sh.a Elbasan,Ujësjellës Kanalizime sh.a Berat,Ujësjellës Kanalizime sh.a Sarandë,Klubi Sportiv Tirana,Klubi Sportiv Studenti,Tiranë ,Qendra Kulturore dhe Klubi i Sportit Lushnjë,Klubi i Futbollit Gramozi ,Klubi Skëndërbeu.

Grafiku 1. Numri i NJP-ve që kanë plotësuar pyetësorin e vetëvlerësimit për vitin 2023



2.1 Analiza e sistemit sipas 5 komponentëve të ndarë në 17 parime të MFK[15] bazuar në vetëvlerësimin e njësive publike[16].

Kontrolli i brendshëm përbëhet nga pesë komponentë të ndërlidhur, të cilët ndërveprojnë me njëri-tjetrin, duke formuar një sistem të integruar që reagon në mënyrë dinamike ndaj ndryshimit të kushteve.

Grupimi i tyre siguron një kombinim të kontrolleve menaxheriale dhe operacionale, të tilla si krijimi i një mjedisi në të cilin kontrolli i brendshëm mund të funksionojë dhe të përparojë, së bashku me lloje më të rrepta dhe më tradicionale të kontrolleve parandaluese dhe financiare, të cilat marrin në konsideratë riskun e mashtrimit dhe korrupsionit.

Pesë komponentët e kontrollit të brendshëm të cilët do të analizohen më poshtë në bazë të analizës së parimeve janë:

- Mjedisi i kontrollit,
- Menaxhimi i riskut,
- Aktivitetet e kontrollit,
- Informimi dhe komunikimi,
- Monitorimi.

I. Mjedisi i Kontrollit

Mjedisi i kontrollit i jep tonin njësisë, duke influencuar vetëdijen kontrolluese të punonjësve të saj. Ai përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë duke siguruar disiplinën dhe strukturën. Mjedisi i kontrollit përbëhet nga dy aspekte: strukturat formale dhe aspektet e sjelljes individuale; dhe të dy duhet të ndërveprojnë. Menaxhimi ka rolin kyç në miratimin dhe mbështetjen e mjedisit të kontrollit.

---

[15] Analiza e parimeve, e detajuar për secilin komponent gjendet në Aneksin III.

[16] Në këtë analizë përfshihen edhe shoqëritë tregtare që kanë detyrimin për raportim sipas nenit 18 të ligjit të MFK.

Faktorët e mjedisit të kontrollit përfshijnë integritetin, vlerat etike dhe aftësinë e stafit të njësisë; filozofinë e drejtimit dhe stilin e punës; mënyrën sesi menaxhimi cakton përgjegjësi dhe të drejta dhe organizon dhe zhvillon stafin, si dhe përkushtimin dhe orientimet që jep grupi i menaxherëve. Vendosja e tonit të duhur në krye është një element i mjedisit të kontrollit që reflektohet në ushtrimin e integritetit dhe vlerave etike në të gjithë njësinë. Ky element fuqizon menaxhimin për të qeverisur dhe mbikqyrur arritjen e objektivave të njësisë përmes aftësive dhe kompetencës. Në këtë mënyrë, realizohet vlerësimi i performancës dhe stimulohet përgjegjshmëria e menaxherëve për arritjen e objektivave.

Mjedisi i kontrollit në mbështetje të vlerësimit të pesë parimeve (bazuar kjo në analizën e detajuar të përgjigjeve të dhëna në pyetësorët e vetëvlerësimit), nga të cilat përbëhet, vlerësohet në tërësi pjesërisht efektiv.

Konkretisht, progresi në këtë komponent vjen si rezultat i krijimit të instrumentave mbështetës të tillë si: hartimi i një Kodi të veçantë Etike apo Rregulloret e Brendshme të rishikuara të cilat përmbajnë standardet e sjelljes dhe parimet e etikës.

Përsa i përket programeve individuale të trajnimit të punonjësve, në pjesën më të madhe të institucioneve evidentohet se janë marrë masat për hartimin e një regjistri të nevojave për trajnim, të koordinuar paraprakisht dhe depozituar pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) si institucioni përgjegjës për realizimin e trajnimeve në masë për rritjen e kapaciteteve të punonjësve të administratës publike. Mbi rritjen e kapaciteteve në fushën e MFK-së, pothuajse të gjitha njësitë e marra në analizë nuk kanë parashikuar dhe hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet dhe zbatimin e kërkesave kryesore në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Nga analiza vërehet një rritje e angazhimit të menaxherëve për të ushtruar përgjegjësitë e tyre në funksion të realizimit me cilësi të veprimtarisë së institucionit. Objektivat kryesorë të institucioneve dhe treguesit e performancës për përmbushjen me sukses të tyre janë përcaktuar në dokumentin e programit buxhetor afatmesëm. Si rezultat i këtij procesi, raportimi fokusohet në ecurinë e veprimtarisë dhe performancës financiare të institucionit, si realizimi i shpenzimeve buxhetore apo ecuria e realizimit të investimeve dhe më pak në drejtim të raportimit të arritjeve apo problematikave në zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Për rrjedhojë, evidentohet nevoja për vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe parashikimin e masave konkrete për adresimin e mangësive.

Mos arritja e nivelit të duhur të efektivitetit vjen për shkak të mënyrës së zbatimit të procedurave të delegimit, ku vijon të mbetet thelbësor ndërgjegjësimi i menaxherëve lidhur rëndësinë që mbart zbatimi i këtij instrumenti. Pavarësisht përmirësimit të bazës ligjore dhe nënligjore të fushës, mungesa apo devijimi i rregullave të delegimit të dokumentuar, ndikon në veprimtarinë e përditshme të institucioneve dhe në vendosjen e autoritetit dhe përgjegjshmërisë së menaxherëve.

Pjesa më e madhe e institucioneve të marra në analizë, kryejnë procesin e vlerësimit të performancës në punë të punonjësve në përputhje me formatet e përcaktuara në legjislacionin përkatës për nënpunësit civilë si dhe hartojnë përshkrimet e punës, në bazë të rregullave të vendosura nga Departamenti i Administratës Pulike. Në njësitë e vetëqeverisjes vendore, përshkrimet e punës me detyrat specifike dhe linjat e raportimit për punonjësit janë të pasqyruara në dokumentin e rregullores së brendshme.

Gjithashtu, politikat e burimeve njerëzore dhe praktikat e ngjashme lidhen me rekrutimin transparent, emërimin, vlerësimin e nevojave për trajnimin e vazhdueshëm, vlerësimin korrekt të performancës, si dhe me veprimet disiplinore të punonjësve të institucioneve publike. Pavarësisht ndjekjes së politikave të vendosura për menaxhimin e burimeve njerëzore, ende pjesa më e madhe e institucioneve nuk kanë politika të mirëfillta favorizuese për punonjësit e tyre, ku vlen të theksohet se rritja e vazhdueshme e motivimit dhe nxitjes në karrierë të punonjësve bazuar në rezultatet e performancës, mbetet një ushtrim formal. Ajo që është evidentuar gjatë analizimit të pyetësorëve (kryesisht në njësitë e vetëqeverisjes vendore) është fakti se, gjatë procedurave të rekrutimit për pozicionet e shpallura vakant, nuk ka kërkesa për aplikime apo shprehje të interesit për punësim.

Kryesisht, njësitë publike, zbatojnë përgjegjshmërinë menaxheriale përmes strukturave, autorizimeve dhe përgjegjësive. Vlen të theksohet se, pavarësisht vlerësimit të pyetësorëve të vetëvlerësimit por bazuar edhe në rezultatet e procesit të vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në disa prej institucioneve, evidentohet se kryesisht njësitë kanë të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale në dokumentin e rregullores së brendshme, bazuar në funksionet dhe pozicionet e punës të gjithësecilit. Gjithashtu, referuar përcaktimeve të ligjit të nëpunësit civil, në ministritë e linjës dhe institucionet e pavarura janë hartuar përshkrimet e punës specifike për çdo pozicion pune të cilat përmbajnë objektivat strategjike dhe operacionale të njësisë si dhe përgjegjësitë për përmbushjen e tyre dhe raportimin e rezultateve.

Një çështje që ka nevojë për trajtim të mëtejshëm në kuadër të përcaktimit dhe forcimit të përgjegjshmërisë menaxheriale është funksionimi i rregullt i Grupit për Menaxhimin Strategjik (GMS) në kuadër të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

II. Menaxhimi i Riskut

Komponenti i menaxhimit të riskut përfshin identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për realizimin e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Ky komponent është i rëndësishëm sepse çdo njësi publike përballet me risqe të brendshme dhe të jashtme që kërcënojnë arritjen e objektivave të tyre. Risqet vazhdojnë të ndryshojnë me ndryshimin e mjedisit dhe faktorëve të tjerë. Si i tillë, identifikimi dhe vlerësimi i riskut për arritjen e objektivave të njësisë publike është një proces dinamik dhe përsëritës. Menaxhimi i riskut mundëson cilësi më të mirë të vendimmarrjes, parashikim dhe optimizim më të mirë të burimeve në dispozicion, ballafaqim me prioritetet dhe shmangien e problemeve që mund të shfaqen në të ardhmen.

Ky komponent përfshin katër parime gjithëpërfshirëse zbatimi i të cilave ndihmon në arritjen e objektivave dhe mirëfunksionimin komponentit të menaxhimit të riskut. Menaxhimi i riskut vlerësohet pjesërisht efektiv bazuar në analizën e informacionit të dhënë në pyetësorët e vetëvlerësimit.

Vlen të theksohet angazhimi i institucioneve në përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm ku janë identifikuar objektivat dhe prioritetet e institucionit së bashku me programet që këto objektiva i përkasin. Nga analiza e kryer, rezulton se një pjesë e institucioneve (drejtoritë dhe departamentet) i zhvillojnë objektivat e tyre operacionalë duke i vendosur në linjë me objektivat strategjikë dhe politikat kombëtare. Realizimi i këtij procesi në tërësi, duke krijuar

një lidhje të qartë mes qëllimit të politikave, objektivave strategjikë e operacionalë si dhe buxhetit të akorduar për realizimin e tyre shërben si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike. Në përgjithësi, mos funksionimi në nivelin e kërkuar të këtij komponenti vjen si rezultat i moskonkludimit të procesit të strukturuar të përcaktimit të objektivave në plane konkrete veprimi për përmbushjen e tyre nga të gjithë punonjësit sipas përgjegjësive të caktuara.

Gjithashtu, mos konkretizimi i planifikimit të objektivave strategjikë e operacionalë edhe në plane specifike për menaxhimin e riskut ndikon në efektivitetin e zbatimit real të këtij procesi. Nga analiza e kryer, rezulton se jo të gjitha njësitë janë angazhuar në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, paraqitjen e tyre në regjistrin e riskut, impaktin që ato përcjellin dhe masat/planet e nevojshme për trajtimin dhe minimizimin e efektit të tyre.

Një situatë më pozitive vijohet të paraqitet në disa prej ministrive të linjës, institucioneve të pavarura apo bashki të cilat janë mbështetur nga Projekti i Financave Lokale në krijimin e mekanizmave të menaxhimit të riskut të tilla si: ngritja e grupit të menaxhimit të riskut, rregulloret për funksionimin e tij apo dhe identifikimi, vlerësimi dhe trajtimi i risqeve për disa nga proceset kryesore të këtyre njësive.

Në përgjithësi, nuk janë përcaktuar procedura specifike të vlerësimit të riskut të mashtrimit në institucione si dhe nuk merren masa konkrete për adresimin e riskut të mashtrimit të raportimit financiar, raportimit jo-financiar, përvetësimit të pasurive dhe akteve të paligjshme (përfshirë korrupsionin), ndërkohë që baza ligjore në të cilën mbështeten institucionet në rastet e mashtrimit mbetet legjislacioni për sinjalizimin.

Vlen të theksohet se, vetëm në pak raste (kryesisht ministritë e linjës) menaxhimi i lartë dhe stafi marrin në konsideratë vlerësimin e riskut të mashtrimit si një pjesë integrale të procesit të menaxhimit të riskut, gjë që e ndihmon njësinë në arritjen e objektivave dhe e bën këtë proces më efektiv.

Situata paraqet një mungesë të mekanizmave për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve që lidhen me ndryshimet e rëndësishme. Në përgjithësi, institucionet analizojnë pjesërisht ndyshimet që ndodhin në sistemin e kontrollit të brendshëm për shkak të ndryshimeve strukturore apo menaxheriale. Ky rezultat, vjen kryesisht si pasojë e vështirësisë në identifikimin e shkaqeve potenciale, të cilët ndikojnë në arritjen ose jo të një objektivi, si dhe vështirësisë në vlerësimin e probabilitetit të ndodhjes së këtyre shkaqeve, për të cilët duhet vlerësuar efekti i mundshëm në arritjen e objektivave dhe shkalla në të cilën mund të menaxhohet risku.

III.Aktivitetet e Kontrollit

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve. Në vendosjen e aktiviteteve të kontrollit, titullarët e njësive duhet të marrin parasysh përfitimin që pritet prej tyre, si dhe kostot për futjen dhe zbatimin e tyre. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Ky komponent përbëhet nga tre parime të cilat ndihmojnë në arritjen e objektivave dhe përmbushjen e aktiviteteve të kontrollit. Në tërësi, komponenti vlerësohet pjesërisht efektiv, por shumë afër të qënit efektiv, duke evidentuar nevojën për marrjen e masave të mëtejshme për sigurimin e funksionalitetit të veprimtarive të kontrollit në mënyrë që ky komponent të jetë efektiv.

Nga analiza e kryer për vitin 2023, rezulton se, NJQP-të *menaxhojnë me efektivitet* aktivitetet e kontrollit të cilat janë kryesisht të lidhura me një sistem funksional të menaxhimit të riskut ku paraprakisht janë identifikuar dhe vlerësuar risqet kryesore që pengojnë realizimin e objektivave. Aktivitetet e ndërmarra eleminojnë apo reduktojnë në një nivel të pranueshëm risqet ndaj të cilave këto institucione janë të ekspozuara.

Ky vlerësim, vjen si rezultat i parashikimit dhe zbatimit të aktiviteteve të kontrollit si masa që rrjedhin nga akte ligjore dhe nënligjore të fushës. Kryesisht situatë pozitive paraqitet në zbatimin e aktiviteteve për ruajtjen dhe mirëmenaxhimin e aktiveve, zbatimit të rregullave të prokurimit publik, ekzekutimin e veprimtarisë financiare si dhe përdorimin e sistemit të duhur të teknologjisë së informacionit.

Ndërkohë, mbetet ende në nivele jo të kënaqshme, kryesisht në njësitë e vetëqeverisjes vendore, mungesa e hartimit me cilësi të hartave apo manualit të proceseve të punës, duke sjellë mbivendosje dhe paqartësi në ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive. Për më tepër, kontrollet për sigurimin e ndarjes së detyrave mund të mos zbatohen në mënyrë adekuate në ato institucione ku strukturat janë të vogla, lëvizja e stafit është e shpeshtë apo veprimtaria e tyre është e kufizuar.

Pjesa më e madhe e njësive publike ka vendosur aktivitetet përkatëse të kontrollit për zgjedhjen, zhvillimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e teknologjisë së një njësie publike, si dhe procedurat e nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë kundrejt risqeve potenciale. Në përgjithësi, institucionet bazohen në rregullat e përgjithshme të përcaktuara nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe në pak raste pranë disa institucioneve janë përcaktuar rregulla dhe procedura të brendshme në këtë fushë, të përfshira kryesisht në dokumentin e rregullores së brendshme apo rregullore të tjera specifike për teknologjinë e informacionit.

Përdorimi i politikave dhe procedurave të përcaktuara nga komponenti i aktiviteteve të kontrollit, u jep punonjësve një pamje të qartë të veprimtarisë së njësisë për të cilën ata kontribuojnë, duke mbajtur në konsideratë llojin e kulturës dhe filozofisë që menaxherët transmetojnë. Pavarësisht nga madhësia e njësisë publike dhe kompleksiteti i veprimtarisë së saj, zhvillimi dhe shpërndarja në të gjitha nivelet e politikave dhe procedurave mbetet një nga mekanizmat thelbësorë që çon në mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Të gjitha grupet e institucioneve pohojnë se zbatojnë me rigorozitet këto procedura dhe rrallëherë evidentohen problematika lidhur me këtë fushë.

IV. Informacioni dhe Komunikimi

Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërisë.

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. Komunikimi i brendshëm ndan informacionin lart, poshtë dhe në të gjithë njësinë publike për të ndihmuar në përmbushjen e përgjegjësive si dhe arritjen e rezultateve të synuara. Ndërkohë, komunikimi i jashtëm siguron informacion të vlefshëm me njësitë e tjera, përcakton kufijtë, përgjegjësitë, kërkesat, si dhe synimet e pritshme.

Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara. Informacioni duhet t'i komunikohet menaxhimit dhe punonjësve të tjerë, në formën dhe brenda një harku kohor të duhur, që i ndihmon ata për të kryer përgjegjësitë e tyre. Sistemi i MFK-së kërkon ekzistencën e sistemit të menaxhimit të informacionit që përfshin baza të dhënash, regjistrime dhe linja raportimi të përcaktuara qartë.

Ky komponent përfshin tre parime, zbatimi i të cilave ndihmon për të arritur një komunikim dhe informacion efektiv. Informimi dhe komunikimi vlerësohet pjesërisht efektiv për vitin 2023 duke u vlerësuar në të njëjtin nivel në krahasim me vitet paraardhëse, referuar dokumentacionit bazë të analizuar.

Pjesa më e madhe e institucioneve të marra në analizë, evidentojnë se, sistemi i komunikimit funksionon në mënyrën e duhur duke përcjellë një informacion cilësor me qëllim përmbushjen e kërkesave dhe specifikat e nevojshme të menaxhimit. Kryesisht, të gjitha njësitë kanë një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit. Përsa i përket raportimit të informacionit të përpunuar, nga përgjigjet e analizuara, evidentohet se njësitë përgatisin për menaxhimin/drejtuesit, raporte të nevojshme mbi performancën (përmbushjen e detyrave) e njësisë në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me eficiencë dhe efektivitet, por nuk rezulton që të ketë një bazë rregullative që të përcaktojë llojet e raportimit dhe periodicitetin e tyre, në kuadër të standardizimit të këtij procesi.

Megjithatë, fokusi i këtyre raporteve mbetet në dhënien e informacionit mbi përformancën financiare, të tilla si: raportet për monitorimin e buxhetit apo raportet për detyrimet financiare dhe më pak mbi përgatitjen e raporteve periodike mbi ecurinë dhe statusin e implementimit të objektivave të vendosura apo edhe çështjeve që lidhen me sistemet e kontrollit të brendshëm (kryesisht ky proces realizohet nga ministritë e linjës apo dhe disa institucione të pavarura).

Ndërkohë, situata mbetet jo në nivel të kënaqshëm në njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku ende mungojnë strategjitë, politikat apo procedurat standarde për menaxhimin e të dhënave që përcaktojnë pritshmëritë e kontrollit për informacionin, përdorimin e sistemeve të informacionit, cilësinë dhe periodicitetin e raportimeve. Kjo situatë është krijuar kryesisht si pasojë e nivelit të ulët të angazhimit të drejtuesve mbi zhvillimin e kësaj fushe.

Për arritjen e performancës maksimale, në vijim mbeten për t'u adresuar rastet që lidhen me mundësinë e transmetimit të informacioneve të pasakta apo jo relevante apo rëndësinë e hartimit të një metodologjie komunikimi. Gjithashtu, mbetet i nevojshëm formalizimi i procedurave për transmetimin e informacionit me njësitë e varësisë si dhe transmetimi i një informacioni gjithëpërfshirës.

Në përputhje me parimet dhe procedurat e sistemeve të komunikimit të brendshëm, dhe për komunikimin e jashtëm, pjesa më e madhe e njësive kanë përcaktuar rregullat bazë për

zbatimin e këtij komunikimi në rregulloren e brendshme të institucionit. Nisur nga veprimtaria specifike që kryejnë këto njësi, evidentohet se, pothuajse të gjitha njësitë publike hyjnë në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresor apo në rrugë elektronike nëpërmjet aksesit në adresat zyrtare të e-mailit.

Pothuajse të gjitha njësitë e marra në analizë pohojnë se zbatojnë procedurat për konsultimin publik në kuadër të transparencës lidhur me aktivitetet mbi hartimin e buxhetit, projektet apo investimet, realizimi i të cilave ka impakt në shoqëri.

V. Monitorimi

Sistemi dhe komponentët e tij të veçantë mund të vlerësohen nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të monitorimit dhe nëpërmjet një sistemi vlerësimesh të shkëputura. Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten efiçente me kalimin e kohës.

Në kryerjen e monitorimit, titullari i njësisë, NA dhe menaxherët e tjerë, duhet t'i kushtojnë vëmendje gjendjes së MFK-së dhe objektivave të arritura. Procedurat e vendosura për monitorim duhet të jenë në përputhje me kulturën dhe rregullat e brendshme të njësisë, si dhe të garantojnë përshtatshmërinë me rregullat. Sistemi i MFK-së kërkon monitorim të vazhdueshëm për të mundësuar vlerësimin sa më të mirë të funksionimit të këtij sistemi, për të bërë përditësimet në kohën e duhur në rast të ndryshimit të rrethanave dhe mënyrave të operacioneve, si dhe për të identifikuar masat që synojnë një zhvillim të vazhdueshëm të sistemit.

Ky komponent përfshin dy parime, zbatimi i të cilave ndihmon për të arritur një sistem monitorimi efektiv. Për vitin 2023, komponenti i monorimit vlerësohet pjesërisht efektiv duke ritheksuar nevojën për përmirësimin e kuadrit rregullator dhe krijimin e një sistemi procedurash për monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Ndryshimet në kuadrin rregullator, ndryshimet në staf apo praktikat e burimeve njerëzore janë ndryshime që ndikojnë në mjedisin e kontrollit dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar ndryshimet e mundshme është i nevojshëm krijimi i një sistemi monitorimi efektiv dhe të vazhdueshëm.

Pjesa më e madhe e institucioneve vijon të bazohet në dokumentin e rregullores së brendshme për zbatimin e rregullave për monitorimin dhe raportimin e realizimit të objektivave të përcaktuar duke evidentuar nevojën për hartimin e një sistemi të procedurave të shkruara, manualeve dhe hartave të proceseve të punës ku të jenë ndarë në mënyrë të qartë detyrat dhe përgjegjësitë për realizimin dhe raportimin periodik të tyre. Ende nuk është bërë praktikë pune vlerësimi dhe monitorimi i elementëve të ndryshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili kur ndërthuret me lëvizjet e shpeshta të stafit, sjell një ulje të performancës të këtij sistemi dhe veprimtarisë së vetë institucioneve.

Një element tjetër i rëndësishëm, i lidhur ngushtë me procesin e monitorimit është raportimi dhe adresimi i mangësive të evidentuara. Planet e veprimit për ngritjen e sistemit të MFK ndihmojnë në evidentimin e masave konkrete, afateve dhe strukturave përgjegjëse për adresimin e problematikave të evidentuara gjatë vlerësimeve. Ajo që vihet re gjatë këtij viti,

është fakti se ende ka një mungesë ndërgjegjësimi për realizimin e monitorimit dhe hartimin e planit të veprimit, ku, një pjesë e institucioneve nuk kanë respektuar formatin e duhur të planit të veprimit, nuk kanë hartuar një plan veprimi për vitin 2024 apo mbajnë ende në përdorim planet e hartuara për vitin 2023. Situatë e përmirësuar vërehet për ministritë e linjës, dhe institucionet e pavarura, ndërkohë që njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe sh.a-të me kapital shtetëor, rezultojnë të jenë më pak efektive në këtë drejtim.

Nga përgjigjet e dhëna në pyetësor, por edhe nga rezultatet e procesit të vlerësimit të cilësisë, pjesa më e madhe e njësive të marra në analizë pohojnë se menaxhimi identifikon mangësitë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe i bëhen të njohura titullarit apo nëpunësit autorizues, por në pak raste këto mangësi përfshihen në planet e veprimit së bashku me evidentimin e masave korrigjuese për adresimin e tyre. Ky proces realizohet formalisht nga institucionet të cilat janë monitoruar në vend nga DH/MFKK gjatë periudhës 2022-2023, ndërkohë që për pjesën tjetër të institucioneve ende nuk është kthyer në një praktikë pune.

2.2 Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në bashkitë e përzgjedhura për asistencë teknike nga Projekti i Financave Lokale

Prej një harku kohor mbi 5 (pesë) vitesh, Ministria e Financave në bashkëpunim me Projektin e Financave Lokale, të financuar nga qeveria zvicerane, kanë bashkëpunuar ngushtë për forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm me të gjithë elementët e tij në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Gjatë vitit 2023, stafi i DPH/KBFP dhe ekspertët e projektit u fokusuan kryesisht në realizimin e aktiviteteve në përmbushje të rezultateve të mëposhtme:

(i) Bashkëpunimi për rishikimin e akteve ligjore dhe nënligjore të sistemit te menaxhimit financiar dhe kontrollit që sjellin përmirësimin e mjedisit të kontrollit në të gjitha njësitë publike;
(ii) Forcimi i menaxhimit të risqeve që cënojnë veprimtarinë e bashkisë, veçanërisht në lidhje me procesin e planifikimit të buxhetit afatmesëm;
(iii) Përmirësimi i kapaciteteve të stafit në të gjitha bashkitë: Kjo përfshin përmirësimin e aftësive të tyre në raportimin financiar periodik dhe monitorimin efektiv të sistemeve të kontrollit të brendshëm.
(iv) Përmirësimi i kapaciteteve dhe efektiviteti i funksionit të audituesve të brendshëm në auditimin e sistemit të menaxhimit të të ardhurave vendore.

Për sa më lartë, konkretisht:

- ✓ Gjatë vitit 2023, ekipi i projektit Financat-Lokale ka qenë aktivisht i angazhuar me stafin e DH/MFKK për të dhënë kontribut gjatë procesit të rishikimit të manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, me fokus kryesor në forcimin e tre linjave të mbrojtjes së shpenzimeve publike, dhe rishikimin e instrumentave të MFK-së.
- ✓ Vijoi puna me asistencë direkte dhe në distancë të 45 kordinatorë risku dhe drejtues financash të bashkive që u përfshinë në zbatimin e metodologjisë së re të planifikimit afatmesëm vendor sipas funksioneve 2024-2026, mbi identifikimin dhe adresimin paraprakisht të risqeve potencialë, duke siguruar efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e programeve buxhetore vendore. Në këtë kuadër në bashkëpunim me Shkollën e Administratës Publike, 27 koordinatorë të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorë risku nga 18 bashki u trajnuan për çështjet e kontrollit të brendshëm bazuar në risk, dhe u certifikuan në përfundim të tij.
- ✓ Gjatë tre viteve të fundit, njësitë vendore kanë raportuar rregullisht për vështirësitë e tyre financiare, me mbështetje nga ekipi i projektit dhe monitorim të ngushtë nga Ministria e

Financave. Kjo vëmendje e shtuar e menaxhimit të lartë ka çuar në përmirësimin e menaxhimit të financave vendore. Është pikërisht cilësia e raportimit financiar që luan një rol vendimtar në ndihmën e menaxhimit të lartë të njësisë vendore për të marrë vendime të informuara, duke rritur përgjegjësinë ndaj tatimpaguesve dhe duke përmirësuar reputacionin e njësisë. Si rezultat i bashkëpunimit midis ekipit të projektit dhe stafit të MF, Ministri i Financave miratoi urdhërin Nr. 52/6.03.2023 për të gjitha degët e thesarit, që të gjenerojnë në SIFQ dhe dërgojnë mbi bazë kërkese mbi 20 raporte financiare periodike për njësitë vendore gjatë gjithë vitit fiskal.

- ✓ Është thelbësore që auditimi i brendshëm, si një funksion i rëndësishëm për monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të sjellë vlerë shtesë për njësitë vendore duke fokusuar punën audituese në çështjet e menaxhimit të të ardhurave vendore që janë relevante qoftë për menaxhimin ashtu edhe për përfituesit e shërbimeve vendore. Prandaj përmirësimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të auditimit dhe përditësimi me ndryshimet ligjore mbetet i rëndësishëm në krye të listës së prioriteteve. Në këtë kontekst, u zhvilluan 4 trajnime rajonale (3 ditë secili) në bashkëpunim me Ministrinë e Financave. Këto trajnime, mblodhën mbi 100 audituesë të brendshëm nga 47 bashki dhe u fokusuan në auditimin e bazuar në risk të sistemit të menaxhimit të të ardhurave lokale.

KONKLUZION I DH/MFKK PËR VLERËSIMIN E SISTEMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT PËR VITIN 2023

Për vitin 2023 , për njësitë publike raportuese, janë evidentuar zhvillime por edhe devijime të vogla nga kuadri ligjor e rregullator në fuqi për fushën e kontrollit të brendshëm të cilat ndikojnë në progresin e funksionimit të sistemi të MFK-së.

DH/MFKK është angazhuar të sigurojë konkluzione dhe rekomandime të qenësishme duke u bazuar në vlerësimin e dokumentacioneve të depozituara nga njësitë publike raportuese si dhe nga vlerësimi në vend i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në NJQP-të e përzgjedhura për vlerësim cilësie.

Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm nëpërmjet vetëvlerësimit të njësive publike raportuese dhe vlerësimit në vend të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm të NJQP-ve bazohet respektivisht në nenin 18, pika 1 dhe nenin 26, pika 2 e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar. Gjithashtu, vlerësimi i performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm nëpërmjet 18 treguesve gjithëpërfshirës, të vlerësuar sipas Metodologjisë për monitorimin e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" (miratuar me Urdhrin e ministrit përgjegjës për financat nr. 117, datë 01.04.2019, i ndryshuar) përbën një nga informacionet bazë për prezantimin e ecurisë së veprimtarisë së planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit dhe zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Për sa më sipër evidentojmë problematikat e konstatuara si më poshtë:

- Në mbështetje të analizës mbi pyetësorët e vetëvlerësimit për të gjitha grupet e njësive të marra në analizë (ministri linje, njësi të vetëqeverisjes vendore, institucione të pavarura dhe grupit 87, Sh.A-të me kapital shtetëror dhe njësi shpenzuese me buxhet të madh) rezulton se edhe për këtë vit, vlerësim më të lartë marrin grupi i ministrive të linjës ndërkohë që situata vijon të paraqitet jo e kënaqshme në njësitë e vetëqeverisjes vendore pavarësisht rritjes së lehtë të nivelit maksimal të pikëve për vlerësimin e performancës. Sh.A-të si njësi të reja raportuese, kanë nevojë për përmirësimin e mënyrës së raportimit.

- Rezultojnë ende vështirësi në procesin e lidhjes së objektivave strategjikë dhe operacionale, si dhe detajimit të objektivave në plane konkrete veprimi duke përcaktuar linjat e qarta të përgjegjshmërisë për përmbushjen dhe raportimin e tyre nga të gjithë menaxherët.
- Procesi i menaxhimit të riskut rezulton lehtësisht i përmirësuar, por jo i strukturuar si duhet kryesisht me elementët që lidhen me riskun e mashtrimit duke mos marrë në konsideratë format e ndryshme të mashtrimeve, si falsifikimi i dokumentave, raportimi i informacionit të pasaktë për gjendjen financiare apo performanca në përmbushjen e objektivave të përcaktuar.
- Në lidhje me procedurat monitoruese, njësitë zbatojnë pjesërisht procedurat monitoruese, vlerësuese e raportuese për sistemin e kontrollit të brendshëm. Në pjesën më të madhe të institucioneve, pyetësori i vetëvlerësimit është instrumenti i vetëm për kryerjen e kontrollit nga ana e menaxherëve dhe gjen një përdorim të vogël plani i veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
- Institucionet vijojnë të paraqesin vështirësi në hartimin apo zbatimin e instrumentave të menaxhimit financiar dhe kontrollit (regjistër risku, plani i menaxhimit të risqeve, manuali i proceseve të punës, gjurmë auditimi).
- Në përgjithësi delegimi i funksioneve kryhet në përputhje me procedurat ligjore në fuqi dhe realizohet kryesisht për autorizimin e punonjësve në mungesë, ndërkohë që delegimi sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor të MFK përdoret në pak raste.

Për sa më sipër, nga analizimi i detajuar i bazës së të dhënave, konstatojmë se, sistemi i kontrollit të brendshëm për vitin 2023 paraqitet pjesërisht efektiv, ku progresi i mëtejshëm në zhvillimin e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm duke përfshirë një kuadër ligjor dhe nënligjor në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira si dhe rritjen e përgjegjshmërisë menaxheriale në funksion të zbatimit të instrumentave të kontrollit të brendshëm përbëjnë standardet themelore për të vijuar angazhimin e qeverisë për aderimin në Bashkimin Evropian.

KAPITULLI III. VLERËSIMI I CILËSISË SË SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Procesi i vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm shërben për vlerësimin e efektivitetit të funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, identifikimin e mangësive kryesore si dhe planifikimin e rekomandimeve të nevojshme për adresimin e tyre. Procedurat për realizimin e procesit të vlerësimit të cilësisë janë përcaktuar në dokumentin e Metodologjisë për Vlerësimin e Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme (miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 311, datë 23.12.2020).

Në përmbushje të dispozitave ligjore të fushës së kontrollit të brendshëm (neni 18, pika 3 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar), MF e realizon procesin e vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm bazuar në raportet vjetore të konsoliduara të përfituesve të fondeve publike mbi statusin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditimit të brendshëm. Pyetësorët e vetëvlerësimit janë instrumenti kryesor për analizimin e komponentëve dhe parimeve të kontrollit të brendshëm, informacioni i të cilave, depozituar çdo vit nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, pavarësisht integritetit dhe pergjegjshmërisë menaxheriale të nëpunësit autorizues, mund të mbartë në vetëvete nota subjektivizmi. Ky element mbahet në konsideratë gjatë vlerësimit profesional dhe realizimit të analizës së rezultateve të vlerësimit të efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Për sa më sipër, në kushtet e sigurimit të një vlerësimi në detaje dhe sa më real të gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm, bazuar në nenin 25 dhe 26 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, ministri përgjegjës për financat nëpërmjet DH/MFKK është përgjegjës për vlerësimin e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në vend, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Ky proces, me synimin kryesor përmirësimin e standardeve të punës si dhe analizimin dhe vlerësimin me detaje të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, ofron një tablo të qartë dhe aktuale të stadit të zhvillimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe propozon rekomandimet e duhura për adresimin e mangësive të identifikuara.

Në përfundim të procesit të vlerësimit, hartohet një raport i detajuar me gjetje dhe rekomandime të cilat duhet të ndiqen në vazhdimësi nga institucionet e vlerësuara mbi ecurinë e veprimtarisë së tyre nëpërmjet planit të veprimit të MFK.

Bazuar në planin vjetor 2023 të DH/MFKK, referuar edhe kapaciteteve të DH/MFKK, për vitin 2023, u planifikua realizimi i procesit të vlerësimit të cilësisë në 20 (njëzetë) njësi të qeverisjes së përgjithshme ku u finalizua procesi i vlerësimit të cilësisë në 18 (tetëmbëdhjetë) NJQP, ndërkohë në 2 (dy) prej tyre ky proces nuk u realizua për shkak të mosangazhimit të këtyre institucioneve për vënien në dispozicion të grupit të vlerësimit të dokumentave zyrtarë të gjeneruar.

Përzgjedhja për vlerësim e këtyre njësive është kryer mbi bazën e vlerësimit të nivelit të riskut që paraqesin këto njësi në ushtrimin e veprimtarisë së tyre si dhe zbatimin rigoroz të sistemit të kontrollit të brendshëm. Gjithashtu, vlerësimi realizohet mbi bazën e listës së kontrollit shoqëruar me dokumentacion justifikues, dokument ky i ndryshëm nga pyetësori i vetëvlerësimit, i cili mundëson identifikimin e progresit të arritur deri në momentin e kryerjes së procesit të vlerësimit.

Në institucionet e vlerësuara, sistemi i kontrollit të brendshëm rezulton të jetë kryesisht "pjesërisht efektiv", ku evidentohet nevoja për rritjen e angazhimit dhe përfshirjes së punonjësve në realizimin me efektivitet të proceseve të punës dhe ndërgjegjësimit të nivelit të lartë menaxherial në ndërmarrjen e masave për adresimin e mangësive të evidentuara dhe zbatimin e instrumentave të MFK. Në mënyrë të përmbledhur, vlerësimi për këto institucione paraqitet si më poshtë:

Vlerësimi	**Institucionet**
Sistem efektiv i kontrollit të brendshëm	Ministria e Shëndetësise dhe Mbrojtjes Sociale, SPAK, Agjencia Autonome e Auditimit të Fondeve të BE
Sistem pjesërisht efektiv i kontrollit të brendshëm	Ministria e Brendshme, Bashkia Kukës, Bashkia Elbasan, Bashkia Shkodër, Komisioni i Prokurimit Publik, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Agjencia për Hapje Dialog dhe Bashkëqeverisje, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
Sistem jo efektiv i kontrollit të brendshëm	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Bashkia Fier, Bashkia Mallakastër, Bashkia Kurbin, Qendra Kombëtare e Kulturës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Bashkia Delvinë
Institucione në të cilat nuk është kryer vlerësimi i cilësisë	Bashkia Berat, Bashkia Konispol

Nga procesi i vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, rezultuan gjetjet e mëposhtme:

1. Rregullorja e Brendshme evidentohet si dokumenti bazë ku njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbështeten për funksionimin e tyre. Në përgjithësi, rregullat e përcaktuara në dokumentin e rregullores së brendshme rezultojnë të rishikuara me ndryshimet e fundit strukturore, ose rezultojnë në fazë rishikimi në momentin e realizimit të vlerësimit të cilësisë. Ndërkohë, rregullat për sjelljen dhe etikën janë miratuar nëpërmjet një dokumenti të veçantë, ose janë përfshirë në rregulloren e brendshme;
2. Programit Buxhetor Afatmesëm rezulton si dokumenti kryesor i përcaktimit të objektivave për realizimin e veprimtarisë së çdo strukture brenda institucionit dhe jo në të gjitha rastet janë hartuar planet vjetore të punës të konsoliduara, me objektiva operacionalë dhe aktivitete të specifikuara;
3. Menaxhimi i burimeve njerëzore realizohet duke respektuar rregullat e përcaktuara nga vetë institucioni apo nga Departamenti i Administratës Publike duke mbajtur në konsideratë edhe trajtimin dhe rritjen e kapaciteteve të punonjësve në fusha të ndryshme, shpesh jo të lidhura me fushën e manxhimit financiar dhe kontrollit. Trajnimi i punonjësve realizohet kryesisht nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnimet e realizuara nga ASPA;
4. Institucionet paraqesin vështirësi ose mungesë angazhimi në hartimin apo zbatimin e instrumentave të menaxhimit financiar dhe kontrollit (regjistër risku, strategji/plani i masave të risqeve, manuali i proceseve të punës, gjurmë auditimi);
5. Delegimi i funksioneve kryhet në përputhje me procedurat ligjore në fuqi dhe realizohet kryesisht për autorizimin e punonjësve në mungesë, ndërkohë që delegimi sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor të MFK përdoret në më pak raste;
6. GMS-të janë ngritur me urdhër të brendshëm të titullarit, të shoqëruara me plan veprimi, por në këto grupe diskutohen vetëm çështje të aspektit buxhetor dhe nuk ka evidencë që të jenë trajtuar çështje të MFK;
7. Në pjesën më të madhe të njësive nuk është ngritur GMR apo funksioni i koordinatorit të MFK për fushën e riskut, nuk është deleguar;
8. Në disa prej institucioneve, evidentohet një mungesë e vlerësimit apo monitorimit në vazhdimësi të sistemit të kontrollit të brendshëm me qëllim komunikimin dhe adresimin e problematikave të konstatuara. Kryesisht, vlerësimi dhe raportimi realizohet për veprimtarinë financiare të institucionit;
9. Njësitë e Auditimit të Brendshëm për ato institucione që kanë një strukturë të tillë (ose auditimi i kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit), në misionet e tyre audituese, kanë bërë një vlerësim gjithëpërfshirës për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm si dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse, por nuk evidentohet përfshirja e rekomandimeve në planet e zbatimit të masave.

Rekomandimet kryesore adresuar institucioneve në lidhje me këto gjetje, janë si më poshtë vijon:

1. Ngritjen e Grupeve të Menaxhimit të Riskut dhe realizimin e një procesi cilësor dhe efektiv të menaxhimit të riskut nëpërmjet zbatimit të funksioneve të Koordinatorit të MFK për fushën e riskut duke shfrytëzuar mundësinë e delegimit të këtij funksioni sipas kërkesave ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e MFK;
2. Rritjen e rasteve të delegimit të detyrave sipas kërkesave rregullatore të fushës së MFK, si një prej instrumentave që çojnë në rritjen e përgjegjshmërisë menaxheriale;

3. Gjithëpërfshirjen në trajtimin e problematikave që lidhen me zbatimin e sistemit të MFK gjatë mbledhjeve të GMS-ve, si dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e sistemit, duke i evidentuar këto takime në bazë dokumentare;
4. Miratimin dhe zbatimin e instrumentave të MFK me qëllim lehtësimin dhe përmirësimin e procedurave të funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm;
5. Standardizimin e procedurave të raportimit të përhershëm dhe periodik mbi informacionet që duhet ti raportohen drejtuesit dhe menaxherëve të tjerë të strukturave të institucionit, duke përfshirë raportim jo vetëm të informacioneve me karakter financiar. Dokumenti standardizues duhet të përmbajë formatet, mënyrën e raportimit, periodicitetin e raportimit, treguesit e performancës, si dhe mënyrën se si informacioni duhet të shpërndahet në të gjitha nivelet e njësisë;
6. Ndjekjen e zbatimit të planit të veprimit për ngritjen e sistemit të MFK-së duke raportuar në mënyrë periodike te Nëpunësi Autorizues (NA).
7. Sigurimin dhe zbatimin e funksioneve mbikëqyrëse/monitoruese nëpërmjet realizimit të shërbimit të auditimit të brendshëm apo përfshirjes së strukturave të tjera brenda institucionit për evidentimin e statusit të zhvillimit dhe efektivitetit të veprimtarisë së institucionit, duke ofruar siguri për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe ndikuar në përmirësimin e procesit të vendimmarrjes.

Për krijimin dhe zbatimin e mekanizmave për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna për përmirësimin e mëtejshëm të funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, të gjitha masat për adresimin e rekomandimeve, duhet të përfshihen në planin e veprimit të MFK për institucionin përkatës, pasi ky plan përbën bazën e punës për krijimin e një sistemi të shëndoshë të kontrollit të brendshëm. Gjithashtu, në funksion të përmirësimit të këtij sistemi, institucionet janë përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve përkatëse në kohën dhe cilësinë e duhur. Një kopje e planit të veprimit, me afatet dhe përgjegjësitë konkrete, dërgohet zyrtarisht pranë MF.

KAPITULLI IV- MBËSHTETJA E MF-SË PËR ZHVILLIMIN E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM

MF, nëpërmjet DP/KBFPRF, ushtron rolin e saj si rregullator, vlerësues, monitoues dhe mbështës i njësive publike gjatë procesit të ngritjes dhe zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm. Çdo vit, MF analizon dhe vlerëson performancën e veprimtarisë menaxhimit financiar, kontrollit dhe kontabilitetit, auditimit të brendshëm në sektorin publik në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuara të kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm, si dhe praktikat më të mira të fushës.

4.1. Aktivitet mbështetëse të MF të ndërmarra përgjatë vitit 2023.

- **Hartimi dhe përmirësimi i bazës ligjore/nënligjore të fushës së kontrollit të brendshëm.**

  Në vijim të rishikimit të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", me ligjin nr. 14/2023, ku fokusi kryesor ka qenë në rishikimin e terminologjisë së përdorur, saktësimin dhe forcimin e përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë publike, rolin dhe funksionet e strukturës përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar, kontrollit dhe kontabilitetit, funksionalitetin e Bordit të KBFP,

përmirësimin e sistemit të sanksioneve etj., prioritet është hartimi dhe përmirësimi i bazave nënligjore të fushës së menaxhimit financiar, kontrollit dhe kontabilitetit. Konkretisht:

- ✓ Në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, fokus ishte rishikimi i urdhrit të ministrit përgjegjës për financat nr. 108, datë 17.11.2016 për miratimin e "Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit" ,dhe udhëzimit nr. 28, datë 15.12.2011 "Për paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike".
- ✓ Në fushën e kontabilitetit fokus është hartimi i një manuali nga MF mbi përditësimin e njohurive të raportimit financiar në sektorin publik për punonjësit e financës dhe kontabilitetit, si dhe hartimi i një metodologjie për menaxhimin e aseteve në sektorin publik, bazuar në dokumentat e prodhuar nga faza e I e projektit për zzbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik (IPSAS), të cilat janë në fazë draftimi.

- **Vlerësimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.**

Gjatë vitit 2023, DH/MFKK është angazhuar në realizimin e procesit të vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në mbështetje të metodologjisë përkatëse (Urdhri i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 311, datë 23.12.2020), me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të procedurave të monitorimit dhe standardeve të punës, analizimin dhe vlerësimin me detaje të gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësitë publike, si dhe dhënien e rekomandimeve përkatëse për adresimin e mangësive të identifikuara. Për vitin 2023, është planifikuar realizimi i procesit të vlerësimit të cilësisë në 20 njësi të qeverisjes së përgjithshme ku, u realizua vlerësimi i cilësisë në 18 NJQP pasi dy prej tyre, bashkia Berat dhe bashkia Konispol nuk iu përgjigjën me dokumentacione grupit të vlerësimit. Këtyre institucioneve, në përputhje me kërkesat ligjore, iu tërhoq vëmendje me shkresë të ministrit përgjegjës për financat.

- **Ofrimi i asistencës teknike në 5 NJQP të përzgjedhura për tu asistuar pas vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm.**

Ofrimi i asistencës teknike fillon si proces që në momentin e vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në institucionin, i cili shërben për të identifikuar mangësitë në mënyrë që të vijohet më tej me asistencë konkrete.

Për sa më lart, nga vlerësimi i deritanishëm u identifikuan 5 institucione (Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Komisioni i Prokurimit Publik, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Agjencia e Bashkëqeverisjes) me një nivel jo të kënaqshëm të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dhe në vijim këto institucione u asistuan sipas specifikës së tyre, kryesisht mbi hartimin e planeve operacionale të punës, zbatimin e procedurave të delegimit dhe përdorimin e linjave të raportimit, ndërtimin dhe finalizimin e manualeve dhe hartës së proceseve të punës, gjurmës së auditimit për proceset kryesore të punës, regjistrin e riskut, planin e masave të menaxhimit të riskut, si dhe planin e veprimit për ngritjen e sistemit të MFK-së. Në kuadër të asistencës teknike u trajnuan 44 punonjës.

- **Ndërgjegjësimi i njësive publike mbi rolin dhe rëndësinë e zbatimit të sistemit të MFK-së**

Në kuadër të ndërgjegjësimit të njësive publike DH/MFKK ka realizuar këto aktivitete:

- ✓ Në bashkëpunim me ASPA janë trajnuar 399 nëpunës publikë për çështjet që lidhen me vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm (97 punonjës), konceptet e KBFP (46 punonjës), llogaridhënien menaxheriale (66 punonjës), si dhe menaxhimin e rrezikut (190 punonjës të njësive publike nga të cilët 15 prej tyre janë certifikuar).
- ✓ Në bashkëpunim me Projektin e Financave Lokale janë realizuar disa trajnime me fokus zbatimin e procesit të menaxhimit të riskut, instrumentet e MFK-së si dhe treguesit e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm. Në këto trajnime morën pjesë rreth 185 pjesëmarrës, përfaqësues të 46 njësive të vetëqeverisjes vendore.
- ✓ Lidhur me risitë e ndryshimve të ligjit të MFK, u organizua trajnim për informimin dhe mënyrën e raportimit më përfaqësues nga sh.a-të me kapital shtetëror, të cilat sipas ndryshimit të ligjit të MFK nr.14/2023, u bënë pjesë e institucioneve që duhet të raportojnë në Ministrinë e Financave mbi zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e tyre.

- **Vijimin e progresit të funksionimit të KBFP bazuar në aktivitetet e parashikuara në dokumentat strategjikë**

Gjatë periudhës raportuese, DH/MFKK, në kuadër të procesit të integrimit të vendit tonë në BE, ka realizuar vlerësimin, hartimin dhe raportimin periodik mbi ecurinë e aktiviteteve të parashikuara në fushën e kontrollit të brendshëm dhe kontabilitetit në sektorin publik sipas kapitujve respektivë 6, 22, dhe 32. Gjithashtu, kontribut është dhënë edhe për rishikimin e strategjisë së menaxhimit të financave publike nëpërmjet përcaktimit të objektivave kryesore në planin e masave 2023-2026.

- **Përmirësimi në fushën e Kontabilitetit të Sektorit Publik në Shqipëri.**

Që prejt vitit 2018, Banka Botërore, nëpërmjet financimit nga Sekretariati Zvicerian i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO), po mbështet Ministrinë e Financave (MF) në zbatimin e reformës për zhvillimin e kontabilitetit në sektorin publik në Shqipëri, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, duke patur si synim kryesor përmirësimin e vendimmarrjes, përgjegjshmërisë, transparencës dhe performancës në sektorin publik. Kjo reformë mbështetet në qasjen e adoptimit me faza (nga viti 2021 – 2027), të cilat janë parashikuar në Strategjinë dhe Planin e Veprimit të Vendit si dhe është në mbështetje të prioriteteve të përcaktuara në Strategjinë e mëparshme të Menaxhimit të Financave Publike (PFM 2019- 2022) si dhe do të vazhdojnë të jenë të parashikuara në strategjinë e ardhshme.
Realizimi i kësaj reforme ka filluar që nga viti 2018 dhe përmes projektit të implementuar deri në dhjetor 2022 ka realizuar sa më poshtë vijon:

- Krijimin e kornizës rregullatore për kontabilitetin dhe raportimin financiar bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS) dhe parakushteve të tjera të domosdoshme për realizimin e kësaj reforme. Kjo është kryer përmes përgatitjes të një metodologjie të re të kontabilitetit dhe të proceseve të punës të lidhura me të. Kjo bazë e re rregullatore përbëhet nga dhjetë udhëzime që mbulojnë të gjitha fushat e kontabilitetit në përputhje me IPSAS si inventarët, provigjionet, aktivet afatgjata jomateriale, aktivet afatgjata materiale mbi shpenzimet si dhe mbi përfitimet sociale dhe përfitimet e punonjësve, të ardhurat, mbi konsolidimin e

pasqyrave financiare si dhe mbi instrumentat financiarë si dhe nga plani i llogarive bazuar në kontabilitetin mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara (IPSAS). Kjo tërësi dokumentash do të mundësojë hartimin e bazës ligjore për hyrjen në fuqi të zbatimit të metodologjisë të re. Gjithashtu, ka përfunduar procesi i përkthimit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS) nëpërmjet programit TRADOS dhe është nënshkruar marrëveshja me Federatën Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC) për përfitimin e të drejtës për përkthimin e këtyre standardeve në gjuhën shqipe si dhe publikimin e tyre.

- Zhvillimi i kapaciteteve dhe aftësive profesionale në fushën e kontabilitetit për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe për financierët e sektorit publik. MFE në bashkëpunim me kompaninë konsulente ndërkombëtare The Chartered Institute of Public Finance and Accountancy (CIPFA) ka realizuar aktivitetin e trajnimit dhe testimit të trajnerëve për kontabilitetin dhe raportimin financiar në sektorin publik bazuar në standardet IPSAS, ku morën pjesë 28 pjesëmarrës të përzgjedhur nga MFE si dhe nga palët e interesit, aktivitet i cili u konkludua me realizimin e një testimi. Gjithashtu, është realizuar pilotimi për herë të parë i trajnimit mbi kontabilitetin në sektorin publik dhe raportimit financiar bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS), duke trajnuar 100 pjesëtarë të stafit të angazhuar në fushën e kontabilitetit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme në Republikën e Shqipërisë si dhe ka përfunduar procesi i trajnimit të 400 punonjësve të tjerë. Ndërkohë, është konfiguruar mënyra e ruajtjes dhe e përditësimit të njohurive dhe aftësive të punonjësve të kontabilitetit, nevojë e domosdoshme për zbatimin me sukses të reformës, përmes përgatitjes së politikave dhe programeve të Edukimit të Vijueshëm që parashikohet të bëhet operacionale gjatë viteve 2024 e në vazhdim.

Ndërkohë, në vijim të arritjeve të mësipërme, është vijuar dhe po procedohet me hartimin e dokumentit të projektit, në lidhje me miratimin e projektit të ri mbi implementimin e reformës në fushën e kontabilitetit të sektorit publik, duke identifikuar aktivitetet, produktet, rezultatet, si dhe kohën e zbatimit të hapave të mëtejshëm.

Bazuar në arritjet si më sipër, u vlerësua se MF ka kapacitetet për të siguruar drejtimin metodologjik dhe për të filluar zbatimin e fazës të dytë të reformës në fushën e kontabilitetit publik, që do të konsistojë në zbatimin e metodologjisë së re kontabël dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të qeverisë qendrore të bazuar në IPSAS. Në këtë kuadër, është punuar në drejtim të konceptimit të një projekti të ri në bashkëpunim me BB dhe janë bërë hapat e nevojshëm për sigurimin e financimit të tij me fonde të huaja (donacion). Më poshtë, po ju paraqesim konceptin e projektit për zbatimin e metodologjisë të re të kontabilitetit në sektorin publik të diskutuar me BB dhe SECO, qëllimi final i të cilit është përgatitja e pasqyrave financiare individuale dhe të konsoliduara mbi bazë IPSAS, proces i cili pritet të fillojë në vitin 2027. Ky qëllim do të realizohet përmes aktiviteteve si më poshtë:

1. Realizimin e zhvillimit të sistemit SIFQ bazuar në nevojat e identifikuara të përgatitura gjatë fazës të parë me projektin aktual që do të mundësojnë përshtatjen e sistemit me metodologjinë e re kontabël, përmirësimin e konfigurimeve ekzistuese që sigurojnë regjistrimet kontabël dhe raportimin financiar si dhe automatizimin e proceseve të hartimit të pasqyrave financiare të konsoliduara të qeverisë.
2. Realizimi i ndryshimeve të nevojshme ligjore për të mundësuar heqjen e pengesave për fillimin e zbatimit të metodologjisë të re kontabël dhe përgatitjen e pasqyrave financiare bazuar në IPSAS.

3. Krijimi i funksioneve dhe kapaciteteve të reja brenda strukturës përgjegjëse për thesarin dhe strukturën përgjegjëse për metodologjinë kontabël, për të garantuar raportim financiar të saktë nga ana e institucioneve publike, bazuar në IPSAS.
4. Sigurimi i ekspertizës kontabël të nevojshme për të mbështetur drejtpërdrejtë institucionet publike në çeljen e llogarive të reja kontabël në përputhje me metodologjinë e re bazuar në IPSAS, në kryerjen e vlerësimeve dhe të çmuarjeve kontabël, në realizimin e njohjeve dhe të matjeve kontabël dhe përgatitjen e pasqyrave financiare individuale dhe të konsolidura në përputhje me kërkesat e IPSAS.
5. Vijimi i rritjes së kapaciteteve teorike dhe praktike si dhe zhvillimi profesional për rreth 1500 kontabilistë dhe auditues të brendshëm të sektorit publik mbi Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik, proces ky i nisur gjatë këtij projekti dhe që duhet të përfundojë gjatë projektit të ri.

Kohëzgjatja e zbatimit të këtij projekti parashikohet 3 vjet dhe është në përputhje me parashikimet në Strategjinë dhe Planin e Veprimit për reformën në kontabilitetin e sektorit publik. Sipas vlerësimeve nga ekipi i zbatimit, pavarësisht kompleksitetit të procedurave të miratimit, është e mundur që ky projekt të fillojë nga zbatimi gjatë vitit 2024.

4.2 Impakti për vitin 2023.

Gjatë vitit 2023, DH/MFKK ka kryer një sërë aktivitetesh në funksion të realizimit të objektivave të vendosura, me synimin kryesor garantimin e një sistemi të financave publike që nxit transparencën, përgjegjshmërinë, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike për ofrimin e shërbimeve të përmirësuara dhe zhvillimin ekonomik.

Vlerësimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në NJQP dhe ofrimi i asistencës teknike së bashku me aktivitetet e ndërmarra kanë sjellë një përmirësim të sistemit të MFK-së në disa institucione publike duke rezultuar në një performancë më të mirë të tyre të karakterizuar nga operacione të përmirësuara të sistemit të planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit, si dhe forcimin e mekanizmave për garantimin e përgjegjshmërisë menaxheriale. Gjithashtu, realizimi i programeve të trajnimit në fushën e kontrollit të brendshëm dhe raportimit financiar ka ndihmuar dukshëm në forcimin e kapaciteteve të menaxherëve dhe stafit dhe rritjen e interesit për zbatimin me rigorozitet të kërkesave në këtë fushë, si dhe kryerjen me eficiencë të funksioneve të përcaktuara.

Pavarësisht arritjeve të evidentuara në zhvillimin e instrumentave të mjedisit të kontrollit dhe aktiviteteve të kontrollit, vlen të theksohet nevoja për një ndërgjegjësim dhe angazhim më të madh të titullarëve, nëpunësve autorizues dhe menaxherëve të tjerë për zhvillimin e qëndrueshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm në të gjitha nivelet. Vlen të theksohet se, kuadri institucional dhe organizativ është një element i cili duhet të forcohet në të gjithë dimensionet, duke siguruar një qëndrueshmëri të strukturave organizative e nevojshme për përmbushjen e funksioneve administrative, si dhe përmirësimin e koordinimit ndërmjet institucioneve të ndryshme.

KAPITULLI V. REZULTATET KRYESORE DHE PROGRESI NË ARRITJEN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË TË VEPRIMTARISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM PUBLIK

Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike dhe axhenda e integrimit evropian të vendit janë pikënisja për planifikimin strategjik të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik, në nivel institucional dhe të sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.

5.1 Analizë e veprimtarisë së auditimit të brendshëm

5.1.1 Planifikimi i Angazhimeve të Auditimit

Auditimi i brendshëm i ofron titullarit të njësisë publike siguri të arsyeshme mbi efektivitetin e menaxhimit të riskut, proceseve të kontrollit dhe qeverisjes. Ai ndihmon gjithashtu njësinë e audituar në arritjen e objektivave dhe gjithashtu kontribuon në menaxhimin me efiçencë dhe efektivitet të burimeve duke nxitur një kulturë të performancës (ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet). Auditimi i brendshëm edhe pse indirekt kontribuon në qeverisjen e përgjithshme si dhe në arritjen e objektivave ambiciozë të axhendës dhe programit financiar të saj. Bazuar në vlerësime të thelluara të riskut për çdo njësi publike të audituar , audituesit e brendshëm identifikojnë risqet që kërcënojnë apo mund të kërcënojnë objektivat dhe programin qeverisës të cilat përfshihen në planet strategjike dhe vjetore të veprimtarisë audituese.
Në Planin Strategjik 2023–2025 dhe Plani i Auditimit për vitin 2023 (të konsoliduar) të 136 NJAB-ve, u parashikuan të mbuloheshin me auditim 1062 fusha dhe sisteme, të cilat u vlerësuan duke u mbështur në disa faktorë të rëndësishëm të tillë si:

- Vlerësimin e risqeve strategjike, financiare dhe të përputhshmërisë për çdo sistem dhe fushë;
- Prioritizimi i sistemeve sipas nivelit të riskut të vlerësuar duke siguruar që sistemet me risk të lartë të auditohen çdo vit;
- Gjetjet nga auditimet e brendshme të mëparshme dhe auditimet e KLSH-së;
- Kërkesa të titullarëve dhe organeve drejtuese për auditime të fushave specifike
- Burimet dhe kapacitetet e auditimit.

Të dhënat e planit të konsoliduar vjetor të NJAB-ve janë analizuar me të dhënat e auditimeve të realizuara, evidentuar në 128 raportet vjetore të veprimtarisë së NJAB.


Mbështetur në planifikimin e çdo njësie të auditimit të brendshëm (NJAB), Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm (DH/AB) harton Planin Strategjik dhe Vjetor të konsoliduar të veprimtarisë audituese çdo vit. Vlerësimet dhe faktorët e riskut të përcaktuar nga NJAB-të janë identifikuar dhe tendencat dhe zhvillimet e pritshme në fushën e veprimtarisë audituese i paraqiten në mënyrë të përvitshme Ministrit të Financave si dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Plani i konsoliduar është një mjet efektiv i monitorimit nga DH/AB të planifikimit të veprimtarisë audituese të çdo njësie. Nga analiza e përgatitjes dhe zbatimit të planeve DH/AB identifikon dobësitë për çdo NJAB në planifikimin e auditimeve dhe ka adresuar

individualisht problematikat duke rekomanduar dhe orientuar për korrigjimet e nevojshme, duke synuar cilësi të lartë në planifikimin e punës.

Gjatë vitit 2023, janë bërë ndryshime nga plani fillestar të cilat janë argumentuar dhe miratuar nga titullarët e njësive publike, megjithatë, NJAB-të mbeten ende larg pritshmërive për një planifikim efektiv dhe njëkohësisht fleksibël të veprimtarisë audituese.

Grafiku.2. Auditime të planifikuara dhe të realizuara në vite



Përgjatë vitit 2023, nga NJAB-të u përfunduan 971 angazhime auditimi që rezultuan në një nivel të realizimit të Planit Vjetor në vetëm 91,4 %.

Në grafikun e mësipërm paraqitet realizimi i angazhimeve të auditimit për vitin 2023 të ndara sipas llojit. Nga të dhënat e pasqyruara vërehet se gjatë vitit ka një numër të madh auditimesh të kombinuara (385 auditime) dhe auditime përputhshmërie (431 auditime), si dhe një numër i konsiderueshëm i auditimeve të pa planifikuara, 41 me kërkesë të titullarëve të njësive publike. Këto të fundit, zëvendësojnë llojet e tjera të auditimeve të planifikuara, për shkak të mos trajtimit të planeve paraprakisht me titullarët e njësive publike ose për shkak të ndryshimit të shpeshtë të këtyre të fundit.


Angazhimet e kryera përfaqësojnë 6 lloje të ndryshme të auditimit dhe përfshijnë:

Tabela 9. Lloji i angazhimit të auditimit

Lloji i Angazhimit të Auditimit	Nr. Auditime
Auditime të Kombinuara	385
Auditime të përputhshmërisë	431
Auditimime Financiare	81
Auditime të Performancës	20
Auditime të TI	10
Auditime Tematike (me kërkese të Titullarit)	41
Shërbime të Këshillimit	3
Total Auditime të Realizuara 2023	**971**

Gjatë vitit janë kryer vetëm 3 shërbime të këshillimit nga auditimi i brendshëm për titullarët e subjekteve publike, përgjithësisht kur është kërkuar hartimi i ligjeve, procedurave, apo projekte të reja, për të cilat audituesi ka dhënë mendimet por nuk është përfshirë në vendimmarrje. Shërbimet e këshillimit kërkojnë nivel të lartë të kapaciteteve profesionale të audituesve dhe njëkohësisht mbartin riskun e cënimit të pavarësisë për shkak të konfliktit të interesave që mund të shkaktohet. Për këtë shkak audituesit e brendshëm duhet të mbajnë në konsideratë të tilla risqe kur angazhohen në shërbimet e sigurisë.

Grafiku 3. Realizimi i auditimeve të planifikuara sipas llojit për vitin 2023



Në analizën e mosrealizimit të Planit Vjetor të Auditimit kanë ndikuar faktorë të rëndësishëm sikurse:

- Kapacitete të pamjaftueshme të strukturave të auditimit të brendshëm. Mungesa dhe qarkullim i stafit audites të çertifikuar; Qarkullimi i shpeshtë i stafit audites, largimi i audituesve me eksperiencë dhe të kualifikuar dhe zëvendësimi i tyre me staf të ri, çka tregon për humbje të investimit që është bërë më parë në kapacitete. Ky fenomen bëhet më i theksuar në NJAB e pushtetit vendor dhe shoqërive aksionare.
- Ndryshimi i prioriteteve në veprimtaritë e subjekteve të audituara, pra ndryshim i shkallës së vlerësimit të riskut, përgjatë vitit ushtrimor. Sisteme komplekse dhe të reja që kërkojnë më shumë kohë për tu audituar;
- Planifikim të pabazuar në burimet reale të NJAB (planifikojnë numër të madh auditimesh dhe nuk arrijnë ti realizojnë.
- Planifikim "me rezerva" ku vihet re që NJAB-të kanë më shumë kapacitete në dispozicion duke planifikuar një numër të kufizuar auditimesh por në fakt realizojnë shumë më tepër çka tregon mungesë efektiviteti dhe shpërdorim të burimeve.
- Kërkesa specifike të menaxhimit të lartë për auditime të fushave dhe sistemeve që janë paraqitur me risk më të lartë gjatë vitit;
- Procedura të zgjatura të auditimit si rezultat i komunikimeve dhe diskutimeve me palët e treta të përfshira në procesin e auditimit.

Mangësitë e vërejtura në planifikimin e veprimtarisë audituese mbartin riskun që angazhimet e auditimit nuk sigurojnë që risqet kryesore janë adresuar dhe fushat apo sistemet me risk të lartë e të mësëm që kanë ndikim thelbësor në arritjen e objektivave të jenë mbuluar me auditim. Ato gjithashtu "flasin" për një efiçiencë të ulët në planifikimin e burimeve të faktorëve të cilët mund të ndikojnë në të gjithë cilësinë e procesit të auditimit si gjatë punës në terren ashtu dhe në arritjen e objektivave të auditimit.

Dobësitë në planifikimin e veprimtarisë dhe ndryshimet e shpeshta gjatë vitit, bartin riskun që veprimtaria audituese të mos realizohet në mënyrë sistematike dhe të disiplinuar, duke vazhduar të jetë e orientuar nga inspektimet financiare. Me qëllim që t'i përgjigjet zhvillimeve dhe ndryshimeve të ambientit ku operojnë , qasja e auditimit me bazë risku duhet të aplikohet për të planifikuar angazhimet e auditimit, me qëllim që auditimet të fokusohen tek sistemet me risk më të lartë me qëllim që ti përgjigjen sa më mirë nevojave të subjektit, si në numër ashtu dhe sipas llojit të auditimit.

Gjatë procesit të konsolidimit të Planit Strategjik dhe Vjetor të NJAB, DH/AB ka identifikuar në mënyrë individuale të metat dhe dobësitë e çdo NJAB dhe i ka adresuar për ndryshim dhe përmirësimet përkatëse.

5.2 Treguesit kryesorë të performancës nga angazhimet e auditimit të brendshëm. Gjetjet dhe Rekomandimet e Auditimit.

5.2.1 Vlerësimi dhe prioritizimi i riskut të sistemeve

Në aplikimin e qasjeve se auditimit mbi bazë risku, si faktorë mbi të cilët NJAB-të kanë mbështetur përcaktimin e riskut për sistemet janë përzgjedhur në bazë të rëndësisë, natyrës së veprimtarisë së subjektit të audituar, objektivave të auditimit si dhe në mendimin dhe opinionin e titullarit.

Në vlerësimin e riskut faktorët që janë marrë në konsideratë nga audituesit përshijnë:

- Përcaktimi i qartë i objektivave të njësisë publike;
- Niveli i arritjeve të objektivave strategjikë të vendosura nga njësitë publike;
- Efektiviteti i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm;
- Ekspozimi ndaj parregullsive, etj;
- Lëvizjet e shpeshta të stafeve në strukturat menaxhuese;
- Kompleksiteti i veprimtarisë së njësisë publike.

Duke marrë parasysh që veprimtaritë e NJAB janë ushtruar në ambiente me shkallë të ndryshme kompleksiteti, fusha të ndryshme të përgjegjësisë, nivele të ndryshme të kualifikimit dhe të kapaciteteve audituese etj., analiza e raporteve të NJAB për qëllime të këtij raporti është realizuar e ndarë në disa grupime/klasa si: ministri linje, njësi shpenzuese me buxhet të madh, institucionet e pavarura, shoqëritë aksionere dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në këtë analizë janë evidentuar sistemet e vlerësuara me risk të lartë nga ana e secilit grupim, gjetjet më kryesore sipas sistemeve dhe rekomandimet e adresuara për përmirësimin e problematikave të evidentuara.

Nga sa më sipër, u evidentuan sistemet e prokurimeve, detyrimeve të prapambetura dhe aseteve, të cilat vlerësohen me risk të lartë në veprimtarinë audituese të të gjitha grupimeve të analizuara.

Tabela 10. Vlerësimi i riskut në njësitë publike


Kat.I	**Vlerësimi i riskut në Ministritë e Linjës**	• **Sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit.** • **Sistemin e prokurimeve, blerjeve dhe investimeve;** • **Sistemin e administrimit të aseteve;**

		• **Sistemin e koncesioneve, ankandeve dhe administrimit të pronës.** • **Sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit.** • **Sistemin e prokurimeve, blerjeve dhe investimeve;** • **Sistemin e administrimit të aseteve;** • **Sistemin e koncesioneve, ankandeve dhe administrimit të pronës.**
Kat.II	**Vlerësimi i riskut në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore**	• Sistemi i kontrollit të brendshëm. • Sistemi i menaxhimit buxhetor • Sistemet e menaxhimit të burimeve njerëzore • Sistemi i prokurimeve • Sistemi i menaxhimit të aktiveve • Sistemi i kontabilitetit • Sistemi i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura
Kat.III	**Vlerësimi i riskut në Institucionet Qendrore**	• Sistemin e menaxhimit e kontrollit financiar; • Sistemin e Teknologjisë së Informacionit; • Sistemin e prokurimeve, blerjeve dhe investimeve; • Sistemin e administrimit të aseteve; • Sistemin e detyrimeve të prapambetura.
Kat.IV	**Vlerësimi i riskut në Shoqëritë Aksionere**	• Sistemin e programimit financiar dhe të ardhurave; • Sistemin e prokurimeve, blerjeve dhe zbatimit të kontratave; • Sistemin e kontrollit të brendshëm.
Kat. V	**Vlerësimi i riskut në Institucionet e Pavarura**	• Sistemin e investimeve publike; • Sistemin e mbikëqyrjes së projekteve.

Vlerësimi i riskut të sistemeve, edhe pse është një element thelbësor mbi të cilin mbështetet çdo fazë e procesit audituesdhe ka impakt të rëndësishëm në arritjen e objektivave të auditimit, nuk bëhet në përputhje të plotë me kërkesat e standardeve, nuk kuptohet nga vetë audituesit dhe si i tillë gjen zbatim në nivel të ulët në praktikë. Kjo tregon mangësi në udhëzuesit dhe metodologjitë për qasjen e auditimit mbi bazë risku dhe kompetencat dhe aftësitë e audituesve janë të pamjaftueshme për të siguruar kryerjen e auditimeve me cilësi të lartë dhe efektivitet.

5.2.2 Gjetjet e auditimit

Struktura e gjetjeve sistemike nuk ka patur ndryshime, ku vijon të konsiderohet me dobësi deri në efekte negative financiare sistemi i prokurimeve, ku janë identifikuar numri më i madh i shkeljeve te procedurave të prokurimit publik. Po ashtu në fushën e tatim taksave dhe doganave kanë rezultuar me një numër të konsiderueshëm të devijimeve dhe shkeljeve të cilat kanë sjellë dhe efekt financiar negativ.



Grafiku 4. Numri i gjetjeve sipas sistemeve

Të tjera sisteme ku paraqitet nivel i lartë i gjetjeve dhe në nënsistemet përkatëse përfshijnë: sistemi i pagave dhe shpërblimeve, administrimi i aseteve, planifikimi buxhetit dhe sisteme të tjera operacionale sipas natyrës së subjekteve të audituara.

Rezultatet e punës audituese kanë evidentuar problematika të ndryshme në hallka të ndryshme të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes në nivel qëndror dhe vetëqeverisjes vendore, ashtu dhe agjencive shtetërore dhe shoqërive aksionere publike për të cilat janë dhënë opinionet dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e funksionimit efektiv të sistemeve të menaxhimit të riskut, kontrollit dhe qeverisjes, me qëllim që objektivat të arrihen dhe fondet publike të përdoren për qëllimin që ato janë buxhetuar, me ekonomi, eficensë dhe efektivitet.

Vëmendjen kryesore në raportimin e rezultateve të auditimit e kërkojnë shkeljet e disiplinës financiare të cilat kanë shkaktuar efekt financiar negativ në Buxhetin e Shtetit prej **473.2 milion Lekë** nga të cilat rreth 38.5% në sisteme të tjera specifike të njësive publike dhe rreth 23.1% e efektit është konstatuar në tatime, taksa. Vlera e shkeljeve financiare e konstatuar gjatë vitit 2023 është rritur në krahasim me vitin e mëparshëm. Edhe pse dëshmon një punë më të kujdesshme dhe aftësi më të mira investigimi të auditimit, ky tregues tërheq vëmendjen se perfomanca e subjekteve ku është identifikuar shkelja është e dobët dhe se sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit paraqesin risk të lartë të dështimit për përdorimin me efektivitet, ekonomi dhe efiçencë të fondeve publike.


Tabela 11. Gjetjet me efekt financiar negativ sipas sistemeve për vitin 2023

Nr.	**Gjetjet me efekt financiar negativ sipas sistemit**	**Dëmi ekonomik (000/lekë)**
1	Prokurim, blerje dhe investime	52,010.2
2	Paga, shpërblime, trajtime, komisione	37,456.98
3	Fondet e sig. shoq dhe shëndetësore	889.48
4	Tatime, taksa dhe dogana	109,134.68
5	Admin. prone dhe pasurie	54,515.79
6	Privatizime, shitje dhe qeradhënie	29,034.8

7	Koncesione dhe ankande	6,698
8	Legalizime, Urbanistikë, kth. Pronash	1,386
9	Kreditim, suvencione	2
10	Të tjera	182,104,15
	TOTALI	473,232.1

Për vlerën e efektit negativ të shkaktuar është kërkuar rikuperimi i shumës dhe ndjekja e arkëtimit deri në zhdëmtimin e plotë. Krahas, janë dhënë rekomandime për forcimin e kontrolleve dhe procedurave me qëllim parandalimin e përsëritjes të këtyre rasteve në të ardhmen.

Grafiku 5. Struktura e shkeljeve financiare sipas sistemeve kryesore



Nga Njësitë e Auditimit të Brendshëm janë identifikuar 8 raste të shkeljeve, të cilat në gjykimin profesional të audituesve janë dërguar për investigim të mëtejshëm tek Titullari përkatës për ndjekje nga Drejtoria e Inspektimit Financiar në MF dhe në institucione të tjera: 1 rast Ministria e Brendshme, 1 rast Ministria e Kulturës, 1 rast Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, 1 rast Ujësjellës Kanalizime Tiranë dhe 4 raste Bashkia Shkodër.

Roli i auditimit të brendshëm si një hallkë e rëndësishme në zinxhirin e luftës kundër korrupsionit dhe shpërdorimit të fondeve publike, duhet të forcohet jo vetëm në drejtim të identifikimit të shkeljeve dhe kërkimit për zhdëmtim, por sidomos të marrë një profil të ri i orientuar më shumë tek parandalimi dhe mos përsëritja e fenomeneve negative.

Kjo kërkon trajnime të thelluara për kualifikimin e kapaciteteve audituese, për t'i bërë të afta të identifikojnë fushat ku risku i mashtrimit dhe korrupsionit është më i lartë, duke ndikuar në një ndarje gjithnjë e më të qartë të rolit të audituesit të brendshëm nga inspektimi financiar, dhe në formimin e audituesit si profesionist, vlerësues e këshillues, i fokusuar jo vetëm në sisteme financiare por dhe jo financiare.
Auditimi i brendshëm në ministritë e linjës ka konstatuar mungesën e rregulloreve dhe udhëzimeve për aktivitete të caktuara të kontrollit, të cilat shërbejnë për të dhënë siguri që risqet janë mbjtur brenda kufijve të pranueshëm. Këto mangësi janë identifikuar kryesisht në në fushën e menaxhimit të aktiveve, e pagesave për aktivitete të veçanta, për kontrollin e zbatimit të kontratave të shërbimit dhe të blerjes së mallrave, etj.

Gjetjet kryesore në ***sistemin e prokurimeve*** evidentohen në:

- Mos argumentim dhe mbështetje me kërkesat dhe nevojat e njësisë në planifikimin për mallra/shërbime, si dhe përllogaritjen e fondit limit;

- Shkelje të procedurave të prokurimit publik përfshirë specifikimet teknike, procedurat e tenderimit, si dhe zbatimi i kontratave;
- Mos ndjekjen e të gjithë hapave ligjorë për blerjet me vlera të vogla, si dhe favorizimi në disa raste të blerjeve të të njëjtit operator ekonomik;
- Përllogaritje e pa argumentuar e fondi limit, si bazë për fillimin e procedurave të prokurimit;
- Nënshkrim të kontratës duke ndryshuar kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit me të cilat është shpallur fitues subjekti.

Gjetjet kryesore në ***sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit*** evidentohen në:

- Nivel i ulët i përgjegjshmërisë menaxheriale që ka të bëjë me ndarjen e përgjegjësive që lidhen me vendimarrjen, kontrollin, zbatimin dhe vendosjen e linjave të raportimit, në përputhje me përgjegjësitë e deleguara;
- Mungesën e strategjisë për menaxhimin e riskut, mangësi në identifikimin e risqeve dhe hartimin e përditësimin e regjistrave të risqeve;
- Mungesën e manualeve të proceseve të punës;
- Mungesën e hartimit dhe miratimin e gjurmëve të auditimit për proceset kryesore;
- Mos përcaktimin e qartë të detyrave për secilin punonjës.

Gjetjet kryesore në ***sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar*** evidentohen në:

- Mos menaxhimi i mirë nga njësitë publike i procesit të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve dhe kryesisht të aparaturave dhe pajisjeve;
- Mungesën e regjistrit të aktiveve nga njësitë publike;
- Mungesën e dokumentacionit të shfrytëzimit të mjeteve të transportit për shpenzimet e karburantit;
- Ngritjen e komisionit për vlerësimin e aktiveve dhe për nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre, në kundërshtim me rregullat në fuqi;
- Kryerjen e pagesave për blerje mallrash, pa hartuar më parë proces-verbalet e marrjes në dorëzim nga komisionet përkatëse dhe të pashoqëruara me dokumentacionin justifikues;
- Në problemet me menaxhimin e aseteve, në përdorimin dhe plotësimin e tyre me dokumentacionin specifik.

Gjetjet kryesore në ***sistemin e koncesioneve dhe ankandeve*** evidentohen në:

- Mos respektimin e kushteve të marrëveshjeve lidhur me garancitë financiare të marrëveshjeve.
- Mungesën e monitorimit të zbatimit të kontratave koncesionare që janë në fazën e ndërtimit ose kanë hyrë në fazën e shfrytëzimit;
- Mos monitorimin e veprimtarisë së sektorit të oponencës teknike;

Gjetjet kryesore në sistemin e **menaxhimit të burimeve njerëzore** evidentohen në:

- Mungesën e përshkrimeve të punës dhe mos vendosjes së treguesve të matshëm për të vlerësuar performancën.
- Mos plotësimin e vendeve vakante me persona që plotësojnë kërkesat për kualifikim dhe eksperiencë;

- Mos përcaktimin e rregullave të sakta dhe të qarta në rekrutimin e stafit;

Audituesit e brendshëm në ministritë e linjës kanë vlerësuar se sistemet e kontrollit të brendshëm në disa raste nuk funksionojnë efektivisht, si pasojë e mangësive në zbatimin e përshtatshëm të rregullave dhe procedurave. Këto dobësi janë më evidente dhe më të shpeshta në strukturat e varësisë për shkak të ndryshimit të shpeshtë të organizimit të strukturave dhe stafit, ndarjen jo të qartë të detyrave, ka mbivendosje, raste të konfliktit të interesit dhe mos zbatim të procedurave ligjore, evidentimin e personave përgjegjës, të cilët nuk kanë menaxhuar me efektivitet dhe efiçensë burimet njerëzore dhe financiare, parregullsi në dokumentimin dhe menaxhimin e aseteve publike.

✓ **Gjetjet në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore**

NJAB në njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë evidentuar gjetjet sipas sistemeve të mëposhtme:

Sistemin e prokurimeve, blerjeve

- Planifikim jo i saktë i nevojave duke mos marrë parasysh gjendjen e magazinave në fund viti të cilat rezultojnë me gjendje në shuma të konsiderueshme;
- Fondit limit të llogaritur i mungon argumentimi dhe analiza e nevojave nga sektorët përkatës në momentin e përgatitjes së PBA;
- Shkelja e parimit të barazisë në tendera dhe shpallja e padrejtë fitues e operatorit nga Komisioni pasi rezulton me detyrime të pashlyera ndaj organeve shtetërore.

Sistemi i pagesave të pagave, sigurimeve

- Mos rinovim i kontratave të punës me një afat të caktuar 3 mujor, pas mbarimit të periudhës së provës nuk janë nënshkruar kontrata të reja, tek të cilat duhet të cilësohet afati i ri kohor i marrëdhënies së punës të punonjësit;
- Punonjësit, të cilët janë transferuar në pozicione të tjera brenda institucionit nuk janë lidhur me kontrata të reja pune ku të evidentohet pozicioni i ri dhe afati kohor i këtij pozicioni;
- Dhënë shtesë page për punonjës të administratës në kundërshtim me kriteret e përcaktuara për shtesa mbi paga;
- Përllogaritje e gabuar e shtesës së vjetërsisë për pozicionin kategoria II, klasa IV, të vendosur gabim dhe jo në përputhje me aktet nënligjore;
- Në urdhërat e emërimit evidentohen se mungon specifikimi i kategorisë, grupit dhe vjetërsisë në punë që i takon punonjësit.

Sistemi i administrimit të pronave, pasurive

- Mungesë ose format i paplotë i regjistrit të aktiveve të qëndrueshme si pyje kullota plantacione, ndërtime dhe kostruksione, rrugë, mjete vepra ujore përveç vlerës **fillestare të kontabilitetit nuk përmban kërkesat specifike të përcaktuara në** udhëzimin përkatës;
- Nuk sigurohet plotësia e transaksionit. Në dokumentat fletë hyrje në magazinë mungonin procesverbalet e hartuara nga komisionet e marjes në dorëzim si dhe dokumentacioni tjetër shoqërues si fletë analizë, çertifikata, etj;

- Informacion i paplotë dhe jo i qartë lidhur me inventarin e aktiveve të qëndrueshme, gjë që vështirëson verifikimin fizik të tyre dhe vlerësimin nëse ky inventar është kryer në mënyrë korrekte për vetë hapësirën teritoriale të Bashkive;
- Fletët e inventarit janë të panënshkruara nga komisioni por vetëm nga punonjësit me përgjegjësi materiale;
- Për zërin mjete transporti është kryer vetëm inventarizimi fizik për konstatimin dhe rivlerësimin e tyre dhe nuk është vazhduar me procedurat e tjera të kontrollit periodik;
- Evidentohen probleme me trasferimin e aseteve, duke mos zbatuar aktet nënligjore në fuqi.

Gjetjet kryesore në ***sistemin e kontrollit të brendshëm*** evidentohen në:

- Mos përcaktimin e objektivave strategjikë;
- Mos përcaktimin e saktë të risqeve që mund të cënojnë realizimin e objektivave;
- Mos miratimin e rregulloreve të brendshme;
- Mos hartimin dhe përditësimin e përshkrimeve të punës.

Gjetjet kryesore në ***sistemin e programimit dhe zbatimit të buxhetit*** evidentohen në:

- Mos planifikimin real dhe mos realizimin e shpenzimeve me efektivitet dhe efiçencë;
- Mos realizimin e buxhetit në raport me objektivat e realizuara;
- Mos hartimin dhe monitorimin e procedurave për përfituesit nga lehtësirat e taksave dhe tarifave vendore.

Gjetjet kryesore në ***sistemin e menaxhimit të aktiveve*** evidentohen në:

- Mos hartimin dhe mos përditësimin e regjistrave të aktiveve (njësitë administrative-ish komuna;
- Mos administrimin e aktiveve për parandalimin e keqmenaxhimit të tyre;
- Mos plotësimin e dokumentacionit dhe ndjekjen e procedurave të inventarizimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të ndërtesave.

Gjetjet kryesore në sistemin e blerjeve dhe prokurimeve evidentohen në:

- Mos hartimin sipas përcaktimeve ligjore të regjistrave të prokurimeve

Audituesit e brendshëm në njësitë e qeverisjes vendore në lidhje me vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm kanë evidentuar dobësi materiale të cilat duhet të adresohen në mënyrë të menjëhershme nga titullarët/kryetari bashkisë. Ka nevojë për përmirësime në hartimin dhe përditësimin e rregulloreve, përcaktimin e saktë të detyrave dhe përgjegjësive, identifikimin e risqeve, etj.

✓ **Gjetjet në Institucionet Qendrore**

NJAB në grupin e njësive shpenzuese me buxhet të madh kanë evidentuar gjetjet sipas sistemeve.

Gjetjet kryesore në **sistemin e prokurimeve** evidentohen në:

- Mos respektimin e rregullave për argumentimin dhe dokumentimin qartësisht të llogaritjes së fondit limit;
- Përcaktimin e fondeve në kundërshtim me procedurat e miratuara;
- Realizimin e procedurave të prokurimit në kundërshtim me ligjet dhe aktet nënligjore;
- Pagesën e kontratave/faturave tatimore pa u realizuar punimet, kryer shërbimi, apo në kundërshtim me kontratën e firmosur.

Gjetjet kryesore në **sistemin e kontrollit të brendshëm** evidentohen në:

- Mos funksionimin e procesit të identifikimit, analizimit dhe menaxhimit të riskut;
- Mungesën e rregulloreve të brendshme, ndarjen konkrete të detyrave dhe përgjegjësive.

Gjetjet kryesore në **sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar** evidentohen në:

- Mungesën e kartelave të AQT sipas viteve të vënies në punë, vlerës fillestare, amortizimit të akumuluar dhe vlerës së mbetur;
- Mos vlerësimin e aseteve stok, për vënien në efiçensë apo nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre;
- Mos regjistrimin e pasurive të paluajtshme në zyrat vendore të regjistrimit të pasurive;
- Plotësimin e gabuar të pasqyrave financiare.

Gjetjet kryesore në **sistemin e detyrimeve të prapambetura** evidentohen në:

- Mos identifikimin e risqeve që pengojnë reduktimin, shlyerjen dhe parandalimin e detyrimeve të prapambetura;
- Mos kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të gjitha detyrimeve që nga koha e krijimit të tyre;
- Mungesa e Planit të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura dhe planifikimit të fondeve te dedikuara për pagesat;
- Mos respektim i qasjes FIFO në radhën e shlyerjes së detyrimeve.

Gjetjet kryesore në **sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore** evidentohen në:

- Mospërputhjen e kërkesave të vendit të punës me aftësitë dhe eksperiencën e stafit;
- Lëvizjet e shpeshta të stafit dhe mos plotësimin në kohë të vendeve vakante;
- Mos zbatimin e procedurave lidhur me punësimin, lëvizjen dhe largimin e stafit.

Audituesit e brendshëm në grupin e institucioneve me buxhet të madh në lidhje me vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm kanë evidentuar përmirësime të sistemit krahasuar me auditimet e mëparshme por akoma evidentohen dobësi në disa hallka të sistemeve, në mënyrë më specifike në zbatimin e politikave dhe procedurave. Shkaqet e këtyre dobësive kanë ardhur nga faktorë të tillë si: qarkullim i shpeshtë i stafit, procedura të cilat hasin vështirësi në zbatimin në praktikë, rregullat dhe normat e vendosura nuk përditësohen dhe si të tilla nuk i shërbejnë më objektivit për të cilin janë krijuar , menaxhimi i riskut bëhet më shumë si detyrë në formë dhe nuk ka cilësi në përmbajtje dhe kjo sjell si pasojë mungesën e aftësisë së institucionit për të menaxhuar me sukses risqet që cënojnë arritjen e objektivave etj.

✓ **Gjetjet në Shoqëritë Aksionere**

NJAB në shoqëritë aksionere kanë evidentuar gjetjet sipas sistemeve. Gjetjet kryesore në sistemin e kontrollit të brendshëm evidentohen në:

- Mos hartim të regjistrit të riskut;
- Mos hartimin e strategjisë për menaxhimin e riskut;
- Mungesën e veprimtarive të kontrollit;
- Mos hartimin dhe miratimin e gjurmës së auditimit;
- Mos përditësimin e manualeve të proceseve të punës.

Gjetjet kryesore në sistemin e prokurimeve evidentohen në:

- Mos hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike;
- Mos zbatimin e "Gjurmës së auditimit";
- Mos llogaritjen e drejtë të vlerës së fondit limit.

Gjetjet kryesore në sistemin e kontabilitetit dhe raportimit publik evidentohen në:

- Mos mirëmenaxhimin e bazës materiale të dalë nga magazina;
- Mungesën e procedurave të lëvizjes së materialeve;
- Mos marrjes në ngarkim të bazës materialo-teknike nga personat përgjegjës.

Gjetjet kryesore në sistemin e pagesave dhe shpërblimeve të punës evidentohen në:

- Pagesat për punën e kryer jashtë kohës normale të punës;
- Mos dokumentimin sipas kërkesave ligjore të shpenzimeve për udhëtim e dieta;
- Përfitime të pa justifikuara të pagës së grupit duke mos e argumentuar me dokumente justifikuese.

NJAB vlerësojnë që sistemet e kontrollit të brendshëm në subjektet e audituara nuk janë efektive dhe nuk kanë të miratuara procedura për funksionimin e tyre (OSHEE, KESH, OST, Posta Shqiptare, Albpetrol dhe Albgaz). Dobësitë bëhen dhe më të dukshme në kushtet e ekzistencës së një kuadri legjislativ tepër kompleks ku ushtrojnë veprimtarinë këto shoqëri.

5.2.3 Rekomandimet e Auditimit të Brendshëm

Rekomandimet e auditimit përcaktojnë dhe i japin prioritet masave dhe veprimeve që duhet të ndërmerren nga subjekti i audituar për një funksionim më të mirë të këtyre sistemeve, ndreqjen e parregullsive, ruajtjen e aseteve dhe minimizimin e rasteve të mashtrimit duke ndikuar në mirë administrimin e aseteve dhe fondeve publike.
Kuadri ligjor në fuqi, njeh të drejtën, por njëkohësisht detyrimin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit si përgjegjësi e titullarëve të subjekteve të audituara, por auditimi i brendshëm duhet të monitorojë dhe verifikojë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e rekomandimeve të dhëna dhe të pranuara, pasi vetëm në këtë mënyrë vlerësohet impakti dhe vlera e auditimit të brendshëm si promotor i ndryshimit pozitiv. Përgjegjësia përfundimtare e zbatimit të rekomandimeve të auditimit i përket titullarit/vendimmarrësit të subjektit të audituar, po aq sa dhe auditimi i brendshëm ka përgjegjësinë për cilësinë e rekomandimeve të dhëna, të cilat

duhet të adresojnë gjetjen e konstatuar, që zbatimi i masave të rekomanduara do të jetë zgjidhja efektive dhe e nevojshme për përmirësimin e sistemeve.

"Udhëzimi për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm" ndihmon audituesit e brendshëm dhe të gjitha NJAB-të për të matur vlerën dhe impaktin e punës audituese për subjektet e audituara. Udhëzuesi u sugjeron audituesve procedura dhe rregulla të unifikuara mbi mënyrën se si duhet të ndiqet niveli i pranimit dhe zbatimi i rekomandimeve, se si duhet të punohet për të matur deri në hallkën më të fundit rezultatet e auditimit dhe si duhet të raportohen këto rezultate. Të dhënat që kërkohet të raportohen kanë si qëllim të japin një pamje më realiste dhe të qartë mbi nivelin e pranimit apo të mos pranimit të rekomandimeve të auditimit nga njësitë e audituara, dhe të hedhin dritë mbi shkaqet e reagimeve. Po kështu këto procedura janë një mjet shtesë për monitorimin e veprimtarisë së NJAB-së dhe krijojnë mundësi për analiza të cilësisë së rekomandimeve të auditimit.
Për vitin 2023, niveli i pranimit të rekomandimeve mbetet i lartë, **deri në masën 99.8%,** nga **7385 rekomandime të dhëna** janë **pranuar 7370** dhe nuk janë pranuar vetëm 15 rekomandime.

Grafiku 6. Rekomandime të pranuara dhe zbatuara në vite




Zbatimi i rekomandimeve të auditimit varet dhe nga natyra e rekomandimeve që jepen. Kjo për faktin se zbatimi i disa prej masave të rekomanduara shtrihet në kohë që shkon përtej afateve kohore të raportimit.

Në funksion të ndjekjes deri në zbatimin e plotë të rekomandimeve, NJAB vazhdojnë të monitorojnë zbatueshmërinë e rekomandimeve deri në dy vjet pas lëshimit të raportit Final të Auditimit. Në këtë këndvështrim niveli i zbatimit të rekomandimeve i shtrirë në dy vjet (2022 -2023) vlerësohet të jetë 61.5%

Tabela 12. Rekomandime sipas llojit për vitin 2023[17]

Nr.	Rekomandimet sipas llojit	Rekomandimet (në numër)
1	Rekomandime për përmirësim sistemesh	2216
2	Rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor	273
3	Rekomandime të karakterit organizativ	2710
4	Rekomandime për arkëtime	506
5	Rekomandime të tjera	1397
	TOTALI	**7102**

Rekomandimet për përmirësim të sistemeve kanë referuar sistemet kryesore të menaxhimit, administrimit dhe funksionimit.



shifër kjo që vërehet edhe në peshën specifike që kanë gjetjet me efekt financiar negativ në këtë fushë.

Sistemi i prokurimeve publike, që është dhe përfituesi i pjesës më të madhe të buxhetit të shtetit, ka marrë vëmendjen e audituesve me rekomandime që kërkojnë përmirësime si në drejtim të zbatimit të procedurave por dhe në disenjimin e tyre.

Gjatë analizës së rekomandimeve janë evidentuar mangësi në lidhje me cilësinë e rekomandimeve të dhëna (NJAB e pushtetit vendor), ku ndër më kryesoret mund të përmendim:

- Mungon analiza në rrënjë e cila i mundëson audituesit të adresojë rekomandimin tek shkaku dhe jo vetëm tek pasoja;
- Formulim jo i qartë i masave apo veprimeve që duhet të ndërmerren, të cilat shpesh kanë karakter përgjithësues dhe nuk i adresohen sistemit specifik që ka nevojë për përmirësim;
- Nuk respektohet ndërlidhja: Gjetje-konkluzion- rekomandim;
- Rekomandime që nuk ofrojnë qartësisht pronësinë/ strukturën apo personin përgjegjës për zbatimin e rekomandimit;

[17] Të dhëna të analizuara nga Raportet Vjetore të NJAB

- Përcaktimi i afatit të zbatimit të rekomandimeve nuk lidhet me natyrën e rekomandimit të dhënë. Rekomandimet për ndryshime të kuadrit ligjor kërkojnë kohë dhe implikimin e institucioneve të tjera , jashtë subjektit të audituar.

Nga analiza ka rezultuar se në njësitë e qeverisjes së përgjithshme ka përpjekje për zbatimin e plotë të rekomandimeve, por kjo ndikohet në një masë të madhe nga faza e zbatimit të rekomandimeve. Nga 7370 rekomandime të pranuara rreth 53.1% janë zbatuar, 39.5% e tyre janë në proces zbatimi dhe vetëm 7% janë të pazbatuara. Këtij qëllimi do ti shërbejë dhe aplikimi i instruksioneve të dhëna në Udhëzimin për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm.

✓ **Rekomandimet në Ministritë e Linjës**

Rekomandimet e dhëna nga ministritë e linjës vlerësohen në përgjithësi si të përshtatshme, të qarta dhe të zbatueshme. Rekomandimet kryesore janë fokusuar në përmirësim sistemesh dhe kuadri rregullator, si dhe të karakterit organizativ:

- Rekomandime të karakterit organizativ që lidhen me miratimin ose përmirësimin e rregulloreve të brendshme, miratimin e manualeve të proceseve të punës, rishikim i përshkrimeve të punës për çdo punonjës, ndarjen e qartë të detyrave, miratim i rregullave të brendshme për delegimin e detyrave, etj;

- Specifikisht, në rekomandime për përmirësimin e sistemeve që lidhen me hartimin e regjistrit të aseteve, hartimin e regjistrit të risqeve, hartimin dhe miratimin e gjurmëve të auditimit për proceset e punës, rritjen e cilësisë së planifikimit dhe zbatimit të buxhetit të shtetit, ruajtja e aseteve, etj;

- Rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor lidhen me propozime për ndryshime të akteve ligjore dhe nënligjore, për miratim udhëzimesh etj. të lidhura me fushën e përgjegjësisë së çdo ministrie.

✓ **Rekomandimet e auditimit në Institucionet Qendrore**

Rekomandimet e lëna pranë subjekteve të audituara nga NJAB e grupit të institucioneve me buxhet të madh janë të sakta, realiste dhe të zbatueshme por disa prej rekomandimeve të lëna paraqesin referencën ligjore mbi të cilën ato janë mbështetur ose rekomandohet zbatimi i legjislacionit të fushës, duke mos dhënë opinion e rekomandim konkret për sistemin e vlerësuar:

- Rekomandime për përmirësimin e sistemeve që lidhen me hartimin e regjistrit të riskut, hartimin dhe miratimin e gjurmëve të auditimit për proceset e punës, etj;

- Rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor që lidhen me propozime për ndryshime ligjore, për përditësim të urdhrave, udhëzimeve dhe manualeve në fuqi, të lidhura këto me misionin dhe fushën e veprimtarisë së subjekteve të audituara;

- Rekomandime të karakterit organizativ që lidhen me përmirësimin e rregulloreve të brendshme, miratim i manualeve të proceseve të punës, miratim i procedurave për delegimin e detyrave;

- Rekomandime sipas qëllimit dhe misionit të institucionit.

✓ **Rekomandimet në Shoqëritë Aksionere**

Rekomandimet më të rëndësishme të njësive të auditimit të brendshëm janë fokusuar në:

- Rekomandime për përmirësimin e kuadrit rregullator të fushës, të cilat lidhen me propozime për ndryshime të akteve nënligjore, përditësim e ndryshim të udhëzimeve, manualeve dhe rregulloreve në fuqi;

- Rekomandime për përmirësimin e sistemeve, që lidhen me hartimin e rregulloreve të brendshme sipas përshkrimeve të punës në përshtatje me ndryshimet strukturore të shoqërive, hartimin e gjurmëve të auditimit për proceset e punës, hartimin e një strategjie në funksion të minimizimit të riskut, delegimin e detyrave për koordinimin e riskut tek menaxherët në varësi direkte të administratorëve, etj;

- Rekomandime të karakterit organizativ, në funksion të rritjes së efektivitetit të punës, të cilat lidhen me përcaktimin e metodave dhe procedurave të unifikuara sipas një dokumentacioni standard që duhet të zbatohet nga çdo punonjës në shërbim të shoqërive aksionere, etj.

Auditimet e detyrimeve të prapambetura të njësive publike

Në kuadër të forcimit të disiplinës financiare për të parandaluar akumulimin e detyrimeve të prapambetura në të ardhmen, të cilat mund të kthehen në një rrezik serioz potencial për financat publike, me impakt negativ në ekonominë e vendit në tërësi, MF ka marrë një sërë masa të efektshme për forcimin dhe përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, të cilat lidhen me parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura nga të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Në këtë kontekst, auditimi i detyrimeve financiare të prapambetura, mbetet si një nga prioritetet kryesore të auditimit të brendshëm në sektorin publik, ku Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, luan një rol kryesor në drejtim të orientimit të të gjithave strukturave audituese në vend, për të planifikuar dhe kryer auditimin e detyrimeve të prapambetura, bazuar në dispozitat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe udhëzimeve plotësuese për këtë qëllim.

Nga analizimi i të dhënave të raportuara mbi gjetjet dhe rekomandimet e këtij sistemi, rezultojnë se detyrimet e prapambetura vazhdojnë të jenë akoma të larta, duke përbërë në përgjithësi një risk për treguesit buxhetorë, sepse dhe qasja e auditimit do të përqendrohet në përcaktimin e vëllimit, kategoritë dhe shkaqet kryesore të ekzistencës dhe zhvillimit të detyrimeve të prapambetura, në mënyrë që të jetë në gjendje të nxjerrë përfundime të sakta dhe të japë rekomandime të përshtatshme për menaxhimin e njësisë së audituar në funksion të marrjes së masave të duhura për zbutjen (mitigimin) e risqeve dhe karakteristikave të tyre.

Nisur nga një vështrim i përgjithshëm, i problematikave të konstatuara nga strukturat e auditimit të brendshëm në sektorin publik, mbi auditimin e këtij sistemi dhe impaktin financiar/ buxhetor i riskut të shtimit të detyrimeve të prapambetura, janë evidentuar mangësi apo parregullsi në drejtim të mos planifikimit të saktë të zërave të shpenzimeve, investimeve i cili vjen për shkak të mos realizimit të të ardhurave (sidomos në NJVV), të mos ndryshimit të

zërave buxhetorë të planifikuara në varësi të nevojave shtesë për likujdim, për paga të prapambetura, vendime gjyqësore, apo në drejtim të raportimit të informacionit mbi procedurat e prokurimit publik të parashikuara, në mos regjistrimin në kontabilitet të detyrimeve nga nëpunësi zbatues, mungesë informacioni mbi raportimet e pasqyrave financiare për detyrimet.

Për rrjedhojë të gjithë këtyre efekteve negative të treguesve të mësipërm, arrihet në konkluzionin se nga titullarët e NJQP dhe njësive të tjera të sektorit publik, nuk menaxhohet si duhet risku i krijimit dhe shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, duke përbërë në këtë mënyrë një burim të dhënash që shpenzimet e përgjithshme dhe detyrimet e prapambetura të cilat sipas rastit mund të paraqiten si një risk fiskal, jo vetëm për treguesit buxhetor të institucionit përgjegjës, por edhe në nivel makroekonomik për financat publike.

Së fundmi, duhet të theksohet se nga kryerja e angazhimeve të tilla nga ana e strukturave të auditimit të brendshëm, ku në bazë të gjetjeve janë adresuar edhe rekomandimet përkatëse të cilat nga zbatimi i tyre do të varet edhe impakti i cili konsiston në përmirësimin e situatës, duke ndërgjegjësuar titullarët e njësive publike NA dhe NZ, në ndërprerjen e praktikave të krijimit të detyrimeve të reja të prapambetura, në marrjen e masave konkrete për likujdimin e detyrimeve totale mbi bazën e një plani të mirë detajuar, për të forcuar disiplinën buxhetore, kryesisht në drejtim të planifikimit buxhetor, kontrolleve financiare paraprake, rritjen e eficencës së shpenzimeve, brenda kritereve të vendosura në strategjinë e zhvillimit afatmesëm e afatgjatë të institucioneve, etj.

5.3. Vlerësimi i sistemeve të Kontrollit të Brendshëm

Në zbatim të Standartit 2450 – Opinionet e Përgjithshme Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm, Raporti Vjetor i Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm **duhet të përfshijë** dhe ***Opinionin e Përgjithshëm mbi efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm.***

Në lëshimin e një opinion të përgjithshëm, NJAB ka marë në konsideratë strategjitë, objektivat dhe risqet e organizatës, si dhe pritshmëritë e Titullarit të njësisë publike, menaxhimit të lartë, bordit dhe palëve të tjera të ineresuara. Opinioni i përgjithshëm duhet të mbështetet në informacion të mjaftueshëm, të besueshëm, të duhur dhe të dobishëm.

Ky opinion bazohet në vlerësimin e audituesve të brendshëm mbi krijimin, vendosjen dhe efektivitetin e funksionimit të kontrolleve të brendshme brenda njësisë publike.

Opinioni i audituesve të brendshëm është pjesë e çdo raporti të angazhimit të auditimit, dhe në mënyrë të veçantë konsolidohet në Raportin Vjetor të Veprimtarisë Audituese.

Mbështetur në standardet dhe praktikat e mira ndërkombëtare të vendeve të BE nivelet e vlerësimit të Kontrollit të Brendshëm ndahen në 4 kategori kryesore:


Opinioni i Vlerësimit të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm	**Përshkrimi i Opinionit, baza e Opinionit**
Niveli 1- Sistem Efektiv: "Sistemi i Kontrollit të Brendshëm funksionon efektivisht/mirë".	Sistemi i Kontrollit të Brendshëm funksionon në mënyrë efektive, nuk ka mangësi apo dobësi materiale (të mëdha), ose ekzitojnë pak dobësi dhe mangësi të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm. Nuk ka nevojë për përmirësime ose

	shumë pak përmirësime janë të nevojshme.
Niveli 2 - Sistem Pjesërisht Efektiv: "Sistemi i Kontrollit të Brendshëm funksionon efektivisht/mirë, por ka nevojë për disa përmirësime të sistemeve dhe procedurave".	Sistemi i Kontrollit të Brendshëm funksionon në mënyrë efektive, por u gjetën disa mangësi, të cilat kanë apo mund të kenë ndikim të moderuar në objektivat e njësisë publike. Ka nevojë për marrjen e veprimeve për përmirësime në disa drejtime.
Niveli 3 - Sistem Pjesërisht Efektiv: "Sistemi i Kontrollit të Brendshëm nuk funksionon plotësisht në mënyrë efektive/mirë dhe ka nevojë për përmirësime të rëndësishme, thelbësore".	Sistemi i Kontrollit të Brendshëm funksionon pjesërisht në mënyrë efektive, ka mangësi serioze të cilat ekspozojnë njësinë publike ndaj risqeve të larta. Ka nevojë për marrjen e veprimeve të rëndësishme për përmirësime thelbësore në shumë drejtime.
Niveli 4 - Sistem Jo Efektiv: "Sistemi i Kontrollit të Brendshëm nuk funksionon".	Sistemi i Kontrollit të Brendshëm nuk funksionon. Elementët e Kontrollit të Brendshëm nuk janë vendosur dhe nuk funksionojnë sipas kërkesave të kuadrit ligjor. Ka nevojë për marrjen e veprimeve të rëndësishme për të siguruar krijimin dhe funksionim efektiv të Sitemit të KB.

Nga 136 NJAB vetëm 90 prej tyre kanë dhën opinion për efektivitetin e sisitemit të kontrollit të brendshëm.

- 9 NJAB ose 10 % e tyre kanë vlerësuar se "Sistemi i Kontrollit të Brendshëm funksionon efektivisht/mirë";
- 53 NJAB ose 59 % e tyre kanë vlerësuar se "Sistemi i Kontrollit të Brendshëm funksionon efektivisht/mirë, por ka nevojë për disa përmirësime të sistemeve dhe procedurave";
- 26 NJAB ose 29 % e tyre kanë vlerësuar se "Sistemi i Kontrollit të Brendshëm nuk funksionon plotësisht në mënyrë efektive/mirë dhe ka nevojë për përmirësime të rëndësishme, thelbësore";
- 2 NJAB ose 2 % e tyre kanë vlerësuar se "Sistemi i Kontrollit të Brendshëm nuk funksionon".

Grafiku 8. Opinioni Përgjithshëm mbi Kontrollin e Brendshëm



5.4 Kapacitetet audituese dhe zhvillimi profesional

5.4.1 Strukturat e auditimit të brendshëm

Shërbimi i auditimit të brendshëm në sektorin publik gjatë vitit 2023 është realizuar nga 136 NJAB, të krijuara në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Struktura organike e miratuar për stafin audituesë në NJAB ka parashikuar 505 audituesë të brendshëm por në fund të vitit 2023 janë evidentuar të punësuar vetëm 441, ku duket se mungesa prej 64 pozicione vakante, mbart riskun që veprimtaria audituese të mos mbështetet nga burimet e nevojshme, kapacitetet profesionale njerëzore që do të mundësonin realizimin në kohë dhe me cilësi të shërbimit të auditimit.

Vendet vakante të 64 audituesve evidentohen të jenë: 15 në ministritë e linjës, 13 në njësitë e vetëqeverisjes vendore, 12 në institucionet qendrore, 4 institucionet që përfaqësojnë fondet speciale, 4 në institucionet e pavarura, 2 në universitetet publike, 2 në qendrat spitalore dhe 12 në shoqëritë aksionere, duke treguar një përmirësim të lehtë të situatës në rekrutimin e audituesve në bashkitë e ndryshme.
Në njësitë e auditimit të brendshëm, 355 audituesë të brendshëm në detyrë janë të certifikuar si "Audituesë të brendshëm në sektorin publik", dhe 86 pritet të ndjekin procesin për sezonin 2023-2024 për të përmbushur detyrimin e certifikimit gjatë 3 viteve të para të punësimit. Numri më i madh i audituesve të pa certifikuar gjithsej 50 i përket njësive të vetëqeverisjes vendore dhe shoqërive aksionere publike.

DH/AB konstaton se ndërsa ka një përmirësim në plotësimin e vendeve vakante në njësitë e vetëqeverisjes vendore është rritur numri i audituesve të cilët kanë nevojë të ndjekin procesin e certifikimit për të fituar dëshminë e profesionit të audituesit të brendshëm në sektorin publik. Kjo mangësi vjen si rezultat i disa faktorëve demografikë që kanë sjellë vështirësi në gjetjen e punonjësve të kualifikuar në zonat urbane dhe rurale (rasti i bashkive) apo kuadër ligjor kompleks, siç është rasti i shoqërive aksionere publike, i cili lë shkak për keqinterpretime. Identifikimi i këtyre problematikave kërkon nje ridimensionim të politikave për zhvillimin profesional të audituesve të brendshëm duke kaluar në një fazë tjetër, atë të krijimit dhe zhvillimit paralelisht të kapaciteteve audituese.

Tabela.13. Të dhëna për Audituesit e Brendshëm

Viti	Nr. NJAB	Nr AB Plan	Nr AB Fakt	Vende Vakante	AB të cert	AB të pa cert	AB në proc cert
2017	119	428	400	28	308	56	36
2018	127	469	429	40	330	59	40
2019	129	478	428	50	344	84	0
2020	129	469	414	55	318	46	50
2021	135	485	433	52	342	91	0
2022	**136**	**499**	**435**	**64**	**309**	**51**	**75**
2023	**136**	**505**	**441**	**64**	**355**	**86**	**0**

Struktura profesionale e audituesve të brendshëm konsiston në:

- 348 ekonomistë,
- 69 juristë dhe


- 24 me profesione të tjera, specifike sipas sektorëve të ekonomisë.

Nevoja për këtë profilizim të audituesve të brendshëm lidhet me fushat objekt i auditimit, të cilat në sektorin publik në disa raste kërkojnë specializim të veçantë[18].

Larmishmëria e profesionistëve të përfshirë në strukturat audituese vlerësohet si një indikator pozitiv në orientimin e auditimit të brendshëm jo vetëm në operacione financiare dhe të përputhshmërisë por dhe në sisteme të tjera jo financiare.

Eksperienca në profesion është një kriter bazë për punësimin dhe zhvillimin në karierë të audituesve e diferencuar për drejtues të NJAB dhe auditues të brendshëm. Kriteri i eksperiences përmbushet nga 246 auditues të brendshëm që kanë vjetërsi pune mbi 5 vjet dhe 195 kanë vjetërsi në auditim deri në 5 vjet.

Grafiku 9. Strukturat e Auditimit të Brendshëm dhe Punësimi



Një nga mangësitë e vërejtura në krijimin e NJAB-ve dhe që po kthehet në një fenomen sistematik është mos plotësimi i kritereve të kërkuara në ligjin e auditimit të brendshëm, që përfshijnë:

- 21 njësi me **më pak se tre auditues**, nga të cilat 15 NJAB, me 1 punonjës dhe 6 NJAB, me 2 punonjës *(tre më pak se vitin e kaluar).*
- 15 njësi me drejtues të NJAB me më pak se 3 vjet në auditim të brendshëm ose të jashtëm, 8 njësi me drejtues të NJAB të pa certifikuar, 5 auditues të brendshëm me diplomë nivel bachelor.

Kriteret e vendosura në ligjin për auditimin e brendshëm në krijimin e njësive të auditimit janë një faktor i rëndësishëm për ndërtimin e kapaciteteve audituese dhe mbështetjen e auditimit me burime të mjaftueshme njerëzore.

DH/AB vlerëson se krijimi i njësive të auditimit duke mos përmbushur këto kritere mbartin risk të lartë dhe mund të kenë efekt në funksionimin dhe performancën e auditimit.

[18] Evidentuar në analizën e raporteve të KAB

Strukturat e auditimit të brendshëm në njësitë e vetëqeverisjes vendore

Në njësitë e vetëqeverisjes vendore që realizojnë shërbimin e auditimit të brendshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kanë krijuar NJAB përfshihen 50 Bashki, ku janë të punësuar 143 audituesë të brendshëm kundrejt 156 të miratuar në strukturat organike përkatëse.

Kapacitete profesionale të auditimit të brendshëm në disa nga njësitë e vetëqeverisjes *vendore (kryesisht njësi të vogla me më pak se 200 mijë banorë)* vlerësohet të kenë vështirësi në rekrutimin e stafit që zotëron plotësisht kërkesat për punësim si audituesë i brendshëm në sektorin publik. Nga 143 audituesë të brendshëm të punësuar në njësitë e vetëqeverisjes vendore 93 janë të çertifikuar dhe 50 janë audituesë të rekrutuar rishtazi dhe që pritet të fillojnë procesin e çertifikimit në sezonin 2024-2025.

Ndërkohë njësitë e vetëqeverisjes vendore relativisht të vogla (Finiq, Libohovë dhe Pustec) e kanë realizuar shërbimin e auditimit me akt-marrëveshje me njësi auditimi të brendshëm të njësive të tjera publike dhe Poliçani ka realizuar shërbimin me anë të kontraktimit [19].

Njësitë e vetëqeverisjes vendore (Belsh, Pukë, Konispol, Delvinë, Tropojë, Këlcyrë dhe Përmet) nuk realizojnë shërbimin e auditimit të brendshëm me asnjë nga format e përcaktuara në kuadrin rregullator.

Kapacitetet e pamjaftueshme profesionale dhe njerëzore dhe mbulimi jo i plotë me auditim i të gjithë njësive të vetëqeverisjes vendore, e vendos këtë nivel qeverisje në kategorinë e njësive publike me risk të lartë i cili mund të ndikojë në mirëqëverisjen dhe cënon arritjen e objektivave të tyre.

5.4.2 Mbështetja për zhvillimin e Auditimit të Brendshëm

DH/AB, analizon dhe vlerëson në mënyrë të vazhdueshme performancën e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në të gjithë sektorin publik për përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuar.

Nëpërmjet komunikimit dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me NJAB-të e ministrive të linjës, institucioneve qendrore, institucioneve të pavarura dhe të pushtetit vendor, DH/AB ofron udhëheqjen metodologjike dhe mbështet zhvillimin profesional të audituesve të brendshëm, çka e siguron me anë të shkëmbimit të informacionit, konsolidimit të planeve strategjike dhe vjetore dhe raporteve vjetore të veprimtarisë së strukturave audituese në sektorin publik, hartimit dhe zhvillimit të politikave, manualeve, metodologjive dhe udhëzuesve si dhe programit të trajnimit dhe certifikimit profesional.

[19] Germa ç, pika 1 , neni 10 i Ligjit të auditimit të brendshëm 2014/2015.

Figura 1. Shtyllat e veprimtarisë së DH/AB



Harmonizimi i tre elementëve: krijimi dhe mbajtja e përditësuar e kuadrit ligjor, metodologjik e profesional, trajnimi dhe zhvillimi profesional i kapaciteteve audituese dhe vlerësimi i cilësisë së veprimtarisë së njësive të auditimit të brendshëm kanë synuar të krijojnë një ambient që të nxisë progresin dhe zhvillimin e sistemit të auditimit të brendshëm në linje me kërkesat e standardeve ndërkombëtare dhe praktikave të mira profesionale.

Krijimi dhe mbajtja të përditësuar e akteve ligjore e nënligjore që lidhen me auditimin e brendshëm, hartimi i metodologjive dhe udhëzuesve për auditimin duke reflektuar çdo ndryshim dhe përmirësim në nivel global të profesionit synojnë të krijojnë një ambient të përshtatshëm dhe të nxisin zhvillim dhe progres të vazhdueshëm në sistemin e auditimit të brendshëm. Hartimi dhe ofrimi i programeve të trajnimit dhe certifikimi i audituesve të brendshëm kanë si qëllim që të përcjellin tek audituesit njohuritë dhe dijet që ofron kuadri ligjor e metodologjik, për t'i aftësuar audituesit, për t'i pajisur me kompetencën e duhur profesionale në mënyrë që të kryejnë auditime cilësore e në pajtueshmëri të plotë me standardet. Monitorimi i veprimtarisë së njësive të auidtimit të brendshëm shërben për të vlerësuar se deri në ç'masë veprimtaria e auditimit të brendshëm kryhet në përputhje me kërkesat e standardeve, kuadrit ligjor dhe praktikat e mira profesionale.

Në këtë mënyrë të tre hallkat e sistemit janë të lidhura ngushtësisht me njëra tjetrën dhe ndikojnë në mënyrën se si funksionon i gjithë sistemi i auditimit të brendshëm në sektorin publik në tërësi: outputet e njërës hallkë janë inpute për hallkën tjetër dhe shërbejnë për të sjellë ndryshim dhe progres të nevojshëm për të çuar përpara sistemin. Veprimtaritë e realizuara nga DH/AB i kanë shërbyer përmbushjes së misionit dhe arritjes së objektivave që përcaktohen për sa vijon:

- Monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së auditimit të brendshëm, zbatimi i metodologjisë së vlerësimit të jashtëm të cilësisë së veprimtarisë audituese;
- Harmonizimin, bashkërendimin dhe udhëheqjen metodologjike të të gjithë NJAB në sektorin publik, duke siguruar dhe mbështetje efektive për zhvillimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik;
- Zhvillimin e vazhdueshëm profesional nëpërmjet trajnimit të audituesve të brendshëm në detyrë; dhe

- Certifikimin e punonjësve të njësive të auditimit të brendshëm, bazuar në programin e miratuar.

Funksionimi i Komiteteve të Auditimit të Brendshëm

Komiteti i Auditimit të Brendshëm si organ i pavarur që monitoron dhe ofron këshilla dhe rekomandime objektive për titullarin e njësisë publike, në lidhje me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, vlerësohet të jetë një mjet shumë efektiv në mbështetje të njësisë së auditimit të brendshëm për përmbushjen e përgjegjësive të saj, dhe garanci shtesë në ruajtjen e pavarësisë së auditimit.

Gjatë vitit 2023, krijimi dhe funksionimi i Komiteteve të Auditimit, ka gjetur zbatim në disa Ministri të linjës dhe institucione të pavarura. Me qëllim nxitjen dhe rritjen e efektivitetit të Komitetit të Auditimit, duke marrë shkas dhe nga ndryshimet në ligjin 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", është përgatitur Projekt-Vendimi i Këshillit të ministrave "Për disa shtesa dhe Ndryshime në VKM nr.160 datë 2.3.2016 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike" i cili përcakton kritere të qarta mbi mënyrën e krijimit, ku dhe si do të funksionojnë komitetet e auditimit në njësitë publike, si dhe cilësimin e funksioneve dhe rolit të tyre në qeverisjen e njësive publike.

Raportet e Komiteteve të Auditimit të Brendshëm për vitin 2023 prezantojnë një pamje të përgjithshme mbi situatën dhe performancën e strukturave të auditimit, duke identifikuar gjetjet për dobësitë e sistemit dhe adresuar konkluzionet me rekomandimet përkatëse.

Çështjet kryesore të trajtuara nga KAB përfshijnë sa vijon:

- Konsatohet se disa njësi auditimi kanë ende mangësi në zbatimin e planit të auditimit, në vlerësimin e riskut, të evidentuara këto edhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo DH/AB në MF.
  Rekomandohet që procesi i vlerësimit të riskut të bëhet me profesionalizëm dhe përgjegjësi, pasi kjo do të siguronte një nivel më të lartë të efektivitetit të punës audituese.
- Cilësia e rekomandimeve të auditimit duhet të përmirësohet, veçanërisht në përcaktimin e qartë të shkakut dhe përgjegjësisë për çdo gjetje të konstatuar. Krahas kësaj, kërkohet të përcaktohet qartë dhe afati zbatimit të rekomandimit dhe të monitorohet në vijimësi.
  Rekomandohet vendosja e një sistemi efektiv të monitorimit dhe ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të auditimit.
- Programi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë vazhdon të mungojë në një pjesë të madhe të njësive të auditimit. Kjo tregon për një dobësi në sistemin e menaxhimit të cilësisë së auditimit.
  Rekomandohet hartimi, miratimi dhe nëse është i nevojshëm përditësimi i indikatorëve për Programin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.
- Vlerësohet se sistemi i pagave dhe shpërblimit për audituesit e brendshëm nuk nxit dhe promovon zhvillimin profesional të tyre, por mund të behët shkak për cënimin e pavarësisë.
  Rekomandohet rishikimi i politikave të pagave të audituesve të brendshëm në sektorin publik, si dhe për disa funksione mbështetëse si p.sh paga e sekretarit në komitete.
- Ka mangësi në planifikimin e auditimeve të teknologjisë së informacionit dhe auditimet e performancës.

Rekomandohet të trajnohen audituesit e brendshëm me përvojë në lidhje më këto auditime specifike dhe të planifikohen në vazhdimësi angazhimet e auditimit të sipërcituara, duke siguruar mbështetjen me ekspertizën e nevojshme sipas përcaktimeve që ofron kuadri ligjor në fuqi.

- Puna në terren planifikohet dhe realizohet për një periudhë të pamjaftueshme e cila mund të ndikojë cilësinë e auditimit.
  Rekomandohet që drejtuesi i NJAB-së të studiojë dhe përcaktojë në mënyrë të argumentuar normimin e punës audituese, duke konsideruar të gjithë faktorët që ndikojnë në planifikimin e burimeve: kohës, numrit dhe kompetencave të audituesve.
- Në kuadrin e reformave të ndërmarra dhe procesit të integrimit evropian të vendit, kërkesa për auditimin e fondeve IPA vjen gjithnjë në rritje, çka duhet të shoqërohet me intensifikimin e trajnimeve të posaçme në këtë fushë, brenda dhe jashtë vendit.
  Rekomandohet trajnimi i audituesve të brendshëm për qasjen e auditimit të fondeve IPA.

Komitetet e Auditimit të Brendshëm konkludojnë se veprimtaria audituese është në përgjithësi në përputhje me kuadrin rregullator, por evidentohet se ka nevojë për përmirësim në fusha specifike për të cilat janë dhënë rekomandimet përkatëse, për çdo NJAB nga Komiteti që mbështet veprimtarinë e auditimit të brendshëm. Të sigurohet mbështetja e NJAB për të forcuar kapacitetet teknike dhe teknologjike, në mënyrë që të sigurohet monitorimi i praktikave që mbartin risk të lartë. Mekanizmat e kontrollit të shpejtë nëpërmjet teknologjisë së informacionit do të mbanin nën presion subjektet e auditimit, panvarësisht pamundësisë për tu audituar çdo vit.

5.5 Vlerësimi i jashtëm i cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm

Vlerësimi i jashtëm i cilësisë së punës audituese është një nga elementet kyç të efektivitetit të monitorimit. Nëpërmjet angazhimeve të vlerësimit, DH/AB analizon dhe vlerëson se deri në çfarë niveli veprimtaria e auditimit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe njësitë publike janë në pajtueshmëri me kërkesat e standardeve, kuadrin ligjor për auditimin e brendshëm, standartet dhe procedurat e punës, Kodin e Etikës dhe efeciencën e kësaj veprimtarie. Metodologjia e vlerësimit të jashtëm të cilësisë shërben si një mekanizëm nëpërmjet të cilit vlerësuesit e DH/AB mbështetur në gjetjet e angazhimit, japin Opinionin e Përgjithshëm të Pajtueshmërisë.


Vlerësimi i jashtëm i cilësisë ka një mision të dyanshëm: nga njëra anë shërben për të identifikuar dobësitë në krijimin dhe funksionimin e shërbimit të auditimit duke adresuar risqet që kërcënojnë arritjen e objektivave të auditimit dhe nga ana tjetër synon të ndihmojë NJAB, për të kryer veprimtarinë e tyre në përputhje të plotë me standardet e auditimit të pranuara.

Mbështetur në kërkesat e standardeve të auditimit të pranuara sipas së cilave çdo NJAB duhet të vlerësohet nga jashtë të paktën një herë në 5 vjet, numri i vlerësimeve të jashtme të cilësisë së NJAB-ve është rritur me 30% krahasuar me vitin 2020 dhe thuajse dyfishuar krahasuar me dy vite më parë. Deri tani janë realizuar vlerësuar 117 NJAB dhe DH/AB po synon të arrijë në normën mesatare të nevojshme për përmbushjen e kërkesave të standardeve që çdo strukturë audituese të vlerësohet nga DH/AB jo më pak se një herë në 5 vjet.

5.5.1 Opinionet e vlerësimit të jashtëm të cilësisë nga DH/AB

Për periudhën 2017-2023, opinionet e vlerësimit paraqesin një pamjen si poshtë vijon:

Grafiku 10. Opinionet e Vlerësimit të Jashtëm të cilësisë në vite



Deri në fund të vitit 2023 janë realizuar gjithsej 117 VJC kundrejt 136 NJAB të krijuara, pra 86 % e sistemit, është vlerësuar për nivelin e përputhshmërisë së punës audituese me kërkesat e kuadrit ligjor dhe standarteve të auditimit.

Nga Drejtoria e Harmonizimit të AB janë dhënë Opinione të Vlerësimeve të cilat përfshijnë:

- 21% opinion pozitiv: Veprimtaria AB përgjithësisht në përputhje me kërkesat e SNA;
- 26% opinion negativ: Veprimtaria AB përgjithësisht në MOS përputhje e plotë me kërkesat e SNA;
- 37 % opinion thuajse negativ: Veprimtaria AB në pjesën më të madhe është në MOS përputhje e pjesshme me kërkesat e SNA, përmirësime të rendësishme janë të nevojshme;
- 16% opinion pjesërisht pozitiv: Veprimtaria AB në disa fusha është në Mospërputhje me kërkesat e SNA.

Për vitin 2023, DH/AB vlerësoi në total 19 njësi të auditimit të brendshëm (3 Institucione Qendrore, 1 Institucion të pavaruar, 2 Shoqëri Aksionere dhe 13 Bashki), vlerësimi përfundimtar rezultoi me dhënien e opinioneve siç pasqyrohen në Aneksin IV.

5.5.2 Gjetjet kryesore të vlerësimeve të cilësisë së auditimit

Ndër gjetjet më të rëndësishme në këto procese, në vlerësimin për njësitë e auditimit, u evidentuan:

- Cilësia dhe efektiviteti i punës audituese nuk përmbush plotësisht pritshmëritë e menaxhimit dhe grupeve të interesit, kjo ndikon dhe në perceptimin e drejtë të vlerave dhe rolit të auditimit të brendshëm nga menaxhimi.
- Në disa raste Karta e Auditimit duhet të përditësohet, si një dokument kryesor që përcakton statusin dhe përgjegjshmërinë e auditimit të brendshëm dhe siguron pavarësinë *de juro* të auditmit të brendshëm;

- Përshkrim jo i qartë dhe i mjaftueshëm mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e audituesve në Rregulloren e Brendshme, si pjesë integrale e njësisë publike;

- Njësia e auditimit të brendshëm nuk është krijuar sipas kërkesave të ligjit për auditimin e brendshëm (ka më pak se 3 audituesstaf) dhe vetë Drejtuesi apo audituesit nuk plotësojnë kriteret e punësimit referuar eksperiencës në auditim dhe kërkesës për certifikim;

- Burimet në dispozicion të strukturës audituese nuk janë të plota në numër dhe disa raste ka mungesë të përvojës së punës në auditim. Kjo mbart riskun e pamjaftueshmërisë së burimeve për arritjen e objektivave në sasi por mund të cënojë dhe cilësinë e auditimeve;

- Mos respektimi i plotësisë së informacionit që duhet të përmbajë Programi i Angazhim Auditimit, duke mos përfshirë të gjitha sistemet e nevojshme për t'u vlerësuar nga ana e audituesve të brendshëm;

- Mangësi në hartimin e pyetësorëve të vlerësimit të kontrollit të brendshëm dhe teste të pamjaftueshme për sistemet/fushat e përzgjedhura;

- Raportimi i rezultateve te auditimit nuk respekton parimet e raportimit në formë dhe disa herë në përmbajtja. Raportet e auditimit janë të gjata dhe jo të qarta dhe konçize, për të adresuar rekomandime me mesazh të plotë për titullarët e subjekteve të audituara;

- Nuk respektohet lidhja organike gjetje, konkluzion e rekomandim, nuk trajtohen observacionet e subjektit, si dhe opinion për funksionimin e KB duhet të jetë më i qartë;

- Në disa rste mungon Plani i Veprimit të dakortësuar me njësinë e audituar për zbatimin e rekomandimeve të auditimit, si dhe tek Programet për sigurimin e brendshme të cilësisë dhe përmirësimin në disa raste mungojnë ose indikatorët e perfiormancës nuk janë të përcaktuar me mangësi;

- Nuk është vendosur një sistem efektiv për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit, duke mos arritur deri në impaktin përfundimtar të auditimit.

5.5.3 Rekomandimet kryesore të vlerësimeve

Bazuar në gjetjet e konstatuara dhe në konkluzionet e arritura, grupet e vlerësimit kanë dhënë rekomandime lidhur me masat që duhet të merren nga këto njësi për përmirësimin e

veprimtarisë së auditimit në të ardhmen. Rekomandimet kryesore ku është kërkuar marrja e masave për përmirësim nga njësitë e auditimit dhe titullarët e njësive publike përfshijnë:

- Përditësimin e Dokumenteve bazë të auditimit, Kartës së Auditimit, e të tjera të nevojshme sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe të sigurohet aplikimi i tyre në praktikën e punës audituese;

- Qartësimin e rolit, funksionit, detyrave dhe përgjegjësive të auditimit të brendshëm në Rregulloren e Brendshme të njësisë publike si dhe përcaktimin e qartë të linjave të komunikimit duke respektuar Kodin e Etikës për shmangien e konfliktit të interesit;

- Programi i angazhimeve të auditimit të kryhet mbi bazën e një analize reale të vlerësimit të riskut dhe të adresojë të gjitha sistemet dhe fushat sipas prioritarizimit të riskut që këto sisteme paraqesin;

- Çdo NJAB duhet të hartojë, miratojë dhe të mbajë të përditësuar Programin e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, i cili zbatohet për çdo angazhim auditimi mbi bazën e indikatorëve të matjes së cilësisë së performancës;

- NJAB të dokumentojë procesin e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve, si dhe komunikimin me subjektin e audituar, lidhur me marrjen e informacionit mbi progresin që është bërë për zbatimin e rekomandimeve, duke e përfshirë këtë monitorim dhe në raportin vjetor të veprimtarisë së tij.

5.6 Zhvillimi i Aftësive Profesionale të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik

Objektivi strategjik i DH/AB për zhvillimin profesional të audituesve të brendshëm publik është sigurimi i kapaciteteve audituese me aftësitë dhe njohuritë që kërkon profesioni i auditimit të brendshëm i pavarur.

Në funksion të këtij objektivi, krijimi dhe menaxhimi i vazhdueshëm i sistemit të trajnimit dhe certifikimit për të siguruar përfshirjen e personelit të ri të auditimit të brendshëm dhe edukimin e vazhdueshëm profesional për audituesit tashmë të certifikuar, ka qenë dhe mbetet në fokus të Programit të Zhvillimit Profesional të audituesve të brendshëm për vitin 2023.

Standardet e Auditimit të Brendshëm kërkojnë që: *"...Audituesit e brendshëm duhet të zotërojnë njohuri, aftësi dhe zotësi të tjera të nevojshme, për të përmbushur përgjegjësitë individuale. Aktiviteti i auditimit të brendshëm bashkërisht duhet të zotërojë ose të fitojë njohuritë, aftësitë dhe zotësitë e nevojshme për të përmbushur përgjegjësitë përkatëse..."*. Aftësimi i audituesve të brendshëm kërkon *përqendrimin e njohurive dhe dijeve mbi çfarë ndodh në mjedisin aktual, vlerësimin e tendencave, prirjet dhe çështjet e reja të mundshme, pasi vetëm në këtë mënyrë do të mundësohet për ta dhënia e këshillave dhe rekomandimeve të auditimit të përshtatshme dhe që shtojnë vlerë për subjektin që auditohet.*

Për këtë qëllim, standardet e auditimit nxisin dhe inkurajojnë iniciativat e zhvillimit profesional të audituesve të brendshëm, të cilët duhet të tregojnë aftësitë e tyre, të zotërojnë njohuri e dije të profesionit, duke ndjekur trajnime profesionale dhe të zotërojnë certifikatat e kualifikimet e duhura profesionale.

DH/AB dhe çdo drejtues i auditimit të brendshëm në sektorin publik duhet të sigurojnë që stafi audituesë të marrë asistencë, këshilla, udhëzime dhe njohuri dhe zotësi të nevojshme për të realizuar misionin e auditimit me sukses.

Për këtë qëllim Programi i Zhvillimit Profesional të Audituesve hartohet duke konsideruar çështje thelbësore të formimit profesional të audituesit të brendshëm të tilla si:

- Nevojat dhe pritshmëritë e titullarë, duke përfshirë natyrën, kohën dhe komunikimin e rezultateve të angazhimit;
- Kompleksitetin përkatës dhe shtrirjen e nevojshme të punës për të përmbushur objektivat e angazhimit; dhe
- Koston e angazhimit të konsulencës përkundrejt përfitimeve të mundshme.

5.6.1 Programi Trajnimit të Vazhdueshëm Profesional

Trajnimi i vazhdueshëm profesional i audituesve të brendshëm në sektorin publik ka si qëllim që nëpërmjet përditësimit të njohurive, përshtatjes së aftësive të audituesve me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të përparuara të punës të sigurojnë ofrimin e një shërbimi auditimi sa më cilësor, si dhe adresimin e përmirësimeve të nevojshme me anë të komunikimit të rezultateve për çdo angazhim auditimi të kryer në njësinë publike ku ata zhvillojnë këtë veprimtari.

Standardet kërkojnë që audituesit të tregojnë kujdes profesional, të tregojnë se kanë aftësitë e duhura, janë kompetentë dhe të tregojnë maturi dhe objektivitet në ushtrimin e gjykimit të tyre profesional.

Audituesit e brendshëm duhet të ushtrojnë kujdesin e duhur profesional duke marrë në konsideratë:

- Shtrirjen e punës së nevojshme për të arritur objektivat e angazhimit;
- Kompleksitetin, materialitetin dhe rëndësinë relative të çështjeve për të cilat përdoren procedurat e siguridhënies;
- Mjaftueshmërinë dhe efektivitetin e proceseve të qeverisjes, administrimit të rrezikut dhe proceseve të kontrollit;
- Probabilitetin e gabimeve të konsiderueshme, mashtrimit apo të papajtueshmërisë; dhe
- Koston e siguridhënies në raport me përfitimet e mundshme.

Standardet gjithashtu udhëzojnë që audituesit e brendshëm duhet të marrin parasysh përdorimin e auditimit të mbështetur në teknologji dhe në teknika të tjera të analizimit të të dhënave, të jenë vigjilentë ndaj rreziqeve të konsiderueshme që mund të ndikojnë objektivat, operacionet ose burimet. Megjithatë, vetëm procedurat e siguridhënies, edhe kur kryhen me kujdesin e duhur profesional, nuk garantojnë se do të identifikohen të gjitha rreziqet e konsiderueshme.

Kërkesat e Standarteve janë pikënisja dhe baza mbi të cilën është hartuar dhe zhvilluar Programi i Formimit Profesional të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik.

Edhe pse zhvillimit profesional i auditimit të brendshëm ka një histori zhvillimi disavjeçare, trajnimi i vijueshëm profesional gjatë viteve të fundit paraqet një mënyrë të përmirësuar të të punuarit dhe evoluimit të profesionit më strategjike, elastike, si pjesë integrale e zhvillimit të

përgjithshëm strategjik si dhe më të aftë për t'iu përgjigjur pritshmërive ndaj auditimit të brendshëm publik.

Ruajtja e kompetencës profesionale, kur audituesve iu duhet të përballen me sfida të mëdha, nxjerr si kërkesë të domosdoshme që vetë audituesit të krijojnë dhe mbajnë një qasje të *"krijimit të kulturës së të mësuarit"*.

Trajnimi dhe zhvillimi i audituesve duhet të sigurojnë një bazë të njohurive, aftësive dhe vlerave profesionale, e cila u mundëson atyre të zhvillohen në vijimësi dhe t'iu përshtaten ndryshimeve gjatë gjithë jetës se tyre profesionale.

Objektivat e Programit te Zhvillimit Profesional për vitin 2023
Programi i Trajnimit të Vijueshëm Profesional të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik për vitin 2023 është përgatitur duke u mbështetur në një Analizë të Nevojave për Trajnim si dhe i orientuar drejt rezultatit për të siguruar qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të auditimit të brendshëm.

Programi i zhvillimit profesional ka synuar të ndërtojë kapacitetet e nevojshme audituese për të qenë aktorë efektivë dhe që t'i përgjigjen me sukses sfidave aktuale dhe të reja. Në programin e trajnimit të vijueshëm profesional 2023 informacioni i përcjellë ofroi njohuri të thelluara mbi:

- Riskun e mashtrimit dhe rolin e auditimit të brendshëm në raportimin e rasteve tek inspektimi financiar;
- Praktikat më të mira të zhvillimit të procedurave të prokurimeve publike;
- Auditimin mbi bazë sistemi të bazuar në risk;
- Planifikimin strategjik dhe vjetor mbi bazë risku të veprimtarisë audituese në njësitë publike;
- Vlerësimin dhe trajtimin e risqeve të sigurisë së informacionit.

DH/AB, në funksion të përshtatjes së aftësive të audituesve të brendshëm me standardet ndërkombëtare, praktikat profesionale, përvojat më të mira të fituara, si dhe përditësimit të njohurive e njohjes me zhvillimet e reja në këtë fushë për vitin 2023, ka zhvilluar trajnimin e vazhdueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik sipas moduleve të Programit të trajnimit të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 295, datë 30.12.2022.
Trajnimi i Vazhdueshëm Profesional të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik për vitin 2023, ofroi 20 tema trajnimi të zhvilluara në 40 orë dhe u dha mundësinë 317 audituesve të brendshëm të certifikuar të marrin njohuri të thelluara dhe të përditësuara me qëllim aftësimin dhe rritjen e kapaciteteve audituese.

Nga krahasimi i të dhënave për numrin e planifikuar dhe faktik të audituesve pjesëmarrës në trajnim, rezulton një diferencë e cila përfaqëson auditues të brendshëm të cilët kanë ndërprerë marrëdhëniet e punësimit me Njësinë e Auditimit të Brendshëm për shkaqe të ndryshme (dalë në pension, transferuar në një pozicion të ri pune etj.), si dhe auditues që kanë patur arsye shëndetësore apo nuk kanë patur akses në platformën ku prezantoheshin temat e trajnimit.
Në opinionin e përgjithshëm audituesit e kanë vlerësuar trajnimin të dobishëm për mënyrën sesi është konceptuar në funksion të përditësimit, zhvillimit të njohurive dhe pasurimit të përvojës së tyre për ushtrimin e detyrës.

Kontakti i drejtpërdrejtë me lektorët dhe kolegët i bëri seancat e trajnimit sa më interesante, të larmishme dhe efiçentë, duke i shndërruar ato në forma diskutimi të hapura për shkëmbim mendimesh, ide dhe përvojash pune të cilat u konsideruan të dobishme për secilin prej tyre, përfitime të cilat erdhën si rezultat edhe i kohëzgjatjes së procesit në tërësinë e tij me të gjithë komponetët përbërës. Analizimi dhe përpunimi i të dhënave nga formularët e vlerësimit plotësuar nga audituesit e brendshëm pjesëmarrës në trajnim, kanë përcaktuar treguesin e vlërësimit të përgjithshëm të trajnimit në nivelin e **mirë.**

Tema të cilat janë vlerësuar se kanë përmbushur në një masë të konsiderueshme pritshmërinë e audituesve pjesëmarrës në këtë trajnim janë:

- Planifikimi strategjik dhe vjetor mbi bazë risku;
- Qasja audituese mbi bazë sistemi, të bazuar në risk;
- Procesi i raportimit. Llojet dhe përgatitja e raporteve të auditimit;
- Dallimet midis shërbimit të siguridhënies dhe këshillimit;
- Cilat janë metodat, teknikat që përdoren për identifikimin, vlerësimin, monitorimin e risqeve, etj.

Në disa anketa të plotësuara nga pjesëmarrësit në Trajnimin e Vazhdueshëm Profesional, për vitin 2023, u evidentuan edhe komente të cilat shprehnin dobësitë në trajtimin e temave të caktuara, të cilat konsistonin në zhvillimin e temave të trajnimit nga ana e trajnereve me shumë shembuj konkretë (raste studimore) nga paraktika e punës së përditshme të auditimit, si dhe në ndonjë rast kanë shprehur papajtueshmëri me mënyrën didaktike të dhënies së temës nga trajnerë të veçantë.

5.7 Procesi i Certifikimit të Audituesve të Brendshëm për sezonin 2022-2023

Puna e DH/AB synon gjithashtu krijimin e një sistemi për audituesit e brendshëm për të marrë pjesë në trajnimin përgatitor dhe më pas në testime për të marrë provime për certifikim. Kjo kërkon trajnim adekuat për auditorët e brendshëm dhe programin e certifikimit (kombëtar).
Pas vlerësimit nga ana e Komisionit të Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm, 81 audites të brendshëm në NJAB e sektorit publik u vlerësuan të plotësonin kriteret për ndjekjen e certifikimit. Ky proces zhvillohet tashmë prej vitit 2016 nën një kuadër të ri dhe modern të kurrikulave të kategorizuara në 6 Module, sipas një programi dhe rregullore te procedurave që janë hartuar me mbështetjen e SIGMA-s.

5.8 Pyetësori i Vetëvlerësimit të NJAB


Njësitë e auditimit të brendshëm për vitin 2023, kanë plotësuar Pyetësorin e vetëvlerësimit të NJAB, bazuar në Metodologjinë për monitorimin e performancës së njësive publike, e ndryshuar. Nga 136 NJAB të cilat kanë raportuar, këtë pyetësor e kanë plotësuar 115 NJAB. Nga NJAB që kanë detyrimin për të raportuar veprimtarinë e tyre pranë DH/AB, disa njësi publike megjithëse e kanë të miratuar strukturën e NJAB nuk e kanë të plotësuar me stafin audites dhe për këtë arsye nuk kanë dërguar raport për vitin 2023 (Ujs. Kan. Kukës, Ujs. Kan. Dibër, Ujs. Kan. Kamëz, Ujs. Kan. Lushnjë, Ujs. Kan. Berat, Bashkia Kolonjë dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë).

Krahas këtyre rasteve ka institucione të cilat në Raportin Vjetor të Veprimtarisë u mungon Pyetësori i vetëvlerësimit, ku përfshihen: (Agrokredit sha, Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Agjensia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Ujs. Kan. Lezhë, Bashkia Mat, Bashkia Klos, Bashkia Divjakë, Bashkia Fier, Bashkia Has), ndërsa Bashkia Elbasan, Bashkia Fushë Arrëz, Bashkia Kukës dhe Bashkia Sarandë kanë paraqitur një pyetësor të pa përditësuar.

Pyetësori i vetëvlerësimit përmban pyetje për të gjitha fazat e veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Kjo analizë është fokusuar në katër grupime pyetjesh, përkatësisht mbi:

Funksionimin e NJAB sipas akteve ligjore.
NJAB e krijuara në sektorin publik duhet të funksionojnë në përputhje me bazën ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe duhet të përbëhen minimalisht nga tre audites. Kriteret e përcaktuara nuk janë të plotësuara nga një pjesë e konsiderueshme e njësive publike dhe kjo sjell si pasojë performancë të njësive të auditimit jo në kërkesat e standardeve ndërkombëtare. Nga analiza e të dhënave vetëm 81% e NJAB janë ngritur dhe funksionojnë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, pra e përmbushin këtë kriter.
Një nga parimet e auditimit të brendshëm është pavarësia. Një veprimtari audituese e pavaruar funksionalisht jep gjykime dhe vlerësime të pa ndikuara për risqet dhe sistemet e kontrollit të brendshëm. Në të njëjtën kohë të gjitha NJAB duhet të kenë komunikim të rregullt me titullarin e njësisë publike. Nga analiza e të dhënave rezulton se vetëm 80% e NJAB e plotësojnë këtë kriter.


Grafiku 11. Përputhshmëria e NJAB me kërkesat e akteve ligjore



Nga të dhënat e konsoliduara të pyetësorëve, rezulton se 92% të NJAB audituesit e brendshëm nuk përfshihen në veprimtari operacionale. Pjesa tjetër 8% e tyre rezulton në kundërshtim me kriteret ligjore, në to vihet re përfshirje e audituesve të brendshëm në veprimtari operacionale.
Roli i auditimit të brendshëm është të ndihmojë njësinë publike në arritjen e objektivave. Objektivat e NJAB gjithnjë duhet të jenë në përputhje me objektivat e njësisë publike. Nga analiza e të dhënave, vihet re se 87% e NJAB i kanë objektivat e tyre në përputhje me objektivat e njësive publike në të cilat ato operojnë.

Identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve nga NJAB.
Është detyrë e NJAB që në procesin e planifikimit duhet të përdorin metodologji për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve e njësive publike, si dhe të marrin opinionin e titullarit gjatë këtij procesi. Në bazë të kësaj metodologjie organizohet puna që njësitë e identifikuara me risk të lartë të përfshihen në planin vjetor të auditimit. Nga analiza e përgjigjeve të NJAB, rezulton që 72% e tyre e bazojnë planin e auditimit plotësisht në vlerësimin e riskut të veprimtarisë së njësisë publike.

Grafiku 12. Identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve




Evidentohet se vetëm 73% e NJAB kanë vlerësuar drejt risqet e lidhura me objektivat e njësisë publike, kurse 27% e NJAB kanë nevojë për përmirësime në këtë vlerësim. Në lidhje me këtë është e nevojshme të trajtohet me prioritet si në programet e trajnimit ashtu dhe në seminaret e ndërgjegjësimit në fushën e auditimit të brendshëm, sepse është një nga vlerësimet e rëndësishme që duhet trajtuar nga audituesit.

NJAB si pjesë integrale e strukturës organike të njësisë publike duhet të japë kontributin e saj në hartimin e regjistrit të riskut. Nga të dhënat e analizuara vetëm 68% e NJAB përmbushin këtë kriter, sepse nga të dhënat që MF disponon një numër i konsiderueshëm njësish publike nuk kanë hartuar regjistrin e riskut.

NJAB gjatë veprimtarisë së tyre duhet të vlerësojnë funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Nga analiza evidentohet se 82% e NJAB e përmushin këtë kriter dhe 18% e vlerësojnë pjesërisht, duke mos përmbushur detyrimin ligjor. Megjithëse është e nevojshme të përmirësohet dhe ky vlerësim evidentohet në të gjitha raportet e auditimit NJAB të vlerësuara nga DH/AB, gjatë vitit 2023.

Vendosja e kontrolleve efektive dhe monitorimi i rekomandimeve.
Vihet se se, vetëm 70 % e NJAB vlerësojnë përshtatshmërinë e kontrolleve të vendosura, kurse 30% e tyre i vlerësojnë ato pjesërisht. Në këtë fushë kërkohet vëmendje më e madhe si e drejtuesve të NJAB ashtu dhe nga audituesit për të marrë trajnimet e nevojshme në këtë fushë.
Nga analiza e përgjigjeve të NJAB në lidhje me monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna rezulton që vetëm 78% të NJAB i monitorojnë në vazhdimësi këtë komponent dhe 22% e NJAB i monitorojnë ato pjesërisht. Ky proces i rëndësishëm është në monitorim të vazhdueshëm nga DH/AB.

Grafiku 13. Vlerësimi për kontrollet e vendosura dhe funksionimi i tyre




Vihet re se 87% të drejtuesve të NJAB paraqesin analizën vjetore të veprimtarisë në KAB dhe/ose tek titullari i njësisë publike. Manuali i auditimit të brendshëm ka një procedurë të qartë në lidhje me raportimin e angazhimit të auditimit. 13% e NJAB e realizojnë pjesërisht këtë kërkesë të Manualit.

Vlerësimi i brendshëm i cilësisë së veprimtarisë audituese.

Në lidhje me Programin e Sigurimit të Cilësisë vetëm 61% të NJAB rezultojnë të kenë hartuar, miratuar dhe zbatuar këtë program dhe 29% e NJAB e kanë zbatuar pjesërisht këtë program. Kjo mangësi është evidentuar në pjesën më të madhe të NJAB të vlerësuara nga MF, kryesisht në NJAB që funksionojnë jashtë kritereve (me 1 ose 2 audites) të cilat duhet ta realizojnë këtë shërbim nga ana e NJAB tjetër (sipas përcaktimeve të Manualit të Auditimit të Brendshëm).

Grafiku 14. Vlerësimi i brendshëm i cilësisë së veprimtarisë audituese



Në lidhje me rishikimin e brendshëm të cilësisë nga ana e drejtuesve të NJAB, rezulton se vetëm 62% e tyre realizojnë këtë proces në përputhje me standardet. Në këtë tregues

evidentohet se 28% e NJAB nuk e realizojnë fare këtë proces për shkak të strukturave të cunguara dhe jashtë kritereve (me 1 ose 2 auditues). Kjo problematikë me nivelin e strukturave është në monitorim të vazhdueshëm nga MF.

Evidentohet se vetëm në 70% të NJAB rekomandimet e rishikimit të brendshëm të cilësisë merren në konsideratë nga audituesit. Në këtë element evidentohet se 30% e tyre nuk bien dakort me rekomandimet e dhëna nga ana e rishikuesve.

Nga analiza në tërësi e "Pyetësorit të vetëvlerësimit", vihet re që një pjesë e konsiderueshme e NJAB nuk kanë qenë të qarta dhe koncize në përgjigjet e tyre. Të dhënat tregojnë që përgjigjet e dhëna nuk janë plotësisht në përputhje me të dhënat reale, të cilat janë konsoliduar nga të dhënat e raporteve vjetore të veprimtarisë së NJAB.

Në lidhje me problematikat e konstatuara në këtë analizë, DH/AB do të ketë një nga prioritetet e saj ndërgjegjësimin dhe koordinimin më të madh të informacionit me NJAB për mirëfunksionimin e shërbimit të auditimit të brendshëm në përafrim të plotë me standardet ndërkombëtare.

ANEKSI I. TREGUESIT E PERFORMANCËS SË NJQP-VE.

Treguesit e Buxhetit

1. Planifikimi buxhetor është një hap i rëndësishëm për të arritur suksesin dhe sigurinë në mirëmenaxhimin financiar. Nëpërmjet një planifikimi të mirë buxhetor është e mundur mbikëqyrja e procesit të sigurimit të të ardhurave të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e nevojshme si dhe marrja e vendimeve financiare më të mira. Treguesi **"Realizimi i shpenzimeve buxhetore"** përcakton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet buxhetore gjatë vitit kundrejt planit të buxhetit të miratuar nga Kuvendi. Për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar mesatarisht në nivelin 2.42 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 60.5%), duke reflektuar një performancë mesatare në rritje për njësitë e marra në analizë. Krahasuar me periudhat paraardhëse, evidentohet një nivel i më i lartë i performancës së këtij treguesi. Në përgjithësi Përformancë më të mirë kundrejt këtij indikatori kanë ministritë e linjës dhe institucionet e pavarura. Ndikimin kryesor në vlerësimin e performancës për këtë tregues e paraqesin njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku edhe për këtë vit vlerësohet më pak se ministritë e linjës apo institucionet e pavarura. Nga analiza e kryer nga struktura monitoruese në Ministrinë e Financave, për të gjitha grupet e njësive rezulton se arsyet për mosrealizimin e këtij treguesi në nivelet e preferuara vijnë kryesisht si pasojë e mosrealizimit të shpenzimeve për paga, sigurime në rastet kur nuk plotësohet struktura organizative me punonjës, nga mosrealizimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime apo shpenzimeve për udhëtime e dieta për jashtë vendit, apo nënzërave të tjerë të këtij grupi shpenzimesh. Për institucione ku realizimi në fakt i fondeve paraqitet më i lartë se sa plani fillestar i miratuar në Kuvend, arsyeja është se gjatë vitit këtyre institucioneve i janë shtuar fondet e planifikuara përkatësisht me Aktet Normative të miratuara gjatë vitit 2023 , si edhe me përdorimet nga Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit, nga Fondi i Rindërtimit dhe fondi i veçantë.
2. **"Realizimi i shpenzimeve buxhetore sipas klasifikimit ekonomik"**, mat diferencën midis buxhetit të miratuar dhe buxhetit faktik në fund të vitit për çdo grup të shpenzimeve buxhetore të ndara sipas klasifikimit ekonomik. Kategorizimi i shpenzimeve përmirëson raportet e shpenzimeve të njësisë dhe ofron informacion të detajuar mbi shpenzimet dhe kthimin nga investimet. Ky informacion përdoret nga strukturat e financave për planifikimin e buxhetit dhe optimizimin e procesit të shpërndarjes së burimeve. Nga vlerësimi i kryer për këtë tregues, rezultati është 1.82 pikë ose 45.5%, duke paraqitur një nivel mesatar të performancës së njësive lidhur me këtë tregues, me një rritje të lehtë në krahasim me vitin e kaluar. Përformancë më të mirë kundrejt këtij indikatori kanë ministritë e linjës dhe institucionet e pavarura. Njësitë e vetëqeverisjes vendore paraqiten me vlerësimin më të ulët me 0.49 pikë (12.05%), ku kryesisht evidentohet se llogaritë me treguesin më të ulët janë ato të investimeve dhe subvencioneve, i cili lidhet me afatet kohore që në shumë raste tejkalohen duke vështirësuar realizimin në kohë të këtyre shpenzimeve.
3. Treguesi **"Reduktimi i nivelit të detyrimeve të prapambetura"** paraqet diferencën e stokut 12 – mujor të detyrimeve të prapambetura të vitit buxhetor korrent me stokun 12-mujor të vitit paraardhës në raport me stokun 12 – mujor të vitit paraardhës. Për vitin 2023 , ai është vlerësuar mesatarisht 3.40 pikë (85%), duke treguar një nivel lehtësisht më të ulët në krahasim me vitin e mëparshëm. Në nivel të përgjithshëm stoku 12 mujor i detyrimeve të prapambetura për vitin 2023 është ulur me 35.6% krahasuar me stokun e detyrimeve të vitit paraardhës 2022 . Referuar pikëzimit të përcaktuar në matjen e treguesit të performancës për reduktimin e detyrimeve të prapambatura me 4 pikë janë vlerësuar disa prej institucioneve që kanë ulur stokun e

detyrimeve. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Institucione të tjera Qeveritare, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Drejtësisë, rezultojnë me shkallën me të lartë të reduktimit të detyrimeve nga viti 2022 në vitin 2023. Disa ministri apo institucione vlerësohen me 2 pikë pasi e kanë mbajtur në nivel konstant stokun e detyrimeve të prapambetura si Presidenca, dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit . Kuvendi, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Prokuroria e Përgjithshme, dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë rezultojnë me nivel më të lartë detyrimesh krahasuar me një vit më parë duke u vlerësuar me 1 pikë. Vlen të theksohet se tashmë monitorimi i detyrimeve të prapambetura është një proces i konsoliduar në kohë dhe cilësi, përmes monitorimit periodik intesiv të të gjitha detyrimeve të pashlyera të institucioneve buxhetore. Duke nisur nga muaji Dhjetor 2020, ky monitorim dhe raportimi, i cili më parë kryhej mbi bazë tre-mujore nëpërmjet raportimit shkresor të institucioneve, gjenerohet automatikisht nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 37, datë 6.10.2020 "Për Monitorimin dhe Publikimin Periodik të Stokut të Detyrimeve të Prapambetura të Qeverisjes së Përgjithshme". Ky format i raportimit të detyrimeve të prapambetura përveçse rrit saktësinë dhe siguron të dhënat në kohë reale, është gjithashtu një format gjithëpërfshirës duke unifikuar raportin për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

4. Treguesi **"Realizimi i shpenzimeve kapitale"** paraqet devijimin nga plani i realizimit të shpenzimeve kapitale në një vit kundrejt shpenzimeve kapitale totale të planifikuara me ligjin e buxhetit vjetor në Kuvend. Shpenzimet kapitale paraqesin planifikimin afatgjatë dhe shpenzimet për asete duke synuar mbështetjen e mirëqënies dhe përmirësimin e shërbimeve publike. Nisur nga rëndësia, realizimi i shpenzimeve kapitale mbetet në vëmendjen e njësive publike. Për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar mesatarisht me 0.87 pikë (21.69%), duke shfaqur një performancë jo të kënaqshme të njësive publike, duke qenë se paraqet një nivel të konsiderueshëm devijimi nga fondet e planifikuara. Nga të gjitha grupet e NJQP-ve të marra në analizë, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë devijimin më të lartë, në krahasim me ministritë e linjës dhe institucionet e pavarura. Për ato njësi, të cilat paraqesin një performancë shumë të ulët të realizimit të këtij treguesi, evidentohet se shkaqet kryesore janë të lidhura kryesisht me problematikat dhe vonesat që ndodhin gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit. Nga analiza e kryer, rezulton se, për disa institucione vijon të mbetet praktikë mosplanifikimi i investimeve edhe përgjatë vitit 2023. Institucionet duhet të fokusohen në marrjen e masave për realizimin e këtij treguesi pasi mungesa e injektimit të likuiditetit në ekonomi ndikon ndjeshëm në sigurimin e mirëqënies në vend, në mos-stimulimin e rritjes ekonomike, në hapjen e vendeve të reja të punës apo të ardhurat nga tatimet e taksat.
5. **"Investimet kapitale shumëvjeçare janë hedhur në sistem sipas planit kontraktual të disbursimit"** është një tregues tjetër i rëndësishëm, i cili paraqet shumën totale të shpenzimeve për projektet e investimeve në periudhën e vlerësimit (një ose disavjeçare) kundrejt shumës totale të planit shumëvjeçar të parashikuar për projektet. Për shkak të mungesës së të dhënave për vlerësim nga struktura përkatëse në MF, njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashki dhe këshill qarku), nuk përfshihen në analizë për këtë tregues. Për periudhën analizuese, për minitritë e linjës dhe institucionet e pavarura, gr.87, ky tregues është vlerësuar mesatarisht me 2.51 pikë (ose 62.66%) të nivelit referues, duke reflektuar një ulje të lehtë në krahasim me vitin 2022, ku ka qënë i vlerësuar me 3.35 pikë. Pavarësisht vlerësimit për vitin 2023, mund të evidentojmë faktin se pothuajse të gjitha njësitë publike të marra në analizë

kanë realizuar një performancë të kënaqshme përsa i përket parashikimit të fondeve në fillim të vitit buxhetor, gjë e cila ka sjellë diferenca apo devijime më të ulëta të planeve buxhetore. Ndërkohë që, problematikat e këtij treguesi vijnë kryesisht nga rishikimi i buxhetit, i cili kryhet duke i kaluar fondet nga projektet me ecuri më të ulët në ato me ecuri më të lartë, ku ecuria e ulët mund të jetë rezultat edhe i planifikimit të gabuar dhe nuk janë mbajtur parasysh faktorët që mund të pengojnë ecurinë e projektit gjatë vitit.

**Rënia e lehtë e pësuar në këtë indikator dhe në indikatorin 4, për të gjitha institucionet argumentohet se ulja e indikatorëve është e ndikuar kryesisht nga realizimi shumë i ulët i Financimit të Huaj dhe kryesisht i Granteve i cili u realizua vetem në masën 54 % për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022, i cili u realizua në masën 85%. Gjithashtu, një ndikim ka dhënë edhe Financimi i Brendshëm i cili është realizuar në masën 95.8% për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022 i cili u realizua në masën 97.8%.*

Treguesit e Thesarit

6. Ekzekutimi i buxhetit është një cikël procesesh që përfshijnë monitorimin, përshtatjen dhe raportimin e buxhetit të planifikuar të vitit aktual. Ekzekutimi me sukses i buxhetit ndikohet nga procedurat financiare të institucionit dhe nga aftësitë administrative. Në këtë kuadër, një nga treguesit e analizuar për vlerësimin e performancës është **"Të gjitha faturat janë dërguar në kohë për pagesë pranë degës përkatëse të thesarit"**, i cili përcakton numrin e faturave të dërguara në thesar për pagesë pas afatit kohor prej 30 ditësh kundrejt numrit total të faturave të dërguara për pagesë. Për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar mesatarisht në nivelin 2.41 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 60.13%), duke reflektuar një rritje të lehtë të performancës në krahasim me dy vitet paraardhëse. Pavarësisht rezultatit, realizimi i këtij treguesi mbetet ende mjaft i luhatshëm për të gjitha grupet e njësive të qeverisjes së përgjithshme të marra në analizë. Struktura përgjegjëse për gjenerimin dhe analizimin e të dhënave për këtë tregues, evidenton se arsyet e mosdërgimit në kohë të faturave në thesar vijnë për shkak se furnitorët nuk paraqesin faturat në kohë në institucion, dokumentacioni mbështetës i dërguar nuk është i plotë ose i saktë si dhe ndodh që shpesh të ketë vonesa në lidhje me dërgimin e të dhënave bankare të furnitorit. Gjithashtu, një faktor tjetër prezent për rezultatin e vlerësimit të këtij treguesi është paqëndrueshmëria e strukturave dhe mosfunskionimi i institucioneve dhe stafit përkatës me kapacitet të plotë duke sjellë vonesa në respektimin e afateve kohore të vendosura. Për institucionet të cilat kanë kaluar afatin 30-ditor të paraqitjes faturave për likuidim janë dërguar shkresa "tërheqje vëmendje" nga Nëpunësi i Parë Autorizues, çdo muaj gjatë vitit 2023, për marrjen e masave të nevojshme dhe respektimin e afateve të parashikuara në ligj.
7. **"Faturat e detyrimeve të prapambetura janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit për regjistrimin në SIFQ si shpenzime të periudhave të ardhshme (llogaria ekonomike 486)"** është një tjetër tregues i analizuar nga struktura përgjegjëse për thesarin. Për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar me 1.68 pikë (ose 42%), duke u pozicionuar në të njëjtin nivel në krahasim me vitin 2022. Referuar vlerësimit për këtë vit, rezulton se 42% e faturave të detyrimeve të prapambetura nuk janë kontabilizuar brenda afatit kohor prej 30 ditësh në SIFQ. Në përgjithësi problematikat vinë për shkak të mungesës së fondeve buxhetore nga ana e institucioneve, të cilat ndërmarrin angazhime përtej kapaciteteve të tyre ose për shkak të mosplanifikimit të duhur mujor të arkës. Ajo që duhet të mbahet në konsideratë, është fakti se, gjatë vlerësimit të këtij treguesi, ka pasur mungesë të dhënash për

pjesën më të madhe të institucioneve, kryesisht institucionet e nivelit qendror, për të cilat struktura përgjegjëse për thesarin është shprehur se nuk mund të japë një vlerësim për ekzistencën apo jo të faturave të detyrimeve të prapambetura, për aq kohë sa ato nuk janë paraqitur për regjistrim në degët përkatëse të thesarit nga ana e institucioneve.

8. Një tregues tjetër i analizuar është **"Të gjitha kontratat janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit"**, i cili përcakton numrin e kontratave të dërguara pranë degëve të thesarit pas tre ditëve nga data e nënshkrimit të tyre kundrejt numrit total të kontratave të dërguara në thesar. Për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar mesatarisht në nivelin 2.12 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 52.91%), duke reflektuar një situatë më të përmirësuarnë krahasim me dy vitet e mëparshme. Të gjitha grupet e institucioneve paraqesin mangësi në këtë fushë, kryesisht njësitë e pavarura, institucionet me buxhet të madh dhe ministritë e linjës.. Ndërkohë, arsyet për mosrealizimin e këtij treguesi vijnë kryesisht si pasojë e mungesës së disponibilitetit të personave, të cilët nënshkruajnë kontratën, duke shkaktuar vonesa në dërgimin e tyre. Gjithashtu, ashtu siç është kontestuar edhe nga institucionet e marra në analizë, afati ditor prej 3 ditësh për dërgimin e kontratave në thesar është praktikisht i pamundur për t'u zbatuar, kryesisht nga ato institucione të cilat nënshkruajnë dhe menaxhojnë një numër të konsiderueshëm kontratash. Për institucionet të cilat kanë tejkaluar afatin 3-ditor të paraqitjes së urdhrave të blerjes në degët e Thesarit janë dërguar shkresat "tërheqje vëmendje" nga Nëpunësi i Parë Autorizues, çdo muaj gjatë vitit 2023 për marrjen e masave të nevojshme dhe respektimin e afateve të parashikuara në ligj.
9. Treguesi **"Numri i urdhër-prokurimeve të paautorizuara"** paraqet numrin e urdhër prokurimeve të paautorizuara kundrejt shumës totale të urdhër prokurimeve të dërguara për pagesë në thesar. Nga analiza e kryer, rezulton se për vitin 2023, ky tregues paraqet një performancë mjaft të kënaqshme për të gjitha grupet e institucioneve, duke u vlerësuar me 3.95 pikë (ose 98.83%), me një përformancë në rritje në krahasim me dy vitet paraardhëse. Institucionet me vlerësimin më të ulët paraqiten bashkitë, ndërkohë që grupet e tjera të institucioneve kanë një vlerësim maksimal, si rezultat i faktit se të gjitha njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimeve Publike me autorizimin e Thesarit. Pavarësisht detyrimit ligjor për kryerjen e një procesi të saktë të prokurimit publik, ende paraqitet një numër i vogël institucionesh të cilat devijojnë nga këto rregulla për shkak të mungesës ose mospërputhjes së dokumentacionit mbështetës të urdhër prokurimeve. Edhe në këto raste, specifikisht për institucionet të cilat kanë paraqitur urdhër prokurime të paprocesuara nga degët e Thesarit, ministria përgjegjëse për financat, nëpërmjet Nëpunësit të Parë Autorizues ka njoftuar zyrtyarisht institucionet çdo muaj gjatë vitit 2023, për marrjen e masave të nevojshme dhe respektimin e afateve të parashikuara në ligjin përkatës.
10. Një tjetër tregues i marrë në analizë nga struktura përgjegjëse për thesarin është **"Kufizimi i avancimit të planit mujor të arkës"**, i cili përcakton vlerën e avancimeve të kryera gjatë vitit nga njësitë shpenzuese kundrejt totalit të planit vjetor të arkës. Për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar në nivelin 3.94 pikë (ose 99%), duke reflektuar për një situatë mjaft pozitive për këtë fushë për të gjitha institucionet e marra në analizë, e ngjashme edhe me dy vitet paraardhëse. Pavarësisht se problematikat për këtë tregues janë minimale dhe vijnë kryesisht për shkak të situatave emergjente të paparashikuara të institucioneve si dhe mungesës së parashikimit të duhur të fluksit të mjeteve monetare, evidentohet nevoja e

parashikimit mujor të fluksit të mjeteve monetare nga institucionet si dhe raportimin në intervale kohore të shpeshta pranë strukturave përgjegjëse në MF.

11. Treguesi **"Paraqitja, nënshkrimi dhe respektimi i afatit kohor të dorëzimit të pasqyrave financiare sipas kuadrit ligjor në fuqi",** i cili mat respektimin e afatit kohor, nënshkrimit, përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore në NJQP, për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar në nivelin 3.52 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 88%), duke reflektuar një performancë të kënaqshme por lehtësisht në ulje në këtë fushë. Në zbatim të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NJQP", pika 117 dhe 118, të cilat përcaktojnë paraqitjen e pasqyrave financiare dhe afatet kohore ligjore për dorëzimin e pasqyrave financiare, institucionet depozitojnë pasqyrat financiare pranë degëve përkatëse të thesarit.

<u>Treguesit e menaxhimit financiar dhe kontrollit</u>

12. Treguesi i parë i analizuar nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar, kontrollit dhe kontabilitetit është **"Hartimi me cilësi i planit të veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK) dhe paraqitja brenda afateve kohore të përcaktuara**", i cili përcakton respektimin e afatit kohor dhe cilësinë e përmbajtjes së Planit të Veprimit për ngritjen e sistemit të MFK-së në NJQP. Plani i veprimit për ngritjen e sistemit të MFK-së ndihmon në evidentimin e masave konkrete, afateve dhe strukturave përgjegjëse për adresimin e problematikave të evidentuara gjatë vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm. Për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar mesatarisht në nivelin 2.73 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 68.32%), duke reflektuar një performancë të përmirësuar lehtë në krahasim me dy vitet paraardhëse për të gjitha grupet e institucioneve. Nga monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes dhe funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në NJQP, DH/MFKK evidenton se ndikimin kryesor në rritjen e performancës për këtë tregues e ka angazhimi dhe mbështetja e vazhdueshme që kjo strukturë ju ofron NJQP. Konkretisht, realizimi i procesit të vlerësimit të cilësisë apo ofrimi i asistencës teknike, ka mundësuar rritjen e ndërgjegjësimit të menaxherëve dhe stafit për njohjen dhe zbatimin e instrumentave të MFK. Rekomandimet e dhëna në raportet e vlerësimit kanë shërbyer si pikënisje për hartimin e planit të veprimit me qëllim evidentimin e masave për adresimin e mangësive të konstatuara dhe ndjekjen në vazhdimësi të tyre duke kontribuar në përmirësimin e mekanizmave të monitorimit të sistemit të kontrollit të brendshëm. Pavarësisht performancës në rritje të këtij treguesi, referuar edhe situatës së prezantuar në pyetësorët e vetëvlerësimit, evidentohen mangësi në zbatimin e tij kryesisht në njësitë e vetëqeverisjes vendore, në të cilat vihet re një mungesë e ndërmarrjes së masave për sigurimin e realizimit të procesit të monitorimit në institucion dhe zbatimit të masave konkrete për adresimin e problematikave. Në këtë kuadër, për vitin 2023 është evidentuar se një pjesë e e institucioneve nuk kanë hartuar një plan veprimi për vitin 2024, nuk kanë respektuar formatin e rishikuar dhe miratuar në manualin e MFK si dhe kanë ende në përdorim planin e veprimit për vitin 2023 , gjë e cila ka ndikuar edhe vlerësimin me pikë për secilin institucion. Gjithashtu, vazhdon të mbetet problematikë vështirësia e institucioneve në konkretizimin e rekomandimeve të dhëna nga Njësitë e Auditimit të Brendshëm dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit në një plan veprimi për nxitjen dhe përmirësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.
13. Një tjetër tregues i analizuar nga DH/MFKK është **"Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm",** i cili përcakton përmbushjen e kritereve ligjore, cilësinë e raportit vjetor dhe deklaratës së cilësisë si

dhe gjithëpërfshirjen e informacionit mbi statusin e implementimit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike (nëpërmjet pyetësorëve të vetëvlerësimit). Për vitin 2023 , ky tregues është vlerësuar mesatarisht në nivelin 2.97 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 74.31%), duke reflektuar një performancë mesatarisht të kënaqshme edhe pse me një ulje të lehtë, në këtë fushë kryesisht për ministritë e linjës dhe institucionet e pavarura, të ngjashme me dy vitet paraardhëse. Ndërkohë, vlerësimi për njësitë e vetëqeverisjes vendore vijon të jetë më i ulët se për grupet e tjera të marra në analizë, specifikisht 2.73 pikë. Pjesa më e madhe e institucioneve kanë respektuar afatin kohor të dërgimit të raportit vjetor dhe deklaratës së cilësisë si dhe i kanë paraqitur ato në formatin e duhur. Gjithashtu, pyetësorët e vetëvlerësimit, në përgjithësi, kanë pasqyruar një informacion të plotë, gjithëpërfshirës në lidhje me statusin e implementimit si dhe të arsyetuar me evidenca mbështetëse konkrete, duke treguar për një rritje të ndërgjegjësimit lidhur me mënyrën dhe rëndësinë e plotësimit të tij në kuadër të paraqitjes së situatës reale të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike. Ndërkohë, ashtu si vitin e kaluar, ende ka njësi (kryesisht njësi të vetëqeverisjes vendore), të cilat nuk kanë depozituar pyetësorët në formatin e duhur apo përmbajtja dhe cilësia e informacionit të përfshirë nuk ishte në nivelin e dëshiruar për të realizuar një analizë të thelluar të gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm. Gjithashtu, edhe për këtë vit analizues, janë evidentuar institucione të cilat nuk kanë zbatuar kërkesat ligjore në fuqi duke mos depozituar pranë MF-së, deklaratën dhe raportin për cilësinë dhe gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm apo pyetësorin e duhur të vetëvlerësimit.

14. Treguesi i fundit i analizuar nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar, kontrollin dhe kontabilitetin është **"Efektiviteti i mekanizmave bazë të përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë e sektorit publik",** i cili vlerëson se në çfarë mase dhe sa shpesh njësitë publike përmbushin kriteret themelore të përgjegjshmërisë menaxheriale. Procedura për vlerësimin e këtij treguesi i referohet përzgjedhjes dhe analizimit të 31 pyetjeve në pyetësorin e vetëvlerësimit, të cilat lidhen me fushën e përgjegjshmërisë menaxheriale. Ky tregues, mbart një rëndësi të veçantë dhe qëndron në fokusin e vlerësimeve të vazhdueshme nga organizmat ndërkombëtarë, si një nga faktorët kryesorë në zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe përmbushjen e kërkesave për integrimin në Bashkimin Evropian. Për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar mesatarisht në nivelin 2.92 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 73%), duke reflektuar një performancë të mirë në këtë fushë, të ngjashme me atë të dy viteve paraardhëse me një rritje shumë të lehtë. Referuar mekanizmave bazë për zhvillimin e përgjegjshmërisë menaxheriale, nga analiza e detajuar për të gjitha grupet e NJQP, evidentohet se, institucionet kanë miratuar struktura organizative të përshtatshme me madhësinë, natyrën dhe kompleksitetin e veprimtarisë së tyre. Gjithashtu, institucionet kanë të përcaktuara deklaratat e misionit dhe objektivat e tyre strategjikë dhe operacionalë, pjesë e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm, duke krijuar një lidhje organike midis këtyre prioriteteve dhe objektivave të performancës. Në hartimin e këtij dokumenti janë të përfshirë të gjithë drejtuesit e programeve, të cilët analizojnë situatën dhe përcaktojnë, monitorojnë dhe raportojnë prioritetet dhe objektivat për t'u realizuar. Ashtu sikurse është evidentuar edhe nga vlerësimet e kaluara, ende vazhdon të mbetet problematikë mungesa e raportimeve të rregullta periodike si dhe ndërmarrja e masave konkrete për adresimin e çështjeve në lidhje me sistemin e kontrollit të brendshëm, gjë e cila evidenton nevojën për hartimin e një sistemi procedurash lidhur me krijimin, zbatimin dhe raportimin standard periodik pranë menaxherëve apo strukturave të tjera të institucionit.

Referuar përgjjigjeve të dhëna dhe situatës së prezantuar në pyetësorët e vetëvlerësimit, fokusi i raportimeve mbetet në dhënien e informacionit mbi performancën financiare, siç janë raportet për monitorimin e buxhetit apo raportet për detyrimet financiare dhe më pak mbi përgatitjen e raporteve periodike mbi ecurinë dhe statusin e implementimit të objektivave të vendosura apo edhe çështjeve që lidhen me sistemet e kontrollit të brendshëm. Një situatë e ngjashme evidentohet edhe nga vlerësimet në terren të realizuara nga DH/MFKK me disa përjashtime ku institucionet e monitoruara kanë krijuar dhe zbatojnë mekanizma për raportimin periodik të objektivave të planifikuara në planet operacionale të punës, proces i cili ndihmon në paraqitjen e një tabloje të qartë të funksionimit të veprimtarisë së institucionit. Një mekanizëm tjetër i rëndësishëm për funksionimin e një sistemi efektiv të përgjegjshmërisë menaxheriale është edhe përdorimi i procedurave të rregullta të delegimit të detyrave dhe përgjegjësive, element ky, që gjen pak zbatim dhe vlerësohet në nivele jo të kënaqshme për pjesën më të madhe të institucioneve. Pavarësisht mbështetjes së ofruar nga MF nëpërmjet kuadrit rregullator apo asistencës teknike si dhe rekomandimeve të dhëna gjatë kryerjes së vlerësimeve të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm të pakta janë ato institucione që kanë kthyer në praktikë pune procesin e delegimit duke rritur efektivitetin e realizimit të veprimtarisë së tyre. Mangësitë e evidentuara për zbatimin e këtij instrumenti lidhen kryesisht me mungesën e ndërgjegjësimit për të kuptuar rëndësinë e tij si dhe përcaktimin e qartë të termave, rregullave dhe procedurave që duhet të ndiqen në procesin e delegimit të detyrave brenda njësisë publike.

<u>Treguesit e Auditimit të brendshëm</u>

15. **Organizimi i NJAB-ve dhe kapacitetet e AB.** Ky tregues vlerëson nivelin e përputhshmërisë së krijimit dhe funksionimit të NJAB-ve si dhe të kritereve të punësimit dhe kualifikimit profesional të audituesve të brendshëm me kërkesat ligjore dhe standartet profesionale të pranuara në fushën e auditimit të brendshëm publik. Krijimi dhe funksionimi i strukturave të auditimit në përputhje me kriteret e caktuara dhe pajisja e tyre me kapacitetet e nevojshme profesionale përbën një parakusht të rëndësishëm për kryerjen e veprimtarisë audituese sipas standarteve ndërkombëtare profesionale dhe praktikave më të mira. Forma e krijimit dhe mënyra e funksionimit të shërbimit të auditimit të brendshëm të vendosur brenda njësisë publike siguron gjithashtu pavarësinë organizative dhe funksionale të auditimit të brendshëm. Gjatë vitit 2023 ky indikator vlerësohet me 2.82 (70.57%), duke rezultuar në një nivel me rritje në krahasim me vitin 2022 (vlerësuar me pikë mesatare 2.38 pikë). Në Faktorët që ndikojnë në këtë nivel lidhen më së shumti me vështirësitë në gjetjen e stafit të kualifikuar për tu punësuar si " Audituesë të Brendshëm" dhe /apo 'Drejtues të Njësisë së Auditimit të Brëndshëm" në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe njësitë publike të nivelit të dytë të qeverisjes së përgjithsme. Përmirësim i dukshëm vërehet në drejtim të zhvillimit profesional të Audituesve të brendshëm si në nivelin e audituesve të certifikuar ashtu dhe në trajnimin e vijueshëm profesional sipas të cilit të gjithë audituesit e brendshëm ndjekin jo më pak se 80 orë trajnimi të shpërndara në dy vjet. Zbatimi i Programit të Trajnimit të Vijueshëm për audituesit e brendshëm (miratuar çdo vit nga Ministri i Financave) ka bërë të mundur që të gjithë audituesit e brendshëm në detyrë të ndjekin trajnimet e ofruara nga DH/AB në rreth 40 orë në vit.
16. **Cilësia e përgatitjes së planifikimit strategjik dhe vjetor nga NJAB-të.** Ky tregues vlerëson cilësinë e përgatitjes së planit strategjik dhe vjetor të NJAB-ve dhe në çfarë mase NJAB-të përmbushin kriteret e përgatitjes së këtij dokumenti. Cilësia e

përgatitjes së Planit Strategjik dhe Vjetor nga NJAB-të e sektorit publik është një tregues që ndihmon të vlerësojmë se deri në çfarë mase puna audituese është e orjentuar të mbulojë zonat me risk më të lartë në njësitë publike si dhe të planifikojë efektivisht burimet e nevojshme për kryerjen e angazhimeve të auditimit të brendshëm në mënyrë të tillë që të ofrojnë siguri të pavarur dhe objektive për titullarin e njësisë publike si dhe të sjellë vlerë të shtuar. Planifikimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm është pjesë e planit të përgjithshëm të veprimtarisë së çdo njësie publike dhe duhet ti shërbejë arritjes së objektivave strategjikë institucionale. Për vitin 2023 ky indikator është vlerësuar me pikë 2.79 pikë, ose 69.7%, në krahasim me vitin 2022 (mesatarja 2.47, pikë), pra duke demostruar një nivel përrmirësimi në drejtim të zbatimit të kërkesave të standarteve profesionale, krahasuar me përiudhën e mëparshme. Njësitë e auditimit të brendshëm kanë përmirësuar punën në vlerësimin e risqeve institucionale dhe kadresuar fokusin në drejtim të fushave me risk të lartë, por dhe çështje të rendësishme për të gjithë sistemin e financave publik dhe angazhimeve në rrugën drejt integrimit evropian.

17. **Cilësia e përgatitjes së Raportit vjetor të NJAB-ve,** Ky tregues vlerëson performancën e njësisë së auditimit nëpërmjet cilësisë së Raportit Vjetor të NJAB-ve. Raporti Vjetor i cili përgatitet çdo vit nga njësitë e auditimit të brendshëm në sektorin publik, dërgohet në ministrinë përgjegjëse për financat dhe bëhet pjesë e Raportit Vjetor të KBFP. Raportimi është dokumenti ku auditimi i brendshëm ofron rezultatet e punës audituese nëpërmjet të cilit vlerësohet përgjegjshmëria e titullarëve të njësisë publike në vendosjen dhe mbajtjen e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm, qeverisjes dhe menaxhimit të riskut dhe përbën një mjet të fuqishëm për të nxitur ndryshimin pozitiv dhe përmirësimin e performancës të vetë njësisë publike. Niveli i përmbushjes së kërkesave për parimet e raportimit të auditimit për vitin 2023 vlerësohet në nivelin 2.74 pikë, ose 68.62% duke rezultuar me rritje në krahasim me vitin 2022, vlerësuar me 2.4 pikë.

18. **Zbatimi i rekomandimeve të AB-së.** Niveli i zbatimit të rekomandimeve të AB-së nga subjektet e audituara përfaqëson treguesin kryesor të përformancës dhe efektivitetit të funksionit të auditimit të brendshëm. Rekomandimet të cilat adresojnë gjetjet nga auditimi janë forma nëpërmjet së cilës auditimi i brendshëm ofron këshillë dhe ndihmon në vlerësimin e risqeve, korrigjimin e shkeljeve dhe parregullsive si dhe përmirësimin dhe forcimin e sistemeve të audituara për dobësitë e identifikuara. Cilësia e punës audituese vlerësohet në mënyrë të ndjeshme nëpërmjet impaktit që auditimi sjell në njësinë publike, çka për të cilin për vitin 2023 vlerësohet me 1.82 pikë, ose 45.57% në krahasim me vitin 2022, vlerësuar me 1.1 pikë. Vërehet një nivel shumë i mirë i "Rekomandimeve të pranuara", në masën 99% nga titullarët e institucioneve, çka tregon se në përgjithësi titullarët e institucioneve gjejnë të dobishme dhe me vlerë masat dhe veprimet që rekomandohen nga auditimi për tu ndërmarrë në përgjigje të gjetjeve të identifikuara. Megjithatë zbatimi i plotë i rekomandimeve mbetët një sfidë për shkak të faktorëve të tillë si: ndërgjegjësimi i tilluarëve dhe nivelit të lartë të menaxhimit mbi rolin dhe vlerën e auditimit të brendshëm e cila mbështet gjithashtu rezistencën ndaj ndryshimit, qarkullimi i lartë i stafit, niveli profesional i punonjësve etj.

ANEKSI II. VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË SISTEMIT TË MFK-SË NË NJËSITË SHPENZUESE ME BUXHET TË MADH

DH/MFKK si çdo vit ka vijuar procesin e vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm edhe në njësitë shpenzuese me buxhet të madh, me qëllim sigurimin e një pamje më të qartë të funksionimit dhe progresit të këtij sistemi për vitin 2023. Për këtë vit, janë analizuar 13 njësi shpenzuese me buxhet të madh, duke mundësuar krahasimin në përformancë përgjatë dy viteve.

Vlerësimi i performancës së sistemit të MFK-së në këto njësi varësie për vitin 2023 u bazua në 18 treguesit e performancës lidhur me planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit si dhe treguesit mbi zbatimin e kërkesave ligjore të kontrollit të brendshëm.
Gjatë kësaj analize u vlerësuan edhe 17 parimet e MFK-së me qëllim evidentimin e progresit të sistemit të kontrollit të brendshëm në tërësi dhe adresimin e problematikave të cilat kufizojnë zhvillimin e mëtejshëm të këtij sistemi, përfundimet e së cilës janë paraqitur në Kapitullin nr. II.

Nga vlerësimi i treguesve të përformancës për vitin 2023 institucioni, i cili paraqet një nivel të kënaqshëm të efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm, është Agjencia e Trajtimit të Pronave duke u renditur në vendin e parë me 59 pikë nga 72 pikë maksimale të mundshme dhe me një realizim performance prej 82%. Gjithashtu, për këtë vit vlerësohet se performanca e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave", është në nivele të ulëta, duke u pozicionuar në vendin e fundit me 50 pikë.

Një vështrim i përgjithshëm për treguesit e performancës për këto njësi varësie paraqitet si më poshtë vijon:

1. Treguesi i parë i analizuar nga struktura përgjegjëse për buxhetin në Ministrinë e Financave është **"Realizimi i shpenzimeve buxhetore",** i cili përcakton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet buxhetore gjatë vitit kundrejt planit të buxhetit të miratuar nga Kuvendi. Për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar mesatarisht në nivelin 3.2 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 81 %), duke pësuar një rritje krahasuar me vitin 2022, i cili ka qenë i vlerësuar me 3 pikë (ose 75%) dhe ka reflektuar një performancë të kënaqshme për njësitë e marra në analizë. Rezultati evidenton faktin se, pjesa më e madhe e njësive janë efiçiente dhe efektive në përdorimin e buxhetit dhe realizimin e shpenzimeve të planifikuara për mbarëvajtjen e veprimtarisë së institucionit, ndërkohë që, arsyet për mosrealizimin e këtij treguesi vijnë kryesisht si pasojë e shtyrjes së afateve të realizimit nga procesi i prokurimit, mosrealizimi i shpenzimeve për udhëtim e dieta për jashtë si dhe nënzërave të tjerë të këtij grupi shpenzimesh, apo edhe nga vonesat në paraqitjen e dokumentacionit teknik e financiar për lëvrimin e fondeve. Gjithashtu, për ato institucione në të cilat realizimi faktik i fondeve paraqitet më i lartë sesa plani fillestar i miratuar në Kuvend, arsyeja është shtimi i fondeve të planifikuara përkatësisht me Aktet Normative të miratuara gjatë vitit 2023, si edhe me përdorimet nga Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit.
2. Një tregues tjetër është **"Realizimi i shpenzimeve buxhetore sipas klasifikimit ekonomik"**, i cili mat diferencën midis buxhetit të miratuar dhe buxhetit faktik në fund të vitit për çdo grup të shpenzimeve buxhetore të ndara sipas klasifikimit ekonomik. Nga vlerësimi i kryer për këtë tregues, rezultati është 2.8 pikë ose 69 %, duke pësuar një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2022, i vlerësuar me 2.6 pikë ose 65%. Për ato njësi, që paraqiten me një nivel të realizimit të shpenzimeve më të ulët se plani fillestar i miratuar në Kuvend, evidentojmë se shkaqet kryesore që ndikojnë

në performancë, konsistojnë në mosrealizimin e shpenzimeve për paga, sigurim si edhe rastet e mosplotësimit të punonjësve në organikë. Gjithashtu, mund të përmendim problematikat e krijuara nga mosrealizimi i shpenzimeve për "Mallra e shërbime", për shkak të mosrealizimit të zërave të tillë si shpenzime për udhëtim dhe dieta për jashtë, mosrealizimi i zërit "Transferta tek individët. Institucionet me performancën më të ulët janë: Agjensia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime, Agjencia e Trajtimit të Pronave, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe Garda e Republikës, vlerësuar me 0 pikë.

3. Treguesi **"Reduktimi i nivelit të detyrimeve të prapambetura"** paraqet diferencën e stokut 12 – mujor të detyrimeve të prapambetura të vitit buxhetor korrent me stokun 12-mujor të vitit paraardhës në raport me stokun 12 – mujor të vitit paraardhës. Për vitin 2023, ai është vlerësuar me 3.6 pikë (90 %) duke reflektuar një performancë të mirë, por me një rënie të lehtë krahasuar me vitin 2022, ku është vlerësuar me 4 pikë ose 100%.
4. Treguesi **"Realizimi i shpenzimeve kapitale"** paraqet devijimin nga plani i realizimit i shpenzimeve kapitale në një vit kundrejt shpenzimeve kapitale totale të planifikuara me ligjin e buxhetit vjetor në Kuvend. Për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar mesatarisht me 2 pikë (50 %), duke shfaqur një performancë mesatare të njësive publike me buxhet të madh dhe ka pësuar rënie në krahasim me vitin 2022, i cili është vlerësuar me 2.7 pikë (67%) Për ato njësi të cilat paraqesin një performancë të ulët të realizimit të këtij treguesi, evidentohet se shkaqet kryesore janë të lidhura kryesisht me kryerjen e procedurave të prokurimit.
5. **"Investimet kapitale shumëvjeçare janë hedhur në sistem sipas planit kontraktual të disbursimit"** është një tregues tjetër i rëndësishëm, i cili paraqet shumat totale të shpenzimeve për projektet e investimeve në periudhën e vlerësimit (një ose disavjeçare) me shumën totale të planit shumëvjeçar të parashikuar për projektet. Për periudhën analizuese, ky tregues është vlerësuar mesatarisht me 2.54 pikë (ose 63 %) të nivelit referues. Vihet re, se në krahasim me vitin paraardhës 2022 ku vlerësimi ka pësuar një rënie të lehtë (3.15 pikë ose 79%). Duhet evidentuar fakti se, për një pjesë të njësive të varësisë të marra në analizë problematika shfaqen lidhur me parashikimin e fondeve në fillim të vitit buxhetor, gjë e cila ka sjellë dhe diferencat apo devijimet e planeve buxhetore. Gjithashtu, rishikimi i buxhetit kryhet duke i kaluar fondet nga projektet me ecuri më të ulët në ato me ecuri më të lartë. Ecuria e ulët mund të jetë rezultat edhe i planifikimit të gabuar, ku nuk janë mbajtur parasysh faktorët që mund të pengojnë ecurinë e projektit gjatë vitit.
6. Treguesi i parë i gjeneruar nga struktura përgjegjëse për thesarin është **"Të gjitha faturat janë dërguar në kohë për pagesë pranë degës përkatëse të thesarit"**, i cili përcakton numrin e faturave të dërguara në thesar për pagesë përtej afatit kohor prej 30 ditësh kundrejt numrit total të faturave të dërguara për pagesë. Për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar mesatarisht me 2.85 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 71 %), duke pësuar rritje të ndjeshme në krahasim me vitin 2022, ku ka qënë i vlerësuar me 2.1 pikë ose 52%. Pavarësisht performancës në rritje, situata e reflektuar evidenton nevojën për ndërmarrjen e masave për respelktimin e kuadrit rregullator. Kryesisht, arsyet e mosdërgimit në kohë të faturave në thesar vijnë për shkak se furnitorët nuk paraqesin faturat në kohë në institucion, dokumentacioni mbështetës i dërguar nuk është i plotë ose i saktë si dhe ndodh që shpesh të ketë vonesa në lidhje me dërgimin e të dhënave bankare të furnitorit. Për këtë tregues, institucionet që shfaqin më shumë problematika janë: Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" dhe Spitali Universitar i Traumës, institucione të cilët janë vlerësuar me pikë minimale.

7. **"Faturat e detyrimeve të prapambetura janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit për regjistrimin në SIFQ si shpenzime të periudhave të ardhshme (llogaria ekonomike 486)"** është një tjetër tregues i analizuar nga struktura përgjegjëse për thesarin. Lidhur me këtë tregues, theksojmë se nuk ka të dhëna për pjesën më të madhe të institucioneve, duke e vlerësuar treguesin në një nivel të ulët me 1 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 25%). Vihet re, se krahasimisht me vitin paraardhës 2022 ka përmirësim, pasi kishte të dhëna vetëm për një institucion (Autoriteti Rrugor Shqiptar), çka e bënte të pamundur më parë vlerësimin për këtë tregues.
8. Një tregues tjetër i analizuar nga struktura përgjegjëse për thesarin është **"Të gjitha kontratat janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit"**, i cili përcakton numrin e kontratave të dërguara pranë degëve përkatëse të thesarit pas tre ditëve nga data e nënshkrimit të tyre, kundrejt numrit total të kontratave të dërguara në thesar. Për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar mesatarisht në nivelin 1.85 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 46 %), duke reflektuar një situatë më pozitive në njësitë e marra në analizë në krahasim me vitin 2022, ku vlerësimi ishte 1.45 pikë ose 37%. Mangësitë e evidentuara vijnë kryesisht si pasojë e mungesës së disponibilitetit të personave, të cilët nënshkruajnë kontratën, duke shkaktuar vonesa në dërgimin e tyre. Gjithashtu, afati ditor prej 3 ditësh për dërgimin e kontratave në thesar është praktikisht i pamundur për t'u zbatuar nga institucionet, të cilët nënshkruajnë dhe menaxhojnë një numër shumë të madh kontratash. Janë vlerësuar me 1 pikë pjesa më e madhe e institucioneve të analizuara.
9. Treguesi **"Numri i urdhër-prokurimeve të paautorizuara"** paraqet numrin e urdhër prokurimeve të paautorizuara kundrejt shumës totale të urdhër prokurimeve të dërguara për pagesë në thesar. Edhe për vitin 2023, ky tregues paraqet një performancë shumë të kënaqshme, me një vlerësim maksimal 4 pikë (100%), duke u vlerësuar në të njëjtin nivel si në vitin 2022. Rezultati evidenton faktin se, njësitë janë efiçente dhe efektive në mbarëvajtjen e procesit të dërgimit të urdhër-prokurimeve të autorizuara në thesar.
10. Një tjetër tregues i marrë në analizë nga struktura përgjegjëse për thesarin është **"Kufizimi i avancimit të planit mujor të arkës"**, i cili përcakton vlerën e avancimeve të kryera gjatë vitit nga njësitë shpenzuese kundrejt totalit të planit vjetor të arkës. Për vitin 2023 ky tregues është vlerësuar maksimalisht me 4 pikë (100%), sikurse në vitin 2022, duke reflektuar një situatë mjaft të mirë dhe të qëndrueshme në këtë proces, duke treguar një aftësi të mirë parashikuese e flukseve të mjeteve monetare.
11. Treguesi i fundit i marrë në analizë nga struktura përgjegjëse për thesarin është **"Paraqitja, nënshkrimi dhe respektimi i afatit kohor të dorëzimit të pasqyrave financiare sipas kuadrit ligjor në fuqi"**, i cili mat respektimin e afatit kohor, nënshkrimit, përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar në nivelin 3.7 pikë (ose 92 %), duke reflektuar një situatë shumë pozitive në këtë fushë, pavarësisht se ka pësuar një rënie të lehtë në krahasim me vitin 2022 i vlerësuar me 3.84 pikë ose 96%. Kjo evidenton nevojën për zbatimin me rigorozitet të kuadrit ligjor të fushës duke përfshirë dhe respektimin e ndryshimeve të realizuara në udhëzimin për përgatitjen e pasqyrave financiare.
12. Treguesi **"Hartimi me cilësi i Planit të Veprimit të MFK-së dhe paraqitja brenda afateve kohore të përcaktuara"**, paraqet respektimin e afatit kohor dhe cilësinë e përmbajtjes së Planit të Veprimit për ngritjen e sistemit të MFK-së në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Për vitin 2023, të dhënat pasqyrojnë një performancë të

mirë për njësitë e marra në analizë, duke qënë se treguesi është vlerësuar mesatarisht me 3.7 pikë nga 4 pikë të mundshme (ose 92 %) të nivelit referues të vlerësimit, në nivel më të lartë se viti 2022, ku vlerësimi ka qenë 3.2 pikë (81%). Nga analiza e kryer, evidentohet se njësitë e vlerësuara kanë paraqitur në formatin e duhur masat e ndërmarra për të adresuar problematikat e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, problematika të dala gjatë procesit t ëvetëvlerësimit. Ndërkohë, vijon të mbetet problematikë vështirësia e institucioneve në konkretizimin e rekomandimeve të dhëna nga Njësitë e Auditimit të Brendshëm dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit.

13. Treguesi **"Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm"**, përcakton respektimin e afatit kohor për depozitimin e pyetësorit të vetëvlerësimit të njësive të marra në analizë si dhe cilësinë e tij, ku një pyetësor është konsideruar gjithëpërfshirës nëse përmban një informacion të plotë, të saktë, të mbështetur në statistika dhe evidenca. Për vitin 2023, ky tregues është vlerësuar mesatarisht me 3.4 pikë ose 85 %, duke reflektuar një performancë më të lartë se ajo e vitit paraardhës 2022, ku është vlerësuar me 3 pikë ose 77%. Pjesa më e madhe e institucioneve të analizuara kanë pasqyruar një informacion të plotë, gjithëpërfshirës në lidhje me statusin e implementimit si dhe të arsyetuar me evidenca mbështetëse konkrete, duke treguar për një rritje të ndërgjegjësimit lidhur me mënyrën dhe rëndësinë e plotësimit të tij në kuadër të paraqitjes së situatës reale të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike.
14. Treguesi **"Efektiviteti i mekanizmave bazë të përgjegjshmërisë menaxheriale në njësitë e sektorit publik"** vlerëson se në çfarë mase dhe se sa shpesh njësitë publike përmbushin kriteret themelore të përgjegjësisë menaxheriale, të specifikuara në ekzistencën e një strukture organizative, të përshatshme me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së saj, hartimin e planit vjetor të punës me objektiva të matshëm e të miratuar nga titullari i njësisë dhe monitorohet të paktën një herë në vit, raportime vjetore mbi nivelin e rezultateve të arritura kundrejt objektivave dhe synimeve të paracaktuara si dhe procedura delegimi sipas bazës ligjore në fuqi. Për vitin 2023, ky tregues është analizuar duke marrë në konsideratë 31 pyetje të pyetësorit të rishikuar të vetëvlerësimit, nga vlerësimi i të cilave, efektiviteti i këtij treguesi është mesatarisht 3.23 pikë ose 81 %, duke pasqyruar një ulje të lehtë në krahasim me vlerësimin e vitit 2022, ku vlerësimi ka qenë 3.3 pikë (83%). Referuar këtij treguesi, institucionet me buxhet të madh kanë reflektuar një performancë të mirë. Nga analiza e kryer, të gjitha institucionet kanë miratuar struktura organizative të përshtatshme me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së tyre. Gjithashtu, institucionet kanë të përcaktuara deklaratat e misionit dhe objektivat e tyre strategjikë dhe operacionalë, pjesë e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm, duke pasur një lidhje organike midis këtyre prioriteteve dhe objektivave të performancës. Në hartimin e këtij dokumenti janë të përfshirë të gjithë drejtuesit e programeve, të cilët analizojnë situatën dhe përcaktojnë, monitorojnë dhe raportojnë prioritetet dhe objektivat për t'u realizuar. Ashtu sikurse është evidentuar edhe nga vlerësimet e kaluara, ende vazhdon të mbetet problematikë mungesa e raportimeve të rregullta periodike si dhe ndërmarrja e masave konkrete për adresimin e çështjeve në lidhje me sistemin e kontrollit të brendshëm. Ndërkohë, mbetet ende problematikë zbatimi i procedurave të sakta të delegimit çka e bën të nevojshme ndërmarrjen e masave për adresimin e problematikave dhe përcaktimin e qartë të termave, rregullave dhe procedurave që duhet të ndiqen në procesin e delegimit të detyrave brenda njësisë publike, në përputhje me kuadrin rregullator në fushën e kontrollit të brendshëm.

ANEKSI III. ANALIZA E 17 PARIME TË MFK BAZUAR NË VETËVLERËSIMIN E NJËSIVE PUBLIKE[20].

Analiza në bazë të parimeve të 5 komponentëve COSO të MFK-së.

I. Mjedisi i Kontrollit

Mjedisi i kontrollit në mbështetje të vlerësimit të pesë parimeve (bazuar kjo në analizën e detajuar të përgjigjeve të dhëna në pyetësorët e vetëvlerësimit), nga të cilat përbëhet, vlerësohet në tërësi pjesërisht efektiv

Parimi 1 - Njësia Publike demostron angazhim për integritet dhe vlerat etike

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet angazhimi i njësive publike në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Janë menaxherët e nivelit të lartë të njësisë publike që duhet të shprehin dhe demonstrojnë rëndësinë e integritetit dhe vlerave etike në të gjithë njësinë publike.

Informacioni i reflektuar në pyetësorët e vetëvlerësimit ka qënë baza për analizimin e situatës dhe vlerësimin e këtij parimi. Ky parim vlerësohet pjesërisht efektiv por shumë afër efektivitetit (një luhatje shumë e vogël) në krahasim me vitin 2022 që rezultonte *efektiv. Kjo luhatje ka ardhur për shkak të ndryshimit statistikor të njësive raportuese për vitin 2023 dhe përfshirjes në vlerësim të Sh.A-ve raportuese.*

Progresi në këtë parim është si rezultat i krijimit të instrumentave mbështetës të tillë si: hartimi i një Kodi të veçantë Etike apo Rregulloret e Brendshme të rishikuara të cilat përmbajnë standardet e sjelljes dhe parimet e etikës. Në këtë dokument janë të evidentuara përgjegjësitë dhe detyrat konkrete të secilit aktor në institucion dhe linjat e raportimit ndërkohë që vijon të ketë mangësi për sa i përket përfshirjes së procedurave të delegimit. Nga analiza e kryer, evidentohet se parimet e etikës dhe respektimi i përgjegjësive të caktuara zbatohen pothuajse nga të gjithë punonjësit dhe janë të pakta rastet e devijimit ndaj këtyre rregullave. Këto raste identifikohen dhe trajtohen nga strukturat përkatëse në njësi sipas rregullave dhe procedurave ligjore në fuqi.

Përsa i përket programeve individuale të trajnimit të punonjësve, në pjesën më të madhe të institucioneve evidentohet se janë marrë masat për hartimin e një regjistri të nevojave për trajnim, të koordinuar paraprakisht dhe depozituar pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) si institucioni përgjegjës për realizimin e trajnimeve në masë për rritjen e kapaciteteve të punonjësve të administratës publike. Të pakta janë ato institucione të cilat kanë krijuar dhe trajtuar një program të dedikuar për njohjen e punonjësve me bazën rregullatore apo kodin e etikës. Duke marrë në konsideratë faktin se, ASPA realizon trajnimet nëpërmjet platformave online të cilat rrisin mundësinë e aksesit dhe pjesëmarrjes, nga informacionet e vëna në dispozicion, vihet re një rritje e interesit dhe numrit të pjesëmarrësve në këto trajnime.

[20] Në këtë analizë përfshihen edhe shoqëritë tregtare që kanë detyrimin për raportim sipas nenit 18 të ligjit të MFK.

Parimi 2 - Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
Organi mbikëqyrës (Titullari / Bordi apo Këshilli i drejtuesve në varësi të llojit të njësisë) duhet të demonstrojë pavarësi në ushtrimin e detyrave dhe ushtron mbikëqyrje për zhvillimin dhe performancën e kontrollit të brendshëm. Konkretisht në njësitë që funksionojnë me borde duhet të sigurohet mbikëqyrja e funksioneve në mënyrë të veçantë dhe veçmas menaxhimit të nivelit të lartë me qëllim operimin në mënyrë të pavarur.

Nga analiza vërehet një rritje e angazhimit të menaxherëve për të ushtruar përgjegjësitë e tyre në funksion të realizimit me cilësi të veprimtarisë së institucionit edhe pse evidentohet një situatë pjesërisht efektive edhe për vitin 2023 të njëjtë me dy vitet paraardhëse. Referuar grupeve të institucioneve të marra në analizë, rezulton se vetëm në një pjesë prej tyre (kryesisht ministri linje dhe institucione të pavarura) janë krijuar dhe funksionojnë mekanizmat e nevojshëm për mbikëqyrjen e veprimtarisë dhe performancës së institucionit duke raportuar progresin dhe mangësitë. Objektivat kryesorë të institucioneve dhe treguesit e performancës për përmbushjen me sukses të tyre janë përcaktuar në dokumentin e programit buxhetor afatmesëm. Si rezultat i këtij procesi, raportimi fokusohet në ecurinë e veprimtarisë dhe performancës financiare të institucionit, si realizimi i shpenzimeve buxhetore apo ecuria e realizimit të investimeve dhe më pak në drejtim të raportimit të arritjeve apo problematikave në zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Për rrjedhojë, evidentohet nevoja për vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe parashikimin e masave konkrete për adresimin e mangësive. Për zbatimin e këtij procesi, lind nevoja e hartimit të një sistemi procedurash, të inkorporuara në bazën rregullative të institucionit me qëllim sigurimin e mbikëqyrjes së performancës nga menaxherët/drejtuesit.

Në rastin e institucioneve që funksionojnë me borde, evidentohet që ky organ realizon funksionet e tij të përcaktuara në aktin e themelimit dhe statutin, dhe anëtarët e bordeve informohen mbi objektivat përkatëse të institucionit. Ndërkohë, për sa i përket mbikëqyrjes dhe raportimit të progresit, evidentohet se raportet e gjeneruara i përkasin realizimit të treguesve financiarë (realizimi i shpenzimeve, i të ardhurave, pasqyrat e pozicionit financiar etj) dhe ende nuk është bërë praktikë pune vlerësimi, mbikëqyrja apo raportimi periodik mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Parimi 3 - Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë

Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organigramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësive funksionale të çdo niveli autoriteti, si dhe nivelit të delegimit të tyre.
Ky parim përcakton përgjegjësinë e Titullarit/NA për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.

Ashtu sikurse në dy vitet paraardhëse, ky parim vijon të vlerësohet pjesërisht efektiv , ku situatë e përmirësuar paraqitet në grupin e ministrive të linjës, veprimtaria e të cilave bazohet ndër të tjera edhe në prioritetet e përcaktuara në strategjitë ndërsektoriale të shoqëruara me plane konkrete veprimi ku janë përcaktuar masat, përgjegjësitë, treguesit e performancës dhe

afatet për realizim. Ndërkohë, vlerësimi mbetet i njëjtë për grupet e tjera të institucioneve të cilat kanë të përcaktuara deklaratat e misionit si dhe objektivat e tyre strategjikë dhe operacionalë si pjesë e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm, duke pasur gjithashtu një lidhje organike midis këtyre prioriteteve dhe objektivave të performancës.

Mos arritja e nivelit të kënaqshëm të plotësimit të këtij parimi, vjen për shak të procedurave të delegimit, ku vijon të mbetet vendimtare ndërgjegjësimi i menaxherëve për rëndësinë që mbart zbatimi i këtij instrumenti. Pavarësisht përmirësimit të bazës ligjore dhe nënligjore të fushës, mungesa apo devijimi i rregullave të delegimit të dokumentuar, ndikon në veprimtarinë e përditshme të institucioneve dhe në vendosjen e autoritetit dhe përgjegjshmërisë së menaxherëve.

Parimi 4 - Njësia publike demostron angazhim në realizimin e kompetencave

Ky parim kompleks dhe gjithëpërfshirës vlerëson angazhimin e njësive publike për të krijuar dhe vlerësuar efektivitetin e politikave dhe procedurave të përputhshmërisë si dhe adresimin e çdo mangësie të evidentuar. Gjithashtu, nëpërmjet këtij parimi vlerësohet kapaciteti i njësisë për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësisë. Nga analiza e kryer për vitin 2023, ashtu si në dy vitet paraardhëse, rezulton se ky parim paraqitet *pjesërisht efektiv*, ku pjesa më e madhe e institucioneve të marra në analizë, kryejnë procesin e vlerësimit të performancës në punë të punonjësve në përputhje me formatet e përcaktuara në legjislacionin përkatës për nënpunësit civilë si dhe hartojnë përshkrimet e punës, në bazë të rregullave të vendosura nga Departamenti i Administratës Pulike. Ashtu sikurse u evidentua edhe më parë, në njësitë e vetëqeverisjes vendore, përshkrimet e punës me detyrat specifike dhe linjat e raportimit për punonjësit janë të pasqyruara në dokumentin e rregullores së brendshme.

Gjithashtu, politikat e burimeve njerëzore dhe praktikat e ngjashme lidhen me rekrutimin transparent, emërimin, vlerësimin e nevojave për trajnimin e vazhdueshëm, vlerësimin korrekt të performancës, si dhe me veprimet disiplinore të punonjësve të institucioneve publike. Pavarësisht ndjekjes të politikave të vendosura për menaxhimin e burimeve njerëzore, ende pjesa më e madhe e institucioneve nuk kanë politika të mirëfillta favorizuese për punonjësit e tyre, ku vlen të theksohet se rritja e vazhdueshme e motivimit dhe nxitjes në karrierë të punonjësve bazuar në rezultatet e performancës, mbetet një ushtrim formal. Ajo që është evidentuar gjatë analizimit të pyetësorëve (kryesisht në njësitë e vetëqeverisjes vendore) është fakti se, gjatë procedurave të rekrutimit për pozicionet e shpallura vakant, nuk ka kërkesa për aplikime apo shprehje të interesit për punësim. Arsyet kryesore konsistojnë në mungesën e besimit për një karrierë profesionale si dhe niveli i ulët i trajtimit me pagë të punonjësve.

Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e MFK-së, pothuajse të gjitha njësitë e marra në analizë nuk kanë parashikuar dhe hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet dhe zbatimin e kërkesave kryesore në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit përveç trajnimeve që janë organizuar nga ASPA. Vlen të theksohet se, përgjatë gjithë vitit 2023 , DH/MFKK në bashkëpunim me ASPA ka ofruar trajnime informuese dhe kurse trajnimi me certifikim për konceptet e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik dhe instrumentat e MFK, të fokusuar kryesisht në realizimin e një procesi efektiv të menaxhimit të riskut.

Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale

Zbatimi i këtij parimi të kontrollit do të thotë njohje shumë e mirë por edhe zbatim në praktikë të konceptit të përgjegjshmërisë menaxheriale. Nëpërmjet këtij parimi synohet që

njësia publike duhet të krijojë mekanizmat e përshtatshëm për të vlerësuar performancën dhe për të kryer veprimtarinë e saj në përputhje me rregullat e etikës si dhe për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësive dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm nëpërmjet stimujve dhe procesit të promovimit. Nga analiza e përgjigjeve të dhëna në pyetësorët e vetëvlerësimit, ky parim vijon të vlerësohet *pjesërisht efektiv* për të gjitha grupet e institucioneve. Kryesisht, njësitë publike, zbatojnë përgjegjshmërinë menaxheriale përmes strukturave, autorizimeve dhe përgjegjësive. Vlen të theksohet se, pavarësisht vlerësimit të pyetësorëve të vetëvlerësimit por bazuar edhe në rezultatet e procesit të vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në disa prej institucioneve, evidentohet se kryesisht njësitë kanë të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale në dokumentin e rregullores së brendshme, bazuar në funksionet dhe pozicionet e punës të secilit. Gjithashtu, referuar përcaktimeve të ligjit të nëpunësit civil, në ministritë e linjës dhe institucionet e pavarura janë hartuar përshkrimet e punës specifike për çdo pozicion pune të cilat përmbajnë objektivat strategjike dhe operacionale të njëjsisë si dhe përgjegjësitë për përmbushjen e tyre dhe raportimin e rezultateve.

Një çështje që ka nevojë për trajtim të mëtejshëm në kuadër të përcaktimit dhe forcimit të përgjegjshmërisë menaxheriale është funksionimi i rregullt i Grupit për Menaxhimin Strategjik (GMS). Zbatimi i rregullave por dhe përcaktimi i tyre në një dokument (p.sh edhe në urdhërin e ngritjes së GMS) mbi funksionimin e GMS mbetet thelbësore për standardizimin e detyrave dhe përgjegjësive të anëtarëve të kësaj strukture duke sanksionuar shtrirjen e veprimtarisë edhe në trajtimin e problematikave të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm përveç diskutimeve dhe vendimmarrjeve që lidhen me planifikimin e fondeve buxhetore apo ecurinë dhe realizimin e treguesve financiarë të njësisë. Gjithashtu, dokumentimi i këtyre takimeve nëpërmjet procesverbaleve apo minutave të takimit mbart rëndësi në vërtetësinë e këtij procesi dhe krijimin e një kronologjie të diskutimeve dhe vendimeve të marra.

II. Menaxhimi i Riskut

Ky komponent përfshin katër parime gjithëpërfshirëse zbatimi i të cilave ndihmon në arritjen e objektivave dhe mirëfunksionimin komponentit të menaxhimit të riskut. Menaxhimi i riskut vlerësohet *pjesërisht efektiv* bazuar në analizën e informacionit të dhënë në pyetësorët e vetëvlerësimit.

Parimi 6 – Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva

Ky parim krijon bazat për të realizuar vlerësimin e riskut nga vetë njësitë publike si dhe paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët/NA/Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitetet, raportimet dhe pajtueshmërinë. Nga analiza e pyetësorëve të vetëvlerësimit, situata paraqitet e njëjtë me vitin e kaluar duke e vlerësuar këtë parim *pjesërisht efektiv* lehtësisht afër të qenit *efektiv*. Mos qënia plotësisht efektiv i këtij parimi vjen si rezultat i moskonkludimit të procesit të strukturuar të përcaktimit të objektivave në plane konkrete veprimi për përmbushjen e tyre nga të gjithë punonjësit sipas përgjegjësive të caktuara. Ndërkohë, vlen të theksohet angazhimi i institucioneve në përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm ku janë identifikuar objektivat dhe prioritetet e institucionit së bashku me programet që këto objektiva i përkasin. Në zbatim të kuadrit ligjor të fushës, procesi i

vendosjes së objektivave në të gjithë njësinë publike drejtohet nga titullari dhe citohet se i'u komunikohet të gjitha strukturave të njësisë nëpërmjet takimeve, postës elektronike ose me memo. Nga analiza e kryer, rezulton se një pjesë e institucioneve (drejtoritë dhe departamentet) i zhvillojnë objektivat e tyre operacionalë duke i vendosur në linjë me objektivat strategjikë dhe politikat kombëtare. Realizimi i këtij procesi në tërësi, duke krijuar një lidhje të qartë mes qëllimit të politikave, objektivave strategjikë e operacionalë si dhe buxhetit të akorduar për realizimin e tyre shërben si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike.

Parimi 7 – Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave.

Ky parim përqëndrohet në risqet, për të gjithë veprimtarinë e njësisë publike, që ndikojnë arritjen e objektivave dhe analizimin e faktorëve për përcaktimin e mënyrave për menaxhimin e risqeve. Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial ose në një funksion operativ, çelësi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen risqet në të gjithë njësinë publike. Parimi vlerësohet pjesërisht efektiv.
Të pakta janë ndryshimet që vihen re në krahasim me dy vitet e kaluara përsa i përket progresit të bërë në funksion të krijimit dhe zbatimit të një procesi sa më efektiv të menaxhimit të riskut. Një pjesë e institucioneve, kryesisht ministri linje dhe institucione të pavarura, kanë krijuar dhe përdorin mekanizma apo instrumenta funksionalë për identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e risqeve. Nga analiza e kryer, marrë në konsideratë dhe performancën e njësive të vlerësuara apo rezultatet konkrete të procesit të vlerësimit në vend të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm gjatë vitit 2023, evidentohet se veprimtaria e tyre ndikohet ndjeshëm nga efektet e një procesi jo të mirëorganizuar të menaxhimit të riskut. Për sa i përket këtij konstatimi, vlen të përmendet performanca e njësive të marra në analizë lidhur me realizimin e treguesve për planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit, ku problematikat e identifikuara në zbatimin e kontratave, rritjen e stokut të detyrimeve të parapambetura apo mosplanifikimin e duhur të likuiditeteve kërkojnë ndërhyrjen e menjëhershme të nivelit të lartë menaxherial në sistematizimin e procesit të menaxhimit të riskut.

Gjithashtu, mos konkretizimi i planifikimit të objektivave strategjikë e operacionalë edhe në plane specifike për menaxhimin e riskut, ndikon në efektivitetin e zbatimit real të këtij procesi. Nga analiza e kryer, rezulton se jo të gjitha njësitë janë angazhuar në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, paraqitjen e tyre në regjistrin e riskut, impaktin që ato përcjellin dhe masat/planet e nevojshme për trajtimin dhe minimizimin e efektit të tyre. Një situatë më pozitive paraqitet në disa prej ministrive të linjës, institucioneve të pavarura apo bashki të cilat janë mbështetur nga Projekti i Financave Lokale në krijimin e mekanizmave të menaxhimit të riskut të tilla si: ngritja e grupit të menaxhimit të riskut, rregulloret për funksionimin e tij apo dhe identifikimi, vlerësimi dhe trajtimi i risqeve për disa nga proceset kryesore të këtyre njësive.

Parimi 8 – Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve

Mashtrimi është një element, ekzistenca e të cilit lidhet me kulturën organizative, integritetin apo personalitetin e punonjësve, efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion apo dhe kushteve të punës. Ky parim analizon se si mashtrimi mund të pengojë njësinë nga arritja e objektivave të identifikuara në Parimin 6. Ky parim mundëson realizimin e vlerësimit të gjithë faktorëve të tillë si: burimet njerëzore, proceset dhe teknologjia për të përcaktuar se si mund të sulmohen kontrollet e sigurisë për të kryer veprimtari abuzive/mashtruese.

Në lidhje me këtë parim, situata paraqitet e njëjtë me dy vitet paraardhëse (pjesërisht efektive) duke evidentuar faktin se një pjesë e njësive marrin në konsideratë mundësinë e riskut të veprimtarive mashtruese, për të cilën hasin vështirësi në kryerjen e vlerësimeve periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Në përgjithësi, nuk janë përcaktuar procedura specifike të vlerësimit të riskut të mashtrimit në institucione si dhe nuk merren masa konkrete për adresimin e riskut të mashtrimit të raportimit financiar, raportimit jo-financiar, përvetësimit të pasurive dhe akteve të paligjshme (përfshirë korrupsionin), ndërkohë që baza ligjore në të cilën mbështeten institucionet në rastet e mashtrimit mbetet ligji i sinjalizuesve.

Ajo që vlen të theksohet është fakti se, vetëm në pak raste (kryesisht ministritë e linjës) menaxhimi i lartë dhe stafi marrin në konsideratë vlerësimin e riskut të mashtrimit si një pjesë integrale të procesit të menaxhimit të riskut, çka e ndihmon njësinë në arritjen e objektivave dhe e bën këtë proces më efektiv. Një instrument i rëndësishëm për realizimin e këtij procesi është dhe hartimi dhe miratimi i planit të integritetit në disa prej institucioneve, i cili i shërben institucionit për identifikimin dhe parandalimin e tërësisë së risqeve, që cënojnë integritetin e institucionit, zyrtarëve dhe nëpunësve publikë. Ky instrument shërben si një dokument pune ku përcaktohen masa konkrete për trajtimin e risqeve të integritetit dhe arritjen e objektivave strategjike dhe specifike të institucionit.

Parimi 9 - Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme

Ndryshimi krijon risk, prandaj, menaxhimi duhet të zbatojë procese që i mundësojnë atij të identifikojë dhe vlerësojë ndryshimet që ndikojnë në institucion, në kohën e duhur. Ky parim kërkon një vlerësim të ndryshimit në njësinë publike në mënyrë të vazhdueshme, si nga jashtë ashtu edhe nga brenda, që mund të ndikojë në risk. Ndryshimet e jashtme përfshijnë ato në mjedisin ekonomik, rregullator dhe fizik. Ndryshimet e brendshme përfshijnë ato në veprimtarinë dhe operacionet e njësisë si dhe ndryshimet në drejtimin dhe filozofinë e saj.

Nga vlerësimi i këtij parimi rezulton se efektiviteti i sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në *nivele mesatare* (pjesërisht efektive) për të gjitha grupet e institucioneve. Ashtu sikurse dy vitet paraardhëse, situata paraqet një mungesë të mekanizmave për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve që lidhen me ndryshimet e rëndësishme. Në përgjithësi, institucionet analizojnë pjesërisht ndyshimet që ndodhin në sistemin e kontrollit të brendshëm për shkak të ndryshimeve strukturore apo menaxheriale. Ky rezultat, vjen kryesisht si pasojë e vështirësisë në identifikimin e shkaqeve potenciale, të cilët ndikojnë në arritjen ose jo të një objektivi si dhe vështirësisë në vlerësimin e probabilitetit të ndodhjes së këtyre shkaqeve, për të cilët duhet vlerësuar efekti i mundshëm në arritjen e objektivave dhe shkalla në të cilën mund të menaxhohet risku. Gjithashtu, rolet dhe përgjegjësitë që lidhen me këto ndryshime dhe kontrollet përkatëse shpërndahen në shumë palë dhe nuk monitorohen në mënyrë efektive ndërkohë që, menaxhimi nënvlerëson rëndësinë e ofrimit të trajnimit të punonjësve për këto role dhe përgjegjësi të reja gjatë periudhës së tranzicionit, duke krijuar kështu riskun e zbatimit të një sistemi jo efektiv të kontrollit të brendshëm.

Problematikë tjetër e evidentuar në lidhje me këtë parim mbetet ende mungesa e procedurave të shkruara mbi lëvizjet e stafit dhe mungesa e pasqyrimit të këtyre ndryshimeve si risqe në regjistrin e riskut të institucionit. Një pjesë e njësive të vetëqeverisjes vendore pohon se lëvizjet e stafit janë të shpeshta dhe procedurat e rekrutimit në pak raste finalizohen me sukses, duke krijuar vakanca dhe riskun e punësimit të punonjësve me kritere jo plotësisht të përshtatshme për ato pozicione pune. Për vitin 2023 , situata paraqitet problematike si në njësitë qendrore ashtu dhe në ato të vetëqeverisjes vendore, ku efektiviteti në rënie vjen si

pasojë e ndryshimeve të shpeshta të drejtuesve apo stafit të këtyre njësive të cilët kanë shfaqur luhatje të vazhdueshme të kulturës dhe qëndrimeve filozofike përsa i përket menaxhimit të ndryshimeve dhe zhvillimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Për rritjen e stabilitetit të strukturave dhe menaxhimin me efektivitet të risqeve të lidhura me to, ndryshimet strukturore apo menaxheriale duhet të ndiqen nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.

III. Aktivitetet e Kontrollit

Ky komponent përbëhet nga tre parime të cilat ndihmojnë në arritjen e objektivave dhe përmbushjen e aktiviteteve të kontrollit. Në tërësi, komponenti vlerësohet *pjesërisht efektiv* por shumë afër të qenit efektiv, duke evidentuar nevojën për marrjen e masave të mëtejshme për sigurimin e funksionalitetit të veprimtarive të kontrollit në mënyrë që ky komponent të arrijë sa më afër efektivitetit.

Parimi 10 – Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.

Sipas këtij parimi, njësia publike zgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit që kontribuojnë në zbutjen e risqeve për arritjen e objektivave në nivele të pranueshme. Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikat, procedurat dhe përgjegjësitë) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. As menaxhimi dhe as auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me risqet që duhet të minimizohen.
Nga analiza e kryer për vitin 2023, rezulton se, NJQP-të menaxhojnë *me efektivitet* aktivitetet e kontrollit të cilat janë kryesisht të lidhura me një sistem funksional të menaxhimit të riskut ku paraprakisht janë identifikuar dhe vlerësuar risqet kryesore që pengojnë realizimin e objektivave. Aktivitetet e ndërmarra eleminojnë apo reduktojnë në një nivel të pranueshëm risqet ndaj të cilave këto institucione janë të ekspozuara.

Ky vlerësim, vjen si rezultat i parashikimit dhe zbatimit të aktiviteteve të kontrollit si masa që rrjedhin nga akte ligjore dhe nënligjore të fushës. Kryesisht situatë pozitive paraqitet në zbatimin e aktiviteteve për ruajtjen dhe mirëmenaxhimin e aktiveve, zbatimit të rregullave të prokurimit publik, ekzekutimin e veprimtarisë financiare si dhe përdorimin e sistemit të duhur të teknologjisë së informacionit.

Ajo që mbetet ende në nivele jo të kënaqshme, kryesisht në njësitë e vetëqeverisjes vendore, është mungesa e hartimit me cilësi të hartave apo manualit të proceseve të punës i cili sjell mbivendosje dhe paqartësi në ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive. Për më tepër, kontrollet për sigurimin e ndarjes së detyrave mund të mos zbatohen në mënyrë adekuate në ato institucione ku strukturat janë të vogla, lëvizja e stafit është e shpeshtë apo veprimtaria e tyre është e kufizuar. Tek Sh.A-të raportuese ky parim rezulton pjesërisht efektiv.

Parimi 11 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme kontrolli mbi teknologjinë

Sipas këtij parimi, njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë për të mbështetur arritjen e objektivave.Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo njësie. Hyrja në epokën e digjitalizimit kërkon vazhdimisht ndërmarrjen e kontrolleve të duhura mbi teknologjinë e informacionit për të siguruar dhe nxitur efikasitetin e veprimtarisë së tyre. Si pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të

sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive publike, përcaktimi i aktiviteteve të duhura të kontrollit mbi teknologjinë mund të ndihmojë menaxherët në arritjen e objektivave të vendosur.
Nga analiza e pyetësorëve për vitin 2023, ashtu sikurse është vlerësuar në vitet paraardhëse, parimi rezulton *pjesërisht efektiv* ku pjesa më e madhe e njësive publike ka vendosur aktivitetet përkatëse të kontrollit për zgjedhjen, zhvillimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e teknologjisë së një njësie publike si dhe procedurat e nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë kundrejt risqeve potenciale. Në përgjithësi, institucionet bazohen në rregullat e përgjithshme të përcaktuara nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe në pak raste pranë disa institucioneve janë përcaktuar rregulla dhe procedura të brendshme në këtë fushë, të përfshira kryesisht në dokumentin e rregullores së brendshme apo rregullore të tjera specifike për teknologjinë e informacionit.

Për mirëfunksionimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, mirëmbajtjen e tyre si dhe kufizimin e qasjes në sistem vetëm tek personat përgjegjës, është e nevojshme ndarja e detyrave dhe përgjegjësive. Nga përgjigjet e reflektuara në pyetësorët e vetëvlerësimit, detyrat dhe përgjegjësitë kryesore identifikohen kryesisht në dokumentin e rregullores së brendshme apo përshkrimet e punës, çka sjell një ulje të nivelit të riskut mbi mundësinë e ndërhyrjeve të paautorizuara në sistem. Ende ka institucione të cilat në varësi të natyrës dhe specifikave të veprimtarisë që kryejnë, pohojnë se përdorin sisteme të teknologjisë së informacionit, të ndryshme nga ato të përdorura në pjesën më të madhe të intitucioneve, të cilat rrisin efikasitetin e shërbimeve të ofruara. Këtu mund të përmendim sistemet e teknologjisë së administratës tatimore dhe doganore, Bashkisë Tiranë si edhe disa bashkive të tjera të mëdha. Ndërkohë, në pjesën më të madhe të njësive të vetëqeverisjes vendore evidentohet një mungesë e sistemeve teknologjike apo kufizim në aksesin dhe përdorimin e tyre. Ajo që vihet re, është fakti se në strukturat me pak punonjës, mungojnë njësitë e menaxhimit të teknologjisë së informacionit me qëllim ofrimin e suportit për mirëmbajtjen e sistemeve apo çështjeve të tjera teknike të lidhura me to.

Parimi 12 – Njësia Publike vendos aktivitete kontrolli përmes politikave dhe procedurave.

Nëpërmjet këtij parimi njësia publike përcakton aktivitetet e kontrollit përmes politikave që parashikojnë veprimtarinë që do të realizohet si dhe procedurave që vendosin këto politika në veprim. Përdorimi i politikave dhe procedurave u jep punonjësve një pamje të qartë të veprimtarisë së njësisë për të cilën ata kontribuojnë, duke mbajtur në konsideratë llojin e kulturës dhe filozofisë që menaxherët transmetojnë. Pavarësisht nga madhësia e njësisë publike dhe kompleksiteti i veprimtarisë së saj, zhvillimi dhe shpërndarja në të gjitha nivelet e politikave dhe procedurave mbetet një nga mekanizmat thelbësorë që çon në mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Nga analiza e kryer për vitin 2023 si dhe nga rezultatet e vlerësimit në vend të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm ky parim vlerësohet *pjesërisht efektiv,* por shumë afër *efektivitetit* në krahasim me vitin e kaluar, në përgjithësi të gjitha grupet e institucioneve pohojnë se zbatojnë me rigorozitet këto procedura dhe rrallëherë evidentohen problematika lidhur me këtë fushë. Nisur nga situata aktuale e zbatimit të aktiviteteve të kontrollit nëpërmjet politikave e procedurave për përmirësimin e veprimtarisë së njësisë sipas fushës së përgjegjësisë dhe adresimin e mangësive mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, lind nevoja për hartimin dhe zbatimin e një dokumenti të veçantë politikash dhe procedurash si dhe kryerjen e vlerësimeve të rregullta të aktiviteteve të kontrollit me qëllim përditësimin dhe përmirësimin e tyre sa herë është e nevojshme.

IV. Informacioni dhe Komunikimi

Ky komponent përfshin tre parime, zbatimi i të cilave ndihmon për të arritur një komunikim dhe informacion efektiv. Informimi dhe komunikimi vlerësohet *pjesërisht efektiv* për vitin 2023 duke u vlerësuar në të njëjtin nivel në krahasim me vitet paraardhëse, referuar dokumentacionit bazë të analizuar.

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor

Sipas këtij parimi njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Menaxhimi së bashku me stafin evidentojnë dhe vlerësojnë aktivitetet kryesore të njësisë për të identifikuar kërkesat për informacion. Përdorimi i informacionit dhe të dhënave përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit brenda dhe jashtë njësisë reflektohet në analiza të përmirësuara dhe vendime të duhura për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Nga analiza e kryer për vitin 2023, parimi vlerësohet *pjesërisht efektiv* ashtu sikurse edhe në dy vitet paraardhëse. Pjesa më e madhe e institucioneve të marra në analizë, evidentojnë se, sistemi i komunikimit funksionon në mënyrën e duhur duke përcjellë një informacion cilësor me qëllim përmbushjen e kërkesave dhe specifikat e nevojshme të menaxhimit. Kryesisht, të gjitha njësitë kanë një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit. Përsa i përket raportimit të informacionit të përpunuar, nga përgjigjet e analizuara, evidentohet se njësitë përgatisin për menaxhimin/drejtuesit, raporte të nevojshme mbi performancën (përmbushjen e detyrave) e njësisë në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me efiçencë dhe efektivitet, por nuk rezulton që të ketë një bazë rregullative që të përcaktojë llojet e raportimit dhe periodicitetin e tyre. Megjithatë, fokusi i këtyre raporteve mbetet në dhënien e informacionit mbi performancën financiare, të tilla si: raportet për monitorimin e buxhetit apo raportet për detyrimet financiare dhe më pak mbi përgatitjen e raporteve periodike mbi ecurinë dhe statusin e implementimit të objektivave të vendosura apo edhe çështjeve që lidhen me sistemet e kontrollit të brendshëm (kryesisht ky proces realizohet nga ministritë e linjës apo dhe disa institucione të pavarura). Ndërkohë, situata mbetet problematike në njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku ende mungojnë strategjitë, politikat apo procedurat standarde për menaxhimin e të dhënave që përcaktojnë pritshmëritë e kontrollit për informacionin, përdorimin e sistemeve të informacionit dhe cilësinë dhe periodicitetin e raportimeve. Kjo situatë është krijuar kryesisht si pasojë e nivelit të ulët të angazhimit të drejtuesve mbi zhvillimin e kësaj fushe.

Përsa i përket sistemeve të mbajtjes së kontabilitetit dhe përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar, evidentohet se një pjesë e konsiderueshme e njësive kanë përditësuar sistemet e informacionit në sisteme të avancuara duke përmirësuar cilësinë e informacionit financiar dhe duke ulur mundësinë për gabime apo deformime të informacionit të transmetuar. Ndërkohë, rregullat për marrjen, gjenerimin dhe përdorimin e informacionit përcaktohen vetëm në rregulloret e brendshme të njësive, të cilat në disa raste nuk janë të përditësuara apo në harmoni me nevojat e njësisë.

Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm

Ky parim kërkon që menaxhimi të përdorë vizionin dhe objektivat strategjikë dhe t'i caktojë ato si objektiva operacionalë për menaxherët e linjës duke përcaktuar rolet përmes politikave

dhe procedurave si dhe një sistem efektiv komunikimi që do të ndihmojë në përmbushjen e misionit të njësisë. Komunikimi është një element thelbësor i lidhur ngushtë me aktivitetet e mbikëqyrjes që siguron se detyrat/përgjegjësitë e caktuara janë realizuar në mënyrën dhe me cilësinë e duhur dhe se objektivat e njësisë janë përmbushur. Njëkohësisht, sistemi i komunikimit sinjalizon menaxhimin mbi pengesat e mundshme apo aktivitetet e panevojshme të cilat ngadalësojnë apo cënojnë arritjen e objektivave dhe synimeve. Komunikimi në mënyrë efektive i objektivave, detyrave dhe përgjegjësive si dhe angazhimi i menaxhimit për të përmbushur rolin e tyre ndikon pozitivisht edhe në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Për vitin 2023, situata paraqitet në nivele *pjesërisht pozitive* ku pjesa më e madhe e institucioneve raportojnë se kanë krijuar dhe përdorin kanalet e komunikimit dhe rregullat bazë për transmetimin e informacionit janë përcaktuar në dokumentin e rregullores së brendshme. Kanalizimi i informacionit brenda njësisë realizohet nëpërmjet komunikimeve zyrtare me shkresa, memo, postë elektronike apo dhe takime të GMS-së. Gjithashtu, informacioni i gjeneruar nga institucioni, në përputhje me kategorinë e klasifikimit, bëhet publik në faqen zyrtare të institucionit në mënyrë që punonjësit dhe publiku të informohen për performancën e veprimtarisë për të cilën është krijuar. Përsa i përket gabimeve apo keqkuptimeve në komunikim, institucionet pohojnë se nuk kanë pasur raste të tilla gjatë vitit 2023, të cilat të kenë ndikuar në cënimin e arritjes së objektivave apo performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm.

Për arritjen e performancës maksimale, në vijim mbeten për t'u adresuar rastet që lidhen me mundësinë e transmetimit të informacioneve të pasakta apo jo relevante apo rëndësinë e hartimit të një metodologjie komunikimi. Gjithashtu, mbetet i nevojshëm formalizimi i procedurave për transmetimin e informacionit me njësitë e varësisë si dhe transmetimi i një informacioni gjithëpërfshirës.

Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm. Përveç ndarjes së informacionit me palët e treta, ajo që vlerësohet është informacioni që ato mund ti ofrojnë menaxhimit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme dhe përmirësimin e strategjive të komunikimit.

Nga vlerësimi i kryer, rezulton se edhe për vitin 2023, ky parim është *pjesërisht efektiv* ku, në përputhje me parimet dhe procedurat e sistemeve të komunikimit të brendshëm, edhe për komunikimin e jashtëm, pjesa më e madhe e njësive kanë përcaktuar rregullat bazë për zbatimin e këtij komunikimi në rregulloren e brendshme të institucionit. Nisur nga veprimtaria specifike që kryejnë këto njësi, evidentohet se, pothuajse të gjitha njësitë publike hyjnë në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresor apo në rrugë elektronike nëpërmjet aksesit në adresat zyrtare të e-mailit.

Pothuajse të gjitha njësitë e marra në analizë pohojnë se zbatojnë procedurat për konsultimin publik në kuadër të transparencës lidhur me aktivitetet mbi hartimin e buxhetit, projektet apo investimet, realizimi i të cilave ka impakt në shoqëri. Gjithashtu, edhe nga verifikimet e kryera gjatë procesit të vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, institucionet publikojnë në faqen zyrtare informacion për sa i përket veprimtarisë financiare dhe jo-financiare, i cili është i aksesueshëm nga publiku dhe palë të treta.

V. Monitorimi

Ky komponent përfshin dy parime, zbatimi i të cilave ndihmon për të arritur një sistem monitorimi efektiv. Për vitin 2023, komponenti i monorimit vlerësohet *pjesërisht efektiv* duke ritheksuar nevojën për përmirësimin e kuadrit rregullator dhe krijimin e një sistemi procedurash për monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe/ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm

Sipas këtij parimi njësia publike zgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe/ose të veçanta për të konstatuar nëse komponentët e kontrollit të brendshëm janë funksional. Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.
Ndryshimet në kuadrin rregullator, ndryshimet në staf apo praktikat e burimeve njerëzore janë ndryshime që ndikojnë në mjedisin e kontrollit dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar ndryshimet e mundshme është i nevojshëm krijimi i një sistemi monitorimi efektiv dhe të vazhdueshëm.

Referuar kuadrit ligjor të kontrollit të brendshëm, vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm kryhet çdo vit nëpërmjet vetëvlerësimit të menaxherëve për strukturat që ata drejtojnë, hartimit të deklaratave dhe raporteve mbi cilësinë e kontrollit të brendshëm por edhe nëpërmjet monitorimeve në vend dhe shërbimit të auditimit të brendshëm apo të jashtëm. Nga vlerësimi i kryer për vitin 2023, i cili rezultoi pjesërisht efektiv, ashtu siç është evidentuar edhe në dy vitet paraardhëse, pjesa më e madhe e institucioneve vijon të bazohet në dokumentin e rregullores së brendshme për zbatimin e rregullave për monitorimin dhe raportimin e realizimit të objektivave të përcaktuar duke evidentuar nevojën për hartimin e një sistemi të procedurave të shkruara, manualeve dhe hartave të proceseve të punës ku të jenë ndarë në mënyrë të qartë detyrat dhe përgjegjësitë për realizimin dhe raportimin periodik të tyre. Ende nuk është bërë praktikë pune vlerësimi dhe monitorimi i elementëve të ndryshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm i cili kur ndërthuret me lëvizjet e shpeshta të stafit, sjell një ulje të performancës të këtij sistemi si dhe veprimtarisë së vetë institucioneve.

Një element tjetër i rëndësishëm, i lidhur ngushtë me procesin e monitorimit është raportimi dhe adresimi i mangësive të evidentuara. Planet e veprimit për ngritjen e sistemit të MFK ndihmojnë në evidentimin e masave konkrete, afateve dhe strukturave përgjegjëse për adresimin e problematikave të evidentuara gjatë vlerësimeve. Ajo që vihet re gjatë këtij viti, është fakti se ende ka një mungesë ndërgjegjësimi për realizimin e monitorimit dhe hartimin e planit të veprimit, ku, një pjesë e institucioneve nuk kanë respektuar formatin e duhur të planit të veprimit, nuk kanë hartuar një plan veprimi për vitin 2024 apo mbajnë ende në përdorim planet e hartuara për vitin 2023 . Situatë e përmirësuar vërehet për ministritë e linjës, dhe institucionet e pavarura ndërkohë që njësitë e vetëqeverisjes vendore rezultojnë të jenë më pak efektive në këtë drejtim.

Gjithashtu, shërbimi i auditimit të brendshëm realizon një vlerësim të sistemit të kontrollit të brendshëm, ku pjesa më e madhe e njësive janë audituar të paktën një herë lidhur me ecurinë e zbatimit të këtij sistemi. Situata vijon e njëjtë për institucionet e pavarura dhe këshillat e qarkut të cilat nuk kanë pjesë të strukturës së tyre organizative njësi auditimi dhe vetëm një pjesë e vogël e tyre e realizojnë këtë shërbim nëpërmjet akt-marrëveshjeve me njësitë e auditimit të brendshëm të njësive të tjera publike. Kryesisht, për të gjitha njësitë publike të marra në analizë, në përfundim të misioneve të kryera të auditimit të brendshëm, gjetjet i bëhen të njohura titullarit dhe në bazë të tyre paraqitet plani i masave për zbatimin e

rekomandimeve. Mungesa e angazhimit dhe ndërgjegjësimit për rëndësinë që mbart procesi i monitorimit të sistemit të kontrollit të brendshëm sjell një nivel të ulët të zbatimit të rekomandimeve të dhëna për përmirësim.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë

Sipas këtij parimi, kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi.
Në bazë të vlerësimit të kryer për vitin 2023, situata mbetet e njëjtë duke vlerësuar këtë parim *pjesërisht efektiv*. Nga përgjigjet e dhëna në pyetësor por edhe nga rezultatet e procesit të vlerësimit të cilësisë, pjesa më e madhe e njësive të marra në analizë pohojnë se menaxhimi identifikon mangësitë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe i bëhen të njohura titullarit apo nëpunësit autorizues, por në pak raste këto mangësi përfshihen në planet e veprimit së bashku me evidentimin e masave korrigjuese për adresimin e tyre. Ky proces realizohet formalisht nga institucionet të cilat janë monitoruar në vend nga DH/MFKK gjatë periudhës 2022-2023, ndërkohë që për pjesën tjetër të institucioneve ende nuk është kthyer në një praktikë pune. Kjo evidenton nevojën për rritjen e nivelit të angazhimit të menaxhimit në kuadër të përmirësimit të mëtejshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm. Gjithashtu, pavarësisht angazhimit të DH/MFKK në procesin e monitorimit, rolin kryesor në vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, evidentimin e mangësive dhe raportimin e tyre, vazhdojnë ta kenë struktura e auditimit të brendshëm apo Kontrolli i Lartë i Shtetit.

ANEKSI IV. OPINIONET E DHËNA GJATË VLERËSIMIT TË JASHTËM TË CILËSISË

Nr.	INSTITUCIONI	VLERËSIMI	PËRPUTHSHMËRIA ME STANDARDET
1	**Instituti i Statistikave**		**Përputhje e plotë** me standardet
2	**Bashkia Mat**		**Mospërputhje e plotë me standardet**
3	**Drejtoria e Përgj. Transportit Rrugor**		**Përputhje e plotë** me standardet
4	**Hekurudha Shqiptare sha**		**Përputhje në disa fusha** me standardet, por kërkohen përmirësime të domosdoshme në fushat ku janë adresuar rekomandimet.
5	**Fondi i Sig. Kujdesit Shëndetësor**		**Përputhje e pjesshme** me standardet, por përmirësimi është i nevojshëm në fusha të caktuara.
6	**Bashkia Klos**		Mospërputhje e plotë me standardet
7	**Bashkia Cërrik**		Mospërputhje e plotë me standardet

8	**Bashkia Fier**		**Përputhje në disa fusha** me standardet, por kërkohen përmirësime të domosdoshme në fushat ku janë adresuar rekomandimet.
9	**Bashkia Vau Dejës**		**Përputhje në disa fusha** me standardet, por kërkohen përmirësime të domosdoshme në fushat ku janë adresuar rekomandimet.
10	**Bashkia Berat**		**Përputhje e pjesshme** me standardet, por përmirësimi është i nevojshëm në fusha të caktuara.
11	**Bashkia Fushë-Arrëz**		Mospërputhje e plotë me standardet
12	**Autoriteti Portual Durrës**		**Përputhje e pjesshme** me standardet, por përmirësimi është i nevojshëm në fusha të caktuara.
13	**Bashkia Sarandë**		**Përputhje në disa fusha** me standardet, por kërkohen përmirësime të domosdoshme në fushat ku janë adresuar rekomandimet.
14	**Bashkia Mallakastër**		**Përputhje në disa fusha** me standardet, por kërkohen përmirësime të domosdoshme në fushat ku janë adresuar rekomandimet.
15	**Bashkia Dibër**		**Përputhje në disa fusha** me standardet, por kërkohen përmirësime të domosdoshme në fushat ku janë adresuar rekomandimet.
16	**Bashkia Vorë**		Mospërputhje e plotë me standardet
17	**Bashkia Kamëz**		**Përputhje e plotë** me standardet
18	**OSHEE sha**		**Përputhje e plotë** me standardet
19	**Bashkia Gjirokastër**		**Përputhje në disa fusha** me standardet, por kërkohen përmirësime të domosdoshme në fushat ku janë adresuar rekomandimet.

SHTOJCA I. LISTA E NJËSIVE PËR TË CILAT NUK KA TË DHËNA PËR DISA TREGUES PERFORMANCE

Për vitin 2023, duke marrë në konsideratë natyrën e veprimtarisë së institucioneve, kompleksitetin e proceseve të punës si dhe nivelin e angazhimit të NJQP të marra në analizë, evidentohen disa mungesa në të dhënat e treguesve të performancës apo tregues të cilët nuk aplikohen në disa prej tyre, të referuar përgjatë analizës së performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.

Në tabelën më poshtë jepen të dhënat mbi njësitë dhe treguesit e performancës për të cilët mungojnë të dhënat:

Tabela 14. Lista e institucioneve për të cilat mungojnë të dhënat për treguesit e performancës të thesarit

Treguesi nr. 7 **Faturat e detyrimeve të prapambetura janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit për regjistrimin në SIFQ si shpenzime të periudhave të ardhshme (llogaria ekonomike 486)**	**Treguesi nr. 8** **Të gjitha kontratat janë dërguar në kohë pranë degës përkatëse të thesarit**	**Treguesi nr. 9** **Numri i urdhër prokurimeve të paautorizuara**
Presidenca	Ministria e Drejtësisë	Drejtoria e Përgjithshme e RTSH
Kuvendi	Drejtoria e Përgjithshme e RTSH	Komisioni i pavarur i Kualifikimit
Kryeministria	Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar	Sekretariati Teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar
Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural	Byroja Kombëtare e Hetimit	
Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	
Ministria e Arsimit dhe Sportit	Komisionerët Publikë	
Ministria e Kulturës	Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil	
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"	Agjencia e Prokurimit Publik	
Spitali Universitar i Traumës	Komiteti për Pakicat Kombëtare	
Ministria e Drejtësisë	Inspektoriati Qendror	
Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor	
Agjencia e Trajtimit të Pronave	Departamenti i Administratës Publike	

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Agjencia për Hapje, Dialog dhe Bashkëqeverisje	
Ministria e Brendshme	Agjencia e Zhvillimit të Territorit	
Garda e Republikës Tiranë	Komiteti Shtetëror i Kulteve	
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit	
Ministria e Mbrojtjes	Sekretariati Teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar	
Shërbimi Informativ Shtetëror	Agjencia Kombëtare e Rinisë	
Drejtoria e Përgjithshme e RTSH	Agjencia për Media dhe Informim	
Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile	
Akademia e Shkencës	Komisioni i Prokurimeve Publike	
Kontrolli i Lartë i Shtetit	Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit	
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit		
Këshilli i Lartë Gjyqësor		
Gjykata Kushtetuese		
Agjencia Telegrafike Shqiptare		
Këshilli i Lartë i Prokurorisë		
Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar		
Byroja Kombëtare e Hetimit		
Instituti i Statistikave		
Shkolla e Magjistraturës		
Qendra Kombëtare e Kinematografisë		
Zyra e Inspektoriati të Lartë të Drejtësisë		
Komisioni i Pavarur i Kualifikimit		
Kolegji i Posaçëm i Apelimit		
Komisionerët Publikë		
Avokati i Popullit		
Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil		
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve		
Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit		
Autoriteti i Konkurrencës		
Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit		

Agjensia e Prokurimit Publik		
Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare		
Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar		
Komiteti për Pakicat Kombëtare		
Inspektoriati Qendror		
Autoriteti Shtetëror Gjeohapsinor		
Shkolla Shqiptare e Administratës Publike		
Departamenti i Administratës Publike		
Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore		
Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike		
Agjencia për Hapje, Dialog dhe Bashkëqeverisje		
Agjencia Autonome e Auditimit të Fondeve të BE		
Autoriteti Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike		
Agjencia e Zhvillimit të Territorit		
Komiteti Shtetëror i Kulteve		
Avokatura e Shtetit		
Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit		
Sekretariati Teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar		
Agjencia Kombëtare e Rinisë		
Agjencia për Media dhe Informim		
Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës		
Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile		
Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale		
Komisioni i Prokurimeve Publike		
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi		

Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit		
Autoriteti për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet ish-sigurimit		
Qarku Gjirokastër		
Qarku Korçë		
Qarku Kukës		
Qarku Shkodër		
Qarku Tiranë		
Qarku Vlorë		
Qarku Dibër		
Qarku Fier		
Bashkia Rrogozhinë		
Bashkia Kolonjë		
Bashkia Krujë		
Bashkia Vlorë		
Bashkia Këlcyrë		
Bashkia Vorë		

ANEKS Ç

Përdorimet e Fondit Kontigjencë për vitin 2023

Nr.	Perfituesi	Kodi	VKM	EMËRTIMI	Buxheti 2023	Ekzekutuar	SIPAS ARTIKUJVE					
				KONTIGJENCA GJITHSEJ	14,980,000							
				Kontigjenca	12,550,000							
				Për mbështetjen e shtresave në nevojë	*1,430,000*							
				Për pagesën e dif pagës magjistratit	*1,000,000*		600	601	602	603	604	606
1	MF	**10**	VKM nr.114, datë 1.03.2023	"Për përdorimin e F. të Kontigjencës për kompensimin financiar të rritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për çdo të punësuar me pagë minimale, për shkak të rritjes së kesaj page në shkallë vendi" i ndryshuar	**452,000**	**452,000**				452,000		
2	MF	**10**	* VKM nr. 242 dt 20.04.2022, i shfuqizuar me VKM nr. 326, datë 31.05.2023, * VKM nr.325 datë 31.05.2023	* VKM nr. 325:" Për miratimin e strukturës së pagave , niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëvë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike". * VKM nr 326:"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike"	**583,671**	**583,671**	495,186	88,485				
3	MF	**10**	VKM nr.187, date 31.03.2023	"Për shpërblimin e pensionistëve për vitin 2023".	**3,536,735**	**3,536,735**					3,536,735	
4	P. Vendor	**00**	* VKM nr. 234, 240, 241, 242 (i shfuqizuar ndryshuar me VKM nr 326), dt 20.04.2023, * VKM nr. 328 datë 31.05.2023	*VKM nr 234: "Për pagat e punonjësve mbështetësdhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar. * VKM nr. 240:"për një ndryshim në Vendimin nr. 350 datë 19.04.2017, të KM "për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", të ndryshuar. * VKM nr 241 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 175, dt 8.03.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë, në arsimin parauniversitar", të ndryshuar	**1,143,108**	**1,143,108**					1,143,108	
5	MAS	**11**	*VKM 241, 242 (i shfuqizuar me VKM nr 326, 243 dt 20.04.2023; * VKM Nr 325, dt 31.05.2023	* VKM nr 241 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 175, dt 8.03.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë, në arsimin parauniversitar", të ndryshuar *VKM nr. 325:" Për miratimin e strukturës së pagave , niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëvë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike"	**923,399**	**923,399**	135,414	23,487			764,498	
6	MB	**16**	* VKM Nr 238 datë 20.04.2023 * VKM nr 239, datë 20.04.2023 * VKM 242 I shfuqizuar me VKM nr 326 dt 31.05.2023 * VKM nr 325, date 31.05.2023	*VKM nr 328"Për një ndryshim në Vendimin nr. 200, dt 15.03.2017 të KM "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të Policisë së Shtetit" * VKM 239 "Për një ndryshim në Vendimin nr. 688 dt 18.11.2021 të KM "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e Gardësse RSH". * VKM nr 325 " Për miratimin e strukturës së pagave , niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëvë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike".	**1,018,907**	**1,018,907**	869,067	149,840				
7	MSHMS	**13**	* VKM nr. 245 dt 20.04.2023; * Nr 325, nr 326 dt 31.05.2023	VKM nr 245:"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 555, datë 11.08.2011, të KM, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjeksor, të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në njësinë mjekësore ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të forcave të armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës".	**649,434**	**649,434**	165,988	32,488			450,958	
8	ASH	**22**	VKM nr. 302, datë 17.05.2023	"Për përcaktimin e masës së shpërblimit mujor të peërhershem për titull të anëtareve të asamblesë së akademisë së shkencave"	**15,900**	**15,900**						15,900

Nr.	Perfituesi	Kodi	VKM	EMËRTIMI	Buxheti 2023	Ekzekutuar	SIPAS ARTIKUJVE					
				KONTIGJENCA GJITHSEJ	14,980,000							
				Kontigjenca	12,550,000							
				Për mbështetjen e shtresave në nevojë	*1,430,000*							
				Për pagesën e dif pagës magjistratit	*1,000,000*		600	601	602	603	604	606
9	ASH	**22**	VKM nr. 325, 326 dt 31.05.2023	*VKM nr. 325:" Për miratimin e strukturës së pagave , niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëvë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" * VKM nr 326:"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike	**7,647**	**7,647**	6,500	1,147				
10	MPJ	**15**	VKM Nr, 325, 327 "Për rritjen e pagave punonjesve".	*VKM nr. 325:" Për miratimin e strukturës së pagave , niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëvë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" * VKM nr 327:"Për përcaktimin e kritereve për funksionet drejtuese dhe përcaktimin e klasës së pagës së diplomatëve të karriesres që punojnë në ministrinë përgjegjëse për Punët e Jashtme".	**62,642**	**62,642**	53,700	8,942				
11	Inspekt Larte I drejtesise	**63**	*VKM nr 325, 326 , Per rritjen e pagave*	*VKM nr. 325:" Për miratimin e strukturës së pagave , niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëvë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" * VKM nr 326:"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike	**27,000**	**27,000**	24,000	3,000				
12	Inspekt Larte I drejtesise (Magjistrati)	**63**	VKM 437, date 19.07.2023	"Për shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023 për disa institucione të pavarura, të krijuara me ligj".	**6,000**	**6,000**	5,200	800				
13	Komisioni I Pavarur I Kualifikimit	**63**	VKM rritjes pagave dhe VKM 437, date 19.07.2023	" Për rritjen e pagave dhe "Për shtese fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023 për disa institucione te pavarura, të krijuara me ligj"	**41,400**	**41,400**	37,820	3,580				
14	Komisioneret Publike	**63**	*VKM nr 325, 326 , Per rritjen e pagave*	*VKM nr. 325:" Për miratimin e strukturës së pagave , niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëvë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" * VKM nr 326:"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike	**7,800**	**7,800**	7,600	200				
15	Komisioneret publike	**63**	VKM 437, date 19.07.2023	"Për shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023 për disa institucione të pavarura, të krijuara me ligj".	**10,000**	**10,000**	10,000					
16	KPA	**63**	*VKM nr 325, 326, dt 31.05.2023*	*VKM nr. 325:" Për miratimin e strukturës së pagave , niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëvë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" * VKM nr 326:"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike	**23,600**	**23,600**	21,840	1,760				
17	KPA	**63**	VKM 437, date 19.07.2023	"Për shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023 për disa institucione të pavarura, të krijuara me ligj".	**15,600**	**15,600**	15,340	260				
18	Keshilli Kombëtar i Kontabilitetit	**82**	*VKM nr 325, 326, dt 31.05.2023*	*VKM nr. 325:" Për miratimin e strukturës së pagave , niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëvë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" * VKM nr 326:"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike	**2,027**	**2,027**	1,751	275				
19	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	**91**	*VKM nr 325, 326, dt 31.05.2023*	*VKM nr. 325:" Për miratimin e strukturës së pagave , niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëvë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" * VKM nr 326:"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike	**9,000**	**9,000**	8,000	1,000				
20	Prokuroria Përgjithshme	**28**	*VKM nr 325, 326, dt 31.05.2023*	*VKM nr. 325:" Për miratimin e strukturës së pagave , niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëvë të kabineteve, prefektit,	**100,000**	**100,000**	89,530	10,470				

Nr.	Perfituesi	Kodi	VKM	EMËRTIMI	Buxheti 2023	Ekzekutuar	SIPAS ARTIKUJVE					
				KONTIGJENCA GJITHSEJ	14,980,000							
				Kontigjenca	12,550,000							
				Për mbështetjen e shtresave në nevojë	*1,430,000*							
				Për pagesën e dif pagës magjistratit	*1,000,000*		600	601	602	603	604	606
				nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" * VKM nr 326:"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike								
21	Prokuroria Përgjithshme	**28**	VKM 437, date 19.07.2023	"Për shtesë fondi ne buxhetin e miratuar për vitin 2023 për disa institucione të pavarura, të krijuara me ligj	**400,000**	**400,000**	378,778	21,222				
22	MPJ	**15**	VKM nr 324, date 31.05.2023	"Për përcaktimin e pagave të punonjësve të personelit shqiptar të misioneve diplomatike të republikës së shqipërisë në shtetet e huaja, në përfaqësitë ushtarake të republikës së shqipërisë pranë nato-s, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare, si dhe të punonjësve të tjerë shqiptarë për kohën që shërbejnë si nëpunës ndërlidhës, si oficerë kontakti, si përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë dhe si prokuror ndërlidhës pranë eurojust në hagë, holandë"Për përcaktimin e pagave të punonjësve të personelit shqiptar të misioneve diplomatike"	**145,200**	**145,200**	111,000	20,000	14,200			
23	Avokati Popullit	**66**	*VKM nr 325, 326, dt 31.05.2023*	*VKM nr. 325:" Për miratimin e strukturës së pagave , niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëvë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" * VKM nr 326:"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike	**29,400**	**29,400**	27,300	2,100				
24	Avokati Popullit	**66**	VKM 437, date 19.07.2023	"Për shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023 për disa institucione të pavarura, të krijuara me ligj"	**2,000**	**2,000**	2,000					
25	DPA	**20**	*VKM nr 325, 326, dt 31.05.2023*	*VKM nr. 325:" Për miratimin e strukturës së pagave , niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëvë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" * VKM nr 326:"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike	**23,000**	**23,000**	19,300	3,700				
26	Kuvendit	**2**	*VKM nr 325, 326, dt 31.05.2023*	*VKM nr. 325:" Për miratimin e strukturës së pagave , niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëvë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" * VKM nr 326:"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike	**232,264**	**232,264**	215,000	17,264				
27	KLP	**35**	*VKM nr 325, 326, dt 31.05.2023*	*VKM nr. 325:" Për miratimin e strukturës së pagave , niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëvë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" * VKM nr 326:"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike	**14,000**	**14,000**	12,500	1,500				
28	Komiteti Shtetëror i Kulteve, Avokati Shtetit, etj.	**87**	*VKM nr 325, 326, dt 31.05.2023*	*VKM nr. 325:" Për miratimin e strukturës së pagave , niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëvë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" * VKM nr 326:"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike	**130,669**	**130,669**	119,456	11,213				
29	KLSH	**24**	*VKM nr 325, 326, dt 31.05.2023*	*VKM nr. 325:" Për miratimin e strukturës së pagave , niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëvë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" * VKM nr 326:"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike	**150,000**	**150,000**	120,000	30,000				

Nr.	Perfituesi	Kodi	VKM	E M Ë R T I M I	Buxheti 2023	Ekzekutuar	SIPAS ARTIKUJVE					
				KONTIGJENCA GJITHSEJ	14,980,000							
				Kontigjenca	12,550,000							
				Për mbështetjen e shtresave në nevojë	*1,430,000*							
				Për pagesën e dif pagës magjistratit	*1,000,000*		600	601	602	603	604	606
30	INSTAT	**50**	*VKM nr 325, 326, dt 31.05.2023*	*VKM nr. 325:" Për miratimin e strukturës së pagave , niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëvë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" * VKM nr 326:"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike	**155,302**	**155,302**	54,360	9,249	91,693			
31	KMSHC	**67**	*VKM nr 325, 326, dt 31.05.2023*	*VKM nr. 325:" Për miratimin e strukturës së pagave , niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëvë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" * VKM nr 326:"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike	**18,000**	**18,000**	16,000	2,000				
32	SHISH	**18**	VKM Nr. 324; nr 340 date 31.05.2023	* VKM 324 Për përcaktimin e pagave të punonjësve të personelit shqiptar të misioneve diplomatike të republikës së shqipërisë në shtetet e huaja, në përfaqësitë ushtarake të republikës së shqipërisë pranë nato-s, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare, si dhe të punonjësve të tjerë shqiptarë për kohën që shërbejnë si nëpunës ndërlidhës, si oficerë kontakti, si përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë dhe si prokuror ndërlidhës pranë eurojust në Hagë, Holandë". * VKM nr 340, date 31.05.2023 "Pwr klasifikimin e funksioneve dhe trajtimin me pagw tw punonjwsit nw SIISH".	**79,000**	**79,000**	64,000	15,000				
33	MTM	**26**	*VKM nr 325, 326, dt 31.05.2023*	*VKM nr. 325:" Për miratimin e strukturës së pagave , niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëvë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" * VKM nr 326:"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike	**143,793**	**143,793**	120,300	23,493				
34	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	**89**	*VKM nr 325, 326, dt 31.05.2023*	*VKM nr. 325:" Për miratimin e strukturës së pagave , niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëvë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" * VKM nr 326:"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike	**18,500**	**18,500**	16500	2000				
35	Autoriteti Konkurrencës	**77**	*VKM nr 325, 326, dt 31.05.2023*	*VKM nr. 325:" Për miratimin e strukturës së pagave , niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëvë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" * VKM nr 326:"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike	**20,700**	**20,700**	**18,400**	2300				
36	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	**57**	*VKM nr 325, 326, dt 31.05.2023*	*VKM nr. 325:" Për miratimin e strukturës së pagave , niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëvë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" * VKM nr 326:"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike	**1,965**	**1,965**	1666	299				
37	MBZHR	**05**	*VKM nr 325, 326, dt 31.05.2023*	*VKM nr. 325:" Për miratimin e strukturës së pagave , niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëvë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" * VKM nr 326:"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike	**370,110**	**370,110**	310,480	59,630				
